

اللّٰه  
رَسُول  
مُحَمَّد

Adnan Oktar  
(Harun Jahja)

# ISLAMI DËNON TERRORIZMIN





**RRETH AUTORIT:** Adnan Oktar, i cili shkruan me pseudonimin Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Që nga viti 1980, autori ka publikuar shumë libra me tema shkencore, politike dhe fetare. Ai është i njohur si autor i veprave të rëndësishme, të cilat nxjerrin në pah mashtrimin e evolucionistëve, pretendimet e tyre të pavlefshme dhe anët e errëta të darvinizmit dhe të ideologjive të tilla të përgjakshme si fashizmi dhe komunizmi.

Të gjitha veprat e autorit kanë një qëllim të vetëm: të përcjellin mesazhin e Kuranit, të inkurajojnë lexuesit për të marrë parasysh çështjet themelore që kanë të bëjnë me besimin, të tilla si ekzistenca e Allahut, uniteti dhe Bota e Përtejme; të analizojë pikëpamjet materialiste, referencat e rreme dhe ideologjitë perverse. Ai ka botuar më shumë se 300 vepra, të përkthyer në 73 gjuhë të ndryshme, të cilat lexohen në të gjithë botën.

Me vullnetin e Allahut, librat e Harun Jahjas do të jenë një mjet, nëpërmjet të cilit, njerëzit në shekullin e 21-të do të arrijnë paqen, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

Ky libër, i shkruar menjëherë pas sulmeve të 11 Shtatorit, argumenton duke u bazuar në ajetet e Kuranit, në praktikën e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të) dhe në shembujt nga historia islame, se Islami e dënon terrorizmin. Ai vë në dukje se feja këshillon për dashuri, mëshirë dhe paqe; feja e vërtetë s'mund ta tolerojë terrorizmin. Megjithatë, sulme terroriste kanë ndodhur në vende të tjera edhe pas 11 Shtatorit.

Sidomos në vitet e fundit, grupet radikaliste janë bërë edhe më të fortë, duke rekrutuar të rinj nga e gjithë bota. Kjo situatë bëri që elita politike, akademike dhe fetare të kërkonin një zgjidhje për terrorizmin, për të kuptuar shkaqet dhe për të punuar për hapat që duhen marrë. Por ata duhet të përpiqen, për të kuptuar Islamin e vërtetë dhe për të përcaktuar mënyrat për t'i dhënë fund terrorizmit brenda botës islame.

Lufta ideologjike kundër terrorizmit ka treguar se pikëpamjet e radikalistëve bazohen në bestytni që janë shtuar më vonë në Islam; këto bestytni u shërbejnë terroristëve, si justifikim për aktet dhe sulmet terroriste. Ky botim i zgjeruar i këtij libri, analizon bazat e ideologjisë së terrorizmit, të cilat rrjedhin nga ky këndvështrim racist dhe po ashtu, shtron alternativa të ndryshme se si duhet luftuar intelektualisht terrorizmi.

**GLOBAL  
PUBLISHING**





بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اللَّهُ  
رَسُولُهُ  
مُحَمَّدٌ



Botimi i parë 2004

Botimi i dytë 2017

*Titulli i origjinalit:*

ISLAM DENOUNCES TERRORISM

*Përkthimi:*

Edvin Cami

*Redaktimi letrar:*

Roald Hysa

*Korrektimi:*

Kujtim Ereqi

*Përkujdesja kompjuterike:*

Studio H. J. S.

*Botuar nga:*

GLOBAL PUBLISHING

Kayışdağı Mah. Değirmen Sok. No: 3

Ataşehir - İstanbul / Turkey

Tel: (+90 216) 6600059

*Shtypur nga:*

Acar Matbaacılık

Promosyon ve Yayıncılık San ve Tic Ltd Şti.

Litros Yolu Fatih İş Merkezi No: 280

Topkapı - İstanbul / Turkey

Tel: (+90 212) 6134041

[sq.harunyahya.com/](http://sq.harunyahya.com/) / [sq.a9.com.tr/](http://sq.a9.com.tr/en.harunyahya.tv)  
[en.harunyahya.tv](http://en.harunyahya.tv)

<http://islamdenouncesterrorism.com/>





# ISLAMI DËNON TERRORIZMIN

*Nuk ka dyshim se ata që  
besuan dhe bënë vepra të mira,  
atyre i Gjithëmëshirshmi  
do t'u dburojë dashuri.  
(Kuran, 19:96)*

**ADNAN OKTAR  
(HARUN JAHJA)**





# ISLAMI DËNON TERRORIZMIN

ADNAN OKTAR  
(HARUN JAHJA)



## Rreth autorit dhe veprave të tij

Autori, i cili tashmë shkruan nën pseudonimin HARUN JAHJA, Adanan Oktar ka lindur në Ankara në vitin 1956. Pasi mbaroi shkollën tetëvjeçare dhe të mesme në Ankara, ai studioi artet e bukura në universitetin Mimar Sinan të Stambollit, si dhe filozofi në Universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka publikuar libra të shumtë në fusha të ndryshme, si ato politike, shkencore dhe fetare. Harun Jahja njihet si autor që ka shkruar punime tepër të rëndësishme për nxjerrë në shesh mashtrimet e evolucionistëve, pavlefshmërinë e pretendimeve të tyre, si dhe anët e errëta që lidhin Darwinizmin me disa ideologji shkatërrimtare të tilla si fashizmi dhe komunizmi.

Veprat e Harun Jahjas të përkthyer në 76 gjuhë të ndryshme, janë pjesë e një koleksioni prej më shumë se 55.000 faqe dhe 40.000 ilustrime.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat "Harun" (Aron) dhe Jahja (Gjon), për të përkujtuar këta dy Profetë që luftuan kundër jobsimitarëve. Vula e Profetit, e cila gjendet në kapakun e librave të autorit përmban një kuptim simbolik që ka lidhje me përmbajtjet e tyre. Ajo përfaqëson Kuranin, i cili është libri i fundit shpallur profetit Muhamed (paqja qoftë me të) i cili është profeti i fundit. Nën udhëheqjen e Kuranit dhe Sunetit, autori ka për qëllim të hedhë poshtë të gjitha doktrinat e ideologjive anti-fetare, në mënyrë që të shuhet të gjitha kundërshtimet ndaj fesë. Ai përdor vulën e profetit të fundit, i cili posedonte urtësinë dhe moralin më të lartë, si një simbol për të përhapur mesazhin hyjnor.

Të gjitha punimet e Harun Jahjas përqendrohen rreth një qëllimi: transmetimi i mesazhit të Kuranit duke i nxitur lexuesit të mendojnë rreth temave të rëndësishme, si ekzistenca e Allahut, bashkimi, Përjetësia etj., dhe të nxjerrë në pah dëmin që sjellin ideologjitë dhe sistemet e zvetënuara.

Harun Jahja gëzon një reputacion të madh në një gamë mjaft të gjerë lexuesish që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, nga Polonia në Bosnje, nga Spanja në Brazil, nga Malajzia në Itali, nga Franca në Bullgari dhe Rusi. Disa prej librave të tij janë të disponueshëm në Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Spanjisht, Italisht, Portugalisht, Urdu, Arabisht, Shqip, Kineze, Suahilisht,





Hausa, Dhivehi (gjuhë e përdorur në Maldive), Rusisht, Boshnjakisht, Polonisht, Malajo, Turqishte e Ujgurëve, Indoneziane, Bengaleze, Daneze dhe Suedeze.

Të vlerësuar në të gjithë botën, këto punime kanë shërbyer për të ndihmuar shumë njerëz të rigjejnë besimin në Zot, apo të arrijnë një kuptim më të thellë të besimit të tyre. Stili i qartë, i lehtë dhe i rrjedhshëm i librave të tij, mund të vihen re nga kushdo që i lexon apo i shqyrton ato. Këto punime kanë pasur një ndikim të shpejtë dhe rezultate tepër të kënaqshme. Ata që i lexojnë këto libra me kujdes dhe mendojnë rreth tyre seriozisht, do të heqin dorë nga ateizmi, nga ideologjitë e zvetënuara apo filozofitë materialiste, sepse këta libra japin rezultate të menjëhershme. Edhe nëse ata vazhdojnë në mohim, kjo tregon se ata bazohen në sentimentalizmin e tyre, pasi këto libra i hedhin poshtë këto ideologji që nga themelet. Sot është bërë e mundur që të gjitha lëvizjet bashkëkohore jobsimtare të pësojnë një disfatë ideologjike, në saj të koleksionit të librave të shkruar nga Harun Jahja.

S'ka dyshim se këto veçori e kanë origjinën nga urtësia dhe udhëzimi i Kuranit. Autori në mënyrë modeste synon që të jetë një ndihmë për njerëzit për të gjetur rrugën e drejtë të Zotit. Për më tepër, ai nuk merr asnjë përfitim material nga librat e tij.

Duke pasur parasysh këto fakte, ata që inkurajojnë njerëzit që të lexojnë këto libra, që të hapin mendjet dhe zemrat duke i udhëzuar të tjerët të bëhen adhurues të devotshëm të Zotit, bëjnë një shërbim të paçmueshëm.

Nga ana tjetër, do të ishte humbje kohe dhe energjie përhapja e atyre librave që krijojnë konfuzion në mendjet e njerëzve dhe nuk kanë ndonjë ndikim të efektshëm në largimin e dyshimeve dhe dilemave nga zemrat e tyre, siç e ka vërtetuar dhe eksperiencia shumëvjeçare. Është më se natyrshme që libra të tillë që janë shkruar më tepër për të theksuar forcën letrare të autorit të tyre, sesa për të fituar kënaqësinë e Allahut, nuk mund të kenë kurrë një efekt pozitiv. Ata që dyshojnë në këtë, mund të shohin se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjas është triumfi ndaj mosbesimit dhe përhapja e vlerave morale të Kuranit.

Nuk duhet të harrojmë një pikë shumë të rëndësishme: Shkaku kryesor i problemeve dhe konflikteve me të cilat përballen njerëzit sot është ndikimi ideologjik i mosbesimit. Të gjitha këto do të marrin fund kur të arrihet disfata ideologjike e mosbesimit, duke u bërë të qarta njerëzve mrekullitë e krijimit dhe moralin kuranor, në mënyrë që të gjithë të jetojnë me frymën e tyre. Duke marrë në konsideratë gjendjen e botës sot, e cila i çon njerëzit në një humnerë të thellë dhune, korrupsioni dhe konfliktesh, është e qartë që ky shërbim duhet të jetë i diponueshëm sa më shpejt dhe sa më efektivisht që të jetë e mundur, ose përndryshe, mund të jetë shumë vonë.

Ne shpresojmë që me Vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahjas do të luajnë këtë rol tepër të rëndësishëm në shekullin 21 dhe do të ndihmojnë njerëzit të fitojnë paqen, bekimin, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

## Per lexuesin

- Një kapitull i veçantë i kushtohet rrënimin të teorisë së evolucionit, sepse kjo teori është themeli i të gjitha filozofive antifetare. Gjatë 150 viteve të fundit, Darwinizmi, i cili mohon faktin e krijimit e, si rrjedhojë, edhe vetë ekzistencën e Allahut, ka bërë që shumë njerëz të largohen nga besimi i tyre dhe të bien në kthetrat e dyshimit. Ndaj, duke provuar se kjo teori nuk është gjë tjetër veç një mashtrim, ne kryejmë një detyrë shumë të rëndësishme që është e lidhur ngushtë me fenë. S'ka dyshim, se ky është një shërbim i rëndësishëm që duhet t'u ofrohet të gjithëve.
- Një pikë që duhet theksuar ka të bëjë me përmbajtjen e librit. Në të gjithë librat e autorit, temat që kanë lidhje me besimin trajtohen në dritën e ajeteve kuranore dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë bashkë me to. Të gjitha temat që kanë lidhje me ajetet kuranore janë shpjeguar në mënyrë të atillë që të mos lënë asnjë shteg për dyshime apo dilema në mendjen e lexuesit. Stili i qartë, i lehtë e i rrjedhshëm mundëson çdo njeri të çfarëdo moshe apo grupi social që të kuptojë me lehtësi librat. Kjo gjë i bën ata shumë tërheqës për t'u lexuar njëherësh, pa e ndërprerë leximin. Edhe ata persona që e mohojnë anën shpirtërore ndikohen pozitivisht nga faktet e përmendura në këto libra dhe nuk mund ta hedhin poshtë vërtetësinë e tyre.
- Ky libër, ashtu si dhe të gjithë librat e tjerë të autorit, mund të lexohet individualisht ose në grupe. Leximi i librit në grup është shumë i dobishëm dhe i rëndësishëm, pasi çdo lexues mund t'i përcjellë tjetrit mendimet dhe eksperiencën e tij.
- Këta libra janë shkruar vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, ndaj dhe kontributi i çdokujt për leximin dhe prezantimin e tyre do të ishte një shërbim i madh për fenë e Allahut. Ndaj, ata që duan t'ua transmetojnë fenë të tjerëve, do të gjejnë një mjet tepër efikas në librat e Harun Jahjas.
- Në këto libra ju nuk do të gjeni shpjegime që bazohen në burime të dyshimta, apo stil shkrimi që bie ndesh me respektin dhe nderimin që duhet të tregojmë për gjërat e shenjta, apo ide të pabaza që fusin dyshim dhe shkaktajnë devijim në zemër.







# Përmbajtja

PARATHËNIA NË KËTË BOTIM TË RI.....	10
HYRJE .....	13
MORALI ISLAM: BURIMI I PAQES DHE I SIGURISË .....	19
PIKËPAMJET KURANORE TË SHERIATIT, XHIHADIT DHE LUFTËS .....	43
GABIMET E RADIKALISTËVE DHE E VËRTETA.....	105
FYTYRA E VËRTETË E TERRORISTËVE QË VEPROJNË NË EMËR TË FESË.....	163
KËNDVËSHTRIMI I ISLAMIT MBI ITHTARËT E LIBRIT.....	189
ISLAMI KA SJELLË PAQE DHE HARMONI NË LINDJEN E MESME.....	223
RRËNJËT E TERRORIZMIT: DARVINIZMI DHE MATERIALIZMI.....	235
PËRFUNDIM: REKOMANDIME PËR BOTËN PERËNDIMORE DHE PËR MYSLIMANËT ...	275
SHTOJCË: MASHTRIMI I EVOLUCIONIT .....	280

## PARATHËNIE NË KËTË BOTIM TË RI

Ky libër është shkruar mbas sulmeve të 11 Shtatorit të vitit 2001, të cilat ndodhën në dy qytete të mëdha në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nëpërmjet citimeve të vargjeve nga Kurani, të traditës së profetit Muhamed (paqja qoftë me të) dhe shembujve nga historia e Islamit, në atë botim u bëhej e qartë lexuesve se feja Islame e dënon terrorizmin. Por sulme terroriste ndodhën edhe pas 11 Shtatorit, në disa vende të tjera si psh, në Britaninë e Madhe, Spanjë, Turqi dhe Francë. Kjo gjë nxiti politikanët, akademikët, udhëheqësit shpirtërorë të feve dhe shkrimtarët në të gjithë botën, po ashtu edhe mjaft njerëz nga e gjithë bota, për të gjetur zgjidhjen për terrorizmin, për të kuptuar çfarë e shkakton atë dhe cilët do të ishin hapat e duhur që duheshin marrë.

Kur ky libër u shkrua në fillim, në vitin 2002, ne shpjeguam me fakte se terroristët apo prijësit e tyre janë egoistë, mizorë dhe të pamëshirshëm






dhe këta individë të ushqyer me dogmat materialiste dhe darviniste e shohin jetën si një betejë ku vetëm më të fortët mbijetojnë. Të tillë njerëz besojnë se dhuna dhe luftërat janë mjete të justifikuara për qëllimet e tyre. Al Kaida ishte mjaft aktive në atë kohë. Por përveç kësaj, gjatë viteve të fundit u shfaqën edhe organizata të tjera terroriste dhe ato kanë përdorur simbole të ngjashme me ato të Islamit, në sulmet e tyre të kryera ndaj civilëve.

Këto grupime po bëhen më të forta, duke rekrutuar anëtarë të rinj nga e gjithë bota. Kjo e ka shtyrë elitën politike, akademike dhe fetare, të përpiqen për të kuptuar Islamin e vërtetë dhe të gjejnë rrugët për t'i dhënë

**Nëse dikush është në kërkim, për shkak të kryerjes së një akti terrorist, burimin e atij akti duhet ta kërkoni në ideologjitë jofetare. Feja thërret në rrugën e dashurisë, dhembshurisë, faljes, paqes dhe jetës sipas standardeve të larta morale. Terrorizmi, nga ana tjetër, thërret në rrugën e mizorisë dhe dhunës, duke shkaktuar dhimbje, gjakderdhje dhe vrasje.**



fund terrorizmit në vendet islame. Pas sulmeve të Charlie Hebdo-s, të cilat ndodhën në kryeqytetin e Francës, dolën në pah edhe njëherë interpretimet radikale, të cilat bazohen në bestytni dhe të cilat nuk kanë lidhje me fenë islame. Bestytnitë u përdorën nga terroristët, për të justifikuar aktet e tyre terroriste.

Këto akte janë në kundërshtim me fenë Islame, e cila është një fe që promovon paqen e jo luftën, jetën e jo vdekjen, faljen e jo ndëshkimin, pajtimin e jo konfliktin. Myslimanët e vërtetë nuk promovojnë dhunën ndaj ithtarëve të feve të tjera, as ndaj myslimanëve të cilët mendojnë ndryshe. Pa dyshim, ky mentalitet radikal është problemi më i madh me të cilën përballet bota e sotme.

Në këtë botim të zgjeruar të këtij libri, ne kemi përmendur disa nga burimet e terrorizmit, të cilat i kanë rrënjët në fanatizmin fetar dhe po ashtu përpjekjet intelektuale që duhen ndërmarrë. Shpresojmë që ky libër të ndihmojë ata të cilët e shohin zgjidhjen vetëm tek përdorimi i forcës. Në fakt ata duhet të kuptojnë se interpretimet e gabuara fetare dhe filozofike, nuk mund të zgjidhen më anë të luftës, ndaj paratë e shpenzuara për armë, do të duhej të investoheshin në arsimim dhe për të forcuar bashkëpunimin me të gjithë faktorët, sidomos me myslimanët bamirës dhe të dashur.



# HYRJE

*Allahu urdhëron drejtësi,  
bamirësi, ndihmë të afërmve,  
e ndalon nga imoraliteti,  
e neveritura dhe dhuna.  
Ju këshillon që të merrni  
mësim. (Kuran 16:90)*

Si myslimanë, ne dënojmë fuqishëm të gjitha aktet terroriste në të gjithë botën, e sidomos në të dy qytetet kryesore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës më 11 shtator 2001, të cilat shkaktuan vdekjen e mijëra njerëzve të pafajshëm. Këto sulme sollën në qendër të vëmendjes një çështje të rëndësishme, debatin rreth burimit të vërtetë të terrorizmit.

Shumë udhëheqës të botës, organizata të mëdha të mjeteve të informimit publik e stacione radio-televizive thanë se Islami e ndalon dhunën dhe nxit paqen mes njerëzve e kombeve. Qarqet perëndimore që kishin arritur ta kuptonin mirë Fenë Islame dhe që ishin të mirëinformuar për Islamin burimor u shprehën qartë se fjalët "Islam" dhe "terror", nuk




mund të qëndrojnë pranë njëra-tjetrës dhe se asnjë fe hyjnore nuk e lejon dhunën.

Ky libër pohon se burimi i terrorit të dënuar nga të gjithë ne, është në mënyrë të prerë jashtë çdo feje hyjnore dhe nuk ka asnjë hapësirë për terrorizëm në Islam. Kjo është bërë e qartë në Kuran, i cili është burimi kryesor i Islamit, si dhe në praktikat e të gjithë udhëheqësve të vërtetë myslimanë, ndër të cilët i pari ishte Profeti Muhamed. Ky libër, shfaq në dritën e vargjeve të Kuranit, si dhe me shembuj nga historia, se Islami e ndalon terrorizmin dhe synon të sjellë paqe dhe siguri në botë.

Siç dihet, për shekuj me radhë, akte të ndryshme terrorizmi janë kryer në vende të shumta të botës nga grupe të ndryshme për qëllime të ndryshme. Përgjegjësinë për akte të tilla e kanë marrë përsipër organizatat komuniste, disa herë të tjera grupet fashiste, e nganjëherë edhe fraksionet radikaliste e separatiste. Amerika, ka qenë disa herë objekt i sulmeve prej grupeve raciste dhe ekstremiste, kurse vendet kryesore të Evropës janë shndërruar në qendra të veprimtarive të dhunshme, të kryera nga grupet terroriste. "17 Nëntori" në Greqi, RAF (Fraksioni i Ushtrisë së Kuqe) dhe neonazistët në Gjermani, ETA në Spanjë, IRA në Irlandë, Brigadat e Kuqe në Itali dhe shumë organizata të tjera kërkojnë që të dëgjohen zërat e tyre përmes terrorit dhe dhunës, duke vrarë njerëz të pafajshëm e të pambrojtur. Natyra e terrorizmit ndryshon me ndryshimin e kushteve dhe e rrit ndikimin dhe forcën e saj me mjetet e reja, të siguruar nga teknologjia e zhvilluar. Veçanërisht mjetet e komunikimit masiv, si interneti, e kanë rritur në mënyrë të ndjeshme rrezën dhe ndikimin e veprimtarive terroriste.

Përveç organizatave perëndimore, ekzistojnë gjithashtu edhe



Për shekuj me radhë, akte të ndryshme të terrorizmit janë kryer në pjesë të ndryshme të botës nga grupe të ndryshme, për qëllime të ndryshme. Përgjegjësinë për akte të tilla e kanë marrë përsipër organizatat komuniste, disa herë të tjera grupet fashiste, e nganjëherë edhe fraksionet radikaliste e separatiste. 17 Nëntori në Greqi, RAF dhe neonazistët në Gjermani, ETA në Spanjë, Brigadat e Kuqe në Itali dhe shumë organizata të tjera, përmes terrorit dhe dhunës, kanë vrarë njerëz të pafajshëm dhe të pambrojtur. Gjatë 30 viteve të fundit, PKK-ja ka kryer në Turqi sulme terroriste që rezultuan në martirizimin e dhjetëra mijëra njerëzve.

organizata terroriste me origjinë në Lindjen e Mesme. Këto organizata njihen si përgjegjëse për kryerjen e një numri sulmesh terroriste në të gjitha anët e botës. Fatkeqësisht, fakti se autorët e akteve të ndryshme terroriste i përkasin identiteteve të krishtera, myslimane apo çifute bëhet shkak që disa njerëz të hedhin pretendime që nuk pajtohen me fetë hyjnore. E vërteta është se, edhe nëse terroristët i përkasin identitetit mysliman, terrori i ushtruar prej tyre nuk mund të etiketohet si "terror islamik", ashtu sikurse nuk mund të quhet "terror çifut" nëse ushtruesit e tij janë çifutë, apo "terror i krishterë" nëse autorët janë të krishterë, për arsye se siç do të nxirret në dukje në faqet që vijojnë, **vrasja e njerëzve të pafajshëm në emër të një feje hyjnore është e papranueshme**. Nuk duhet harruar se mes viktimave që humbën jetën në Nju Jork e Uashington, kishte njerëz që e besojnë Jezusin (të krishterë), Moisiun (çifutë) dhe Profetin Muhamed (myslimanë). Vrasja e njerëzve të pafajshëm është një mëkat i madh. Asnjë njeri që beson dhe i trembet dënimit të Zotit nuk duhet ta bëjë kurrë diçka të tillë.

**Kur ushtrohet një dhunë e tillë, mund të dëmtohet vetë feja.** Ata që ushtrojnë një dhunë të tillë japin një paraqitje negative të fesë në sytë e njerëzve, gjë që mund të shkaktojë largimin e njerëzve nga feja dhe të nxisë urrejtjen ndaj atyre që i janë përkushtuar besimit. Për pasojë, çdo sulm me fasadë fetare i kryer ndaj qytetarëve amerikanë apo ndaj njerëzve të tjerë të pafajshëm, bëhet shkak për dëmtimin e fesë.

Feja urdhëron për dashuri, mëshirë dhe paqe. Terrori, nga ana tjetër, është e kundërta e fesë; është mizor, i pamëshirshëm dhe kërkon gjakderdhje e mjerim. Në këtë mënyrë, zanafilla e një akti terrorist nuk duhet kërkuar te besimi, por te mosbesimi. Njerëzit me botëkuptim fashist,



komunist, racist apo materialist për jetën, duhet të vihen në dyshim e të shihen si ushtrues potencialë të terrorizmit. **Terrori** (dmth, vrasja e njerëzve të pafajshëm) **në Islam është një mëkat i madh dhe myslimanët janë të ngarkuar me përgjegjësinë për t'i parandaluar këto akte dhe për të sjellë paqe e drejtësi në botë.**

Hani dhe pini nga  
begatitë e Allahut e mos bëni  
çrregullime në tokë.  
(Kuran 2:60)



# MORALI ISLAM: BURIMI I PAQES DHE I SIGURISË

Një pjesë e atyre që pretendojnë se bëjnë diçka në emër të fesë, në të vërtetë mund ta kenë keqkuptuar atë fe dhe për pasojë ta kenë zbatuar atë në mënyrë të gabuar. Për këtë arsye, do të ishte e pasaktë që të krijohen ide rreth fesë, duke marrë si shembull veprat e këtyre njerëzve. Mënyra më e mirë për ta kuptuar një fe, është studimi i burimit të saj hyjnor.

Burimi hyjnor i Islamit është Kurani që mbështet konceptet e moralit, dashurisë, mëshirës, përkushtimit, sakrificës, tolerancës dhe paqes. Një mysliman që i zbaton siç duhet këto parime në jetën e tij, është një njeri i sjellshëm, i thjeshtë, i drejtë, i besueshëm dhe me të cilin është e lehtë të krijohen marrëdhënie të mira. Ai përhap dashuri, respekt, harmoni dhe kënaqësi te të gjithë ata që jetojnë pranë tij. Por pavarësisht nga ky fakt, në vitet e fundit, fjalët Kuran dhe Islam po shoqërohen me fjalën "frikë",




duke bërë të mundur që islamofobia të përhapet më gjerë. Por shkak i vërtetë i frikës në zemrat e njerëzve nuk është feja islame, por fanatizmi fetar. Jo vetëm radikalistët që veprojnë në emër të islamit, por edhe islamofobët që frikësohen nga radikalizmi, në fakt po bëjnë të njëjtin gabim. Të dy grupimet nuk po arrijnë të kuptojnë se Islami nuk ka të bëjë me fanatizmin. Fanatizmi është një sistem i tmerrshëm, i urreyer dhe i privuar nga dashuria. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të kuptojmë mesazhin e vërtetë të Islamit, sipas shpalljes së Kuranit dhe të nxjerrim në pah rrugën e gabuar të disa njerëzve, të cilët përpiqen t'i mveshin kësaj feje terrorizmin.

### **A mjafton të themi se Islami është fe e paqes?**

Islami është fe e dashurisë, por ekzistojnë disa referenca të pabaza, të cilat urdhërojnë t'u marrin jetën atyre që nuk përmbushin ritet e faljes, që nuk agjërojnë dhe që shkurtojnë mjekrën. Këto pretendime janë në të njëjtën kohë si kontraditore me vlerat e Islamit, po ashtu dhe një rrezik i madh për shoqërinë. Ata që mbajnë ligjërata për rëndësinë që Islami u kushton grave, nuk do ta ndryshojnë gjendjen, nëse ata nuk përpiqen të largojnë keqkuptimet ndaj disa haditheve të tilla si: "Gratë janë të mangëta", "bëj të kundërtën e asaj që të thotë gruaja" apo "në ferr do të ketë më së shumti gra". Kjo nuk do të jetë e mjaftueshme për të thënë se "myslimanët janë njerëz të dashur" ose "Islami është feja e paqes", pa i dhënë fund retorikës së urrejtjes dhe dhunës, që të tjerët i kanë mveshur Islamit gjatë shekujve dhe që bie në kundërshtim me Kuranin.

Sipas Kuranit myslimanët janë njerëz të dashur dhe të mëshirshëm dhe askush nuk ka kurrfarë të drejte t'u imponojë fenë njerëzve të tjerë; por problemi është se disa myslimanë sot nuk ndjekin mësimet e Kuranit, por traditat dhe bestytnitë e tyre fisnore, lokale apo krahinore. Prandaj, nëse të gjitha këto bestytni nuk eliminohen plotësisht dhe nëse myslimanët



Nuk mjafton thënia se "myslimanët janë njerëz të dashur" ose "Islami është fe e paqes", nëse nuk i japim fund retorikës së egër dhe urrejtjes.

nuk i kthehen tërësisht mësimëve të Kuranit, do të ishte e pamundur për t'i parandaluar ata njerëz të dhunshëm, që veprojnë në emër të Islamit, apo për të ndaluar islamofobinë.

Fanatikët ekstremistë portretizojnë si pjesë të Islamit, ide të tilla se, myslimanët nuk duhet të studiojnë shkencë, teknologji dhe arte. Për pasojë, mjaft vende islame në ditët e sotme gjenden të shtypur dhe në injorancë. E vetmja mënyrë për të shuar ndikimin e këtyre ekstremistëve, do të ishte rruga e edukimit. Arsimimi modern përëndimor është padyshim i detyrueshëm. Por megjithatë, numri i njerëzve të arsimuar në Perëndim, të cilët marrin

pjesë në akte terroriste, si në Lindje ashtu edhe në Afrikë, është një fenomen që duhet të na shqetësojë. Prandaj pyetja që kërkon një përgjigje është:

Si është e mundur që në disa akte terroriste, përfshihen edhe njerëz të arsimuar?

Kur vëzhgojmë me kujdes, ne kuptojmë se thelbi i problemit është tek mësimet të cilat legjitimojnë dhunën dhe që hasen gjerësisht, si në Perëndim, ashtu edhe në botën islame. Gjithkush është në dijeni të aspektit negativ që ka botëkuptimi darvinist, i cili është pjesë e edukimit të shoqërive perëndimore. Por ne do të flasim për këtë, më në hollësi, në kapitujt e ardhshëm. Megjithatë, ajo që duhet të shpjegohet në fillim është se, aprovimi i dhunës që ekziston në disa tekste, të grupimeve shia apo suni, është injoruar jo në pak raste dhe shumë të rinj po ndikohen nga këto botime, qysh në hapat e para të fesë. Nëse një brez është plotësisht i pavetëdijshëm rreth përmbajtjes dhe kontekstit të Kuranit dhe i formëson opinionet e tij duke u ndikuar nga metodologjitë radikaliste, atëherë ky brez është i prirur të jenë kontigjent i dhunës. Për këtë arsye, shkaku i terrorizmit nuk është feja hyjnore, por përzierja e ideologjisë darviniste me pikëpamjet fanatike dhe radikale. Zgjidhja e vetme për terrorizmin është përhapja e Islamit të vërtetë, sipas mësimeve të Kuranit, duke mos u ndikuar nga fanatizmi.

### Islami është feja e paqes

Terrorizmi, në kuptimin e tij më të gjerë, është dhunë me qëllime politike e ushtruar kundër objektivave joushtarake. E thënë ndryshe, shenjstra e terrorit janë në tërësi civilët, i vetmi krim i të cilëve është që ata në sytë e terroristëve, përfaqësojnë "krahun tjetër".

Për këtë arsye, terrorizmi kërkon që njerëzit e pafajshëm t'i nënshtrohen dhunës dhe kjo përbën një akt të zhveshur prej çdo justifikimi moral. Aktet terroriste, të cilat nuk dallojnë shumë nga vrasjet e kryera nga Stalini dhe Hitleri, s'janë gjë tjetër veçse krime kundër njerëzimit.



Kurani është një Libër i shpallur për njerëzit si një udhëzues në rrugën e vërtetë. Në këtë libër, Zoti urdhëron njeriun që të përvetësojë sjellje e moral të mirë. Ky moral është i mbështetur në dashuri, dhembshuri, tolerancë dhe mëshirë. Fjala "Islam", rrjedh nga një fjalë arabe me rrënjë të njëjtë me fjalën "paqe". Islami është një fe që i është shpallur njerëzimit me qëllimin e dhurimit të një jete paqësore, nëpërmjet së cilës të pasqyrohet në tokë, mëshira dhe bamirësia e pafund e Zotit. Zoti i fton të gjithë njerëzit në moralin islam, nëpërmjet të cilit mëshira, bamirësia, paqja dhe toleranca mund të bëhen pjesë e jetës në të gjithë botën. Në suren "Bekare", vargu 208, Zoti u drejtohet besimtarëve si vijon:

**"O ju që besuat, hyni tërësisht në Islam (paqe)! Mos ndiqni gjurmët e djallit! Ai është, pa dyshim, armiku juaj i hapur."**

**Një shoqëri, në të cilën respektohen vlerat morale islame, karakterizohet nga paqja, falja, dashuria, dhembshuria, nga mbështetja e ndërsjellë dhe gëzimi.**



Sikurse bëhet e qartë në këtë varg, siguria mund të vendoset vetëm përmes "hyrjes në Islam", d.m.th. përmes të jetuarit me vlerat e Kuranit. Vlerat e Kuranit i bëjnë myslimanët të përgjegjshëm për t'i trajtuar të gjithë njerëzit, myslimanë apo jo, me mirësjellje e drejtësi, për të mbrojtur nevojtarët dhe të pafajshmit dhe **"për të parandaluar përhapjen e mizorisë"**. Mizoria përfshin të gjitha format e anarkisë dhe terrorit që godasin sigurinë, qetësinë dhe paqen, sikurse thuhet në vargun kuranor, **"Zoti nuk e do çrregullimin"**. (Kuran, 2:205)

Vrasja e një njeriu pa të drejtë është një nga shembujt më të dukshëm të mizorisë. Zoti përsërit në Kuran një urdhëresë që Ai më parë ua kishte shpallur Hebrejve në Teurat:

**"...nëse dikush vret një njeri, që nuk ka vrarë askënd apo nuk ka bërë ndonjë çrregullim në tokë, është njëlloj sikur ka vrarë mbarë**

**Terroristët synojnë të krijojnë një botë ku dominon dhuna, konflikti, kaosi dhe frika.**



**njerëzimin. Nëse dikush i shpëton jetën një njeriu, është sikur t'i ketë dhuruar jetë mbarë njerëzimit..." (Kuran, 5:32)**

Sikurse thotë vargu, dikush që vret një njeri të vetëm, ndërkohë që ky i fundit nuk ka vrarë e dëmtuar askënd, kryen një krim që është i njëjlojtë me vrasjen e të gjithë njerëzimit.

Në këto kushte, është mëse e dukshme se ç'mëkate të mëdha janë vrasjet dhe masakrat e njerëzve të pafajshëm. Zoti na bën të ditur në vargun e mëposhtëm kuranor se si do të dënohet kjo natyrë mizore e terrorizmit në jetën e ardhshme:

**"... ata që sillen mizorisht me njerëzit dhe i tejkalojnë kufijtë pa të drejtë. Njerëz të tillë do të vuajnë një dënim të dhimbshëm." (Kuran, 42:42)**

Organizimi i akteve të terrorit kundër njerëzve të pafajshëm është në kundërshtim të plotë me Islamin dhe asnjë mysliman nuk duhet të kryejë kurrë krime të tilla. Përkundrazi, myslimanët kanë përgjegjësi për pengimin e këtyre njerëzve, duke ndalur "mizorinë në tokë" dhe duke sjellë paqe e siguri për të gjithë njerëzit e botës. Islami jo vetëm që nuk mund të pajtohet kurrësesi me terrorin, por ai duhet të shihet si zgjidhja dhe rruga për parandalimin e terrorit..

Ky është themeli i Islamit; shpirti i Islamit është paqja. Por, fanatikët, të cilët e praktikojnë Islamin si bestytini dhe jo sipas mësimëve të Kuranit, besojnë si të vërtetë, të kundërtën e kësaj.

Problemi me fanatikët është se ata i konsiderojnë bestytininë e mësuara si pjesë të besimit të tyre. Por edhe ata që i kritikojnë këta fanatikë, janë nganjëherë po aq radikalë kur besojnë në saktësinë e këtyre bestytynive. Kur këta fanatikë i mbështesin idetë e tyre edhe me dëshmi nga Kurani, numri i tyre rritet. Këtu ata gabojnë rëndë. Nëse njerëzit duan të mësojnë Islamin e vërtetë dhe të gjejnë një zgjidhje për fanatizmin, ata duhet t'i kthehen besimit të vërtetë të shpallur në Kuran.



Përsa kohë nuk ka një dallim të qartë midis fanatizmit dhe Islamit të vërtetë, radikalizmi dhe islamofobia do të vazhdojnë të pllakosin botën.

Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme të promovohen vlerat fisnike të Kuranit, me fjalë të tjera, të predikohet Islami i vërtetë në mbarë botën dhe të bëhet i qartë dallimi ndërmjet fanatizmit dhe Islamit. Duhet ditur se Zoti e ndalon korrupsionin dhe inkurajon virtytin, dhe se liria e mendimit gjendet e mishëruar në Kuran.

### Zoti e dënon ligësinë

Zoti u ka urdhëruar njerëzve që t'i largohen çdo të keqeje. Shtypja, mizoria, vrasja dhe gjakderdhja janë të gjitha të ndaluara. Në disa nga vargjet e shumta kuranore mbi këtë çështje lexojmë:

Në suren el-Maide, ajeti 32, Zoti thotë se në qoftë se dikush vret dikë pa të drejtë, ai është sikur të kishte vvarë gjithë njerëzimin. Vrasja është krejtësisht në kundërshtim me mësimet morale të Kuranit.



**"Hani e pini nga begatitë që ju ka dhënë Zoti dhe mos përhapni çrregullim dhe prishje në tokë!" (Kuran, 2:60)**

**"Mos përhapni çrregullim në tokë, pasi ajo të jetë bërë e begatë dhe drejtוני Atij me frikë e dëshirë! Mëshira e Zotit është pranë atyre që kryejnë vepra të mira." (Kuran, 7:56)**

Ata që mendojnë se do të kenë sukses, duke shkaktuar shtypje, duke përhapur ligësi e përmbysje të mëdha dhe duke vrarë njerëz, bëjnë një gabim shumë të rëndë. Zoti i ka ndaluar të gjitha aktet e ligësisë, përfshirë terrorizmin dhe dhunën, i ka dënuar ata që përfshihen në veprime të tilla.

Megjithatë, në kohën e sotme aktet e terrorizmit, gjenocidit dhe masakrave ndodhin kudo në botë. Njerëz të pafajshëm vriten barbarisht



dhe vendet ku nxitet urrejtja mes grupimeve të ndryshme shoqërore për arsye tërësisht artificiale, zhyten në gjakderdhje. Këto tmerre në vendet me histori, kultura e struktura shoqërore të ndryshme, mund të kenë shkaqe dhe burime nga më të çuditshmet. Sidoqoftë, është e dukshme se shkakut themelor është largimi nga mësimet e Kuranit. Si pasojë e mungesës së fesë, lindin grupime shoqërore që nuk njohin dashurinë dhe frikën ndaj Zotit dhe që besojnë se nuk do të japin ndonjëherë llogari për veprat e veta. Përderisa besojnë se nuk kanë kujt t'i japin llogari për asgjë, ata e kanë të lehtë të priren për të vepruar pa mëshirë, moral dhe ndërgjegje.

Ekzistenca e hipokritëve që shfaqen në shoqëri në emër të Zotit dhe të fesë, por që në të vërtetë, organizohen për të kryer ligësi, dënohet nga Zoti siç tregohet në Kuran.

Në Kuran përmenden disa njerëz jobesimtarë, të cilët betohen në emër të Zotit për të përforcuar veprat e tyre, mirëpo kjo nuk do të thotë se Zoti i miraton veprat e tyre. Në të njëjtën mënyrë, edhe disa myslimanë mund të pretendojnë se gjithçka që ata bëjnë është në përputhje me fenë, mirëpo ka mundësi që ajo ç'ka bëjnë të jetë tërësisht në kundërshtim me Vullnetin e Zotit dhe moralin e fesë. E vërteta e çështjes duhet parë në veprat e tyre. Nëse këto vepra synojnë të "shkaktojnë çrregullim dhe të mos vendosin drejtësinë", sikurse shpallet në Kuran, atëherë duhet të jemi të sigurtë se njerëz të tillë nuk mund të jenë kurrë besimtarë të vërtetë dhe qëllimi i tyre nuk është shërbimi i fesë.

Për dikë që i druhet Zotit dhe që ka kuptuar moralin e Islamit, është e pamundur të mbështesë dhunën apo ligësinë, apo të marrë pjesë në veprime që lidhen me to. Për këtë arsye, Islami është zgjidhja e vërtetë për problemin e terrorizmit. Kur bëhet i qartë morali sublim i Kuranit, është e pamundur për njerëzit që ta lidhin Islamin e vërtetë me ata që mbështesin apo bashkohen me grupet që synojnë padrejtësisht luftë dhe kaos. Zoti në Kuran është shprehur qartë për ndalimin e ligësisë:



**"Kur kthen krahët, nxiton të shkaktojë çrregullim mbi dhé, të rrënojë të mbjellat dhe gjënë e gjallë. Por Allahu nuk e do çrregullimin." (Kuran, 2:205)**

Pra, është jashtë çdo mundësie që dikush që i beson me të vërtetë Zotit, të mund të bëjë një sy qorr qoftë edhe përballë një veprimi që mund t'i shkaktojë dëmin më të vogël njerëzimit. Kurse dikush që nuk beson në Zotin dhe në jetën e pasosur, mund të kryejë lehtësisht çdo lloj të keqeje, përderisa mendon se nuk do t'i duhet t'i japë llogari askujt për veprat e veta.

Për të shpëtuar botën nga murtaja e terrorizmit dhe për t'i fshirë të gjitha ato fanatizma apo bestytini, që deri tani janë shitur në emër të fesë, por që në të vërtetë, nuk kanë të bëjnë aspak me fenë, hapi i parë që duhet bërë është edukimi. Njerëzit duhet të edukohen me moralin e vërtetë kuranor, me dashurinë dhe me respektin ndaj Zotit.

### **Islami inkurajon drejtësinë, mirësinë dhe çdo gjë të bukur**

Një tipar i terroristëve është dështimi për të vlerësuar të ndryshmen tek të tjerët si vlerë dhe pasuri. Sot kudo në botë, disa njerëz trajtohen padrejtësisht dhe pa mëshirë, vetëm për shkak të ngjyrës së lëkurës së tyre, ose për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Megjithatë, Zoti i urdhëron njerëzit në Kuran t'i trajtojnë të tjerët në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjuhës, besimit, racës apo përkatësisë etnike.

Zoti na bën të ditur në Kuran se qëllimi në krijimin e fiseve e popujve të ndryshëm, është **"që ata ta njohin njëri-tjetrin"**. Kombet dhe popujt e ndryshëm duhet ta njohin njëri-tjetrin; kjo do të thotë, të mësojnë për kulturat e tyre të ndryshme, për gjuhët, traditat e veçoritë. Shkurt, njëri nga qëllimet e krijimit të racave e kombeve të ndryshëm, nuk është konflikti dhe lufta por pasuria kulturore. Një shumëllojshmëri e tillë është shprehje e bujarisë së Zotit në krijim. Fakti se dikush është më i gjatë se dikush tjetër

apo se lëkura e tij është e bardhë apo e verdhë, nuk i siguron atij asnjë epërsi ndaj të tjerëve, ashtu sikurse nuk përbën edhe ndonjë arsye për t'u ndjerë i turpëruar. Çdo trajtë që gjendet në pamjen e jashtme të një njeriu, është një vepër e qëllimshme e Zotit, por për Zotin ndryshimet nuk kanë rëndësi përfundimtare. Një besimtar e di se ai arrin të sigurojë epërsi vetëm në sajë të frikës ndaj Zotit dhe forcës së besimit të tij tek Ai. Ky fakt përmendet në vargun e mëposhtëm kuranor:

**"O njerëz! Ne ju krijuam prej një mashkulli e një femre dhe ju shndërruam në popuj e fise, në mënyrë që të njiheni me njëri-tjetrin. Më fisniku ndër ju tek Allahu është ai që është më i devotshëm." (Kuran, 49:13)**

Të kuptuarit e drejtësisë së rekomanduar prej Zotit kërkon trajtim të barabartë, tolerant dhe të paqshëm për këdo, duke përjashtuar çdo diskriminim.

Njerëzit mund t'u shkaktojnë çdo lloj padrejtësie njerëzve të tjerë, ndaj të cilëve ushqejnë ndjenja armiqësie. Njerëzit në shoqëritë ku mbizotëron armiqësia dhe urrejtja nuk kanë besim te njëri-tjetri. Ata shqetësohen se mos bien viktimë e dikujt tjetër në çdo kohë. Pasi kanë humbur besimin e ndërsjellë, ata humbin gjithashtu edhe ndjenjat e tyre njerëzore si toleranca, dhembshuria, vëllazërimi e bashkëpunimi dhe fillojnë ta urrejnë njëri-tjetrin.

Sidoqoftë, ndjenjat që dikush mban në zemër ndaj një njeriu apo bashkësie, nuk duhet të ndikojnë në vendimet e besimtarit. Pavarësisht se sa i keq mund të jetë një njeri, besimtari duhet të lerë mënjanë të gjitha ndjenjat dhe të marrë vendime të drejta. Ndërgjegjja e tij e frymëzon gjithmonë të zbatojë urdhërat dhe këshillat hyjnore dhe të mos e braktisë kurrë mirësinë, sepse kjo është një urdhëresë që Zoti na jep në Kuran. Në suren "El-Maide" thuhet si më poshtë:

Morali islam i urdhëron myslimanët të mbrojnë të drejtat e jetimëve, të varfërve dhe atyre në nevojë, të mbështesin reciprokisht njëri-tjetrin dhe të jenë të predispozuar për të ndihmuar njëri-tjetrin.



**"O ju që besuat! Tregohuni të drejtë në gjykim, dëshmitarë të sinqertë për hir të Allahut! Mos lejoni që urrejtja ndaj një grupi njerëzish t'ju shtyjë të bëni padrejtësi ndaj tyre! Tregohuni të drejtë! Kjo është më pranë devotshmërisë. Kijeni frikë Allahun! Ai është i njohur me atë që veproni." (Kuran, 5:8)**

Sikurse thuhet në këtë varg, mbajtja e një qëndrimi të drejtë është ajo që plotëson më së miri frikën dhe dashurinë ndaj Zotit. Një njeri besimtar e di se do të arrijë kënaqësinë e Zotit vetëm nëse vepron me ndershmeri.

Është e qartë se ata që i druhen Zotit dhe përpiqen të mbajnë lart vlerat shpirtërore, tregojnë zell të madh për t'u shërbyer njerëzve. Në përgjithësi, të tillët janë të prirur për t'i shërbyer shoqërisë dhe ata padyshim janë një e mirësi e madhe. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme për njerëzit, që të mësojnë fenë e vërtetë dhe të jetojnë sipas moralit të shpallur në Kuran, që është libri i fundit i shpallur nga Zoti.

### **Zoti urdhëron për falje dhe mëshirë**


Në vargjet e Kuranit, Zoti e ka përshkruar faljen gjithmonë si një cilësi të lartë dhe në një ajet, Ai ka dhënë lajmin e mirë, se një sjellje e tillë do të shpërblehet:

**"Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek Allahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët." (Kuran, 42:40)**

Zoti ka shpallur në Kuran se të falësh dikë është një sjellje e virtytshme; nëse dikush ka qenë i padrejtë, duhet t'i përgjigjemi të keqes me diçka më të mirë. Zoti thotë:

**Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një grupi prej tyre, përveç një pakice nga ata. Pra falju atyre fajet dhe mos i qorto. Allahu i do ata që bëjnë mirë. (Kuran 5:13)**





*Morali islam na fton tek një  
jetë ku dominojnë paqja,  
mirëqenia, dashuria dhe  
gëzimi për të gjithë njerëzit...*

**KURANI  
FISNIK**

**Nuk barazohet e mira dhe e keqja! Të keqen ktheje me të mirë se atëherë armiku yt do të të bëhet mik i ngushtë. (Kuran 41:34)**

### Islami mbron lirinë e mendimit

Islami është një fe që siguron dhe garanton liri të ideve, të mendimit dhe të jetës. Ai ka lëshuar urdhëresa për të penguar dhe ndaluar tensionin, konfliktet, shpifjet madje edhe mendimin negativ mes njerëzve. Në të njëjtën mënyrë që ai i është kundërvënë terrorizmit dhe të gjitha akteve të dhunës, po ashtu ia ka ndaluar presionin ideologjik ndaj njerëzve:

**"Nuk ka detyrim në fe. Rruga e drejtë dallohet qartë nga e gabuara." (Kuran, 2:256)**

**"Prandaj këshilloji ata, sepse ti nuk je tjetër përveçse këshillues. Ti nuk je vënë për të kontrolluar ata." (Kuran, 88:21-22)**

Detyrimi i njerëzve për të besuar në një fe apo për të pranuar format e saj të besimit, është në kundërshtim të plotë me thelbin dhe shpirtin e Islamit. Sipas Islamit, besimi i vërtetë është i mundur vetëm nëpërmjet vullnetit dhe ndërgjegjes së lirë. Sigurisht që myslimanët mund të këshillojnë dhe nxisin njëri-tjetrin në cilësitë e moralit kuranor. Të gjithë besimtarët janë të obliguar t'u sqarojnë njerëzve këtë moral dhe t'u japin shpjegime në mënyrën më të sjellshme të mundshme. Ata duhet të tregojnë për bukuritë e fesë në dritën e vargut kuranor që thotë: **"Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi e fjalë të mira..." (Kuran, 6:125)** Sidoqoftë, ata duhet të mbajnë parasysh edhe vargun: **"...ti nuk je përgjegjës për udhëzimin e tyre, por është Zoti ai që udhëzon kë të dëshirojë." (Kuran, 2:272)**

Besimtarët nuk mund të përdorin kurrë dhunën dhe as ndonjë lloj presioni fizik apo psikologjik. Atyre nuk u lejohet as të përdorin epërsinë e mundshme materiale për të detyruar dikë në çështje të fesë. Kur ftesës së tyre në besim i jepet përgjigje negative, myslimanët duhet të përgjigjen në linjat e vargut kuranor që thotë:

**"Ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time." (Kuran, 109:6)**

Myslimanët që jetojnë në këtë botë, duhet të jenë tolerantë ndaj të gjitha besimeve dhe të sillen me drejtësi e humanizëm. Kjo përgjegjësi, me të cilën janë të ngarkuar besimtarët, vlen edhe për t'i ftuar njerëzit në bukurinë e fesë së Zotit me mjetet e paqes e tolerancës. Vendimi përfundimtar për t'i zbatuar apo jo këto vlera, për të besuar apo jo, qëndron në krahun tjetër. Imponimi ndaj dikujt për të besuar, apo përpjekja për t'i detyruar atij diçka, përbën shkelje të moralit kuranor. Në të vërtetë, Zoti në Kuran na sjell ndër mend sa më poshtë:

**"Nëse Zoti yt do të kishte dëshiruar, të gjithë njerëzit në tokë do të kishin besuar. Mos vallë mendon se mund t'i detyrosh njerëzit të besojnë?" (Kuran, 10:99)**

Një shembull i shoqërisë, në të cilën njerëzit janë të detyruar të besojnë, është tërësisht në kundërshtim me Islamin. **Besimi dhe lutjet duhet t'i drejtohen Zotit vetëm përmes vullnetit të lirë të individit.** Nëse një sistem u imponon njerëzve besimin dhe adhurimin ndaj Zotit, atëherë njerëzit do të shndërrohen në praktikues të fesë vetëm për shkak të frikës ndaj këtij sistemi. Kjo do të thotë të inkurajosh hipokrizinë dhe këtë gjë asnjë mysliman nuk do ta miratojë. Nga pikëpamja fetare, ajo që është e rëndësishme, është të jetuarit për kënaqësinë e Zotit në një mjedis ku ndërjegjja e njerëzve është plotësisht e lirë.

Historia e Islamit është plot me praktika tolerante të udhëheqësve myslimanë, të cilët kanë respektuar të gjithë besimet dhe kanë ndërtuar me duart e tyre një tolerancë fetare të admirueshme. Për shembull, Tomas Arnold, një misionar britanik, i ngarkuar me detyra shërbimi në qeverinë indiane, e përshkruan lirinë e nxitur nga Islami me këto fjalë:

"Ndërsa për ndonjë përpjekje të organizuar për të shtrënguar popullsitë jomyslimane që të pranojnë Islamin, apo për ndonjë përndjekje sistematike për shkak të besimit të krishterë, nuk



Në vitin 1492, hebrejtë të cilët refuzuan të konvertoheshin u dëbuan nga Spanja, nga mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Izabela (lart). Hebrejtë u pranuan në Perandorinë Osmane, që ishte streha e drejtësisë islame dhe e dhembshurisë.

dëgjojmë kurrë të bëhet fjalë. Nëse kalifët do të kishin zgjedhur të vepronin kështu, ata do ta kishin hedhur tej Krishtërimin nga tokat e tyre me të njëjtën lehtësi që Ferdinandi dhe Izabela hodhën tej Islamit nga Spanja, apo Luigji XIV penalizoi Protestantizmin në Francë, apo çifutët u mbajtën jashtë Anglisë për 350 vjet. Kishat lindore në Azi ishin tërësisht të shkëputura nga pjesa tjetër e bashkësisë së Krishtërit dhe asnjëra prej tyre nuk mund të ngrinte gishtin në interes të vet, pasi ato konsideroheshin si bashkësi heretike. Në këtë mënyrë, edhe mbijetesa e thjeshtë e këtyre kishave deri në ditët tona, është një provë e fortë e qëndrimit përgjithësisht tolerant të qeverive muhamedane ndaj tyre."<sup>1</sup>

### Vrasja është një prej mëkateve më të mëdha në Kuran

Vrasja e një njeriu të pafajshëm është një prej mëkateve të mëdha të shpallura në Kuran:



"...nëse dikush vret një njeri, që nuk ka vrarë askënd apo nuk ka bërë ndonjë çrregullim në tokë, është njëlloj sikur ka vrarë mbarë njerëzimin. Nëse dikush i shpëton jetën një njeriu, është sikur t'i ketë dhuruar jetë mbarë njerëzimit..." (Kuran, 5:32)

Edhe ata që pos Allahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk vrasin njeriun që e ka ndaluar Allahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë imoralitet, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. (Kuran 25:68)

Siç sugjerojnë ajetet, një person i cili vret njerëz të pafajshëm dhe pa asnjë shkak e pret një dënim i madh. Allahu na informon se vrasja e një njeriu të vetëm është po aq mizore sa vrasja e gjithë njerëzimit në tokë. Një person i cili ruan kufijtë e Zotit nuk mund t'i bëjë dëm asnjë krijese të vetme.

E gjithë kjo tregon se morali që Islami u rekomandon njerëzve janë virtytet e harmonisë, paqes dhe drejtësisë. Barbarizmi i njohur si terrorizëm, që është aq shqetësues në botë për momentin, është vepër e njerëzve injorantë dhe fanatikë, që nuk kanë lidhje as me moralin kuranor, dhe as me fenë islame. Zgjidhja për këta njerëz apo grupe, të cilët përpiqen të kryejnë mizori nën maskën e fesë është të edukuarit me moralin e vërtetë kuranor.



Me fjalë të tjera, ata duhen ndërgjegjësuar për gabimet dhe fanatizmin e tyre, në mënyrë që t'i braktisin ato një herë e mirë. Shpjegimi i Islamit sipas Kuranit, do të shkatërrojë rrënjësisht ideologjinë e terrorizmit dhe të terroristëve dhe kjo është zgjidhja e vetme për të shpëtuar botën nga ankthi i terrorizmit.

### **Demokracia e vërtetë do të jetë e mundur, vetëm atëherë kur njerëzit të jetojnë sipas vlerave morale Islame**

Zoti dëshiron lehtësi, lumturi dhe gëzim për njerëzit. Ai nuk dëshiron të keqen për njerëzimin. Feja, si një përmbledhje e urdhëresave të Zotit, gjithashtu u tregon njerëzve rrugën për një jetë të paqtë, të hareshme, të sigurtë, të virtytshme dhe të begatshme. Nuk ka asnjë imponim apo detyrim në besim. Kushdo që beson në Zot, e praktikon fenë e tij duke qenë i ndërgjegjshëm për ekzistencën dhe njëshmërinë e Zotit. Besimi përqafohet vetëm me zemër.

Allahu përshkruan në Kuran lirinë, dashurinë, dhembshurinë, faljen, drejtësinë dhe botën tonë, si një vend ku të gjithë mund të jetojnë të lirë, të shpalesin hapur pikëpamjet dhe mendimet e tyre dhe të jetojnë në paqe. Kjo përmbledhje është një përshkrim i demokracisë; pra, burimi i vërtetë i demokracisë është në Kuran. Kushdo që kërkon drejtësinë dhe barazinë sociale, do ta gjejë të pasqyruar më së miri në Kuran.

#### **1- DREJTËSIA SOCIALE: Zoti i Plotfuqishëm urdhëron për barazi dhe drejtësi sociale**

Drejtësia sociale është një nga parimet themelore të demokracisë. Njerëzit e mësuan drejtësinë sociale nga Profeti Nuh dhe Profeti Ibrahim (paqja qoftë me ata). Sipas burimeve fetare, kur anija u ndal në tokën e thatë, mbas përmblyesjes, Profeti Nuh përgatiti ushqimin me çfarë i kishin mbetur nga perimet, thjerrëzat etj, dhe të gjithë në anije u ushqyen. Kjo është një nga

shembujt më të mirë të drejtësisë shoqërore, sepse me këtë shembull Profeti Nuh na mësoi barazinë, solidaritetin, bujarinë dhe rëndësinë në shpërndarjen e ushqimit për të gjithë.

Në Kuran, në ajetin 69 të sures Hud është shpallur:

**"të dërguarit Tanë i solli lajmin e mirë Ibrahimit. Ata thanë: "Paqe!" Dhe ai gjithashtu tha: "Paqe!" Dhe pa u vonuar u solli një viç të pjekur."** Profeti Ibrahim menjëherë përgatiti një viç dhe kur erdhën mysafirët ua solli atyre për ta ngrënë. Zoti i Plotfuqishëm thekson se Profeti Ibrahim me bamirësi u ofroi ushqim njerëzve, të cilët ai nuk i njihje dhe kjo na tregon rëndësinë që ka ushqimi i të varfërve dhe drejtësia sociale.

## 2 - BARAZIA: Zoti i Plotfuqishëm shpall në Kuran se nuk ka racë superiore

Zoti i Plotfuqishëm ka shpallur në një ajet të Kuranit, se superioriteti qëndron vetëm në devotshmëri. Në këtë ajet Zoti na tregon:

**O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise për t'u njohur mes vete, e s'ka dyshim se te Allahu, më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga mëkatet), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë. (Kuran, 49:13)**

Profeti ynë (paqja qoftë me të) e shpreh këtë të vërtetë të urdhëruar nga Zoti si më poshtë:

**"Ju jeni bijtë e Ademit dhe Ademi u krijua prej dheut. Pra njerëzit s'duhet të mburren për paraardhësit e tyre. "(Suneni i Ebu Daudit, Libri 41, Numër 5097)**

Gjatë predikimit të tij të fundit, Pejgamberi (paqja qoftë me të) u bëri thirrje myslimanëve:

**"Një arab nuk ka superioritet mbi një jo-arab dhe as një jo-arab mbi një arab; as i bardhi mbi të ziun dhe as i ziu mbi të bardhin, veç në devotshmëri. Vërtet më fisniku ndër ju është ai që është më i devotshëm."**

*(The Prophet Muhammad's Last Sermon; <http://www.stanford.edu/~jamila/Sermon.html>)*

### 3 - DREJTËSIA: Zoti i Plotfuqishëm urdhëron për drejtësi

Në Kuran Allahu urdhëron besimtarët: **O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër vetes suaj, kundër prindërve ose të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) i pasur ose i varfër, se Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, Allahu di hollësisht se çfarë bëni. (Kuran, 4:135)**

Urdhëresat që Profeti ynë (paqja qoftë me të) ka shpallur në mesin e myslimanëve dhe qëndrimi i tij i drejtë dhe i dashur - ndaj njerëzve të feve të ndryshme, gjuhëve, racave dhe fiseve, si dhe mënyrën se si ai i trajtonte të gjithë në mënyrë të barabartë, duke mos bërë asnjë dallim midis të pasurve dhe të varfërve, ashtu si Zoti e ka shpallur në Kuran - mbetet një shembull i shkëlqyer i demokracisë.

### Demokracia do të vijë kur njerëzit të jetojnë sipas vlerave morale të urdhëruara nga Zoti

Siç e kemi parë, liria intelektuale dhe liria e besimit dhe e shprehjes, gjenden në esencën e Islamit. Disa njerëz supozojnë se demokracia i ka fillesat me Greqinë e lashtë. Por është Zoti, Ai që ua mëson demokracinë njerëzve. Që nga koha e Profetit Adem, të gjithë profetët kanë qenë përfaqësuesit e vërtetë të lirisë dhe drejtësisë. Thelbi i të gjitha koncepteve kryesore janë liria dhe drejtësia. Profetët nuk ushtruan presion mbi njerëzit dhe i trajtuan ata si qytetarë të barabartë, duke respektuar dhe besuar tek njerëzit dhe jo duke gjykuar ndokënd, për shkak të pikëpamjeve të tij. Të gjitha këto tipare të demokracisë, gjenden në moralin e fesë. Gjatë gjithë historisë, njerëzit i kanë mësuar këto koncepte nga fetë monoteiste të shpallura nga Zoti. Shembujt më të bukur në histori, do t'i hasni vetëm në periudha të caktuara, vetëm atëherë kur njerëzit jetonin sipas udhëzimeve të fesë së drejtë.

Kur ne kthehemi pas në kohën kur njerëzit dhunoheshin për shkak



të opinioneve dhe ideologjive të tyre të ndryshme, do të vërejmë, jo vetëm vuajtjet e besimtarëve të feve të ndryshme, por edhe degradimin e lëmive të ndryshme si artet, shkenca dhe arkitektura. Njerëzit kanë humbur gëzimin e tyre të jetës dhe janë shndërruar pothuajse në robotë, vetëm atëherë kur janë djegur libra, apo kur vrasjet, masakrat dhe gjenocidet janë përhapur në masë. Në të tilla situata, ne do të vërejmë ndikimin që ushtrojnë ideologjitë ateiste e jofetare, por edhe ndikimin e atyre që kanë keqinterpretuar moralin fetar, nën ndikimin e pikëpamjeve radikaliste, duke e larguar atë nga thelbi i saj.

Drejtësia e vërtetë, demokracia, respekti dhe dashuria mund të përjetohen vetëm atëherë, kur njerëzit të praktikojnë fenë në mënyrën që ka urdhëruar Zoti. Shumë shpejt, demokracia, vëllazëria, dashuria, miqësia dhe paqja do të dominojnë botën, me lejen e Zotit dhe njerëzit do të përjetojnë gëzimin, lumturinë dhe mirësitë e panumurta të besimit. Siç mund të shihet qartë nga ajetet, hadithet e Profetit tonë (paqja qoftë me të) dhe nga fjalët e dijetarëve të mëdhenj të islamit, koha në të cilën jetojmë është quajtur Fundi i Kohërave.

Ditëve të vështira dhe të mundimshme të Fundit të Kohërave, do t'u vijë fundi në këtë shekull dhe bota do të hyjë në një epokë të re e të ndritshme. Thirrja në Njëshmërinë e Zotit në mënyrën më të bukur dhe me urtësi, dhe të ftuarit e njerëzve në Islam siç përshkruhet në Kuran, do të sjellë Epokën e Begatë, e cila nuk do të jetë larg, por në një të ardhme të afërt.

**A thua mos po kërkojnë ata gjykimin e kohës së injorancës, por për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më të mirë se ai i Allahut?  
(Kuran, 5:50)**

*S'ka dyshim se Allahu  
është shumë i butë dhe  
mëshirues ndaj njerëzve.  
(Kuran 2:143)*



# PIKËPAMJET KURANORE TË SHERIATIT, XHIHADIT DHE LUFTËS

Dy konceptet që janë shfrytëzuar gjerësisht nga radikalistët, gjoja në emër të fesë islame, në kryerjen e akteve terroriste për ta pasqyruar Islamin si një fe të dhunës, janë sheriatit dhe xihadi.

Zoti në mënyrë të qartë thotë në Kuran: *Kurani është "sçarim për çdo gjë"* (12:111). Por njerëzit me mentalitet radikalist, që kanë zgjedhur si udhërrëfyes të tyre disa hadithe të fabrikuara, kurrë nuk e kanë besuar Kuranin si të mjaftueshëm. Për këtë arsye, gjatë gjithë rrjedhës së historisë, ata kanë pohuar se disa prej urdhëresave të Kuranit "nuk janë të mjaftueshme" dhe duhet të interpretohen (por Kurani është përtej kësaj). Nga kjo, ata kanë zhvilluar idenë se ne mund ta kuptojmë Kuranin vetëm përmes haditheve.

Hadithet e Profetit tonë (paqja qoftë me të) kanë mbërritur deri në ditët e sotme nëpërmjet transmetimeve. Ndërsa disa janë krejtësisht të saktë dhe të besueshëm, të tjerë me kalimin e kohës u janë shtrembëruar kuptimet dhe disa të tjerë janë ndryshuar tërësisht. Nëse një hadith është me të vërtetë thënie apo praktikë e Profetit tonë (paqja qoftë me të), ai duhet të jetë në pajtim të plotë me Kuranin. Pa dyshim është një shpifje e rëndë, pretendimi se disa thënie apo praktika që bien ndesh me Kuranin, t'i

përkasin Profetit (paqja qoftë me të), sepse Profeti ynë nuk e ka kundërshtuar Kuranin.

Ideja që ne mund ta kuptojmë Kuranin vetëm nëpërmjet haditheve, ka sjellë dëm të madh në botën islame, sepse ka prej myslimanëve që e bazojnë besimin e tyre mbi hadithe të fabrikuara. Ata madje e braktisën tërësisht Kuranin, duke marrë si burim të fesë së tyre vetëm këto hadithe.

Nëse një hadith i fabrikuar bien ndesh me Kuranin, ka prej tyre që mund të thonë: "Ky hadith shfuqizon urdhrin e Kuranit." Prej haditheve të fabrikuara lindën rryma të ndryshme, dhe për pasojë edhe katër shkollat nuk u pajtuan me njëri-tjetrin në shumë çështje të Islamit. Dijetarët e Islamit në shumë çështje



**"Brenda në xhami,  
lutja e pasdites", nga  
John Frederick  
Lewis, 1847. Pikturë  
e një koleksioni  
privat.**



sollën mendime të ndryshme nga njëri-tjetri. Ata madje deklaruan se ka prej njerëzve që e kishin braktisur besimin në tërësi.

Profeti ynë (paqja qoftë me të) i përgjerohej Zotit të Plotfuqishëm në Kuran, për gjendjen në të cilën ndodhej bota islame:

**E i dërguari tha: "O Zoti im, vërtet populli im e konsideroi këtë Kuran si (diçka) të hedhur!" (Kuran, 25:30)**

Në të vërtetë, problemi i një pjese të madhe të botës islame sot është se njerëzit e konsiderojnë Kuranin si një libër që është braktisur. Pasi Kurani u braktis, u pa e nevojshme ndihma e "ixhmasë" (Ixhma - teologët sjellin vendime bazuar në ligjin e Sheriatit me anë të analogjisë.) Meqenëse Kurani nuk ishte më udhëzues në jetën e tyre, ata, të ndikuar nga mijëra hadithe të fabrikuara, më në fund vendosën që "as Kurani e as hadithet nuk mund të shpjegojnë urdhëresat." Pas një farë kohe këta "prijës fetarë" filluan të nxirrnin ligje në emër të Islamit.

Kur shkollat filluan kundërshtimet me njëra-tjetrën, marrëveshjet u prishën dhe komunitetet myslimane hynë në konflikt me ato të shkollave të tjera. Kur "prijësit fetarë" i konsideruan interpretimet e tyre si ligje, komunitete të ndryshme filluan t'i bazojnë idetë e tyre në disa praktika të caktuara dhe për pasojë, e gjithë bashkësia Islame u nda në sekte, rryma apo grupime të vogla. Kurani u var në mur si një artikull dekorativ dhe si rezultat i kësaj, një pjesë e madhe e botës islame "e braktisi dhe e injoroi Kuranin."

Duke vërejtur disa nga kundërshtarët e Islamit, shohim se problemi i tyre është i njëjtë me atë të ithtarëve të bestytnisë. Ata nuk mësojnë për Islamin duke iu referuar Kuranit. Po ashtu njësoj si ithtarët e bestytnisë, ata përqendrohen në hadithe të fabrikuara, në traditat dhe interpretimet e Islamit sipas disa udhëheqësve fetarë, që janë përgjithësisht të papajtueshme me Kuranin. Në sytë e tyre, "Islami" është thjesht një mënyrë



**Qabeja, në të cilën vijnë çdo vit rreth dy milionë myslimanë nga të katër anët e botës, është një simbol i paqes dhe i dashurisë, të dyja këto janë pjesë përbërëse e mësimëve të Islamit.**

jetese dhe praktikat janë bestytни. Sipas pikëpamjes së tyre, "Islami" është një fuqi e përfytyruar nga historianët dhe nuk është një besim i shpallur në Kuran. Ata i quajnë praktikat e kësaj feje të fabrikuar si "Sheriat" dhe nuk i njohin ligjet e Kuranit. Ata nuk janë në dijeni të vlerave dhe koncepteve të shpallura në Kuran, por kanë një njohuri të madhe të të gjitha rregullave të fesë së rreme të ithtarëve të bestytnisë. Kur kritikojnë rregullat e kësaj feje të rremë, ata kujtojnë se janë duke kritikuar Islamin. Kaq të ndikuar janë ata prej fesë së ithtarëve të bestytnisë, sa ata nuk të besojnë as kur u thua se: "Nuk është ky Islami." Dhe ky është një gabim jashtëzakonisht i madh.

Nëse njerëzit nuk janë në kundërshtim me Islamin për shkak të bindjeve të tyre filozofike ose fetare dhe nëse duan me të vërtetë një zgjidhje për errësirën që përçojnë idetë fanatike, ata duhet të besojnë në këto që sapo përmendëm. Feja e terroristëve nuk është Islami. Kurani në vetvete është i mjaftueshëm për një mysliman. Hadithet janë të vërteta dhe të besueshme, atëherë kur janë në përputhje me Kuranin. Një hadith që nuk është në përputhje me Kuranin nuk ka vend në Islam. Nëse një mysliman nuk mund ta gjejë dot Islamin në Kuran, kjo do të thotë se ai po kërkon për një fe tjetër, sheriati i së cilës nuk është Islami.



## Sheriati i vërtetë në Kuran

Fjala Sheriat do të thotë "rrugë." Duke u mbështetur në Kuran, një mysliman e ka të qartë se cila "rrugë" duhet ndjekur. Ndalesat në Kuran janë të pakta dhe qartësisht të evidentueshme. Ato nuk kanë nevojë për diskutim apo interpretim. Për shembull, vrasja, tradhtia bashkëshortore, kamata, ngrënia e mishit të derrit apo pirja e gjakut të kafshëve, janë të gjitha ndalesa të shpallura në ajetet e Kuranit, në mënyrë të qartë. Kjo është një karakteristikë e veçantë e Kuranit. Njerëzit nuk mund t'i interpretojnë ndalesat sipas dëshirave të tyre. Zoti e ka shpallur qartë atë që e ka ndaluar, si në këtë ajet:

**(Allahu) Ua ndaloi juve kafshën e ngordhur, gjakun, mishin e derrit dhe atë që therret në emër të dikujt tjetër veç Allahut (Kuran, 2: 173)**

Zoti shpall në Kuran se do të ketë njerëz që trillojnë në emër të Islamit, se çfarë është e ligjshme dhe çfarë është e ndaluar:

**Mos thoni gënjeshtër me gjuhët tuaja: "Kjo është e lejuar e kjo është e ndaluar" e të shpifni ndaj Allahut të pavërtetën. Vërtet, ata që shpifin gënjeshtër ndaj Allahut, nuk kanë shpëtim. (Kuran, 16: 116)**

Pas largimit nga kjo botë të Profetit tonë (paqja qoftë me të), u shfaqën grupime të ndryshme që trilluan gënjeshtër kundër Zotit. Meqë këto grupime nuk morën Kuranin për udhërrëfyes, ata bënë diçka të lejuar apo të ndaluar, sipas dëshirave të tyre.

Zoti thekson veçanërisht karakteristikat e këtyre njerëzve: "Ata i bëjnë të ndaluara, të mirat që janë të lejuara." Zoti ynë thotë në Kuran:

**O ju që besuat! Mos i ndaloni (mos i bëni haram) të mirat që Allahu i lejoi për ju (i bëri hallall) dhe mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (i kalojnë kufijtë e dispozitave të Zotit). (Kuran, 5:87)**

Sistemi i egërsisë i aplikuar nën emrin e shariatit, por që në fakt është krejtësisht i papajtuësëm me Islamin, është si rezultat i braktisjes së Kuranit. Sheriati i vërtetë i përcaktuar në vargjet, ose me fjalë të tjera, rruga e vërtetë në të cilën thërret Kurani, është si vijon:

Sheriati i Kuranit do të thotë dashuri, respekt, dashamirësi dhe mbrojtje për njerëzit e të gjitha feve dhe ideve. Sheriati i Kuranit insiston për demokracinë dhe për lirinë e mendimeve. Sipas Sheriatit të Kuranit, njerëzit duhet të jenë të ditur, të arsimuar, me mendje të hapur, të respektueshëm ndaj ideve të tjera, të lumtur, të pashëm, modern, me ambicje, optimistë, të vlerësojnë artin, shkencën, dashurinë dhe miqësinë. Nuk ka urrejtje, intolerancë, konflikt, përleshje, despotizëm, imponim, kërcënim, hidhërim, zemërim apo luftë në Sheriatin e Kuranit.

A ka një vend islamik sot në botë që i plotëson këto kritere të Sheriatit të Kuranit? Sigurisht që jo; ky shariat duhej zbatuar që nga koha e Profetit tonë (paqja qoftë me të). Vendet që pretendojnë se qeverisen në bazë të ligjit të shariatit, në fakt aplikojnë shariatin e besimit fanatik, të imponuar në emër të Islamit prej grupeve të ndryshme e të dhunshme. Ata zgjedhin hadithe të ndryshme e të pavërteta si udhërrëfyes të tyre, por në fakt kështu ata braktisin Kuranin.



Dështimi për të zbatuar sistemin e vërtetë të shariatit në Kuran, i cili do të sillte begatitë e cituara më lart, dhe ashpërsia në keqinterpretimin e shariatit të Kuranit, janë sigurisht tejet të rënda. Zgjidhja nuk është fajësimi i Islamit. Ata që fajësojnë Islamin bëjnë gabim të madh, sepse ai është zgjidhja e vetme ndaj radikalizmit, dhunës dhe egërsisë. Duke u përpjekur të dobësojnë Islamin, në të vërtetë ata po ua lehtësojnë rrugën radikalistëve. Eliminimi i radikalizmit dhe i besimeve të rreme, të propaganduara nën emrin e Islamit, nuk do të përmbushet, as duke shtuar akuzat ndaj Islamit dhe as duke rritur prodhimin e armëve. E vetmja mënyrë është interpretimi i saktë i Islamit të vërtetë. Problemet që vijnë nga besimet e rreme mund të zgjidhen vetëm duke i zëvendësuar këto besime, me besimin e vërtetë.

**Sheriati kërkon që myslimani të jetë modern, i pastër, fisnik, i mençur, i kulturuar, me mendje të hapur, respektues i mendimit të lirë dhe i dashur. Sheriati i Kuranit është i bazuar në vëllazëri, paqe dhe dashuri. Lufta, mizoria, urrejtja, zemërimi dhe konflikti janë të huaj për të.**



## Xhihadi i vërtetë në Kuran

**Nuk ka asnjë vrasje në xhihadin në Kuran. Nuk ka bombardim në xhihadin në Kuran. Nuk ka kamikazë apo sulme terroriste mbi civilët. Nuk ka urrejtje apo mallkim për njerëzit në xhihadin në Kuran.** Bijtë e Profetit Ibrahim (paqja qoftë me të), e Profetit Jakub (paqja qoftë me të) dhe Profetit Musa (paqja qoftë me të) nuk janë të mallkuar në xhihadin në Kuran. Nuk ka kërcënime dhe tmerr në xhihadin në Kuran. Këto nuk bëjnë pjesë në besimin Islam.

Nuk ka masakra, vdekje, urrejtje dhe zemërim në Islam, as në Krishtërim as në Judaizëm. Prandaj, nëse dikush thotë: "Kam mësuar nga Kurani që unë duhet të vras, të hedh në erë dhe të mallkoj njerëz", ky njeri ose është mashtrues ose i është bërë lavazh truri.

"Xhihadi" në Islam nënkupton përpjekjen për të përsosur virtytet morale dhe përpjekjen për t'i larguar njerëzit nga e keqja. Ata që vrasin në emër të xhihadit, nuk janë duke vepruar sipas Kuranit.



Nëse një radikalist thotë se jam mysliman dhe ndjek një besim vetëm për të vrarë, bombarduar dhe mallkuar, në realitet besimi i tij është i shpikur dhe nuk ka lidhje me Kuranin.

Librin e Shenjtë, të cilin ata e puthin, e prekin me ballin e tyre dhe e varin në mur, mund të mos e kenë lexuar ndonjëherë. Ky është ai lloj besimi, në të cilin çdo gjë është e errët. Ai ofron urrejtje në vend të dashurisë, zemërim në vend të miqësisë, armiqësi në vend të vëllazërisë, vuajtje në vend të bukurisë dhe injorancë në vend të artit, bukurisë, shkencës dhe kulturës. Është e lehtë për të vënë një armë në duart e dikujt që beson diçka të tillë. Është e lehtë t'i thuhet, "Ata janë armiq të tu." Është e lehtë ta manipulosh një person të tillë. Është e lehtë për të ndezur urrejtje tek këta njerëz. **Kjo tirani e tmerrshme, e cila ekziston si mish i huaj jo vetëm në Islam, por edhe në të gjitha besimet e vërteta dhe madje edhe në marksizëm, satanizëm dhe materializëm, me pak fjalë në të gjitha fetë, ideologjitë dhe mënyrat e të menduarit, është për shkak të radikalizmit dhe fanatizmit.**

Po përse hasim radikalistë apo fanatikë? Përgjigja është e qartë: Sepse këta njerëz kështu janë mësuar. Për ata nuk ekziston besim tjetër. Radikalistët që flasin në emër të Islamit, fanatizmin e tyre e shohin si pjesë të Islamit. Ata jetojnë në injorancë, në geton e tyre. Ata janë të distancuar nga shoqëria, nga arti dhe dijet shkencore. Ata kanë qenë gjithmonë të keqinformuar në lidhje me konceptin e "xhihadit" dhe e kanë zbatuar atë gabimisht, sepse kështu u është mësuar. Ata gjithmonë kanë menduar se po bëjnë diçka të mirë, nëse veprojnë në këtë mënyrë. Ata kurrë nuk kanë menduar se ata në të vërtetë po dëmtojnë veten, besimin dhe familjet e tyre, vendin dhe natyrisht, të tjerët. Megjithatë, "xhihadi" i përshkruar në Kuran është shumë ndryshe nga xhihadi i portretizuar nga radikalistët.

Pra, çfarë do të thotë fjala "*xhihad*"?

Fjala xhihad vjen nga fjala arabe "xhahd." Kuptimet e saj janë: 1) puna, përpjekja, vendosmëria, këmbëngulja dhe sakrifica për të arritur rezultatet më të larta në jetë; 2) frenimi prej dëshirave dhe veseve të ulëta. Në bazë të këtyre përkufizimeve, synimi i xhihadit në Islam është që t'u mësojë njerëzve vlerat e duhura morale dhe t'i largojë ata nga e keqja. Duke bërë këtë, myslimani arrin të frenojë veten e tij prej veseve të ulëta, lartësohet drejt virtytit moral dhe e ka më të lehtë të qëndrojë larg zemërimit dhe urrejtjes. Me fjalë të tjera, ajo që duhet të bëjë një mysliman në xhihadin e tij, është të përmirësojë veten në njërën anë dhe nga ana tjetër t'u mësojë njerëzve të vërtetën dhe të drejtën. Ai jo vetëm që duhet të jetë një model me vlerat e tij morale, por duhet të rrezatojë dashuri, paqe dhe t'i largojë njerëzit nga e keqja.

Fjala "xhahd" nuk haset me ndonjë kuptim tjetër në Kuran. Ata që kryejnë masakra nën emrin e "xhihadit" duke thënë se "referenca jonë është Kurani", ata gënjejnë ose mashtrojnë.

Sipas Kuranit, ata të cilët vrasin njerëz në emër të xhihadit, ose hidhen në erë duke vrarë civilë të pafajshëm, janë duke bërë mëkat të rëndë. Ajetet

e Kuranit të cilat keqinterpretohen prej tyre, do të shtjellohen në detaje, në faqet në vijim. Një pikë e rëndësishme duhet të mbahet mend këtu; pjesa më e madhe e radikalistëve kryejnë akte të dhunshme, për shkak të injorancës. Ata nuk e njohin besimin e vërtetë. Ka të ngjarë,





që shumë prej tyre nuk e kanë lexuar asnjëherë Kuranin. Kjo është arsyeja pse ata marrin jetë, sepse e kanë keqkuptuar fenë, nuk janë njohur me mësimet e Kuranit dhe nuk e kanë kuptuar ligjin e Zotit. Ne duhet të pranojmë faktin se për sa kohë ka injorancë, do të ketë edhe radikalistë. Zgjidhja e vetme, për ata që kryejnë akte të dhunës dhe terrorit në emër të xhihadit, është edukimi i vërtetë.

### Vetëvrasja nuk është "xhihad", ajo është e ndaluar në Kuran

Aktet më të bujshme të terrorizmit, të kryera në botë në 20 apo 30 vitet e fundit, sidomos ato nga grupet terroriste me origjinë nga Lindja e Mesme, janë kryesisht me bomba vetëvrasëse. Sipas Kuranit, vetëvrasja

**Disa njerëz, të cilët janë të keqinformuar në lidhje me Islamin, gabimisht besojnë se ai pajtohet me kamikazët; por në fakt Islami është një fe e paqes dhe e dashurisë. Në Kuran, vetëvrasja është një mëkat i rëndë.**



është mëkat. Por si mundet vallë që një person i veshur me eksploziv, të hedhë veten në erë në mes turmës së civilëve?

Pas Luftës së Dytë Botërore shumë nga vendet arabe u prekën nga komunizmi. Partia Ba'ath u zgjerua në Egjipt, Siri dhe Irak. Blloku i Shangait që u themelua nën kujdesin e Kinës, pa bërë zë i mori nën mbrojtjen e saj vendet arabe dhe Iranin. El Fatah që u rrit nën drejtimin e Jaser Arafatit, kurrë s'i ka fshehur prirjet socialiste/komuniste. Socializmi arab i përzierë me nacionalizmin ekstrem, sollën gjakderdhje të shumta në vendet arabe dhe kjo nuk është më një sekret. Ata që nuk janë në dijeni të historisë mjafton të vëzhgojnë situatën aktuale në ato vende, ose mjafton të shohin se si ruhet në Siri trashëgimia e Hafez Asadit.

Një egërsi e tillë është e pashmangshme në mendësinë socialiste apo komuniste. Sipas këtij botëkuptimi të rremë, vetëvrasja nuk shihet si fundi i një jete, por ajo konsiderohet si një kontribut për përparimin e botës dhe për "kauzën". Pra, nëse fundi i jetës së pavlerë të dikujt, bëhet shkak që t'u jepet fund disa jetëve të tjera të pavlefshme, ky do të ishte një kontribut edhe më i madh në sytë e këtij sistemi të egër. Kjo është tejet djallëzore dhe meriton trajtim të veçantë.

Disa njerëz, të cilët janë të keqinformuar për Islamin, gabimisht besojnë se ai i lejon bombat vetëvrasëse, kur në fakt Islami është një fe e paqes dhe e dashurisë. Arsyeja kryesore për këtë keqkuptim është përpjekja e organizatave terroriste në fjalë, për të legjitimuar këtë akt të tmerrshëm, të ndaluar nga Islami, përmes shpifjeve dhe interpretimeve të ndryshme. Në qoftë se një terrorist vetëvrasës, pretendon se aktet e tij bëhen në emër të Islamit, atëherë ky është një turp dhe një shpifje kundër Islamit. Këto janë prej krimeve më të rënda dhe më të tmerrshme.

Një mysliman nuk vret, sepse vrasja është një mëkat i madh. Zoti shpall në Kuran se "**... kush vret një njeri (pa të drejtë), i cili nuk ka vrarë**

**askënd dhe nuk ka bërë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si të kishte vrarë gjithë njerëzimin..." (Kuran, 5:32)**

Ajeti është i qartë. Vrasja dhe vetëvrasja që të dyja janë mëkate. Të hedhësh veten në erë brenda një restoranti nuk është "xhihad", por mëkat. Ata që nderojnë dhe lëvdojnë akte të tilla, duke pretenduar se kamikazi është "martir", në fakt nuk duartrokasin xhihadin, por vrasjen. Të hedhësh në erë veten në mes të civilëve të pambrojtur nuk është xhihad, por vrasje. Ne do të shpjegojmë në detaje më vonë, se Islami ndalon të luftosh kundër njerëzve të pafajshëm.

Xhihadi nënkupton përpjekjen përmes dijes dhe shkencës, për të udhëzuar dikë në rrugën e vërtetë, me dashuri dhe respekt, e jo t'i marrësh atij jetën.

Martirizim do të thotë të sakrifikosh jetën në rrugën e Zotit, për të përhapur dashurinë, miqësinë dhe vëllazërinë e kërkuar nga Islami. Vrasja është krim dhe mëkat. Ajo nuk është një virtyt që nderohet.

Por kamikazët dhe përkrahësit e tyre, propagandojnë një fe që urdhëron vdekjen e të tjerëve. Por feja e tyre nuk është feja e Zotit. Vetëm pak prej atyre që i ndjekin mund ta kuptojnë këtë. Ka njerëz që kujtojnë se kjo fe e rreme është e vërtetë dhe përpiqen ta respektojnë atë.

Problemi i vërtetë është ky: Njerëzit të cilët nuk e njohin fenë e tyre janë duke u shmangur nga e vërteta. Nëse ata nuk e mësojnë fenë e tyre nga Kurani, kamikazët dhe ata që i inkurajojnë dhe i nderojnë, do të vazhdojnë të ekzistojnë. Bombat nuk janë mënyra e duhur për të mësuar të vërtetën. Mënyra e vetme është edukimi i vërtetë. Dhe në mënyrë që të sigurojmë një edukim të vërtetë, myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë duhet të bashkohen. Pasi të themelohet ky unitet i pathyeshëm, atëherë do të fillojnë të na dëgjojnë ata që janë në rrugë të gabuar.

## **Cilat janë arsyet për rritjen e sulmeve vetëvrasëse?**


Sulmet vetëvrasëse të frymëzuara nga politika fillimisht u shfaqën në vitin 1980 në Lindjen e Mesme, gjatë Luftës Civile libaneze, kur Hezbollahu filloi të përdorte kundër objektivave të tij. Prej atëherë e deri në fillim të shekullit të 21-të, rreth 200 sulme vetëvrasëse u kryen në pjesë të ndryshme të botës. Në vitet 2000, këto sulme filluan me një frekuencë gjithnjë në rritje për të rrëmbyer titujt e faqeve të para të gazetave dhe gjatë tri dekadave të fundit, numri i sulmeve të përgjithshme ka arritur në 3,500. Vetëm në vitin 2013, 291 sulme vetëvrasëse u kryen në tetëmbëdhjetë vende, duke marrë jetën e 3,100 njerëzve dhe duke shënuar një rritje dramatike prej 25% në krahasim me një vit më parë (me 230 sulme).

Shumica e këtyre sulmeve u organizuan në vendet myslimane. Lindja e Mesme, me Irakun në krye të listës, pati shumë sulme vetëvrasëse gjatë dhjetë viteve të fundit. Afganistani, Pakistani, Siria, Libani, Tunizia, Libia, Somalia, Mali dhe Nigeria janë në mesin e vendeve myslimane, të cilat janë goditur shpesh nga sulme vetëvrasëse.

Cili është shkaku që çoi në rritjen e sulmeve? Paqëndrueshmëria politike në këto vende është një faktor i rëndësishëm. Pavarësisht supozimit se shpërthimet vetëvrasëse ishin kundër fuqive pushtuese, në fakt vetëm 32% e sulmeve janë kryer në vendet ku një ushtri e huaj ka qenë e pranishme. Rreth 68% të shpërthimeve kishin për viktima qytetarët vendas; me fjalë të tjera, viktimat në këto sulme janë civilë të pafajshëm.

Në vendet si Iraku dhe Siria, sulmet janë nxitur kryesisht nga konfliktet sektare dhe etnike, ndërsa në Egjipt, ndodhën për shkak të konflikteve ndërmjet forcave nacionaliste laike dhe





grupeve islamike. Sulmet vetëvrasëse zakonisht synojnë zonat më të populluara, të tilla si restorantet, tregjet, xhamitë dhe transportin publik; vende ku gjenden civilë dhe ku objektivat në këto sulme janë gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Në të vërtetë, sulme ka pasur madje edhe në xhami, ku myslimanë të shumtë kryenin ritet ditën e premte, siç i kemi parë në Irak, ose gjatë festave fetare, si psh. në Jemen. Kjo është tejet tronditëse.

Shumë grupe myslimane dënojnë Izraelin për dërgimin e trupave ushtarake në një xhami në Jeruzalem, dhe madje edhe e denoncuan atë si një armik që duhet luftuar; por nga ana tjetër, është interesant fakti që po të njëjtat grupe nuk reagojnë për sulmin vetëvrasës në një xhami, ku myslimanët ishin duke u lutur. Disa prej këtyre grupeve i kanë inkurajuar sulme të tilla.

Kur pyeten autorët për veprimet e tyre - për shkak të nivelit të tyre të ulët arsimor dhe padijes së tyre rreth vlerave të vërteta morale të Kuranit, të cilat në të vërtetë mishërojnë falje, paqe dhe dashuri – ata përgjigjen se këto krime janë kryer në emër të Islamit. Për këtë arsye, mësimi i moralit të Islamit të bazuar në Kuran, mbetet një prioritet. Pra, është me mjaft rëndësi, fillimi i një fushate të gjerë botërore.

## Keqkuptimet rreth luftës në Islam

### Myslimani duhet të besojë çdo ajet në Kuran, pa bërë përjashtim

Këtë temë po e trajtojmë për të treguar pretendimet false të fanatikëve, që kërkojnë të fusin bestytini në Islam dhe po të njëjtën gjë bëjnë edhe disa kundërshtarë të Islamit, që i keqpërdorin idetë e mbrapshta të këtyre fanatikëve, se gjoja disa ajete të Kuranit nuk janë më të vlefshëm (sigurisht Kurani është përtej kësaj). Ata e përmendin ajetin e mëposhtëm si dëshmi për pretendimet e tyre;

**Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) ndonjë ajet, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim një tjetër më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e dini se Zoti ka fuqi për çdo gjë? (Kuran, 2:106)**

Ata që i përdredhin gjuhët e tyre ndaj Kuranit e kanë keqinterpretuar këtë varg për të justifikuar imponimin e fesë së tyre. Ata mendojnë në mënyrë të gabuar, se mund të zhvlerësojnë disa ajete dhe madje t'i zëvendësojnë me hadithe të fabrikuara. Disa kundërshtarë të Islamit, nga ana tjetër, thonë se ajetet që flasin për alkolin apo luftën nuk duhen praktikuar, e me këtë kërkojnë të përçajnë myslimanët.

Interpretimi i vërtetë i këtij ajeti është si vijon;

Fjala arabe "Ajet" tek pasazhi " abrogojmë (pezullojmë) ndonjë ajet " është në numrin njëjës. Kur kjo fjalë përdoret në këtë formë, nënkupton argument ose mrekulli. Kur fjala "ajet" shfaqet në numrin njëjës në Kuran, ajo nënkupton dëshmi apo shenjë, dhe kështu është përkthyer në të gjitha ajetet e tjera. Kur fjala "ajete" përdoret për t'iu referuar vargjeve të Kuranit, nuk shfaqet në numrin njëjës.

Për këtë arsye këtu nuk nënkuptojmë "Ajete (vargje) të Kuranit", por





"shenjë, rregull ose sheriat". Sipas këtij ajeti, disa praktika dhe urdhëresa, të aplikuara nga shoqëritë e mëparshme, të cilave u kanë zbritur libra hyjnore si, hebrenjve dhe të krishterëve, por që ishin lënë pas dore me kalimin e kohës, ose janë abroguar ose janë shfuqizuar. Ngjashëm po ndodh edhe me Kuranin.

Ne gjithashtu duhet të përqëndrohemi në ajet te fjalët "*do të bëjë të harrohet*". Në mënyrë që një urdhëresë të shfuqizojë një tjetër, ai më parë duhet të ketë qenë i "*harruar*". Kurani ka mbetur i pandryshuar për 1400 vjet, pra nuk ka ndonjë rast që një ajet të ketë zëvendësuar tjetrin. Urdhëresat që fanatikët pretendojnë se janë të shfuqizuara, në fakt ato nuk janë lënë në harresë, sepse janë ende në Kuran. Kjo tregon qartë se shfuqizimi, të cilit i referohemi këtu, nuk është zëvendësimi i një ajeti me një tjetër, por shfuqëzim i urdhëresave që janë lënë në harresë prej gjeneratave të mëparshme. Urdhëresat që u janë zbritur popujve të mëhershëm, por që janë lënë në "harresë" janë rikthyer si ligj me shpalljen e Kuranit. Në disa raste ato janë të ngjashme, kurse në raste të tjera janë më të dobishme se urdhëresat në librat e shpallur më parë.





## Kurani është një libër "i mbrojtur"

Zoti ynë në mënyrë të qartë thotë në një ajet, se Kurani është një libër "i mbrojtur".

**Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne jemi mbrojtës të tij. (Kuran, 15:9)**

Është e pamundur për disa vargje të një libri, me të cilat obligohen të gjithë myslimanët dhe i cili është "i mbrojtur", që disa urdhëresa të konsiderohen si të vlefshme, e disa të tjera jo. Përsosmëria e Kuranit në tërësinë e tij, mrekullitë e tij matematikore dhe shkencore, fakti se ky libër është një udhërrëfyes dhe se vargjet e tij ka qenë të ruajtura, të gjitha këto hedhin poshtë pretendimet e fanatikëve dhe të disa kundërshtarëve të Islamit.

**Ata që e mohuan Kuranin kur u erdhi, janë të marrë; ai është një libër ngadhënjyes (i pashoq). Atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit. (Kuran, 41:41-42)**

Le të shohim tani se ku gabojnë rëndë këta njerëz.



## Gabimet në dallimin mes "myslimanëve të periudhës së Mekës" dhe "myslimanëve të periudhës së Medinës"

Disa dashakeqës të Islamit, kur flasin për "myslimanët e periudhës mekase" i quajnë ata si myslimanë të moderuar. Sipas mendimit të tyre, në kohën kur Profeti ynë Muhamed (paqja qoftë me të) ishte në Mekë, mbizotëronte paqja e nuk kishte luftëra, por luftërat filluan papritmas pasi Profeti (paqja qoftë me të) migroi në Medinë. Bazuar në këtë, disa njerëz pretendojnë se ithtarët e luftës në Islam njohin vetëm vargjet e shpallura në periudhën e Medinës, ndërsa myslimanët paqedashës, njohin vetëm ajetet e shpallura në periudhën e Mekës. Ky pretendim është i paarsyeshëm dhe vjen prej injorancës.


Siç e kemi parë tashmë, kusht thelbësor në besimin e një myslimani është besimi në të gjitha ajetet e Kuranit, pa përjashtim. Nëse dikush refuzon një ajet të vetëm, atëherë ai e humb atributin e të qenit një mysliman siç përshkruhet në Kuran. Pra sipas Kuranit, nuk quhet besimtar ai që thotë: "Unë jam mysliman" dhe bën dallimin duke thënë: "Unë e besoj këtë ajet, kurse këtë tjetrin jo."

Është e vërtetë se nuk ka pasur luftime në periudhën e Mekës në jetën e Profetit tonë (paqja qoftë me të), por në periudhën medinase ka pasur luftime dhe vargjet janë zbritur në lidhje me këto beteja të veçanta. Në mënyrë që të kuptojmë arsyet për këtë, ne duhet të kuptojmë kushtet e vështira në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë me të).

## Sprovat e rënda të myslimanëve në periudhën e Mekës

Kurani iu shpall Profetit tonë (paqja qoftë me të) gjatë një periudhe 23 vjeçare. Gjatë 13 viteve të para të kësaj periudhe, myslimanët jetonin si pakicë, nën rendin pagan të idhujtarëve të Mekës dhe ata u përballën me shtypje dhe presione të jashtëzakonshme. Shumë myslimanë u torturuan fizikisht dhe disa u martirizuan, shtëpitë dhe pronat e tyre u plaçkitën dhe

**Myslimanët jetonin si pakicë në shoqërinë pagane të Mekës dhe ishin tejet të ekspozuar ndaj shtypjes. Shumë myslimanë u torturuan fizikisht, disa u martirizuan, shtëpitë dhe pronat e tyre u plaçkitën dhe u përballën me fyerje dhe kërcënime të vazhdueshme. Megjithatë, myslimanët nuk iu përgjigjën dhunës me dhunë, qëndronin larg idhujtarëve dhe i ftonin ata në paqe.**



ata ishin të ekspozuar vazhdimisht ndaj kërcënimeve dhe fyerjeve. Megjithatë myslimanët nuk iu kundërpërgjigjën dhunës, u distancuan nga paganët, por gjithmonë i ftonin ata në rrugën e paqes.

Megjithatë, agresioni i shoqërisë pagane ishte i egër.

Fisi i kurejshëve fillimisht e konsideroi profetësinë e Muhammedit (paqja qoftë me të) si diçka të kotë. Edhe pse nuk besonin tek ai, ata nuk reagan kundër Profetit (paqja qoftë me të), për aq kohë sa ai nuk thoshte asgjë kundër idhujve të tyre. Megjithatë, ata e sulmonin Profetin (paqja qoftë me të) me fjalë. Ata i tallnin dhe i trajtonin padrejtësisht myslimanët. "Sulmi verbal" i kurejshëve filloi në këtë mënyrë.

Kurani e përshkruan qëndrimin e tyre me këto fjalë:

**Mëkatarët ishin ata, të cilët i përqeshnin ata që besuan. Dhe kur kalonin (besimtarët) pranë tyre (idhujtarëve), ata ia bënin me sy njëri-tjetrit. E kur ktheheshin te familjet e tyre, ktheheshin të kënaqur. Dhe kur i shihnin ata (besimtarët), thonin: "S'ka dyshim se këta (besimtarët) janë të humbur!" (Kuran, 83:29-32)**

Meka ishte qendra e idhujtarisë. Meka ishte e tejmbushur çdo ditë, me njerëz që vinin për të vizituar Qaben dhe idhujt rreth saj, duke sjellë përfitim të majmë për kurejshët, si në pasuri ashtu edhe në prestigj. Kurejshët e shihnin përhapjen e Islamit në Mekë si një kërcënim, sepse ata mendonin se kjo do të ishte kundër interesave të tyre dhe do të sillte armiqësinë me fiset e tjera. Ata gjithashtu e dinin se Islami i konsideron të gjithë njerëzit të barabartë dhe nuk bën dallime në bazë të prejardhjes apo pasurisë. Prandaj prijësit e Kurejshëve mendonin se duheshin marrë masa për të ndaluar përhapjen e Islamit. Disa prej këtyre "masave" ishin torturat dhe madje edhe vrasjet e myslimanëve. (*Ibni Hisham, 1/287*)

Paganët e kohës nuk mund t'i dëmtonin disa prej anëtarëve të familjeve të forta dhe të shquara, si psh. Ebu Bekrin dhe Uthmanin, por ata, keqtrajtonin në mënyrë të pamëshirshme myslimanët e varfër dhe të



pambrojtur. Disa prej myslimanëve të ekspozuar ndaj keqtrajttimeve të rënda ishin: Ebu Fakih, Khabbab ibn el-Aratt, Bilal ibn Rabah, Suhejb er-Rumi, Ammar bin Jasiri, Jasir ibn Amir dhe Sumejeh bint Khajjat.

Ky keqtrajtim i myslimanëve u bë thjesht, sepse ishin besimtarë dhe u predikonin Islamin të tjerëve. Pavarësisht shtypjes, torturës dhe dhunës, myslimanët kurrë nuk reagueshin ndaj atyre që i kishin shtypur, sepse Islami nuk inkurajon kthimin me të njëjtën monedhë dhe nuk u përpoqën të paktën për të mbrojtur veten e tyre, e cila është e drejta më themelore e njeriut. Duke parë se myslimanët nuk po reagonin, kurejshët rritën agresivitetin dhe torturat e tyre. Kurejshët në fjalë filluan martirizimin e myslimanëve.

Kur situata u përkeqësua, myslimanët - të cilët nuk reagueshin as për të mbrojtur veten e tyre, sepse Kurani e ndalon derdhjen e gjakut - e kishin të pamundur të qëndronin më gjatë në Mekë. Për këtë arsye ata emigruan në Medinë.

### **Periudha e Medinës dhe betejat**

Kur ashpërsia e sulmeve të idhujtarëve në Mekë u rrit, myslimanët emigruan në qytetin e Jethribit (më vonë u quajt Medina), ku gjetën një klimë më të mirë dhe më miqësore dhe atje ngritën administratën e tyre. Megjithatë, edhe pasi ata krijuan strukturat e tyre politike, sulmet nga paganët e Mekës nuk u ndalën. Kurejshët i ndoqën myslimanët dhe nuk hoqën dorë nga sulmet e dhunshme kundër tyre. Por Profeti ynë (paqja qoftë me të) dhe myslimanët pranë tij nuk iu përgjigjën idhujtarëve me luftë.

Nuk ka individ, komunitet apo shtet në botë, që nuk do të përgjigjej në qoftë se do të sulmohej. Ata gjithmonë reagojnë ndaj agresorit për "vetëmbrojtje" dhe në fund të fundit marrin edhe masa mbrojtëse. Njerëzit të cilët angazhohen për vetëmbrojtje, janë të shfajësuar nga ligjet

ndërkombëtare dhe po ashtu edhe popujt që luftojnë për vetëmbrojtje, janë të justifikuar në bazë të së drejtës ndërkombëtare, sepse ata kanë qenë subjekt i një sulmi të padrejtë, ku rrezikohen jetët e njerëzve, nderi, familjet, të afërmit dhe territoret e vendit.

Në vargjet e mëposhtme, të cilat janë shpallur pas emigrimit në Medinë, Profetit tonë (paqja qoftë me të) i është dhënë leje të vetëmbrohet për veten dhe për komunitetin e tij.

**Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtësi, e Allahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (myslimanëve). (U lejua të luftojnë) Ata, të cilët thanë:**



**"Allahu është Zoti ynë!" u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte ... (Kuran, 22:39-40)**

Me këto vargje, myslimanët, që kishin qenë të detyruar padrejtësisht të emigronin vetëm sepse thanë: "Zoti ynë është Allahu", filluan nga përgatitjet për të mbrojtur veten e tyre. Siç thuhet shprehimisht në ajet, myslimanëve "u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtësi" dhe u lejohet të mbrojnë veten e tyre dhe jo të sulmojnë të parët. Pas shpalljes së këtij ajeti, myslimanët filluan të mbrojnë veten e tyre dhe luftuan kundër bashkësisë së egër që i kishte sulmuar ata. Vargjet e shpallura më pas, të cilat bëjnë fjalë për luftën dhe mbrojtjen, përmbajnë

**Paganët e asaj kohe i keqtrajtonin dhe i torturonin myslimanët në mënyrën më barbare, e cila nuk ishte dëgjuar më parë. Profetit tonë (paqja qoftë me të) i jepet leje të vetëmbrohet si për veten, ashtu edhe për komunitetin e tij, në mënyrë që t'i bëjë ballë sulmeve dhe shtypjes.**



detaje lidhur me rregullat gjatë luftimeve që ndodhën në atë kohë. Për ta thënë në një mënyrë tjetër, një përshkrim i veçantë është dhënë për situatën në atë luftë. Prandaj, të gjitha ajetet në lidhje me luftën në Kuran u zbuluan posaçërisht duke iu referuar betejave të veçanta që ndodhën në atë kohë, për të na njohur me kushtet e vështira të kohës dhe me drejtësinë e Profetit tonë (paqja qoftë me të).

### **Cilat ishin betejat në kohën e Profetit (paqja qoftë me të)?**

Një pikë e rëndësishme që duhet të mbahet mend në lidhje me betejat e përshkruara në Kuran është "qëllimi i vërtetë" i luftimeve. Disa burime fetare dhe historike thonë se betejat në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë me të) ishin kundër hebrenjve. Por disa njerëz që i lexojnë ato referenca, me qëllimin për të kërkuar për antisemitizëm në Kuran, pretendojnë se ajetet e shpallura për beteja specifike në Kuran, janë në përgjithësi kundër hebrenjve. Megjithatë, ky është një konstatim i gabuar.

Ishin paganët që u angazhuan në persekutimin kundër Pejgamberit tonë (paqja qoftë me të) dhe myslimanëve. Kryesisht ata ishin idhujtarë. Qëllimi i tyre ishte që të mbronin idhujt e tyre dhe besimet perverse. Disa ishin hipokritë dhe politeistë që kishin ardhur prej bashkësive hebraike, por kjo do të ishte shumë e gabuar për t'i etiketuar këta si hebrenj. Në të njëjtën mënyrë, nëse do të ishte e gabuar të quaje një politeist ose hipokrit prej bashkësisë myslimane si "mysliman", po aq e gabuar është t'i konsiderojmë politeistët dhe hipokritët, të cilët ishin nga hebrenjtë si "hebrenj". Një hebre i vërtetë nuk e fillon luftën i pari dhe nuk vret besimtarë të pafajshëm.

Kurani e mallkon anti-semitizmin. Për këtë arsye, dështojnë ata që kërkojnë armiqësi ndaj hebrenjve në Kuran; njerëz të cilët i interpretojnë vargjet në fjalë si urdhëresë për të luftuar kundër hebrenjve duhet ta



kuptojnë këtë fakt. Profeti ynë (paqja qoftë me të) gjithmonë ka pasur marrëdhënie të mira me hebrenjtë. Ai i ka trajtuar ata me respekt dhe dashuri, dhe po me të njëjtin respekt dhe dashuri e kanë trajtuar hebrenjtë e devotshëm Profetin tonë (paqja qoftë me të). Kjo temë është shpjeguar në detaje më vonë në kapitullin në lidhje me ithtarët e Librit. (Shih kapitullin "Këndvështrimi i Islamit mbi ithtarët e Librit")

### **Përshkrimi i luftës në Kuran**

Kurani është mjaft i qartë se kur dhe si duhet të zhvillohet lufta:

**Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë (që e fillojnë luftën të parët). (Kuran, 2:190)**

Lufta lejohet vetëm **kundër atyre që sulmojnë myslimanët**; ajo duhet të jetë një **luftë mbrojtëse**. Në Kuran është e ndaluar që myslimanët të **sulmojnë** palën tjetër pa asnjë shkak.

Zoti i urdhëron myslimanët në Kuran, se duhet të respektojnë gjithmonë drejtësinë edhe nëse janë të zemëruar me një popull, për shkak të padrejtësive dhe agresionit të tij. Zoti e zbulon këtë në një ajet:

**O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini frikë Allahun, se Allahu di hollësisht për atë që veproni. (Kuran, 5:8)**

Për shembull, në një ajet Zoti i ndalon myslimanët t'i kalojnë kufijtë, në lidhje me ata që përpiqen për të ndaluar myslimanët nga hyrja në Qabe, duke i këshilluar që t'i trajtojnë jomyslimanët dhe të gjithë të tjerët me mirësi:

**... Urrejtja ndaj një populli, që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre. Ndhimohuni mes vete në mirësi dhe mbarësi, e hiqni dorë prej mëkateve e armiqësisë. Kini frikë prej dënimit të Allahut... (Kuran, 5:2)**

Myslimanët janë paralajmëruar nga Zoti i Plotfuqishëm që të mos i kalojnë kufijtë, edhe pse ata qëllimisht kanë qenë penguar nga kryerja e obligimit të tyre fetar, e Haxhit (pelegrinazhit) dhe janë trajtuar padrejtësisht. Zoti i urdhëron myslimanët që të sillen me drejtësi edhe kur u bëhet padrejtësi dhe i urdhëron ata të sillen mirë dhe të mos jenë të zemëruar. Pavarësisht rrethanave myslimanët e kanë detyrim ta zbatojnë këtë urdhëresë në Kuran.

Ky ajet që justifikon luftën vetëm për vetëmbrojtje, gjithashtu përmban edhe një kriter tjetër të luftës: të mos tejkalohet masa. Kjo do të thotë se në rast të ndonjë sulmi, një mysliman duhet thjesht të mbrojë veten e tij, pra nuk duhet reaguari dhe nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim tjetër, përveç masave mbrojtëse. Me fjalë të tjera, agresioni, dhuna, zemërimi dhe ekstremizmi janë të ndaluara në Kuran.

Vargje të tjera, që obligojnë për t'u angazhuar vetëm në luftë mbrojtëse kundër agresorëve, janë si më poshtë:

**Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që janë të drejtë. Allahu ua ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj... (Kuran, 60: 8-9)**

Ekziston një dallim i rëndësishëm këtu. Për myslimanët është e paligjshme që të sulmojnë njerëzit që kurrë nuk i kanë luftuar, edhe nëse ata janë kundërshtarë të fuqishëm të pikëpamjeve të myslimanëve. Një



mysliman ka përgjegjësinë për t'i trajtuar njerëzit e tillë me respekt dhe drejtësi. Sipas këtij ajeti, myslimanët lejohen që të angazhohen në luftë mbrojtëse vetëm kundër njerëzve, të cilët kanë ushtruar shtypje për shkak të besimit dhe janë sulmuar fizikisht prej tyre, pra me fjalë të tjera, kundër agresorëve. Natyrisht që gjithkush do të mbrojë veten në qoftë se e sulmojnë. Kjo është e drejta e çdo individi, qyteti apo kombi dhe gjithashtu është gjëja më e mirë për t'u bërë.

Fakti se Profeti ynë (paqja qoftë me të) nuk luftoi për t'u mbrojtur, derisa iu shpallën ajetet që e lejojnë luftën, është një shembull i përkryer i sakrificës së madhe dhe i përkushtimit fetar. Deri në atë kohë, Profeti ynë (paqja qoftë me të) kishte përdorur vetëm rrugën e kompromisit, duke u përpjekur për të bindur palën tjetër, siç kërkohet nga ajeti "**... polemizo me ata në mënyrën më të mirë ...**" (Kuran, 16: 125) edhe pse qëllimi i vetëm i kurejshëve paganë ishte shfarosja e myslimanëve.

Mbasi qartësuam këtë pikë të rëndësishme, ne tani duhet të shqyrtojmë të gjitha vargjet që ithtarët e bestytnive dhe kundërshtarët e Islamit i ofrojnë



si dëshmi, për dhunën e kryer gjoja në emër të Islamit; ne do të hedhim poshtë pretendimet e tyre të gabuara mbi këtë temë.

Para se të shohim në këto vargje, ne kemi nevojë të dimë se të gjitha betejat e përshkruara në Kuran, janë zhvilluar kundër një komuniteti të caktuar në atë rajon, dhe se aty përmenden edhe kriteret e duhura. Ky komunitet ishte politeist dhe me të kishin edhe një marrëveshje. Prandaj, të gjitha këto beteja janë për shkak të sjelljes dhe agresionit të komunitetit në fjalë, i cili kishte shkelur marrëveshjen e paqes dhe të miqësisë. Vargjet e shpallura në atë kohë tregojnë situatën politike dhe përshkruajnë klimën që mbizotëronte.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë këtë fakt, le të shohim se ç'nënkuptojmë me fjalën "politeist" në atë kohë dhe cilat ishin marrëveshjet e nënshkruara me ata.

### **Marrëveshjet me politeistët**

Edhe pse, sipas disa komenteve të kohës, fjala politeist do të thotë thjesht "të barazuarit e diçkaje me Zotin", termi në të vërtetë i referohet paganëve që adhurojnë idhuj njësoj siç adhurohet Zoti; ata u besojnë hyjnive të panumërta dhe ata nuk janë pjesë e myslimanëve, hebrenjve, sabeasve, të krishterëve apo adhuruesve të zjarrit.

Kur Kurani i referohet feve të ndryshme, që ekzistonin në Arabi gjatë kohës së ardhjes së Islamit, politeistët i përmend gjithmonë si një grup i veçantë. Duke hulumtuar periudhën e Profetit tonë (paqja qoftë me të), edhe pse u ishte lejuar të martoheshin me gratë prej ithtarëve të librit,



hebrenjve dhe të krishterëve dhe të përdornin ushqimet e tyre, myslimanëve u ishte ndaluar të martoheshin me gratë ose të hanin ushqim të gatuar prej adhuruesve të zjarrit, sabiinëve dhe idhujtarëve.

Pasi Profeti ynë (paqja qoftë me të) emigroi në Medine, ai nënshkroi marrëveshje me politeistët dhe me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë në rajon dhe pavarësisht qëndrimeve ekstreme të idhujtarëve, ai i ftoi ata të bashkoheshin për hir të paqes. Kjo provoi se njerëzit me besime dhe gjuhë të ndryshme mund të jetojnë në paqe. Një nga provat më të mëdha, se ai ishte një lajmëtar i paqes dhe i dashurisë, është se letra e parë që kishte shkruar, ishte një marrëveshje paqeje. Pas çlirimit të Mekës, Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) i fali të gjithë politeistët që kishin torturuar myslimanët dhe i trajtoi ata me dhembshuri të madhe. Ky virtyt i lartë, i moralit të Profetit Muhamed (paqja qoftë me të) ishte diçka që nuk ishte hasur më parë në shoqërinë arabe, ndaj dhe u prit me admirim të madh.

Profeti (paqja qoftë me të) është një model për të gjithë myslimanët në çështjen e zbatimit të drejtësisë në territoret e pushtuara. Profeti ynë (paqja qoftë me të) e zbatoi drejtësinë e shpallur në Kuran për banorët e vendeve që ishin nën përgjegjësinë e tij dhe bëri marrëveshje të cilat siguronin të dyja palët, se do të kishin të drejta të barabarta. Profeti ynë (paqja qoftë me të) dhe shokët e tij ishin ata që sollën drejtësinë mes njerëzve, siç shprehet në ajetin:

**"Në mesin e atyre që kemi krijuar, ka prej njerëzve që udhëzojnë në të drejtën dhe veprojnë sipas saj." (Kuran, 7:181)**

Marrëveshja që Profeti ynë (paqja qoftë me të) ka bërë me popullin e krishterë të Nexhranit, në jug të gadishullit Arabik, është një nga shembujt më të mirë të mirëkuptimit dhe drejtësisë.

Në një prej neneve të traktatit thuhet si më poshtë:

**"Jetët e njerëzve të Nexhranit dhe e rrethinave të saj, feja e tyre, toka,**

**pronat, kafshët dhe ata prej tyre të cilët janë të pranishëm apo mungojnë, të dërguarit e tyre dhe vendet e tyre të adhurimit, janë nën mbrojtjen e Zotit dhe nën kujdestarinë e Pejgamberit të Tij ."**

*(Pakti i Nexhranit, neni 6, [http://www.islamicresources.com/Pact\\_of\\_Najran.htm](http://www.islamicresources.com/Pact_of_Najran.htm))*

Pas marrëveshjeve me të gjitha shoqëritë në atë rajon, Profeti ynë (paqja qoftë me të) themeloi shtetin e Medinës duke hartuar kushtetutën e parë në historinë e Islamit, Kushtetutën e Medinës. Ky ishte shembulli i parë dhe më i përsosur i një kushtetute demokratike dhe shumëpalëshe.

### **Kushtetuta e parë shumëpalëshe dhe më demokratikja: Kushtetuta e Medinës**

Me Kushtetutën e Medinës, që ishte kushtetuta e parë e shtetit të Medinës, Profeti ynë (paqja qoftë me të), si kurrë më parë, solli një rend demokratik dhe paqësor në Gadishullin Arabik, në një popullatë të përbërë prej feve, fiseve dhe racave të ndryshme.

Sipas kësaj kushtetute, të gjitha komunitetet në Medinë do të jetojnë së bashku në paqe, duke organizuar jetën e tyre në bazë të besimit dhe bindjeve të tyre, të cilat kanë fuqinë për të vepruar dhe rregulluar institucionet dhe ligjet e tyre. Duke bërë këtë, ata do të jetojnë së bashku në paqe dhe unitet me të gjitha komunitetet në Medinë.

Kushtetuta e Medinës u shkrua në vitin 622, nën udhëheqjen e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të) rreth 1400 vjet më parë, për t'iu përgjigjur kërkesave të njerëzve me besime të ndryshme; ajo ka ardhur deri ne ditët tona e shkruar si një traktat ligjesh. Si rezultat i kësaj, në këtë kushtetutë janë përfshirë komunitete të feve dhe të racave të ndryshme, që ishin armiq për 120 vjet. Me anë të kësaj marrëveshjeje, Profeti (paqja qoftë me të) tregoi se konfliktit në mes komuniteteve mund t'i jepet fund. Dikur ishin armiqësorë ndaj njëri-tjetrit, sepse nuk bënë kompromis me njëri-tjetrin, por mbas marrëveshjes ata mund të jetojnë së bashku në paqe.

Sipas Kushtetutës së Medinës, të gjithë ishin të lirë të bënin zgjedhjet e tyre fetare, politike apo filozofike, pra ishin të lirë nga çdo presion prej dikujt tjetër. Ata mund të krijonin bashkësinë e tyre me ata që kishin pikëpamje të njëjta. Gjithkush ishte i lirë të ushtronte sistemin e tij të drejtësisë. Pra, kush nuk thyente ligjin, nuk kishte nevojë për mbrojtje nga dikush tjetër. Palët në marrëveshje duhet të ndihmonin dhe mbështetnin njëri-tjetrin dhe ato do të ishin nën mbrojtjen e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të). Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të gjykoreshin tek i Dërguarit i Zotit (paqja qoftë me të). Madje, edhe politeistët preferonin gjykimin e Profetit tonë (paqja qoftë me të), pasi ai ishte më i drejti nga të gjithë.

**Kushtetuta e Medinës ishte pluraliste dhe ishte kushtetuta e parë më demokratike në histori. Ajo mbronte jo vetëm të drejtat e myslimanëve, por edhe të drejtat e të gjithë pjesëtarëve të besimeve të tjera, madje edhe të idhujtarëve.**



Ky traktat hartuar nga Pejgamberi ynë (paqja qoftë me të) u zbatua fazë pas faze mes viteve 622 dhe 632. Nëpërmjet kësaj kushtetute, njerëzit u larguan prej strukturës fisnore të bazuar në lidhjet e gjakut dhe të familjes. Si rrjedhim njerëzit me rrënjë shumë të ndryshme gjeografike, kulturore dhe etnike u bashkuan për të qenë një tërësi. Kushtetuta e Medinës gjithashtu siguroi lirinë e besimit dhe të fesë. Në një nga pikat thuhet:

**"Hebrenjtë e fisit Beni 'Auf janë një komunitet së bashku me besimtarët. Hebrenjtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët kanë fenë e tyre."** (*Kushtetuta e Medinës, <http://www.islamic-study.org/jews-prophet-page-2.htm>*)

Kushtetuta e Medinës përbëhet nga 47 nene. Nga neni 1 deri në nenin 23 flitet për të drejtat e myslimanëve, ndërsa nenet nga 24 e deri te 47, bëjnë fjalë për hebrenjtë që u vendosën në Medinë. Referenca e bëra për të krishterët, të cilët ishin shumë të paktë në numër, është gjithashtu një fakt i rëndësishëm përse i përket pjesëmarrjes në marrëveshje të besimeve të ndryshme.

Një analizë e Kushtetutës së Medinës, në artikullin me titull "Një rivlerësim i Marrëveshjes së Medinës sipas Perspektivës Pluraliste të Profesor Leonard Swidler" thekson se Kushtetuta është një dokument i rëndësishëm, që tregon për përpjekjet e Profetit në bashkimin e qytetit dhe afrimin e grupeve së bashku rreth ligjit, i cili ishte i qartë dhe i kuptueshëm për njerëzit.

Sipas këtij raporti, çdo individ kishte të drejta të barabarta, secili gëzonte lirinë për të zgjedhur fenë e tij dhe për të zgjedhur nëse do të luftonin në një ushtri së bashku me myslimanët. Por, u ndalohej të bënin marrëveshje me armikun, dhe kjo ishte një përpjekje për të krijuar një solidaritet të pathyeshëm ndërmjet grupeve të Medinës. Autori i raportit, thotë se ky traktat politik dhe fetar synonte në krijimin e një shoqërie të re, duke u bazuar në vlerat e barazisë dhe lirisë. Siç theksohet në Kushtetutë, epërsia e ligjit mbi individin ishte hapi themelor në arritjen e qëllimit për të siguruar një atmosferë të dialogut dhe bashkëjetesës. Nenet e Kushtetutës gjithashtu nënkuptonin përgjegjësinë e barabartë të çdo individit në



mbrojtjen e qytetit. Sipas këtij raporti, duke pasur parasysh që emrat e të gjitha grupeve në qytet janë përmendur një nga një, Kushtetuta - dhe po ashtu Profeti - i njihje të gjitha këto komunitete si legjitime. (*Kenan Çetinkaya, Amerika'da Diyalog anlayışı ve Medine Vesikası [Understanding of Dialogue in America and Medina Charter]*)

Teksti i Kushtetutës së Medinës tregon se myslimanët ishin mbrojtës të të drejtave dhe ligjeve të idhujtarëve dhe ata dëshironin që këta politeistë të bashkëpunonin me myslimanët në mbrojtjen e Medines. Një qëndrim i tillë ndaj politeistëve nuk është aspak për t'u habitur, sepse në Kuran, myslimanët kanë përgjegjësi për të mbrojtur politeistët, me të cilët ata kanë nënshkruar marrëveshje, madje edhe me koston e jetës së tyre. (Kjo do të shtjellohet në kapitujt në vazhdim.)

Në përfundim, kushtetuta në fjalë konsiderohet si një dokument shumë i rëndësishëm që përmban bërthamën e unitetit, bashkimit, dashurisë, mëshirës, miqësisë, paqes dhe paraqet një shembull të dialogut mes myslimanëve dhe besimeve të tjera në përgjithësi, dhe në mes të myslimanëve dhe hebrenjve në veçanti. Koncepti i dashurisë dhe i paqes së Profetit tonë (paqja qoftë me të) është bazuar në Kuran, por në kohën që ne jetojmë, është e vështirë të identifikosh një shoqëri myslimane, që vë në zbatim të njëjtat koncepte. Fakti që kushtetuta e parë më demokratike në histori është shkruar dhe zbatuar nga Profeti ynë (paqja qoftë me të) është dëshmi shumë e rëndësishme.

Kapitujt pasues të këtij libri duhet të vlerësohen nën dritën e këtij fakti. Praktikrat e sotme të ithtarëve të bestytnive janë tërësisht të ndryshme nga këshillat e Kuranit të Shenjtë, i cili urdhëron mbrojtje për politeistët, ndërsa për ithtarët e librit (hebrenjtë dhe të krishterët) thekson statusin e veçantë që gëzojnë ata tek myslimanët. Po ashtu edhe hadithet e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të) gjithmonë këshillojnë për paqe dhe demokraci. Ithtarët e bestytnive janë gjithmonë në kërkim të konfliktit në Kuran, por Kurani këshillon gjithmonë për paqe. Ky fakt i rëndësishëm nuk duhet neglizhuar gjatë interpretimit të ajeteve që flasin për luftën.



## *Karta e Profetit Muhamed për të drejtat e krishterëve*

*(Letër për murgjit e Manastirit të Shën Katerinës)*

*Ky është një mesazh nga Muhammed ibn Abdullah, si një garantues për ata që përqafojnë krishterimin, qofshin afër apo larg, ne jemi me ata.*

*Vërtet unë, shërbëtorët, ndihmuesit dhe pasuesit e mi i mbrojnë ata, sepse, Të krishterët janë qytetarët e mi dhe betohem në Allah, se unë do të jem kundër çdo gjëje që i mundon ata.*

*Nuk ka detyrim për ata.*

*As gjykatësit e tyre s'kanë për t'u hequr nga postet e as murgjit nga manastiret e tyre.*

*Askush nuk do të shkatërrojë ose do të dëmtojë qoftë edhe një shtëpi të besimtarëve të tyre, apo do të rrëmbejë ndonjë gjë për t'ua dhënë myslimanëve.*

*Kush rrëmben prej tyre, ai ka prishur besëlidhjen me Zotin dhe nuk i është bindur të Dërguarit të Tij. Vërtet, të krishterët janë aleatët e mi dhe kanë garancinë time kundër gjithçkaje që ata urrejnë.*

*Askush nuk do t'i detyrojë ata që të udhëtojnë, apo të luftojnë.*

*Myslmanët duhet të luftojnë për ata.*

*Në qoftë se një e krishterë dëshiron të martohet me një mysliman, kjo nuk duhet të ndodhë pa miratimin e saj. Ajo është e lirë të vizitojë kishën e saj për t'u lutur.*

*Kisha e tyre duhet respektuar. Ata s'duhën ndaluar në riparimin e kishave të tyre dhe nuk duhen ndaluar as në shenjtërimin e besëlidhjeve të tyre.*

*Të gjithë (myslimanët) duhet të respektojnë marrëveshjen deri në Ditën e Fundit (fundi i botës).*

**Përgjatë shekujve, kjo kartë e të drejtave është nderuar dhe zbatuar me besnikëri nga myslimanët, kudo ku ata sundonin.**



## Ajetet që flasin për luftën dhe interpretimi i tyre

Mbasi u njohëm me përkufizimin e luftës në Kuran, le të shqyrtojmë ajetet që flasin për luftën, të cilët keqpërdoren nga disa radikalistë dhe që hidhen si akuza nga disa kundërshtarë të Islamit:


### *Shqyrtimi i ajetit 191 në Suren El-Bekare:*

**Dhe luftojini ata kudo që t'i zini, dëbojini ata nga vendi, sikurse ju dëbuan juve. Provokimi (fitneja) është më i rëndë se vrasja. Mos i luftoni ata në Mesxhid el-Haram (Qabe), derisa ata t'ju luftojnë juve aty. E nëse ju sulmojnë, atëherë i sulmoni edhe ju ata. I këtitillë është ndëshkimi ndaj jobesimtarëve. (Kuran, 2:191)**

Ky ajet është shpallur pasi myslimanët iu nënshtruan presioneve të rënda dhe dhunës, ndaj u detyruan të emigrojnë nga Meka në Medinë. Arsytet i kemi diskutuar në hollësi më lart, pra myslimanëve u lejohet të mbrojnë veten kundër sulmeve të drejtpërdrejta. Politeistët nuk rreshtën kurrë së shtypuri myslimanët dhe ata refuzuan të dëgjojnë thirrjet e besimtarëve për paqe dhe marrëveshje.

Megjithatë, ajeti gjithashtu përmban një kujtesë të rregullave të luftës: **"Mos i luftoni ata në Mesxhid el-Haram (Qabe), derisa ata t'ju luftojnë ju atje. E nëse ju sulmojnë, atëherë i sulmoni edhe ju ata."** Siç e shohim, u lejua të luftohej, për shkak se pala tjetër sulmoi e para. Nëse ata nuk bëjnë luftë, në qoftë se ata nuk sulmojnë, atëherë është e ndaluar për myslimanët që t'i luftojnë idhujtarët.

Kjo është sigurisht shumë e habitshme, se si radikalistët dhe kundërshtarët e Islamit që e keqinterpretojnë ajetin, injorojnë këtë dispozitë shumë të rëndësishme. Ajeti në mënyrë të





qartë i lejon myslimanët të luftojnë vetëm për vetëmbrojtje. Vargu nuk urdhëron për luftë mësymëse apo agresion.

Një tjetër element i rëndësishëm në ajet është shpallur si vijon: "**Provokimi** (fitneja) **është më i rëndë se vrasja.**" Nxitja duke inkurajuar dhe përhapur urrejtje, anarki, shpifje dhe gënjeshtria për të futur njerëzit në armiqësi, është provokim (fitne) dhe ajeti na tregon se fitneja është më e keqe se vrasja. Kështu, komunitetet që sulmojnë myslimanët, haptazi ose në mënyrë të fshehtë, janë ata që shkaktojnë fitne dhe dëmi që ata bëjnë është shumë i madh. Natyrisht kur agresioni ngre krye, myslimanët duhet të mbrojnë veten e tyre.

Disa fanatikë, duke u bazuar në thashetheme apo paragjykime, deklarojnë se disa individë, shoqëri ose besime po përhapin fitne. Pastaj ata kërkojnë prova nga ajetet e Kuranit për supozimet e tyre, por kjo është jashtëzakonisht e gabuar. Fitneja përfshin veprimet që çojnë në korrupsion, të tilla si përçarje në mesin e myslimanëve, duke i çuar ata në humbje dhe në mëkat dhe duke shkakuar të gjitha llojet e trazirave mbi ata, e më pas ajo sjell krijimin e infrastrukturës për kryengritje masive dhe angazhime në sulme fizike dhe verbale ndaj myslimanëve. Prandaj, para se të akuzojnë dikë për fitne, ata duhet të kenë fakte se janë kryer një apo më shumë nga këto akte përçarëse. Ata që kërkojnë të akuzojë hebrenjtë apo Izraelin, si të angazhuar në fitne e kanë keqkuptuar këtë ajet.

Sipas Kuranit, është mëkat të akuzohen të gjithë hebrenjtë apo Izraeli, si të angazhuar në fitne. Njerëz të cilët përhapin fitne, ka në çdo fe apo vend. Ashtu siç është e palogjikshme t'i përgjithësosh të gjithë arabët, turqit apo myslimanët si provokues, thjesht sepse ka disa arabë, turq apo myslimanë të cilët angazhohen në fitne, në të njëjtën mënyrë, nuk mund të përgjithësohen të gjithë hebrenjtë si

provokues. Sipas Kuranit, myslimanit i lejohet të drekojë në shtëpinë e një çifuti, mund të jetë mysafir i tij dhe mik, madje mund edhe të martohet me një grua çifute (kjo do të sqarohet në detaje në kapitullin "Këndvështrimi i Islamit mbi ithtarët e Librit"). Duke qenë kështu, është e ndaluar për myslimanin që të përgjithësojë të gjithë hebrenjtë si njerëz që kërkojnë trazira. Siç thamë në fillim, njerëzit të cilët kanë pretendime të tilla, nuk dinë asgjë rreth Kuranit dhe këto pretendime janë si rezultat i injorancës dhe i ndikimit prej haditheve të panumërta të fabrikuara, në lidhje me njerëzit që përhapin trazira dhe në lidhje me hebrenjtë. Pozita e ithtarëve të Librit në Kuran do të shqyrtohet në kapitujt vijues.

#### *Shqyrtimi i ajeteve 89, 90 dhe 91 në Suren En-Nisa':*

Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, sikurse nuk besuan vetë dhe të bëheni të njëjtë. Mos zini miq prej tyre derisa ata të shpëngulen (si ju) për hir të Allahut, e nëse refuzojnë, atëherë kudo që t'i gjeni, kapini dhe vritini dhe prej tyre mos zini as mik e as ndihmës. (Kuran, 4:89)

Përveç atyre që strehohen te një popull, me të cilin keni marrveshje, dhe përveç atyre që vijnë te ju, e u vjen rëndë të luftojnë kundër jush ose kundër popullit të tyre. Sikur Allahu të donte, do t'u jepte atyre fuqi e pushtet mbi ju dhe ata do t'ju luftonin. Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju lejon të luftoni kundër tyre. (Kuran, 4:90)

Ju do të hasni në të tjerë, që duan të sigurohen te ju (duke u paraqitur si besimtarë) dhe të sigurohen te populli i tyre (si jobesimtarë). E, saherë që thirren, (kundër jush) i përgjigjen thirrjes. Në qoftë se nuk largohen prej jush, nuk ju ofrojnë paqe dhe nuk heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë kapini dhe vritini kudo që t'i takoni. Kundër tyre u kemi dhënë fakte të qarta. (Kuran, 4:91)

Këta ajete u referohen hipokritëve. Ata pretendojnë se janë myslimanë, se jetojnë në mesin e myslimanëve dhe janë prej tyre, por në fakt ushqejnë një armiqësi të madhe ndaj Zotit dhe Islamit dhe përpiqen t'i godasin myslimanët pas shpine. Zoti shpall se ata që vdesin si hipokritë, do të jenë në shtresën më të ulët të ferrit. Siç mund të shihet, për shkak të natyrës së saj dyfytërëshe dhe të pabesë, hipokrizia është një tipar njerëzor tejet i rrezikshëm dhe i neveritshëm, krejt ndryshe nga mohuesit apo idhujtarët.

Në ajetin 89 të Sures En-Nisa' myslimanët urdhërohen që të mos miqësohen me hipokritët e të braktisin myslimanët, sepse hipokritët përpiqen në dëm të myslimanëve. Lufta kundër tyre justifikohet vetëm atëherë kur hipokritët angazhohen në sulme fizike ndaj myslimanëve. Ne e shohim këtë tek ajeti 90 që vijon. Siç është e qartë nga fjalët **"Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju lejon të luftoni kundër tyre"**, pra ndalohet lufta ndaj një komuniteti që nuk angazhohet në sulme. Pra është mjaft e qartë, lufta është e lejuar ndaj atyre që u kanë shpallur luftë myslimanëve dhe i kanë sulmuar të parët. Myslimanët kanë të drejtën për të mbrojtur veten e tyre përballë këtyre sulmeve.

Përveç kësaj, ajeti 90 i Sures En-Nisa' në Kuran është një tjetër manifestim i drejtësisë, i faljes, i dashurisë dhe i paqes. Disa hipokritë, të cilët deri atëherë i kishin tradhtuar dhe i kishin qëlluar me thikë pas shpine myslimanët, por që më vonë kanë mbajtur një qëndrim paqësor, myslimanët nuk duhet t'i sulmojnë. Në ajetin vijues lexojmë: **"Përveç atyre që strehohen te një popull, me të cilin keni marrëveshje, dhe përveç atyre që vijnë te ju, e u vjen rëndë të luftojnë kundër jush ose kundër popullit të tyre"**. Në të njëjtin varg Zoti thotë: **"Në qoftë se ata tërhiqen prej jush, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju lejon të luftoni kundër tyre"** duke theksuar përsëri imunitetin e tyre. Ky është përkufizimi i vërtetë i drejtësisë.

Vargu 91 përmban një situatë, e cila përshkruhet me të njëjtat kushte për ata hipokritë që pendohen dhe që thonë se nuk duan të luftojnë, e më vonë u kthehen provokimeve dhe fillojnë sulmin ndaj myslimanëve. Në këtë rast, dispozita lidhur me luftën në Kuran është se ata janë të mbrojtur për aq kohë sa nuk sulmojnë, por në qoftë se ata fillojnë luftën, atëherë vetëmbrojtja është legjitime.

Ne duhet të kujtojmë se situata e përshkruar në ajet ishte specifike për betejën e Uhudit dhe ka të bëjë me ata hipokritë, të cilët tradhtuan në fushën e betejës.

#### *Shqyrtimi i ajetit 5 në Suren Et-Teube:*

**E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t'i gjeni, i robëroni dhe i ngujoni ata, e u zini pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zekatin, atëherë ua lëshoni rrugën, se vërtet Allahu falë dhe është mëshirues. (Kuran, 9: 5)**

Për të kuptuar ajetin e mësipërm ne duhet të lexojmë edhe ajetin 1 të Sures Et-Teube; në këtë mënyrë do të kuptojmë se lufta nuk shpallet ndaj "të gjithë politeistëve", por vetëm kundër atyre që vrasin myslimanët dhe që më pas **i përmbahen marrëveshjes**, në mënyrë që të mos luftojnë gjatë muajve të shenjtë. Politeistët në këtë rast, janë ata të cilët me dinakëri i kanë përndjekur myslimanët dhe i kanë luftuar ata gjatë muajve të shenjtë. Ata kanë vrarë myslimanë **edhe pse kanë bërë marrëveshje dhe kanë qenë të sigurtë se myslimanët nuk do të hyjnë në luftë gjatë muajve të shenjtë.**

Në këto kushte, myslimanëve u jepet leje, me të drejtë, për të mbrojtur veten kundër sulmeve barbare. Siç tregohet në ajet, edhe pse politeistët kanë kryer masakra në muajt e shenjtë, myslimanët nuk u janë përgjigjur me luftë gjatë këtyre muajve, sepse kështu i kishte urdhëruar Zoti. Besimtarët



duruan gjatë këtyre muajve dhe filluan të mbrohen vetëm pasi përfunduan muajt e shenjtë. Ne gjithashtu vërejmë se vargu përshkruan taktikat e mbrojtjes: konfiskim dhe rrethim në të gjitha rrugët. Disa prej masave kryesore të luftës, në bazë të së drejtës ndërkombëtare janë rrethimi dhe konfiskimi. Rrethimi kryhet me qëllim që palës tjetër t'i pengohet lëvizja. Ky ajet pra përshkruan taktikat tashmë të miratuara dhe të konsideruara si legjitime sipas ligjit ndërkombëtar. I vetmi ndryshim është se nuk janë myslimanët që sulmojnë, ata janë thjesht duke u përpjekur për t'i dhënë fund sulmeve kundër tyre.

Gjithashtu në këtë varg na bëhet e qartë se ata që ndalojnë sulmet e tyre dhe pendohen, duhet të lirohen.

Kur vërejmë ajetin e mëposhtëm, hasim një deklaratë shumë të rëndësishme, që përshkruan frymën e dashur dhe të paqtë të Kuranit. Ky ajet hedh poshtë të gjitha pretendimet e bëra nga kundërshtarët e Islamit në lidhje me myslimanët. Ajeti thotë:

**E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjojë fjalët e Allahut (Kuranin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt, sepse ata janë një popull që nuk dinë (të vërtetën e fesë islame). (Kuran, 9:6)**

Nëpërmjet këtij ajeti, myslimanët këshillohen që të ndihmojnë një politeist, i cili kërkon strehim dhe ndihmën e tyre, edhe në qoftë se jeta e tyre rrezikohet. Ajeti madje sugjeron se një mysliman duhet **të jetë si një mburojë** për të mbrojtur të tillë politeistë. Për ta thënë në një mënyrë tjetër, edhe pse rrezikon jetën e tij, myslimani ka përgjegjësi që të mbrojë dhe t'i shpëtojë jetën atij që mohon Zotin.

Kjo është ajo që urdhëron Kurani. Sipas këtij urdhri, ndalohet të vriten njerëzit, sepse nuk kanë besuar në Zot. Pra, ai duhet të mbrohet, edhe me

koston e jetës së myslimanëve. Për këtë arsye, lufta justifikohet jo sepse pala tjetër nuk beson në Zot, ose i përket një besimi tjetër. Lufta bëhet e lejuar atëherë kur pala tjetër torturon dhe vret njerëz të pafajshëm.

Një fakt tjetër që është saktësuar në ajet, është se të gjithë njerëzit do të jenë nën mbrojtjen e myslimanëve, për aq kohë sa ata nuk sulmojnë ose nuk angazhohen në akte ekstreme, pavarësisht fesë, gjuhës, përkatësisë etnike apo besimeve të tyre. Një mysliman ka përgjegjësinë të mbrojë ithtarët e Librit (të krishterët dhe hebrejtë), apo ateistin dhe komunistin, në të njëjtën mënyrë siç mbron myslimanët e tjerë; kjo është një urdhëresë për myslimanët; ky është përshkrimi i një myslimani në Kuran. Nëse dikush thotë: "Unë jam mysliman," ai duhet të jetë mbrojtës i të pafajshmëve.

#### *Shqyrtimi i ajetit 13 në Suren Et-Teube:*

**Përse të mos e luftoni një popull që thyen zotimet e tij dhe tentoi ta dëbojë të dërguarin? Në të vërtetë luftën e filluan ata të parët. A u frikësoheni atyre? Më e drejtë është t'i frikësoheni Allahut, nëse jeni besimtarë. (Kuran, 9:13)**

Ky është një ajet tjetër në Kuran që sqaron urdhëresat lidhur me luftën. Një komunitet politeist që kishte ardhur për një armëpushim me myslimanët, pra që të jetonte në paqe me ata, siç garantohej në marrëveshje, e thyen atë dhe fillon luftën. Ata u përpoqën ta detyronin Profetin tonë (paqja qoftë me të) të linte vendin e tij dhe të emigronte; dhe ashtu siç thuhet qartë në ajet - **luftën e filluan ata të parët** - myslimanët kishin të drejtën e tyre të kundërpërgjigjeshin me luftë.

***Shqyrtimi i ajetit 33 në Suren El-Maideh:***

Dënimi i atyre që luftojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të vriten ose të gjymtohen, t'u priten duart dhe këmbët e tyre në anët e kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ata në këtë botë, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. (Kuran, 5:33)

Subjekti, që kemi theksuar në të gjitha ajetet që flasin për luftën, është i qartë gjithashtu edhe në këtë ajet. Edhe këtu janë përcaktuar në detaje, karakteristikat e popullit ndaj të cilit shpallet luftë: Ata bëjnë luftë kundër fesë së Zotit dhe kundër Profetit të Tij dhe po ashtu bëjnë shkatërrime kudo. Këta njerëz jo vetëm që angazhohen në sulme fizike ndaj myslimanëve, por ata gjithashtu përhapin korrupsionin në të gjithë botën. Ajeti flet për një komunitet që është një problem i madh për të gjithë botën, këta janë njerëzit e çoroditur, të korrumpuar dhe agresorë.

Si në të gjitha luftërat, ndodhin vrasje për t'i rezistuar një populli që ka deklaruar në mënyrë të hapur luftë ndaj myslimanëve. Përsa kohë ky është një mjet i fundit, një nga masat parandaluese është largimi i njerëzve prej tokave të tyre. Sipas Kuranit, myslimanët në gjendje lufte janë të lejuar të ndër marrin akte që në kushte paqeje janë të ndaluara, të tilla si vrasja e mizorëve ose dëbimi i tyre në mërgim.

***Shqyrtimi i ajetit 57 në Suren El-Enfal:***

Po nëse i ndesh ata në luftë, atëherë ti shpartalloji ata që të marrin mësim. (Kuran, 8:57)

Ne gjithashtu duhet të vlerësojmë këtë ajet në dritën e perspektivës dhe provave deri në detaje. Ajo që nuk duhet të harrohet, është se disa ajete u shpallën gjatë një periudhe luftimesh intensive në Medinë. Ky ishte thjesht rezultati i padrejtësisë së kryer ndaj myslimanëve, ashtu siç thuhet në një ajet: **"të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte, vetëm pse thanë: "Zoti ynë është Allahu"..."** (Kuran, 22:40). Për më tepër, ajeti në suren En-Nisa' thotë: **"Nëse ata qëndrojnë larg jush, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Zoti jua ka ndaluar luftën kundër njerëzve të tillë."** Myslimanët kanë përgjegjësinë të ndalojnë luftimet dhe jo të fyejnë të tjerët.

Disa vargje para ajetit 57 të Sures El-Enfal, u referohen komuniteteve me të cilët myslimanët kishin arritur marrëveshje. Si pothuajse në çdo ajet, Zoti jep lejen të luftohet për vetëmbrojtje, sepse këto komunitete kishin thyer armëpushimin e tyre me myslimanët duke i sulmuar ata.

Është e rëndësishme të formohet një forcë, e cila parandalon krijimin





e grupimeve që angazhohen në sulme të vazhdueshme. Grupime të tilla refuzojnë të dëgjojë arsyeën dhe bëjnë trazira, duke thyer vazhdimisht marrëveshjet paqësore. Nëse këto fenomene parandalohen, njerëzit që dëshirojnë të përhapin trazira, nuk do të ketë fuqinë për ta bërë këtë dhe nga ana tjetër, grupimet e tjera politike që duan të shkaktojnë korrupsion dhe akte të dhunshme, nuk do të kenë guximin për ta bërë këtë. Kjo është një masë e nevojshme dhe e rëndësishme parandaluese, jo vetëm për komunitetin, i cili thyen çdo traktat paqeje, por edhe për ata që duan të parandalojnë konfliktet e mëvonshme.

Në kushtetutat e të gjitha vendeve të botës dhe në të drejtën ndërkombëtare, sanksionet "parandaluese" konsiderohen si të një rëndësie të veçantë. Qëllimi kryesor është parandalimi i veprave penale. Këto masa parandaluese, sipas të drejtës ndërkombëtare, janë të domosdoshme dhe do të ishte e padrejtë, nëse një shtet ligjor nuk i aplikon këto masa kur është fjala për Islamin.

#### *Shqyrtimi i ajetit 4 në Suren Muhamed:*

**Pra, kur t'i takoni (në luftë) ata që nuk besuan, goditini në qafë derisa t'i rraskapitni, atëherë lidhini, e pastaj, ose i lironi me zemërgjerësi, ose kërkoni dëmshpërblim derisa të bëhet armpushimi. Kështu pra, sikur të donte Allahu do të hakmerrej ndaj tyre, por Ai dëshiron t'ju sprovtojë me njëri - tjetrin. Ai nuk ua humb veprat atyre që ranë në rrugën e Allahut. (Kuran, 47: 4)**

Ashtu si vargjet e tjera, edhe ky ajet flet për situatën e luftës. Traktati është thyer, politikeistët janë hedhur në ofensivë dhe nuk ka asnjë alternativë tjetër veç luftës ndaj agresionit. Ky ajet përshkruan rregullat ndërkombëtare të luftës. Përveç kësaj, ai gjithashtu përshkruan diçka që nuk është aplikuar

sipas rregullave ndërkombëtare të luftës: pra lirimin e të burgosurve menjëherë pasi lufta ka përfunduar. Edhe pse lufta në Afganistan ka përfunduar, të burgosurit e luftës janë duke u mbajtur ende në Gjirin e Guantamos në Kubë; OKB dhe NATO, e konsiderojnë këtë burgosje si legjitime. Por Kurani nuk e konsideron këtë burgosje si legjitime: Në këndvështrimin e Islamit, kur lufta merr fund, të gjithë të burgosurit duhet të lirohen menjëherë.

Vargjet që bëjnë fjalë për luftën, janë të përshkruar qartë si luftë mbrojtëse kundër politeistëve dhe hipokritëve, të cilët për shkak të



**Sipas ligjit islam, lufta është e lejueshme vetëm për qëllime mbrojtëse dhe të burgosurit e luftës duhet të lirohen kur lufta përfundon. Kjo është një praktikë që gjendet edhe sot në ligjet ndërkombëtare të luftës. Në të vërtetë, të burgosurit nga konfliktet e kaluara, janë ende duke u mbajtur në kushte të vështira, në burgje si ai në Guantamo.**



armiqësisë përhapnin trazira dhe korrupsion. Arsyeja kryesore pse këto vargje janë keqinterpretuar dhe përdoren nga radikalistët për rritjen e zemërimit dhe urrejtjes, është se Islamit po i mvishen prej disa analistëve qindra hadithe të rreme. Megjithatë, Kurani duhet të lexohet me një mendje të pastër dhe të ndritur, larg ndikimit prej të gjitha haditheve të rreme dhe bestytnive të tjera. Domethënia e këtyre ajeteve është e qartë si kristali, nëse shqyrtohen në kontekstin e kohës.

### **Në Islam nuk ka asnjë justifikim për luftën**

Ata që pretendojnë se Islami është përhapur përmes luftës dhe është një fe militantësh (sigurisht Islami është përtej kësaj), duhet ta kuptojnë se një këndvështrim i tillë, në fakt është diametralisht i kundërt me mësimet e Islamit. Të gjitha idetë e gabuara në lidhje me Islamin, rrjedhin nga hadithet e fabrikuara dhe nga bestytnitë e stisura pas shpalljes së Kuranit dhe pas vdekjes së Profetit Muhamed (paqja qoftë me të). Disa grupe radikale, bazuar në këto hadithe të fabrikuara, keqinterpretuan Islamin dhe sollën disa shpjegime për të justifikuar luftën. Ata sajuan justifikime për sulmet e tyre ndaj jomyslimanëve, madje edhe për sulmet mbi ata myslimanë që kishin pikëpamje të ndryshme.

Siç kemi shpjeguar në detaje më sipër, në Kuran nuk ka asnjë justifikim për luftë. Kurani ofron një përshkrimin të qartë të demokracisë dhe të lirisë njerëzore. Në një klimë demokracie dhe lirie nuk ka arsye për ta denoncuar palën tjetër si armik, apo për t'ia hequr asaj të drejtën e fjalës. Në këtë klimë, të gjithë janë të respektuar dhe të gjithë mund të flasin lirshëm dhe pikërisht, kjo është klima e përshkruar në Sheriatin Islam. Prandaj, në Kuran nuk ka asnjë justifikim për luftën. Por, sipas sheriatit të sajuar prej pasuesve të bestytnive, ka arsye të panumërta për të luftuar, për të sulmuar dhe për të vrarë. Le të shqyrtojmë këtë fakt përmes ajeteve të Kuranit.



## Konvertimi me anë të luftës është i ndaluar në Islam

Ata që imponojnë Islamin nëpërmjet luftës, detyrimit apo dhunës, kanë tradhtuar Kuranin. Një nga deklaratat më të qarta në Kuran është se "nuk ka dhunë apo detyrim në pranimin e fesë": **Nuk ka dhunë në fe ....** (Kuran, 2: 256)

Ky është një urdhër i qartë i Kuranit. Asnjë mysliman s'mund ta kundërshtojë këtë dhe të detyrojë dikë tjetër që të besojë. Kjo është e ndaluar shprehimisht në Kuran.

Profeti ynë (paqja qoftë me të) është vetëm një këshillues. Ai kishte përgjegjësinë që t'u predikonte dhe t'u prezantonte të gjithë njerëzve Islamin, zbulesën e fundit. Në atë kohë, disa nga ata që dëgjuan për Islamin nga goja e Profetit tonë (paqja qoftë me të) dhe e myslimanëve të tjerë, besuan, ndërsa të tjerët nuk besuan. Siç kërkohet shprehimisht nga Kurani, as Profeti ynë (paqja qoftë me të) dhe as myslimanët e tjerë bashkë me të,





nuk qenë ndonjëherë të detyruar për të besuar. Profeti ynë (paqja qoftë me të), është përkujtuar në Kuran; **"E ti pra këshillo, se je vetëm përkujtues, Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!"** (Kuran, 88: 21-22). Prandaj, detyrimi për të besuar është absolutisht i ndaluar.

Sipas Kuranit, të gjithë myslimanët e kanë për detyrë t'u tregojnë njerëzve vlerat morale të Islamit, por askush nuk mund të detyrojë dikë dhe t'i thotë: "Ti duhet të bëhesh mysliman" ose "Ju duhet të kryeni ritet fetare." Qëllimi i Kuranit është të sjellë dashuri dhe paqe në botë. Për këtë arsye, një fenomen i tillë është i papajtueshëm me Kuranin.



Ja disa vargje të tjera në të cilat detyrimi për të besuar është i ndaluar:

**E ti thuaj: E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë le të besojë, e kush të dojë le të mohojë.... (Kuran, 18:29)**

**Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin që të gjithë në tokë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? (Kuran, 10:99)**

**Ne e dimë mirë se çfarë thonë ata, e ti ndaj atyre nuk je dhunues; ti këshilloje me këtë Kuran, atë që i druhet premtimit (dënimit) Tim. (Kuran, 50:45)**

**Thuaj: "O ju jobesimtarë!" Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni! As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time! (Kuran, 109: 1-6)**

Islami respekton të gjitha ideologjitë, të gjitha kombet, të gjitha grupet etnike, të gjitha idetë dhe të gjitha besimet. Islami është një fe në të cilën, të gjitha idetë duhen dëgjuar. **Lufta për shkak të përplasjes së ideve, apo përplasjes së etnive është sigurisht e ndaluar në një besim, me një botëkuptim të tillë të shkëlqyer, të demokracisë dhe lirisë.**

### **Lufta nuk mund të zhvillohet për superioritetin ideologjik apo etnik**

Islami respekton të gjitha ideologjitë, kombet, grupet etnike, idetë dhe të gjitha besimet. Islami është një fe në të cilën, të gjitha idetë duhen dëgjuar. Lufta për shkak të përplasjes së ideve, apo të përplasjes së etnive, sigurisht është e ndaluar në Islam, i cili zotëron një botëkuptim të tillë të shkëlqyer, të demokracisë dhe lirisë.

### **Lufta nuk mund të zhvillohet me qëllim të përhapjes së rregullave të Islamit, të parashtruara nga një udhëheqës mysliman**

Sipas Kuranit, një lider mysliman duhet të jetë dikush, i cili gjithashtu përfshin në komunitetin që ai drejton të krishterë, hebrenj, ateistë, komunistë, agnostikë, budistë dhe njerëz që ndjekin besime dhe sisteme

të tjera ideologjike. Ai duhet t'u sigurojë atyre lirinë e plotë të ideve. Ai duhet t'u sigurojë njerëzve liri të plotë.

Konflikti, shpifjet dhe hipokrizia shfaqen aty ku mungon liria. Ai duhet ta parandalojë atë dhe të praktikojë atë që kërkon Kurani. Në një ajet thuhet: "**O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër** (interesit) **vetes tuaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve...**" (Kuran, 4: 135) çdo besimtar ka përgjegjësi për të ruajtur drejtësinë, pa marrë parasysh për individët, besimet apo origjinën edhe në qoftë se kjo bie ndesh me interesin e tij.

### **Ndalohet lufta për të eliminuar ata që konsiderohen si "armiq"**

Vallë si mund të ketë armiq në Islam? Islami është një fe, që kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të barabartë dhe vëllezër. Sipas Islamit, pa marrë parasysh, se cila është ngjyra, gjuha, feja, raca, nënshitetësia ose pozita shoqërore, ai është i denjë për respekt për vetë faktin se ai është një qenie njerëzore. Sipas të gjitha feve të shpallura, qeniet njerëzore janë vëllezër dhe ne të gjithë jemi fëmijët e Profetit Adem (paqja qoftë me të). Ky parim i vëllazërisë është kriter në besimin fetar.

Islami është kundër të gjitha ideologjive fashiste dhe filozofive darviniste / materialiste, që janë të bazuara në superioritetin racial dhe që i ndajnë njerëzit në kategori të rreme, të tilla si "të përparuara" dhe "primitive". Feja angazhohet në një luftë intelektuale dhe racionale, kundër konflikteve që mbartin këto ideologji dhe nuk mund t'i pranojë ato brenda vetes.

Rregulli në Islam, se çdo qenie njerëzore është e denjë për respekt, paraqet bazën e të gjitha marrëdhënieve ndërmjet njerëzve. Në pikëpamje të Islamit, edhe dikush që vepron gabimisht, ka gjithmonë mundësi për t'u kthyer në drejtim të së mirës. Prandaj është e pamundur për një mysliman të vërtetë, që të ketë armiq. Çdo mysliman ka përgjegjësinë t'i

trajtojë të tjerët me dashuri dhe t'i ftojë ata të virtytet morale dhe jo të bëjë armiq, apo të komplotojë për t'i rrënuar të tjerët.

Sipas Kuranit nuk ka dallim mes njerëzve, përse i përket superioritetit, sepse termi "bijtë e Ademit", tregon se në këtë aspekt, të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë:

**Ne me të vërtetë i nderuam bijtë e Ademit, u mundësua të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira dhe i vlerësua ata (i lartësua) prej shumicës së krijesave që Ne i krijuam. (Kuran, 17:70)**

Edhe pse nuk ka asnjë pretekst nga ajetet që lexuam më sipër, fakti se disa pretendojnë se kjo është një fe e luftës, e ka burimin prej akteve të ithtarëve të bestytive. Disa njerëz kanë ide të gabuara në lidhje me Islamin, sepse ata nuk janë në dijeni të vërtetës dhe ata u referohen mendimeve të radikalistëve. Njerëzit me mendësi radikaliste nuk janë në dijeni se ata janë duke aplikuar urdhëresat që nuk gjenden në Kuran dhe kanë zgjedhur një besim krejt të ndryshëm nga Islami i vërtetë. Megjithatë, feja e Islamit dhe Sheriati janë të bazuara në ajetet kuranore. Burime të tjera që janë të bazuara në hadithe të fabrikuara apo bestytini, nuk bëjnë pjesë në besimin e një myslimani të vërtetë. Pra, a janë myslimanët ata të cilët dëshirojnë luftë?

### **Kush dëshiron luftë?**

Spektori i armatimit financohet nga grupe të caktuara. Ai është gjithashtu i vetmi sektor që nuk preket nga kriza ekonomike. Ky është një sektor dinamik, në të cilin kërkesa dhe oferta kurrë nuk mungojnë dhe risitë janë gjithmonë të pranishme në treg. Pa asnjë mëdyshje, ajo që e mban gjallë këtë sektor është "lufta". Për këtë qëllim, një masë e paditur e njerëzve, të cilët e konsiderojnë fenë e tyre si një fe të luftës dhe të cilët janë të



Zakonisht janë grupet radikale ato që nxisin për të bërë luftë, sepse lufta u nevojitet për të realizuar qëllimet e tyre dashakeqe. Injoranca ka "rëndësi jetike" për grupet në fjalë. Injoranca u nevojitet për të justifikuar mjetet, me të cilat do të arrijnë qëllimin e tyre.



gatshëm të vrasin dhe të vriten, me fjalë të tjera, grupet radikaliste që shfaqen në emër të Islamit, janë të manipuluar.

Disa neokonservatorë dhe kundërshtarë të Islamit në Perëndim, kanë konstatime të sakta në lidhje me dhunën që po përhapet nga radikalistët. Megjithatë, këta njerëz kanë ide të gabuara në lidhje me disa udhëheqës, si psh. Osama bin Laden. Të tillë udhëheqës të ashtuquajtur, në përgjithësi nuk kanë interes për Islamin dhe për myslimanët, por ata mbahen gati, nën mbikëqyrjen e shërbimeve të ndryshme të inteligjencës. Kur nevojitet një klimë trazirash apo lufte, ata përfshihen menjëherë. Ata e kalojnë kohën e tyre në baret dhe në kafenetë e vendeve perëndimore, por kur u vjen urdhëri, ata rrisin mjekrat, ndryshojnë veshjen dhe gjuhën e tyre, sikur të ishin arabë nga Lindja e Mesme dhe nxitojnë për të vënë në zbatim mësimet bestytnore që ata kanë mësuar gjatë viteve.

Ky skenar është bërë realitet disa herë; Osama bin Laden ishte vetëm një nga aktorët e këtij skenari. Ardhja e Hazreti Mehdiut (paqja qoftë me

të), e cila është një nga shenjat në Fundin e Kohës, profetizuar nga Profeti ynë (paqja qoftë me të), u shfrytëzua nga disa qarqe - për shkak edhe të ndjeshmërisë që myslimanët kanë mbi këtë temë - për të dhënë përshtypjen se vetë Bin Laden ishte Mehdiu dhe për këtë janë bërë përpjekje për të bindur shumë njerëz. Plani që filloi me Bin Ladenin goditi jo vetëm Afganistanin, por të gjithë botën myslimane; skenari do të përmbylej me imazhet e trupit të vdekur të Bin Ladenit. Kjo ishte ndoshta pjesa më e habitshme e këtij plani. Sipas këtij plani, bota myslimane do të shihte se Mehdiu i tyre është i vdekur dhe kështu do të humbnin të gjitha shpresat. Ky ishte një skenar sistematik që synonte dobësimin dhe shfrytëzimin e mëtejshëm të botës islame.

**DHUNA, URREJTJA DHE  
MIZORIA JANË TIPARE  
TË RADIKALISTËVE.  
KËTO TIPARE NUK  
KANË VEND NË ISLAM.**

Disa të ashtuquajtur  
udhëheqës fetarë vënë në  
lëvizje çdo mjet kur është e  
nevojshme për të sajuar  
luftë dhe trazira.  
Ata survejohen nga njësi të  
ndryshme të inteligjencës  
dhe luajnë rolin e tyre në  
luftën ku janë të  
angazhuar.

Njerëzit me mentalitet radikalist janë padyshim fajtorë, por ne nuk duhet të injorojmë burimet që i ushqejnë ata. Përsa kohë industria e armatimit është kaq e fortë, lufta do të jetë gjithmonë në shërbim të interesave të disa njerëzve. Zakonisht janë grupet radikaliste ata të cilët nxiten për të luftuar, por nxitja vjen nga ata që dëshirojnë luftë, për të realizuar qëllimet e tyre të liga. Këto grupe radikaliste të gatshme për luftë, për shkak të injorancës së tyre janë një "maskim" i përkryer, për ata që veprojnë prapa kuintave; për pasojë ata që dërgohen në luftë, janë lehtësisht të instrumentalizuar.

Amerikanët apo evropianët, të cilët shqetësohen për radikalistët, nuk duhet të harrojnë menaxherët që kanë marrë përsipër drejtimin e këtyre grupeve. Kjo natyrisht nuk i zbut krimet e atyre që kanë rënë pre e kthetrave të grupeve radikaliste dhe e ithtarëve të bestytnive. Ata janë ndarë në sekte dhe e konsiderojnë njëri-tjetrin armik, ndaj ky realitet nuk duhet injoruar. Në të vërtetë, disa organizata të ndryshme që haptazi organizojnë dhe menaxhojnë protesta dhe kryengritje, veçanërisht në vendet myslimane, janë duke shprehur hapur dhe pa kurrfarë ngurrimi qëllimet e tyre.


Duke marrë parasysh këtë, në mënyrë që të ketë paqe, përpara interesit personal duhet dhënë përparësi asaj që është pozitive për mbarë shoqërinë; lakmisë për zaptime dhe hasmërive duhet t'u japim fund, por edhe mentaliteti fanatik duhet çrrënjësuar. Besimet e vërteta, vlerat morale fetare, besimtarët dhe Kurani, që të gjithë janë të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi. Rritja e konflikteve bazuar mbi ambicjet politike, ekonomike, territoriale apo ideologjike, na kanë vënë përballë sfidave të paimagjinueshme. Ajo çfarë mund të bëjmë, është arsimimi i duhur për të kuptuar besimin e vërtetë, por duke përdorur Kuranin si pikë referimi. Ky edukim mund të eliminojë të gjitha këto gabime dhe të shuajë të gjitha armiqtë. Pasi të ndryshojë mentaliteti i njerëzve, nuk do të ketë arsye për armiqtë apo për luftë dhe e vetmja mënyrë për të arritur këtë mendësi ndryshe, është edukimi sipas moralit të Kuranit



### **Një fakt i rëndësishëm që ushqen radikalizmin: Guantanamo**

Një raport i CIA-s u botua në një edicion tërësisht të rifreskuar në fillim të vitit 2015. Raporti tërhoqi vëmendje të madhe në të gjithë botën. Edhe pse ishte një fakt i njohur, se SHBA-të kanë torturuar rëndë të burgosurit e akuzuar si të dyshuar, sidomos pas 11 shtatorit, në këtë raport gjenden të dokumentuara akte të torturës.

Bota tashmë kishte kuptuar diçka për aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës në SHBA pas 11 Shtatorit, nëpërmjet fotografive nga burgu famëkeq Abu Ghraib, por edhe prej mënyrave të persekutimit në Guantanamo, apo prej deklaratave të dëshmitarëve dhe të paraburgosurve të liruar. Tortura është një praktikë që është përdorur edhe para 11





shtatorit në SHBA, por gjithë bota mësoi nga ky raport, detajet rreth metodave të reja të torturës dhe çfarë mjete janë përdorur për të paguar ekspertët dhe për të zbatuar këto teknika. Pra, çfarë përfitoi në të vërtetë SHBA apo bota e lirë prej këtyre viteve të ushtrimit të torturës?

Ne fare lehtë mund t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje - "asgjë". Senatori amerikan Harry Reid pranon, se nga torturat, SHBA nuk fitoi gjë tjetër përveç emrit të keq.<sup>1</sup> Në kundërshtim me disa republikanë, pas shqyrtimit tronditës të gjashtë milionë faqeve të dokumenteve të CIA-s, hulumtuesit kanë konfirmuar se agjensia nuk arriti të përthithte në kohë informacionet e duhura.

Është një fakt i njohur, se është gati e pamundur për të marrë në kohë reale informacione të sakta në lidhje me organizatat radikaliste e terroriste nga liderët apo anëtarët e saj. Terroristët në posedim të informacioneve të tilla nuk janë kapur, sepse ata ose janë qëlluar nga forcat e sigurisë ushtarake, ose nga ato policore,



ose kanë bërë vetëvrasje para se të kapen. Kjo ka ndodhur kohë pas kohe. Megjithatë, shqyrtimi i profileve të njerëzve të kapur dhe të burgosur nga SHBA, tregon se shumica ishin vënë nën arrest pa bërë rezistencë. Janë burgosur njerëz pa ndonjë akuzë të vërtetë, ndaj dhe mjaft prej dëshmvive të tyre, janë dhënë vetëm e vetëm për t'i dhënë fund torturës. Prandaj, ky mësim historik edhe një herë tregon se terroristët që posedojnë informacione - që mund të nxirren përmes torturës - nuk mund të kapen të gjallë.

Një tjetër pikë ku ne duhet të përqëndrohemi janë vlerat që SHBA-ja lufton për të mbrojtur; por ç'vend zënë torturat në mesin e këtyre vlerave? SHBA-të dëshirojnë që njerëzit e saj të jenë të lirë e jo të jetojnë me frikën e terrorit; ajo dëshiron të ndërtojë një vend në të cilin, vlerat e saj tradicionale janë të ruajtura në paqe dhe qetësi. Ajo shpenzon trilionat dollarë për këtë qëllim, por nga ana tjetër me vetëdije sakrifikon jetët e mijëra të rinjve amerikanë në fushën e betejës. Qëllimi i vetëm është që të ngrihem për vlerat amerikane dhe të sfidojmë çdo kërcënim ndaj tyre.

Siç e dimë të gjithë, edhe pse SHBA është e qeverisur nga një kushtetutë laike, ajo e përshkruan veten si një shoqëri e krishterë e cila është shumë më konservatore se ajo e Evropës. A nuk është Bibla, shkrimi i shenjtë i kësaj bashkësie konservatore, që mëson për dashuri, dhembshuri, falje dhe unitet? Cili i krishterë mund të mbështesë idenë, që një person, i cili ka kryer ndonjë krim meriton të torturohet barbarisht deri në vdekje? Cili i krishterë mund të jetë i kënaqur me jetët e pafajshme të humbura për këtë arsye? Nëse SHBA dëshiron të ngrihet për vlerat e saj, ajo duhet të mbetet e paluhatur ndaj atyre vlerave edhe në kohë të vështira. Duke folur në Senat, Dianne Feinstein, senatorja e Kalifornisë dhe anëtare e Partisë Demokratike, pranoi gjithashtu se tortura ishte një njollë për vlerat që mbart Amerika.<sup>2</sup>

Tortura nuk është mjet për të luftuar, por pjesë e kulturës së mizorisë. Informacioni i mbledhur përmes torturave gjatë 12 viteve të luftës, nuk ka ndihmuar në eliminimin apo dobësimin e grupeve terroriste të tilla si Al-Kaeda. Përkundrazi, organizatat terroriste janë rritur dhe forcuar përmes dhunës, egërsisë dhe mizorisë, duke u shtrirë në shumë pjesë të botës<sup>3</sup> dhe janë bërë edhe më kërcënuese duke krijuar grupe të reja. Prej sulmeve të SHBA-së humbën jetën shumë civilë. Në vend të hedhjes së bombave, duhej filluar një fushatë intelektuale, për të luftuar idealet që e ushqejnë Al-Kaedën. Përpjekja për të eliminuar me anë të ushtrisë, njerëzit e ndikuar nga këto ideale, çoi në zgjerimin e sferës së aktivitetit të organizatave terroriste duke inkurajuar nëngrupe të tjera që të bashkohen me ato.<sup>4</sup>

Përgjigjia ndaj një akti shkatërrues, me një metodë edhe më shkatërruese, nuk mund të parandalojë akte të tjera shkatërruese. Dhuna gjithmonë do të sjellë më shumë dhunë, dhe gjakderdhja do të sjellë gjakderdhje të mëtejshme. Prandaj, përdorimi i taktikave radikale në luftën kundër terrorizmit, thjesht do të rezultojë në një rreth vicioz, që nuk bën gjë tjetër, por vetëm konfirmon pretendimet e këtyre organizatave terroriste dhe forcon bazën e tyre. Kjo do të thotë të mbash derën hapur për konflikte të mëtejshme, deri në pambarim. Nëse duam që brezat e ardhshëm të jetojnë në një klimë paqeje, ku respektohen të drejtat e njeriut, ne duhet të kthehemi në themelin e dashurisë së përbashkët dhe të zemërgjerësisë.

---

1. <http://www.startribune.com/politics/national/285227921.html>

2. <http://www.nytimes.com/2014/12/10/world/senate-intelligence-committee-cia-torture-report.html>

3. 9/11 Ten Years After, Perspectives and Problems, Edited by Rachel E. Utley, Chapter 2, "Ten Years of Britain's War Against Al Qaeda," Warren Chin.

4. <http://www.foreignaffairs.com/articles/67467/leah-farrall/how-al-qaeda-works>

Thuaj: "Erdhi e vërteta dhe  
u zhdruk e kota. Vërtetë e kota  
gjithmonë ka qenë e zhdukur."

(Kuran, 17:81)





# GABIMET E RADIKALISTËVE DHE E VËRTETA

Nje tjetër ide që ne duhet të shqyrtojmë së bashku me atë të terrorizmit, është fenomeni i radikalizmit.

Me radikalizëm nënkuptojmë transformim të papritur në çdo sferë, i cili arrihet me anë të revolucioneve shkatërrimtare dhe zbatimit të një politike të rreptë e pakompromis. Radikalistët karakterizohen nga dëshira të zjarrrta për ndryshime revolucionare dhe nganjëherë ata adoptojnë qëndrime agresive.

Si në çdo sferë të jetës, udhëzues për myslimanin janë ajetet e Kuranit dhe jeta e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të). Kur ne analizojmë radikalizmin, përmes dritës së Kuranit, shohim se ai nuk ka lidhje me mënyrën me të cilën Zoti i urdhëron besimtarët. Kur Zoti përshkruan një besimtar në Kuran, Ai e përshkruan atë, si një njeri i dashur, i butë, që i shmang konfliktet dhe debatet e kota dhe që sillet me njerëzit arrogantë me butësi dhe miqësi.

Një shembull për këtë çështje është urdhëresa që Zoti i dha Musait dhe Harunit (paqja qoftë me ata), që të shkojnë te Faraoni dhe t'i flasin atij me butësi:

**Shko te Faraoni se ai i ka tejkaluar kufijtë. I thoni atij fjalë të buta, se ndoshta ai do të kujtohet e frikësohet. (Kuran, 20:43-44)**

Faraoni ishte një prej mohuesve më mizorë dhe më rebelë të kohës së tij. Ai ishte një despot që e mohonte Zotin dhe nga padija adhuronte idhujt; për më tepër, ai i torturonte besimtarët (izraelitët e kohës) me mizori të tmerrshme dhe vrasje. Por Zoti i urdhëroi profetët e Tij, që të shkonin te ky njeri mizor dhe t'i flisnin atij me butësi.

Ju do të vini re, se rruga e treguar nga Zoti ishte rruga e dialogut miqësor dhe jo rruga e konfliktit me fjalë të ashpra, slogane plot zemërim dhe protesta të trazuarra..

### ***Disa shembuj të komunikimit të këndshëm në Kuran***

Në dialogun mes Profetit Shuajb (paqja qoftë me të) dhe mohuesve, ka disa shembuj për myslimanët se si të komunikojnë. Ky dialog rrëfëhet në Kuran, në këtë mënyrë:

**Edhe Medjenit (i dërguam) vëllain e tyre Shuajbin që ju tha:**

**"O popull im, adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij, mos matni e as mos peshoni mangut, unë po shoh se jeni në begati dhe unë po frikësohem për ju, nga dënimi që do t'ju përfshijë një ditë. O populli im, veproni drejt gjatë matjes dhe peshimit, e mos i dëmtoni njerëzit në asgjë dhe mos shkaktoni rrëmujë në tokë. "Atë pjesë që ua lejoj Allahu është shumë më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë, e unë nuk jam ruajtësi juaj." Ata thanë: "O Shuajb, a namazi yt po të thotë të na urdhërosh, që ta braktisim atë që e adhuroan prindërit tanë,**

ose (po të urdhëron)  
për të punuar me pasurinë  
tonë ashtu si të dëshirojmë?  
Vërtet, ti qenke i butë e i mençur"! "O populli  
im, çfarë mendoni nëse unë kam argumente të sigurta nga Zoti im  
dhe nga ana e Tij. Ai më furnizoi mua me të mira (si mund të mos  
ju udhëzoj në rrugë të drejtë)? Unë nuk dua t'ju kundërshtoj (duke  
punuar) për atë nga e cila po ju ndaloj, unë nuk dua tjetër vetëm  
të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me  
ndihmën e Allahut, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm tek Ai  
jam drejtuar. (Kuran, 11: 84-88)





Kur ne shqyrtojmë atë që thotë Profeti Shuajb (paqja qoftë me të), shohim se ai i ftoi njerëzit që të besojnë në Zot dhe të përqafojnë parimet e larta morale dhe ai e bëri këtë me dashamirësi dhe përlësi. Ne do të shpjegojmë disa pasazhe që përmenden në këto vargje:


- Kur Profeti Shuajb i tha popullit "**unë nuk jam ruajtësi juaj**", ai nuk donte t'i dominonte ata, qëllimi i tij i vetëm ishte t'i udhëzonte ata në të vërtetën që Zoti ia kishte zbuluar. - "**Vërtet, ti qenke i butë e i mençur**": Këto fjalë të mohuesve ndaj Profetit Shuajb, tregojnë karakterin e tij të ngrohtë, të butë dhe të sjellshëm dhe se kjo u vlerësua nga mohuesit.

- "**O populli im, çfarë mendoni**": Kjo shprehje e përdorur nga Profeti Shuajb, tregon se ai i bën thirrje mohuesve të përdorin inteligjencën dhe ndërgjegjen e tyre. Me fjalë të tjera, ai nuk përdor presion duke këmbëngulur, por vë në pikëpyetje idetë e tyre nga një qëndrim i ndryshëm dhe i fton ata ta marrin në konsideratë dhe të arrijnë një përfundim të bazuar në ndërgjegjen e tyre të lirë.

- "**Unë nuk dua t'ju kundërshtoj** (duke punuar) **për atë nga e cila po ju ndaloj**". Urdhëresa e Profetit Shuajb këtu në fakt nuk është një ndalim. Ai shpjegon se disa vepra janë mëkate dhe i fton njerëzit që t'i braktisin ato. Për më tepër, kur Profeti Shuajb i thotë: "**Unë nuk dua t'ju kundërshtoj**", qëllimi i tij nuk është që të polemizojë me popullin;

ai nuk u thotë fjalë të pakëndshme që të nxisë grindje; ai dëshiron vetëm t'i ftojë ata në besim dhe në rrugën e parimeve të larta morale.

Nëse ju shqyrtoni Kuranin, ju do të shihni se të gjithë





profetët karakterizohen nga sjellja e ngrohtë, e butë dhe e mëshirshme. Zoti shpall se Profeti Ibrahim (paqja qoftë me të) ishte "**i dhembshur dhe i butë**" (Kuran, 9: 114). Në një ajet tjetër, në lidhje me parimet morale, Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) është përshkruar në këtë mënyrë:

**Në saj të mëshirës së Allahut u solle butësisht me ata. Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai. (Kuran, 3:159)**

### ***Zoti i urdhëron njerëzit që të shmangin fjalët e ashpra***

Një karakteristikë e dukshme e radikalizmit është zemërimi. Kjo mund të shihet qartë në fjalimet, shkrimet dhe protestat e radikalistëve. Megjithatë, zemërimi nuk është një atribut i myslimanëve. Kur Zoti përmend besimtarët në Kuran, Ai i përshkruan ata në këtë mënyrë:

**"të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit." (Kuran, 3:134)**

Nuk ka situata në të cilën një mysliman tregon zemërim. Çdo mysliman natyrisht dëshiron që njerëzit e tjerë të besojnë në Zot dhe të jetojnë sipas parimeve morale, por kjo është e mundur vetëm nëse dëshiron Zoti. Pa marrë parasysh atë që bëjmë ne, pa marrë parasysh se sa ne përpiqemi për të shpjeguar të vërtetën tek njerëzit, zemrat e njerëzve janë në duart e Zotit. Ai i kujton myslimanët për këtë fakt shumë të rëndësishëm në këtë ajet:

**"... Vallë a nuk e dinë besimtarët, se sikur të dëshironte Allahu do t'i kishte udhëzuar të gjithë njerëzit (në besim)... "**  
**(Kuran, 13:31)**




Prandaj, detyrë e çdo myslimani është vetëm shpjegimi i fakteve dhe ftesa që njerëzit t'i pranojnë ato. Nëse e pranojnë apo jo ftesën, kjo varet prej ndërgjegjes së njerëzve. Zoti e zbulon këtë të vërtetë në Kuran, kur thotë se nuk ka asnjë detyrim në fe.

**Nuk ka asnjë detyrim në fe, sepse është bërë e qartë e drejta nga e gabuara. Kushdo që refuzon hyjnitë e rreme dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu është Dëgjuesi, i Dijshmi. (Kuran, 2:256)**

Prandaj, nuk ka asnjë detyrim që njerëzit të besojnë dhe të bëhen myslimanë, ose ndonjë detyrim që ata të kryejnë namazin dhe t'i largohen mëkatit.

Feja është këshillë. Zoti e zbulon në disa vargje drejtuar të Dërguarit të Zotit (paqja qoftë me të) se myslimanët nuk janë dhunues:





Ne e dimë më së miri se  
çfarë thonë ata, e ti ndaj  
tyre nuk je dhunues, ti  
këshilloje me këtë Kuran atë që i  
frikësohet kërcënimit Tim. (Kuran,  
50:45)

Thuaj: "O ju njerëz, juve ju erdhi e  
vërteta nga Zoti juaj, e kush merr rrugën  
e drejtë, ai e ka vetëm për veten e tij,  
ndërsa kush e merr të shtrembtën, ai e  
ka humbur veten. Unë nuk jam ruajtësi  
juaj". (Kuran, 10:108)

Myslimanët janë përgjegjës vetëm për të  
shpjeguar moralin fetar, ata nuk duhet të  
ushtrojnë presion apo detyrim; ata janë të  
urdhëruar të flasin butë, madje edhe me  
mohuesin më mizor. Njerëzit e tillë nuk mund  
të jetë radikalistë, sepse radikalizmi qëndron në  
krah të kundërt me këto cilësi që kemi  
përmendur më lart. Në të vërtetë, radikalizmi  
është një mendësi dhe një qëndrim politik, që  
u fut në botën islame nga jashtë. Kur ne  
shqyrtojmë fenomenet sociale që përshkruhen  
në termat e radikalizmit, ajo që do të shihet  
është se, në thelb këto janë një koleksion i  
metodave të përdorura nga komunistët, ose ato



janë një shprehje e "fanatizmit të mllefosur" që nuk ka vend në Islamin e vërtetë. (Kuran, 48:26)

### Si mund të këputet rrethi vicioz i radikalizmit dhe i terrorizmit?

Siç thamë më lart, një realitet i dukshëm qëndron pas 13 vitesh operacione ushtarake, nga Afganistani në Libi dhe nga Nigeria në Irak; grupet radikale terroriste nuk kanë arritur të eliminohen përmes forcës ushtarake, dhunës dhe shtypjes, por e kundërta ka ndodhur, ato janë rritur dhe janë bërë më të fortë.

Ajo çka sollën të gjitha llojet e operacioneve ushtarake, duke përfshirë sulmet ajrore dhe operacionet tokësore, ishte **vdekja e shumë civilëve, shkatërrimet në infrastrukturë dhe qytete të rrënuara; zemërimi është në rritje, në vendet në fjalë dhe nga ky zemërim, kryesisht përfitojnë organizatat radikaliste.** Shpenzimi i miliarda dollarëve në mobilizimin e njerëzve dhe sigurimi i burimeve njerëzore për organizatat terroriste, është prej situatave më të padëshirueshme.

Edhe pse vrasja e udhëheqësve të organizatave terroriste mendohet të jetë një taktikë e efektshme nga disa analistë ushtarakë, në fakt, e parë në një perspektivë më të gjerë, nuk ka rezultuar të jetë frytdhënëse. Edhe pse Osama bin Laden u vra, Al-Kaeda vazhdon ende aktivitetin e saj.

Përveç kësaj, **organizatat terroriste janë të afta për t'i kthyer këto sulme kundër tyre, në propagandë.** Ata kanë aftësi për të portretizuar sulmet kundër tyre, si dëshmi për kauzën e tyre. Për këtë arsye, organizatat ose rriten e bëhen më të forta, ose vazhdojnë aktivitetet e tyre në fshehtësi dhe kjo e bën të paefektshme luftën ushtarake kundër tyre.

Që të thyhet spirala e terrorit, duhet të bëhen përmirësime social-ekonomike dhe të ndërmerren politika për sigurimin e zbatimit të proceseve demokratike; këto duhet të evidentohen në mënyrë të qartë, në rajonet ku ka aktivitete intensive terroriste. Në mënyrë që të gjitha këto të ndodhin, është thelbësore çrrënjësia e injorancës që qëndron në rrënjët e mendësisë




# RADIKALIZËM



radikaliste. Kjo arrihet përmes aktiviteteve edukative dhe kulturore. **Edukimi i duhur duhet të zbatohet përmes ideve të qarta**, kjo do të ishte shumë më ekonomike, se shpenzimet e trilionave dollarëve në armatim, apo se shpenzimi i më shumë miliardave në ndihma humanitare dhe padyshim kjo është një metodë që do të prodhojë rezultate më të mira.

Që këta militantë të mos kthehen në vrasës, kjo gjë duhet parandaluar përmes masave të marra kundër ideve propaganduese të këtyre organizatave. Për më tepër, kjo do të parandalonte rekrutimin e anëtarëve të rinj në këto organizata. Asnjë organizatë terroriste nuk do mund t'i rezistojë një lufte të tillë intelektuale me anë të televizionit, radios dhe internetit. **Një lëvizje që e humb bazën e saj intelektuale nuk mund të**




Shtetet në botë investojnë për më shumë armatime në luftën ndaj ekstremizmit; por ky kërcënim vazhdon të rritet. Për të parandaluar terrorin e egër në të gjithë botën, nevojitet edukim.

**mbijetojë.** Shtetet duhet të fillojnë këtë luftë intelektuale, ose të mbështetesin organizatat joqeveritare që e marrin përsipër këtë detyrë.

**Për të parandaluar terrorin e egër që hasim në të gjithë botën, ajo që duhet ndërmarrë, është një mobilizim arsimor, kundër të gjitha organizatave terroriste, pavarësisht boshtit të tyre ideologjik.**

NATO-ja hedh sasi të mëdha monetare në luftimin e ekstremizmit me anë të forcave të armatosura; por përse ky kërcënim vazhdon të rritet? Përgjigja gjendet tek subjektet që përfitojnë nga këto financime. Përpjekja për të luftuar një ideologji ekstreme vetëm me forcë ushtarake, nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do të rrisë numrin e mbështetësve të kësaj ideologjie. Kostoja e fushatave ushtarake janë viktimat e pafajshëm; njerëzit e afërm dhe rrethi i ngushtë i atyre që vdesin në këto sulme, do të jenë më të



motivuar për t'u bashkuar me ekstremistët, për shkak të urrejtjes së tyre kundrejt Perëndimit.

Lëvizjeve të tilla të rrezikshme duhet t'u vijë fundi dhe baza e tyre ideologjike duhet të asgjësohet në të gjithë botën. Në fakt, kjo është ajo që duhet të bëhet në vendet e Lindjes së Mesme dhe për këtë nevojitet ndihma e aleatëve të tyre perëndimorë. Në mënyrë që të çrrënjoset radikalizmi dhe efektet e tij në nivelin global, duhen mbështetur modelet pozitive të tilla si, demokracia, pluralizmi dhe të drejtat e njeriut dhe për t'u arritur kjo, edukimi është hapi më i rëndësishëm. Për të parandaluar përhapjen e radikalizmit – i cili është një kërcënim i madh ndaj sigurisë globale - udhëheqësit botërorë duhet të kuptojnë nevojën urgjente për një fushatë intelektuale dhe të kërkojnë mënyra për të luftuar injorancën me anë të përpjekjeve intelektuale.

# KOSTOJA E VËRTETË E SHPENZIMEVE TË PAJISJEVE USHTARAKE DHE E SHPENZIME TË TJERA



Buxheti ushtarak i SHBA është rritur me 104%, për 11 vjet rresht. Në vitin 2001 shpenzimet ishin 354 miliardë dollarë, kurse në vitin 2011 ato u rritën në 721 miliardë dollarë.

Paratë e shpenzuara në ushtri mund të investohen në shëndetësi dhe në arsim, si dhe për punësimin e mijëra njerëzve.

Këto dy faqe japin disa shembuj, se si shpenzimet ushtarake mund të investohen në fusha të tjera.




**PAJISJET PËR NJË USHTAR AMERIKAN**  
\$17,500



**RAKETA KRUIZ**  
\$830,000



**TANKU ABRAMS**  
\$6,210,000








**RAPTOR F-22**  
**\$150,000,000**

 **3,033.7**

TË ARDHURAT MESATARE NË FAMILJE

 **7,147.6**

SHKOLLIMI 4 VJEÇAR

 **9,951.6**

SIGURIMI SHËNDETËSOR FAMILJAR

 **676.3**

SHTËPITË



**BOMBARDUESI B-2**  
**\$1.01 Billion**

 **20,426.7**

TË ARDHURAT MESATARE NË FAMILJE

 **48,127.3**

SHKOLLIMI 4 VJEÇAR

 **67,007.2**

SIGURIMI SHËNDETËSOR FAMILJAR

 **4,553.7**


SHTËPITË




**NËNDETSJA VIRGINIA CLASS**  
**\$2.3 Billion**

 **46,516.3**

TË ARDHURAT MESATARE NË FAMILJE

 **109,596.9**

SHKOLLIMI 4 VJEÇAR

 **152,590.7**

SIGURIMI SHËNDETËSOR FAMILJAR

 **10,369.7**

SHTËPITË




**AEROPLAN-MBAJTËSJA GERALD FORD CLASS**  
**\$13.5 Billion**

 **273,030.6**

TË ARDHURAT MESATARE NË FAMILJE

 **643,286**

SHKOLLIMI 4 VJEÇAR

 **895,641.2**

SIGURIMI SHËNDETËSOR FAMILJAR

 **60,865.6**

SHTËPITË



**SHPENZIMET PËR NJË VIT, PËR PROGRAMIN E ARMËVE BËRTHAMORE NË SHBA**  
**\$52 Billion**

 **1,051,673.5**

TË ARDHURAT MESATARE NË FAMILJE

 **2,477,842.3**

SHKOLLIMI 4 VJEÇAR

 **3,449,842.3**

SIGURIMI SHËNDETËSOR FAMILJAR

 **234,445.4**

SHTËPITË

## **Sulmi në Charlie Hebdo: një shembull që tregon rëndësinë e luftës intelektuale kundër terrorizmit**

Një nga aktet më të tmerrshme të terrorizmit radikal, që ne do të përshkruajmë në këtë libër është padyshim vrasja e 12 anëtarëve të personelit të revistës satirike Charlie Hebdo në Paris. Pas këtij sulmi, sinagogat, xhamitë, organizatat islamike, dyqanet e hebrenjve madje edhe varrezat kanë qenë gjithashtu nën kërcënim. Sulmi tjetër që ndodhi në një takim të mbajtur në Danimarkë, për të përkujtuar të vvarët në Charlie Hebdo, solli edhe një herë në vëmendje seriozitetin e situatës.

Tashmë gjendemi përballë rrethit vicioz të urrejtjes dhe ky cikël lëndon më së shumti njerëzit e pafajshëm. Radikalistët e çdo filozofie kanë potencialin e duhur për ta bërë Evropën të pabanueshme për të gjithë dhe veçanërisht për minoritetet, si për myslimanët ashtu edhe për hebrenjtë. Për këtë arsye terrorizmi, anarkia dhe dhuna janë problemet më të mëdha të këtij shekulli. Bota islame në veçanti po vuan më shumë nga kjo e keqe. Megjithatë, ne duhet të përsërisim edhe një herë se terrorizmi nuk ka fe.

Terrorizmi dhe dhuna janë rezultate të një sistemi arsimor, që pretendon se qeniet njerëzore s'janë gjë







Një rreth  
vicioz i  
urrejtjes dhe  
kjo dëmton  
njerëzit e  
pafajshëm.

tjetër veçse kafshë të një xhungle që luftojnë për ekzistencë; ky sistem i bën njerëzit mizorë, egoistë dhe të pamëshirshëm. Në këtë sistem, altruizmi, bashkëpunimi, dhembshuria dhe dashuria nuk vlejnë. Një njeri bëhet i fuqishëm vetëm nëse ai është mizor dhe egoist. Një person shpirtërisht i dobët, i edukuar në këtë mënyrë dhe që nuk është i vetëdijshëm për atë çfarë bën, mund të manipulohet lehtë prej çdo lloj ideologjie, që ja servir "dhunën si mjet për të testuar aftësitë e tij dhe për të fituar të drejtat që i takojnë." Për të përmbledhur atë që thamë më lart, një person, i cili edukohet në mënyrë të tillë, mund të bindet lehtë për të ndjekur rrugët e terroristëve. Kjo bindje vjen jo vetëm përmes parimeve komuniste, por edhe përmes ndikimeve radikaliste, të cilat serviren nën petkun e islamit. Për këtë arsye, hapi i parë që bota duhet të ndërmarrë kundër terrorizmit, është korigjimi i këtij sistemi arsimor të gabuar.

Është e vërtetë se artikujt e Charlie Hebdos dhe botimet e tjera të ngjashme i kanë zemëruar myslimanët. Kjo revistë ka botuar artikuj që ofendojnë jo vetëm myslimanët, por edhe të krishterët, hebrenjtë, budistët dhe shumë njerëz të tjerë. Megjithatë, ajo që një mysliman duhet të bëjë përballë një situatë të tillë, është të shfrytëzojë të gjitha rrugët ligjore, për të mbrojtur të drejtat e tij kur ato çënohen. Më mirë akoma, ai mund t'u afrohet ofenduesve (apo atyre të ngjashëm me ata) në një mënyrë miqësore dhe t'u shpjegojë me mirësi, se qëndrimi i tyre nuk është ai i duhuri; humorit nuk duhet t'i kalohet kufijtë dhe humoristët duhet të mbajnë një qëndrim më dashamirës dhe më miqësor. Ata mund të shkruajnë dhe të diskutojnë, se ide të tilla të gabuara duhet të korigjohen dhe këto fakte duhen bërë të ditura në të gjithë botën. Megjithatë, një mysliman që ndjek udhëzimet e Kuranit, nuk vret një person tjetër, thjesht sepse ai nuk ndjek Islamin.

Nga ana tjetër, në të gjithë botën janë kryer vrasje dhe akte brutale në emër të Islamit dhe viktimat e këtyre akteve të tmerrshme janë kryesisht myslimanë. Me mijëra myslimanë vdesin, si pasojë e sulmeve terroriste të kryera në mbarë botën.



Artikujt e Charlie Hebdo dhe botime të tjera të ngjashme kanë fyer myslimanët. Megjithatë, ajo që një mysliman duhet të bëjë është të shfrytëzojë hapësirën ligjore. Ai mund të sugjerojë me dashamirësi që humori mund të lëvrohet edhe pa shkelur normat e etikës.



## SIGURISHT, ISLAMI ËSHTË PËRTEJ IMAZHIT TË PËRSHKRUAR.



Armët nuk vrasin njerëz ...

... Myslimanët radikalistë i vrasin njerëzit me mjete kuzhine.



Islami është përtej këtyre vizatimeve. Një mysliman që beson në Kuran, kurrë nuk vret njerëz, madje as ata që nuk aderojnë në Islam.

Ajo që duhet të mbahet në mend është se, këta njerëz nuk ndjekin një Islam të bazuar në Kuran, por radikalizmin. Radikalizmi që lindi pas vdekjes së Profetit Muhamed (paqja qoftë me të) ka prodhuar rregullisht që nuk janë në fe dhe duke përdorur emrin e Zotit dhe të Profetit (paqja qoftë me të), krijoi një fe të tërë të re. Ky sistem që u zhvillua bazuar në hadithet e fabrikuara, nuk ka vend për dashuri, dhembshuri, miqësi, respekt për gratë,

paqe, bukuri, art dhe shkencë; me fjalë të tjera, për ato ndjenja që sjellin gëzim për njerëzit. Në radikalizëm ka vend vetëm për shtypje, imponim, mizori dhe dhunë. Sistemi radikal praktikisht kërkon t'i varrosë njerëzit për së gjalli dhe merr çdo gjë të bukur prej tyre duke përdorur emrin e Islamit.

Prandaj, është me rëndësi të madhe që në përpjekjet për të shpjeguar faktin se Islami është një fe e paqes, shpjegimet duhet të bazohet në Kuran. Kjo është teknikisht e pamundur për një person, i cili mbron një version të Islamit që është plot me bestytini e radikalizëm, me hadithe të fabrikuara dhe që nuk i intereson për të folur për paqen dhe dashurinë.

Kjo e vërtetë udhëzon jo vetëm myslimanët, por edhe botën perëndimore që dëshiron të ndalojë terrorizmin: Për të ndaluar, të ashtuquajturin terrorizëm islamik, mënyra e duhur është përmes betejës intelektuale. Kjo betejë do t'i eliminojë idetë që e ushqejnë atë. Për sa kohë që do të ketë mendësi radikaliste, bombardim të vendeve myslimane, dërgim të trupave, apo vrasje të liderëve terroriste, luftimi i dhunës me dhunë, nuk do t'i japë fund terrorizmit. Përkundrazi, ajo e furnizon atë dhe e bën një përbindësh edhe më të madh. Çdo gjë që shpie në urrejtje dhe armiqësi, duhet të shmanget me kujdes dhe duhet ndërtuar një klimë ku predominojnë idetë dhe jo armët.

Le ta përsërisim: terrori është i papranueshëm në çfarëdo lloj forme. Në veçanti, sipas Islamit - i cili e konsideron vrasjen e një personi, njësoj me vrasjen e gjithë njerëzimit - terrori është një nga tragjeditë më të tmerrshme të shekullit tonë. Mirëpo, terrori nuk do të zhduket, duke mbajtur marshime proteste në rrugë, as përmes sanksioneve ekonomike e politike, as duke përsëritur: "Islami është një fe e paqes." Fakti se Islami është një fe e paqes është në Kuran, dhe ky fakt duhet të shpallet nëpërmjet mjeteve të informacionit në mbarë botën, vazhdimisht dhe me prova që e mbështesin plotësisht atë. Bota islame gjithashtu duhet të pastrohet nga absurditetet: Mbështetja perëndimore është sigurisht e rëndësishme, por barra e vërtetë u takon myslimanëve.

## Përse anëtarësohen në organizatat radikaliste e terroriste?

Ekspertët ndaj terrorizmit, agjentët e shërbimit të fshehtë, shkrimtarët, redaktorët dhe analistët në perëndim janë vazhdimisht duke kërkuar përgjigje për një pyetje: Përse njerëzit anëtarësohen në organizatat radikaliste?

Ata sjellin teori të shumta; ata flasin për fëmijët e varfër nga rrethinat e qytetit, për njerëzit e paarsimuar dhe injorantë dhe për të rinjtë e mërzitur në kërkim të aventurës. Disa e përshkruajnë këtë fenomen si "forca tërheqëse e politikës utopike", ndërsa të tjerë thonë se këta njerëz i nxit qëllimi për "të shkruar një histori të tyre".

Megjithatë, këto teori janë lënë mënjanë, sepse me kalimin e kohës ata mësuan se në mjaft prej këtyre grupeve, gjenden jo pak njerëz të pasur, njerëz në karrierë, akademikë, mjekë dhe inxhinierë, dhe se shumë prej anëtarëve të tyre janë në gjendje të mirë ekonomike.



Disa kanë deklaruar se ata që anëtarësohen në organizata të tilla kanë "probleme mendore". Përgjigja për këtë erdhi nga John Horgan, një psikolog dhe profesor në Universitetin e Massachusetts pranë Qendrës së Studimeve për Terrorizmin dhe Sigurinë në Lowell: *"Aktet e terroristëve ne supozojmë se mund t'i shpjegojmë nëpërmjet patologjisë së tyre, por orvatja për të shpjeguar terrorizmin si sëmundje mendore, në fakt është çorientuese."*<sup>2</sup>

Horgan dhe të tjerët hoqën dorë prej hipotezave të tilla; as varfëria, as mërzitja dhe as sëmundjet mendore nuk mund të shpjegojnë faktin, se përse njerëzit, pothuajse nga çdo vend i botës, janë aq të vendosur për t'u përballur me vështirësi dhe për t'u bërë pjesë e një sistemi, në të cilin njerëzit vdesin dhe vriten me lehtësi. Askush nuk dëshiron të shkojë në luftë, duke lënë pas familjen e tij dhe të mirat që ai zotëron, thjesht për të "shkruar një histori". Ai kurrë nuk do ta pranonte vdekjen kaq shpejt dhe pa kushte.

Njerëz që bëhen pjesë e grupeve radikale ka nga e gjithë bota, që nga vendet evropiane e deri në Kazakistan, Australi, Somali, Rusi dhe Tunizi. Numri i njerëzve që anëtarësohen në grupe të tilla është vazhdimisht në rritje. Vendet evropiane si Franca dhe Gjermania janë në krye të listës së këtyre anëtarësimeve.

Le të shohim tani një përgjigje të vërtetë për pyetjen që na shqetëson: Lënia mënjanë e Kuranit dhe e mësimave të vërteta të Islamit dhe përqaftimi i interpretimeve të shtrëmbëruara të Islamit, ka bërë që disa myslimanë t'i kthejnë shpinën kulturës, artit dhe shkencës dhe i ka radikalizuar ata në një masë të konsiderueshme. Ngaqë infrastruktura ideologjike e radikalizmit është përhapur në mënyrë të pakontrolluar (dhe nganjëherë në mënyrë të kontrolluar nga forca të caktuara, të fshehta), ajo ka filluar të kërcënojë mjaft vende, duke përfshirë edhe Evropën. Radikalizmi solli rritjen e islamofobisë dhe ithtarët e islamofobisë nuk arrijnë të shohin, se ata pa e kuptuar po inkurajojnë radikalizmin.

Numri i atyre, që e shohin zgjidhjen në shkatërrimin e Islamit dhe të myslimanëve, të cilët nuk duan myslimanë në vendin e tyre dhe që rrinë





**Rreth 15.000 luftëtarë nga të paktën 80 vende, besohet se kanë hyrë në Siri për të ndihmuar në përmbysjen e regjimit të Asadit. Evropa në këtë moment është në një gjendje frike dhe paranoje prej anëtarëve të organizatave radikaliste që mund të kthehen në vendet e tyre të origjinës dhe të kryejnë akte terroriste.**

duarkryq e shikojnë shtypjen e myslimanëve në botë, është rritur dhe kjo i shërben më tej nxitjes së urrejtjes. Pamjet tragjike të bombardimeve, nga ndërhyrjet e forcave të koalicionit në Afganistan dhe Irak, për mjaft njerëz ishin thjesht spastrime. Askush nuk mund të mos pikëllohet nga vrasjet e civilëve dhe nga shkatërrimet prej fuqive perëndimore. Në mënyrë të pashmangshme, dhuna nxit vetëm urrejtje.

Qëllimi i vërtetë i koalicionit perëndimor, mund të ketë qenë instalimi i modelit të tyre të demokracisë në këto vende. Megjithatë, metoda e



përdorur është aq e gabuar, sa që ajo ka dëmtuar jo vetëm Lindjen e Mesme, por edhe vetë perëndimin. Ata që duan të kuptojnë, se përse kaq shumë njerëz nga Evropa janë bashkuar me grupet radikaliste dhe përse vetëvrasja është një problem shqetësues në ushtrinë amerikane, duhet të hedhin një vështrim të thellë në natyrën e gabuar të politikave që janë zbatuar.

Pra, cila është zgjidhja? Grupet radikaliste ndjekin një ideologji të devijuar, që shumë njerëz në botë e besojnë si të vërtetë. Pasuesit e kësaj ideologjie nuk mund t'i kundërshtojnë grupet në fjalë, sepse ata besojnë verbërisht se janë në rrugë të drejtë. Ky problem me rrënjë të thella, mund të zgjidhet vetëm nga bota islame, duke hequr dorë tërësisht prej burimeve të pakuptimta dhe duke iu kthyer Kuranit, dhe ai i cili do ta sjellë zgjidhjen është Hazreti Mehdi (paqja qoftë me të).

Grupet radikaliste kanë goxha impakt në internet. Ata shfrytëzojnë mediat sociale, me qëllim që propaganda e tyre të jetë bindëse. Ata janë shtrirë në të pestë kontinentet dhe mbështetësit e tyre janë shtuar. Ata i



**Më shumë se 1.000 luftëtarë të huaj çdo muaj, janë përfshirë në luftën në Siri. Edhe sulmet ajrore nuk e kanë ndryshuar këtë situatë. Problemi i radikalizmit mund të zgjidhet plotësisht vetëm nga bota islame duke hequr dorë nga burimet e pakuptimta dhe duke iu kthyer Kuranit.**

bëjnë për vete njerëzit, ndoshta vetëm me disa rreshta të shkurtër. Me fjalë të tjera, përmes propagandës.

Horgan e përshkruan ndikimin e tyre me këto fjalë: *"Ata janë bërë aq të aftë në mediat sociale, sa që anëtarësimi i individëve të pakënaqur ka arritur një shkallë globale."*

Kjo është me të vërtetë e habitshme; arsimi është rruga më e lehtë, por forcat e koalicionit perëndimor ende këmbëngulin në përforcimin e bazave të tyre në Lindjen e Mesme, me më shumë armë. Ajo çfarë duhet bërë, është që të përdoren të njëjtat mjete. Njerëzve u duhet treguar natyra e pavërtetë e kësaj feje bestytnore, me anë të dëshmive nga Kurani. Kjo bëhet duke shfrytëzuar një mjet të tillë të fuqishëm komunikimi siç është Interneti. Islami e ndalon egërsinë dhe fton në dashuri dhe paqe. Kjo është ajo që thuhet në librin e shenjtë, në Kuran. Nëse Perëndimi mund ta bëjë këtë, sigurisht nuk ka nevojë për t'i kujtuar të tjerëve se zotëron mjete më të fuqishme se grupet radikaliste. Imagjinoni sikur të gjitha mediat ndërkombëtare, të cilat janë përgjithësisht nën kontrollin e Perëndimit, do



të ofronin një informim të tillë dhe me zë të lartë! Botës do t'i duheshin thjesht disa sekonda për të dëgjuar të vërtetën.

Evropa në këtë moment është në një gjendje të mjerë, prej frikës dhe paranojës, për shkak se anëtarët e organizatave radikaliste mund të kthehen në vendet e tyre të origjinës. Mendohet se nëse njerëzit të cilët kanë luftuar në ato rajone kthehen në shtëpi, do të vazhdojnë në mënyrë të pashmangshme të kryejnë akte terroriste edhe në vendet e tyre të origjinës, ndaj dhe këto vende janë duke marrë masa të jashtëzakonshme për t'u siguruar prej një ankthi të tillë. Megjithatë, atyre nuk u ka shkuar në mendje se problemi mund të zgjidhej me anë të edukimit me Islamin e vërtetë.

Ajo që ata duhet të kuptojnë është se, nëse dikush ka vendosur të vrasë

Grupet radikaliste duhet t'i kthehen librit të tyre të shenjtë të Islamit; Islami refuzon egërsinë dhe mëson dashuri dhe paqe. Nëse mediat ndërkombëtare do të bënin një sensibilizim të tillë, botës do t'i nevojiteshin vetëm disa sekonda për të kuptuar të vërtetën.





ose të vdesë në një vend të huaj, arsyeja për këtë mund të jetë besimi. Nëse besimi është i bazuar në keqinterpretime rreth Kuranit, sigurisht që ekziston një zgjidhje. Njerëzit duhet të mësojnë besimin e vërtetë, nga burimi i vërtetë, me fjalë të tjera, nga Kurani. Megjithatë, në qoftë se vendet e botës, në veçanti ato perëndimore, vazhdojnë t'i kthejnë shpinën këtij edukimi, tragjedia që po kërcënon botën nuk do të ndalet. Zgjidhja e problemit nuk janë bombat, armët dhe raketat; ato janë vetëm një mjet për përhapjen e urrejtjes.



### **Kronikat televizive nuk duhet t'i japin terrorit hapësirë për të marrë frymë**

Sot, edhe vendet më të zhvilluara në mbarë botën janë nën kërcënimin e terrorit. Shembulli më konkret i kësaj është Franca. Këtë vit, për herë të parë që nga Lufta e Dytë Botërore, trupat ushtarake hynë në Paris. Stacionimi i 1,080 ushtarëve rreth Kullës Eifel, në përgjigje të sulmeve terroriste në Paris dhe kundër një sulmi të mundshëm, tregon përmasat e këtij kërcënimi. Megjithatë, edhe këto masa nuk ishin të mjaftueshme dhe akte të reja terroriste ndodhën në qendër të qytetit.



Lëvizjet fashiste dhe e djathta ekstreme, kanë pësuar rritje kohët e fundit në Evropë dhe për pasojë sulmet ndaj emigrantëve, dhe veçanërisht ndaj myslimanëve janë shtuar. Tensionet mes rusëve dhe çeçenëve nuk kanë fund. Në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme zhvillohen luftime prej dekadash. Nga ana tjetër PKK-

ja, e cila pretendon se ka hequr dorë nga aktivitetet e saj terroriste në male, vazhdon me masakrat në qytetet turke.

Gjatë viteve janë propozuar teori të ndryshme që synojnë zhdukjen e terrorizmit dhe për t'ia arritur qëllimit janë provuar metoda të ndryshme. Jo vetëm që nuk sollën asnjë rezultat, por në të vërtetë aktet terroriste u shtuan.

Shembulli më i qartë i kësaj ishte vrasja e Osama Bin Laden. A u shpërbë Al-Kaeda me vdekjen e tij? Jo.

Për të arritur kontrollin mbi shoqërinë, organizatat terroriste dëshirojnë të frikësojnë njerëzit e pafajshëm duke i detyruar të jenë besnikë ndaj tyre; për të arritur këtë qëllim, ata kryejnë aktet më të pamëshirshme dhe janë të etur për gjak. Në kryerjen e këtyre akteve, ata synojnë të mbajnë "lart" moralin e mbështetësve të tyre, duke iu dhënë atyre përshtypjen, se ata janë të fortë dhe se fitorja është afër. Kjo vërehet në Turqi, në aktivitetet terroriste të Partisë Komuniste Kurde.

Organizatat terroriste i thurin planet në mënyrë të veçantë dhe janë të kujdesshëm para se të kryejnë mizoritë e tyre. Sulmi mbi Qendrën Botërore të Tregtisë dhe në Pentagon më 11 shtator, sulmet në metro në Londër, sulmi në stacionin e trenit në Spanjë, bombardimet në teatër në Rusi, sulmet në Francë dhe të gjitha krimet e kryera nga PKK-ja në Turqi, ishin të gjitha rezultat i planifikimit të kujdesshëm. Në të vërtetë, në sulmin e fundit në Paris, terroristët treguan se ishin profesionistë dhe gjakftohtë.

Pothuajse të gjitha grupet terroriste shfrytëzojnë në mënyrë aktive rrjetin mediatik, për qëllime publicitare. Këto grupe, pra, janë mjaft të etur për anarki dhe korrupsion dhe ata përpiqen të kenë shtrirje të gjerë në media. Sipas këndvështrimit të

organizatave terroriste, sukcesi i akteve të tyre, varet prej pasqyrimin në media.

Për shembull, kur një ngjarje është transmetuar disa herë në media dhe është e mbuluar gjerësisht në mediat sociale, kjo ka një efekt të shumëfishtë, njësoj sikur të ishte kryer me qindra herë.

Për këtë arsye, një nga përgjegjëset kryesore, në luftën kundër terrorit, është media. Në raportet e saj, media nuk duhet të mbështesë organizatat terroriste qoftë drejtpërdrejtë, ose tërthorazi, dhe nuk duhet të lejojë që ata të rriten.

Si dhe në ç'mënyrë duhet të mbulojë media aktet e terrorit, ky është një subjekt shumë i debatuar në të gjithë botën. Një nga arsyet kryesore, se përse vendet moderne, më të përparuara dhe më të fuqishme kanë dështuar t'i japin fund terrorit, është se media i ushqen njerëzit me frikë për shkak të papërgjegjshmërisë dhe pandjeshmërisë gati hysterike. Si rezultat i mbulimit të tillë të lajmit, frika ndaj terrorizmit përhapet me shpejtësi.

Nuk ka asnjë dyshim, se media ka për detyrë të pasqyrojë lajmin në mënyrë objektive, por ata duhet të jenë edhe më të kujdesshëm kur është fjala për terrorizmin: Jeta e njerëzve qëndron mbi të gjitha vlerat e tjera dhe mediat duhet të jenë të kujdesshme, që të mos bëhen padashur pjesë e kësaj egërsie duke u bërë zëdhënëse të propagandës terroriste, me mënyrën e tyre tipike dhe sensacionale. Në pasqyrimin e saj të akteve të terrorit, mediat nuk duhet të priren vetëm drejt shikueshmërisë dhe konkurrencës.

Për shembull, mediat amerikane pas sulmeve të 11 shtatorit dhe mediat britanike pas sulmit në metronë e Londrës, e bënë pasqyrimin e lajmit në një mënyrë mjaft të kujdesshme.



Edhe në incidentet e fundit në Ferguson, Misuri, mediat në SH.B.A. e kanë pasqyruar shumë pak dhunën që ndodhi. Megjithatë, mediat globale pasqyruan të gjitha detajet e sulmit në Paris, ditë pas dite, pa pushim.

Duhet të kihet kujdes në mbulimin e lajmeve, duke mos transmetuar detaje të therjes, apo të vrasjeve të cilat shkaktojnë tmerr dhe frikë në publik. Realizimi i programeve në fjalë, kërkon maturi të madhe; nëse ka deklarata që nuk kanë të bëjnë me propagandën e organizatave terroriste, ato duhet të transmetohen. Po ashtu, duhen shmangur përshtypjet që sugjerojnë se një organizatë terroriste është e fortë dhe me ndikim.

Media është një nga armët më të rëndësishme në luftën kundër terrorit. Edukimi publik përmes mediave është shumë i rëndësishëm për qeveritë e shteteve. Ndikimi i fuqishëm i medias mbi publikun, duhet të drejtohet drejt ngritjes së vetëdijes publike kundër terrorizmit. Në të njëjtën mënyrë, ashtu siç organizatat terroriste janë gjithmonë duke u përpjekur për të imponuar ideologjitë e tyre mbi njerëzit, në rajonet që ata kërkojnë të kontrollojnë, edhe qeveritë e shteteve duhet vazhdimisht të rrisin ndërgjegjësimin e publikut kundër terrorizmit, përmes mediave dhe të ofrojnë programe informative. Një mënyrë është transmetimi i analizave të ekspertëve për aktet barbare të kryera nga grupet terroriste. Nuk duhet harruar se terrori nuk mposhtet vetëm përmes armëve dhe politikës. Me të vërtetë, ato që do t'i japin fund terrorit, janë studimet e ekspertëve që do të mundësojnë thërrmimin e infrastrukturës intelektuale të terroristëve.

## Islamofobia, rritja e ekstremit të djathtë dhe lëvizjet ksenofobike, të cilat furnizojnë radikalizmin

Edhe pse frika e njohur si "Islamofobi" u shfaq në të gjithë globin në prag të sulmeve të 11 Shtatorit 2001, rrënjët e saj të çojnë prapa në kohën e kryqëzatave, apo edhe më herët. Tashmë Islami është përhapur në të gjithë botën: myslimanët përfaqësojnë rreth 6 % të popullsisë të Evropës, numri i tyre i kalon 45 milionë banorë. Deri në vitin 2050, mendohet se myslimanët do të arrijnë rreth 20 % të popullsisë dhe një në pesë njerëz në Evropë do të jetë mysliman, dhe kjo është një nga arsyet kryesore për rritjen e islamofobisë në mesin e evropianëve në vitet e fundit.

Megjithatë, shkakut i vërtetë për rritjen e islamofobisë, janë grupet radikaliste dhe terroriste që kanë dalë në emër të Islamit. Këto organizata



radikaliste, me anë të mentalitetit të tyre pervers, që janë shumë larg nga thelbi i Islamit, kanë shkaktuar frikë dhe urrejtje të madhe ndaj Islamit.

Qarqe të ndryshme, kundërshtarë të Islamit, kanë luajtur gjithashtu një rol të madh në përhapjen e frikës në mendjet e njerëzve dhe kjo ka çuar në një industri virtuale që prodhon diskutime dhe reagime islamofobe dhe po ashtu në ngritjen e organeve të sigurisë dhe inteligjencës me vlerë trilionë dollarë. Kjo industri ka për qëllim të frenojë shtimin e besimtarëve në botën islame, një botë e cila posedon burime të mëdha energjitike dhe pasuri nëntokësore.

Politikat e miratuara nga qeveritë perëndimore, veçanërisht pas 11 shtatorit, të cilat në përgjithësi shënjestruan myslimanët, po ashtu edhe ligjet e aprovuara në këtë kontekst, përshpejtuan rritjen e islamofobisë.





Islamofobia është një formë e racizmit dhe Evropa po përjeton një tendencë në rritje të saj. Megjithatë, një faktor që ndikon në rritjen e islamofobisë janë grupet radikale që kanë dalë në emër të Islamit. Këto grupe, janë larguar nga thelbi i Islamit dhe mbase ky është shkak që në ditët tona, mjaft njerëz e kanë frikë dhe e urrejnë Islamin.

Partitë ekstreme të krahut të djathtë, kanë luajtur një rol të madh në shtimin e kundërshtarëve ndaj Islamit. Për të mbledhur vota, anëtarët e këtyre partive përdorën një gjuhë islamofobe, jo vetëm për të rritur ndikimin e tyre, por edhe për të vënë në shënjestër emigrantët myslimanë.

Emigrantët myslimanë në Evropë duhet të përpiqen kundër ksenofobisë dhe islamofobisë. Mentaliteti etnocentrik që i konsideron ata si të ndryshëm dhe i përjashton, i përbuz dhe i dhunon, si fizikisht ashtu dhe psikologjikisht, me arsyetimin se ata (emigrantët) kërcënojnë jetën kulturore dhe sociale, është në rritje në shumë vende evropiane. Sulme dhe rrahje, gurë të hedhur në xhamitë dhe në vendet e punës, hedhja e bombave molotov, rrahja e punëdhënësve dhe e punëtorëve, simbolet naziste dhe parullat fyese të shkruara nëpër mure, sulmet në disa shtëpi







dhe në disa familje, kërcënimet dhe fyerjet verbale, janë disa nga vështirësitë që myslimanët hasin shpesh në Evropë.

Megjithatë, si të gjithë emigrantët e tjerë, myslimanët lënë shtëpitë e tyre dhe kërkojnë të integrohen në vendet ku shkojnë, duke dhënë kontribute të mëdha ekonomike për shoqëritë e tyre. Diskriminimi dhe armiqësia ndaj tyre, jo vetëm që është tërësisht në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe demokracinë moderne, por është e padrejtë dhe e patolerueshme.

Po ashtu do të ishte po aq e gabuar që për shkak të armiqësinë ndaj Islamit dhe myslimanëve në Evropë ata të profilizohen si një kategori e vetme. Njerëzit në përfundim, të cilët mendojnë se myslimanët janë duke ua marrë punën dhe përfitimet, ata të cilët qëllimisht luajnë me këto shqetësime duke inkurajuar armiqësi ndaj Islamit dhe myslimanëve, ata që mendojnë se rritja e numrit të myslimanëve do të eliminojë Krishterimin dhe/ose do të rrënojnë kulturën perëndimore, apo ata të cilët e barazojnë Islamin me terrorin dhe radikalizmin, të gjithë duhen marrë në konsideratë. Ka vetëm një mënyrë për kapërcimin e gjithë kësaj frike; myslimanët e vërtetë duhet të përshkruajnë besimin e tyre me durim dhe modesti, të shpjegojnë dhe të tregojnë se Islami është i pastër prej gjezurave të fanatikëve, është modern dhe i kohës, në përputhje me shkencën, demokracinë, logjikën, dijen, progresin, ai e kundërshton terrorin dhe këshillon për dashuri, vëllazëri dhe paqe. Ata duhet të shpjegojnë se

muslimanët nuk kanë ndërmend të çenajnë të krishterët dhe se Kurani i vlerëson të krishterët. Ata duhet të shpjegojnë se mentaliteti që pajtohet me terrorizmin, me barbarizmat dhe sulmet vetëvrasëse, që është kundër artit, shkencës, të bukurës dhe që është armiqësor ndaj besimeve të tjera, nuk e ka burimin nga Islami, por nga fanatikë të mashtruar dhe të keqorientuar. Nën ndikimin e fanatikëve, perëndimorët imagjinojnë se Islami është kundër arsyes, tolerancës dhe modernitetit dhe se ai përkrah terrorizmin dhe radikalizmin; ata supozojnë se vlerat islame janë të papajtueshme me demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Myslimanët duhet të angazhohen në një fushatë sistematike ndërgjegjësimiti, duke pasur parasysh se dezinformimi është shkaku kryesor i islamofobisë. Shumë njerëz

**Kurani nuk bën dallim mes racave; Kurani këshillon që njerëzit e besimeve të ndryshme të jetojnë së bashku në të njëjtën shoqëri në paqe dhe lumturi. Vetëm në këtë mënyrë njerëzit do të jenë në gjendje të jetojnë në një botë të paqte, pa marrë parasysh se çfarë race apo feje i përkasin, ku çdo perversion racist do të refuzohet dhe ku të drejtat do të respektohen nga të gjithë.**



që kanë frikë Islamin, në fakt dinë shumë pak në lidhje me të dhe se shumë nga ato që ata mendojnë se dinë, janë të pavërteta.

Perëndimi gjithashtu ka një përgjegjësi të madhe, në lidhje me rëndësinë që i jep demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe me trajtimin e të gjitha besimeve në mënyrë të barabartë: Gjëja e parë që Perëndimi duhet të bëjë është marrja e masave ligjore kundër islamofobisë dhe racizmit. Islamofobia duhet të konsiderohet krim, në të njëjtën mënyrë si antisemitizmi. Prioriteti i Perëndimit duhet të jetë zhvillimi i një kulture të bazuar në dashuri, respekt, miqësi dhe vëllazëri, pa përçmuar ata që janë të ndryshëm. Vendet perëndimore, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile duhet sa më parë të tregojnë ndjeshmëri mbi këtë temë. Kjo është çështje tejet emergjente dhe që të arrihet paqja në mbarë botën, duhet miratuar një legjislacion i ri; njerëzit duhen arsimuar, me qëllim që gjeneratat e reja të mos bien pre e paragjyqimeve



### **Ideologjitë radikaliste nuk frenohen me ligje, por me arsimim**

Në prag të sulmit Charlie Hebdo, parlamentet e vendeve evropiane u angazhuan në disa projekte intensive. Vendet e Evropës sollën në fuqi ligjet e tyre antiterror<sup>1,2,3</sup> dhe u hodhën në veprim për të marrë ndihma nga OJQ-të. Ata duhet t'i kushtojnë vëmendje një pike të rëndësishme; të mos ushqejnë ideologjitë helmuese të radikalistëve, ndërsa janë duke luftuar terrorizmin. Terrori radikalist ka kohë që është rritur në një nivel kërcënues dhe mund të ndryshojë demografinë e botës. Në prag të sulmit në Charlie Hebdo janë bërë propozime që mund të shkaktojnë një ndryshim rrënjësor në strukturën e BE-së. Ideja e heqjes së Zonës Shengen<sup>4</sup> ka hyrë në rendin e ditës. Ky është një sugjerim që mund të ulë standardet e jetesës për evropianët, si në fushën e turizmit, ashtu edhe në atë të tregtisë dhe diplomacisë. Vendet e kërcënuara nga terrorizmi, që ushtrojnë kontroll në kufi janë; Britania, Belgjika, Danimarka, Franca, Gjermania, Polonia, Spanja dhe Holanda. Megjithatë, lind pyetja: Cilat do të ishin rezultatet nëse këto vende miratojnë ligje, të cilat do të prishin qetësinë e qytetarëve dhe do të shkaktojnë polarizimin e mëtejshëm në shoqëritë e tyre?

Çdo njeri duhet të dijë, se hapat që merren për të kontrolluar jetën e myslimanëve, nuk do të kenë ndikim mbi grupet radikale; Këto grupe janë të ushqyera nga urrejtja dhe tërbimi, dhe kur vjen puna për t'u përballur me këto dy ndjesi, ligjet e miratuara nuk mjaftojnë.

Ju mund të pengoni përpjekjen e një terroristi, për të vënë



bombë në një qendër tregtare, duke marrë masa të rrepta sigurie dhe duke e bërë jetën të vështirë për çdo qytetar në atë qytet: por, asnjë ligj nuk mund të ndryshojë mendimin e një fanatiku, i cili ndjen urrejtje për gratë që blejnë minifunde provokuese në këtë qendër tregtare.

Objektivi i shoqërisë perëndimore duhet të jetë rritja e brezave që e konsiderojnë jetën e të gjithëve në atë qendër tregtare si të bekuar dhe të respektuar sipas normave civile. Në të kundërt, lufta kundër terrorizmit shndërrohet në një vorbull, si financiare ashtu dhe në aspektin e kohës së humbur dhe në fund, ata që përfitojnë nga kjo janë terroristët.

Propozimi i Ministrit të Brendshëm francez Bernard Cazeneuve për kontrollin e kufijve, në mënyrë të qartë tregon se vendet evropiane nuk po arrijnë të kuptojnë thelbin e radikalizmit. Cazeneuve ofroi një ligj që e bën më të vështirë hyrjen në vendet evropiane,<sup>5</sup> pra duke shtuar pikat e kontrollit në kufijtë brenda BE-së. Ministri francez nuk duket se është në dijeni të faktit se kërcënimet radikaliste nuk njohin kufij. Gjithashtu, ai s' duket se është në dijeni të masës në të cilën radikalizmi i sfidon strukturat shoqërore evropiane. Sot vërejmë të rinj, të lindur në familje evropiane që anëtarësohen në grupime radikaliste. Mjetet e sotme të komunikimit bëjnë të mundur që grupet terroriste t'i edukojnë pasuesit e tyre vetëm përmes internetit dhe me ideologjinë e tyre ata qasin këdo, në çdo cep të botës.

Lëvizja komuniste guerile që u shfaq në vitet 1950 në Kubë rekrutonte anëtarë prej vizitave në fshatra të shumtë dhe të ndryshëm malorë në Sierra Maestra; bllokimi i këtyre fshatrave

nga ushtria ngadalësoi përhapjen e lëvizjes. Po ashtu, parandalimi i përhapjes së shkrimeve të Sun Tzu-së pengoi në trajnimin ideologjik të luftëtarëve guerrilas në vendet e Lindjes së Largët. Por sot, me anë të internetit, fshati më i lartë malor në botë, ose shteti ishull më i vogël, është larg vetëm një klik. Po ashtu, filtrimi i internetit nuk mund të bllokojë shkëmbimin e informacionit. Sapo mbyllet një faqe interneti, një tjetër shfaqet menjëherë në një adresë tjetër. Sot njerëzit që quhen "ujq të vetmuar" i drejtojnë aktet terroriste nga qelitë e burgut; ata hasen pothuajse në çdo shoqëri.

Përballë këtij kërcënimi, vetëm një metodë mund të jetë e efektshme: Kryerja e një lufte intelektuale, duke shfrytëzuar internetin, televizionet dhe radiot më mirë se ç'bëjnë radikalistët. Nëse radikalistët kanë një mijë faqe në internet, që përdoren për qëllime ideologjike, ne duhet të kemi dhjetëra mijëra, për ata që duan të përhapin dashurinë, vëllazërinë dhe unitetin.

Shtetet evropiane duhet të kontribuojnë që në botën myslimane të mbizotërojnë vlerat e vërteta të Islamit, bazuar vetëm në Kuran. Turqia është një vend, i cili ka arritur të krijojë një bazë të qëndrueshme demokratike dhe një kornizë laike kushtetuese; pavarësisht se është një prej kombeve me shumicë myslimane, ajo mund ta ndihmojë Perëndimin. Nëse marrim parasysh suksesin e Turqisë në shmangien e rinisë së saj nga rekrutimi i grupeve terroriste, në integrimin e saj në stilin perëndimor të jetesës - e parë kjo në një studim krahasues midis vendeve evropiane - ne do të shohim rezultate pozitive në edukimin e të rinjve, përgjatë gjithë traditës dhe përvojës islame. Edhe pse

vendet evropiane kanë vetëm një pakicë të vogël myslimane, rekrutimet pranë strukturave terroriste i tejkalojnë ato të Turqisë, e cila është 99% myslimane. Sigurisht, në këtë përpjekje kundër terrorizmit, Turqia është dhe duhet të jetë patjetër partnere e Evropës. Virtytet që Turqia trashëgoi nga e kaluara, janë gur themeli për të ardhmen.

1. <http://www.theguardian.com/commentisfree/libertycentral/2009/jan/22/explainer-terrorism-legislation>
2. <http://www.christiantimes.com/article/david.cameron.wants.new.anti.terror.laws.in.cyberspace.after.paris.attacks/50351.htm>
3. <http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/france/11335586/EU-pushing-for-new-anti-terror-powers-to-monitor-air-travel.html>
4. [http://europa.eu/rapid/press-release\\_MEMO-15-3140\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-15-3140_en.htm)
5. <http://www.ft.com/cms/s/0/9f340c78-99af-11e4-93c1-00144feabdc0.html#axzz3PKGrqhaZ>

**Mjetet e sotme të komunikimit bëjnë të mundur që grupet radikale terroriste t'i edukojnë ndjekësit e tyre me anë të internetit, dhe kështu të kenë qasje në çdo cep të botës. Përballë këtij kërcënimi, ekziston vetëm një metodë e realizueshme: Kryerja e një lufte intelektuale, duke shfrytëzuar internetin, televizionet dhe radiot.**





## Zgjidhja për terrorizmin nuk vjen nga operacionet ushtarake

Ushtarët amerikanë gjithmonë fitojnë në filmat amerikanë. Edhe në operacionet më komplekse fitorja është e garantuar dhe pengjet janë të liruar. Superioriteti amerikan haset shpesh në filma. Por si është ai në botën e vërtetë? Nëse ne shikojmë prapa në histori, do të shohim se faktet nuk përputhen gjithmonë me imagjinatën. Një shembull për këtë është operacioni Eagle Claw. Operacioni i organizuar nga ushtria e SHBA-së në Prill të vitit 1980 për të liruar 52 qytetarët e SHBA-së të mbajtur peng në Ambasadën SHBA-së në Iran, dështoi për shkak të një stuhie rëre të papritur. Një aksident gjatë furnizimit me karburant gjatë rrugës për në qendrën e operacionit USS Nimitz, solli shkatërrimin e avionit C-130 Hercules dhe të një helikopteri të SHBA-së. Ushtria e SHBA-së humbi tetë ushtarë, dy aeroplanë ushtarakë dhe një transportues dhe u tërhoq nga rajoni, pa e përfunduar operacionin. Një ngjarje tjetër ndodhi në Somali. Operacioni





në vitin 1994 nën komandën e gjeneralit William F. Garrison përfundoi në një fiasko me vdekjen e 24 pakistanezëve dhe 19 trupave të SHBA-së në luftimet në Mogadishu. Forcat paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara dhe trupat e SHBA-së u tërhoqën nga rajoni më 3 Mars 1995, për shkak të humbjeve në rritje. Historia ushtarake e SHBA-së është plot me operacione shpëtimi të tilla të dështuara, edhe pse ato nuk janë aq të njohura sa dy rastet e sipërpërmendura. Një incident i tillë ndodhi në mes të dhjetorit 2014, në fshatin Dafaar në provincën jemenase të Abvas. Një operacion shpëtimi nga forcat speciale të SHBA-së përfundoi me dy pengje, të cilët u qëlluan për vdekje nga militantët. Fotoreporteri 33-vjeçar, amerikan i Luka Somers dhe një mësues nga Afrika e Jugut, Pierre Korkie. Po ashtu humbën jetën, një komandant lokal i Al-Kaedës, militantë të ndryshëm, një grua dhe një fëmijë 10-vjeçar. Sekretari i Mbrojtjes të SHBA-së, Chuck Hagel, ka konfirmuar se kjo kishte ndodhur gjatë një operacioni për shpëtimin e pengjeve. Somers dhe Korkie ishin mbajtur peng në Jemen për më shumë se një vit. SHBA-të kanë kryer operacione ajrore në Jemen që nga viti 2002. Megjithatë, shumë prej këtyre operacioneve dështuan, dhe për pasojë shumë civilë humbën jetën. Në vitin 2014, 13 civilë kanë vdekur dhe 20 të tjerë janë plagosur në një sulm ajror mbi objektivat Al-Kaedës në qytetin jemenas Rada. Pra, çfarë duhet bërë tani? Pas ndërhyrjeve ushtarake nga jashtë, të cilat shkaktuan vdekjen e njerëzve të pafajshëm, këto vende nuk janë më në gjendje për të ndaluar aktivitetet terroriste në tokat e tyre. Për të përsëritur, para së gjithash, një luftë intelektuale duhet të zhvillohet kundër organizatave terroriste që përdorin dhunën në emër

të Islamit. Mendësitë e mbrapshta të anëtarëve të këtyre organizatave duhen çrrënjësuar një herë e mirë. Të gjithë opinionistët dhe politikanët duhet prerazi të deklarojnë se në Kuran, është e shprehur qartë, se myslimanët duhet t'i ftojnë njerëzit tek vlerat morale të Islamit, thjesht me fjalë të këndshme dhe jo duke përdorur forcën apo imponimin. Këta njerëz mund të thirren në rrugën e drejtë vetëm duke u shpjeguar atyre lirinë e besimit, që gjendet në vlerat morale islame. Të gjithë myslimanëve, shiitë apo suni, duhet t'u thuhet, se dhuna nuk është rruga e duhur për të kërkuar të drejtat e tyre dhe se kjo është një shkelje flagrante e vlerave morale islame. Ata duhet të dinë se vlerat morale islame nuk mund të përhapen përmes akteve të terrorit; akte të tilla thjesht do të shtojnë numrin e armiqve të Islamit dhe pa dyshim ato do të shkaktojnë dëm të madh për vetë myslimanët. Studentëve në shkolla duhet t'u ofrohen leksione që synojnë minimin e infrastrukturës intelektuale të organizatave terroriste; libra dhe artikuj duhen botuar dhe po ashtu të mbahen konferenca dhe seminare akademike. Kjo është e vetmja mënyrë që terrorizmi mund të çrrënjësohet. Kjo metodë do të thajë moçalin, që ushqen terroristët. Sot ka organizata radikaliste dhe degët e tyre veprojnë në një gamë të gjerë të territorit, nga Azia Qendrore deri në Kaukaz, nga Afrika në Ballkan, dhe nga brenda Evropës në SHBA. Arsyeja e vetme pse radikalizmi është në gjendje të mbledhë mbështetësit nga këto vende dhe kultura të ndryshme është edukimi, orientimi dhe propaganda që terroristët zbatojnë mbi njerëzit, të cilët janë kryesisht injorantë rreth fesë dhe gjykojnë me emocione dhe jo me intelektin e tyre. Interneti dhe mediat sociale janë mjetet

globale propaganduese më të përdorura nga organizatat radikaliste. Prandaj, është e qartë se kundër radikalizmit, përveç përdorimit të forcës dhe armëve, duhen shfrytëzuar mjete të ndryshme të komunikimit. Megjithatë, institucionet më të njohura strategjike të Perëndimit, grupet e ekspertëve dhe këshilltarët politikë nuk ja kanë arritur të dalin me ndonjë alternativë apo të sjellin strategji të reja ushtarake. Për të qenë më të saktë, ideja se një masakër masive mund të jetë një alternativë, kurrë nuk është sugjeruar nga ata. Ata gjithmonë i kanë injoruar faktorët e besimit dhe të ideologjisë, në shfaqjen e fenomeneve sociologjike, siç është radikalizmi. E vetmja mënyrë për t'i dhënë fund terrorit, dhunës dhe vrasjeve, që rrjedhin nga një konceptim i shtrembëruar i Islamit i bazuar në bestytini, interpretime të shtrembëruara, hadithe të rreme dhe në urdhëresa që janë krejtësisht në kundërshtim me Kuranin, është edukimi në mënyrën më të mirë të mundshme i të gjithë botës islame. Islami i vërtetë bazohet në Kuran. Ato besime të rreme dhe keqkuptime mund të korrighohen vetëm nën dritën dhe udhëzimin e shpallur në Kuran. Të gjithë myslimanët duhet të refuzojnë qëndrimin argumentues, të ashpër e jotolerant që nuk ka lidhje me mësimet e Kuranit dhe në vend të kësaj të përqafojnë një qëndrim miqësor, të butë, të dashur, të qetë dhe të mëshirshëm. Myslmanët duhet të jenë shembull për botën; ata janë njerëz të matur, të dhembshur, të ekuilibruar dhe të paqtë. Myslmanët duhet ta përjetojnë Islamin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe vlerat morale islame duhet t'i prezantojnë në mbarë botën; por jo vetëm këto vlera, por edhe arritjet e tyre në fushat e shkencës, kulturës, artit, estetikës, rendit shoqëror dhe në mjaft fusha të tjera.

*Lumturia, drejtësia dhe mirëqenia ekonomike mund të arrihen vetëm përmes paqes dhe unitetit.*

*Të gjitha fetë hyjnore ftojnë në rrugën e dashurisë.*

*Është koha që të gjithë të kuptojnë se paqja vjen nga humanizmi, ndërsa humanizmi i ka rrënjët në moralin e fesë.*







## Shembuj të dhembshurisë, dashurisë dhe humanizmit në historinë islame

Për t'i përmbledhur faktet që kemi trajtuar më sipër, mund të themi se besimi në fenë Islame është paqedashës. Kjo e vërtetë pranohet gjerësisht nga historianët dhe teologët jomyslimanë. Një prej tyre është historia britanike Karen Armstrong, ish-murgeshë dhe eksperte e historisë së Lindjes së Mesme. Në librin e saj "*Lufta e shenjtë*", i cili merr në shqyrtim historinë e tri feve me origjinë hyjnore, ajo parashtron komentet e mëposhtme:

"...Fjala "Islam" në gjuhën arabe rrjedh nga e njëjta rrënjë me fjalën "paqe" dhe Kurani e dënon luftën si një gjendje anormale e çështjeve, në kundërshtim me dëshirën e Zotit... Islami nuk e përllig një luftë tërësisht sulmuese shfarosjeje.... Islami pranon se lufta është e pashmangshme dhe nganjëherë,





një detyrë pozitive për t'i dhënë fund shtypjes dhe vuajtjes. **Kurani mëson se lufta duhet të kufizohet dhe të zhvillohet në një mënyrë sa më njerëzore të mundshme.** Muhamedit i është dashur të luftojë jo vetëm mekasit, por edhe fiset çifute në atë zonë apo fiset e krishtera të Sirisë, të cilët planifikonin ta sulmonin atë në aleancë me çifutët. Megjithatë, kjo nuk e bëri Muhamedin që t'i denonconte Ithtarët e Librit. Myslimanët u detyruan të vetëmbrohen, por ata nuk po zhvillonin një "luftë të shenjtë" kundër fesë së armiqve të tyre. Kur Muhamedi dërgoi njeriun e tij, Zejdin, kundër të krishterëve në krye të një ushtrie myslimanësh, ai i porositi ata **të luftojnë në rrugë të Zotit me trimëri, por njerëzisht.** Ata nuk duhej të shqetësonin as priftërinj, murgj e murgesha, as njerëzit e dobët e të pandihmë që nuk ishin në gjendje të luftonin. Nuk duhej bërë masakër ndaj civilëve, madje nuk duhej prerë as edhe një pemë apo rrëzuar ndonjë ndërtesë."<sup>3</sup>



Kalifët që e ndoqën profetin Muhamed (paqja qoftë me të) ishin gjithashtu, shumë të ndjeshëm në të ushtruarit e drejtësisë. Në vendet e marra nën kontroll, si vendasit, ashtu edhe të sapoardhurit jetonin në paqe e siguri. Ebu Bekri, kalifi i parë, u kërkoi njerëzve të tij që të zbatojnë drejtësinë dhe të mbajnë qëndrime toleruese në këto vende. Të gjitha këto qëndrime ishin në përputhje me vlerat e Kuranit. Ebu Bekri i dha urdhrin e mëposhtëm ushtrisë së tij, në ekspeditën e parë të Sirisë:

"Ndaluni, o njerëz, që të mund t'ju jap dhjetë rregulla për t'i mbajtur në mend e në zemër. Mos tradhëtoni, as mos iu largoni rrugës së drejtë! Ju nuk duhet të gjymtoni, as të vrisni fëmijë, burra të moshuar apo gra. Mos shkulni pemët e hurmave arabe, as mos i digjni ato me zjarr! Mos prisni asnjë pemë frutore! Mos therrni asnjë kafshë nga tufa e deveve, përveç atyre që ju duhen për të jetuar! Ka mundësi të kaloni pranë njerëzve që ia kanë përkushtuar jetën e tyre shërbimit në manastire. Lerini ata të qetë në atë që janë përkushtuar! Ka mundësi, gjithashtu, të gjeni njerëz që do t'ju dhurojnë ushqime të çfarëdollojshme. Mund të hani, por mos harroni të përmendni emrin e Allahut!"<sup>4</sup>

Omer bin Hatabi, i cili ndoqi Ebu Bekrin në detyrën e kalifit, ishte i famshëm për mënyrën se si ushtronte drejtësinë dhe si i respektonte marrëveshjet me banorët e vendeve që merrte nën kontroll. Secila nga këto marrëveshje përbënte një shembull tolerance dhe drejtësie. Për shembull, në deklaratën e sigurimit të mbrojtjes për të krishterët e Jeruzalemit dhe Lodit, ai siguroi se kishat nuk do të rrënoheshin. Omeri garantoi të njëjtat kushte për të krishterët e Betlehemit. Gjatë marrjes së Medainit, deklarata e mbrojtjes, dhënë patriarkut nestorian Ishojab III (650 – 660 e.s.) përsëri garantonte se kishat nuk do të shkatërroheshin dhe se asnjë ndërtesë fetare nuk do të shndërrohej në shtëpi a xhami.<sup>5</sup> Letra e shkruar nga patriarku për peshkopin e Farsit (Persisë), pas marrjes së qytetit përbën një nga





**Jerusalemi, i cili është i shenjtë për myslimanët, hebrejtë dhe të krishterët, duhet të jetë një vend ku të gjithë besimtarët të adhurojnë Zotin në paqe dhe dashuri.**

shembujt më mahnitës, që na tregojnë me fjalët e një të krishteri, tolerancën dhe dashamirësinë e udhëheqësve myslimanë ndaj Ithtarëve të Librit:

"Arabët, të cilëve Zoti u ka dhënë në këtë kohë qeverisjen e botës... nuk e persekutojnë fenë e krishterë. Në të vërtetë, tregojnë dashamirësi ndaj saj, nderojnë priftërinjtë dhe shenjtorët e Zotit dhe u sjellin dhurata kishave e manastireve." <sup>6</sup>

Dokumenti i mëposhtëm nga Omeri na tregon llojin e mirëkuptimit dhe konceptin e drejtësisë, që Zoti ka zgjedhur për njeriun, pra frymën e drejtësisë të përshkruar në Kuran:

Kjo është siguria që Omeri, shërbëtori i Zotit, komandanti i besimtarëve, garanton për popullin e Elia-s. Ai i garanton të gjithë, qofshin të sëmurë apo të shëndoshë, ata kanë siguri për jetën e tyre, pasurinë e tyre, kishat dhe kryqet e tyre, dhe për gjithçka që ka të bëjë me fenë e tyre. Kishat e tyre nuk do të shndërrohen në vende banimi, as do të shkatërrohen, as nuk do të zvogëlohen, as kryqet e banorëve e asgjë nga pasuritë e tyre, asnjë pengesë nuk do të vihet mbi ta në çështjen e besimit të tyre dhe askujt prej tyre nuk do t'i bëhet dëm.<sup>7</sup>

Të gjithë këta shembuj janë shumë të rëndësishëm për të zbuluar e kuptuar drejtësinë dhe mëshirën e besimtarëve të vërtetë. Zoti urdhëron si më poshtë:

**"Zoti ju urdhëron t'ia riktheni pronarëve të tyre sendet që i mbani në mirëbesim dhe kur të gjykoni mes njerëzve, të gjykoni me drejtësi. Sa e mrekullueshme është ajo që Zoti ju urdhëron juve! Zoti dëgjon gjithçka, sheh gjithçka." (Kurani 4:58)**

Kenon Tejlor, një nga udhëheqësit misionarë të Kishës Anglikane, e shpreh kështu bukurinë e shfaqur në moralin islam, në një nga ligjëratat e tij:

"Ai [Islami], solli doktrinat themelore të fesë: njëshmërinë dhe madhësitinë e Zotit, faktin se Ai është i mëshirshëm dhe i drejtë, se Ai kërkon bindje ndaj vullnetit të Tij, përkushtim e besim. Islami shpalli përgjegjësinë e njeriut, një jetë të ardhshme, një ditë gjykimi, si dhe dënimin e ashpër që i pret të ligjtë. Islami solli detyrimin për plotësimin e detyrave të lutjeve rituale, për dhënien e lëmoshës, për agjërim e bamirësi. Islami i hodhi tej virtytet artificiale, mashtrimet e marrëzitet fetare, ndjenjat e zvetënuara morale dhe delikatesën verbale të zënkave teologjike... Islami i solli shpresë skllavit, vëllazëri njerëzimit, si dhe u siguroi njohje të vërtetave themelore të natyrës njerëzore."<sup>8</sup>

Pohimi i rremë, se në vendet e marra nën kontroll nga myslimanët njerëzit u konvertuan në Islam me dhunë, është refuzuar gjithashtu edhe



Në kohën e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të), ndaj ithtarëve të Librit u zbatua një politikë e drejtë dhe e mëshirshme

nga studiuesit perëndimorë; prej tyre konfirmohet gjithashtu drejtësia dhe qëndrimi tolerant i myslimanëve. Studjuesi L. Braun shprehet për këtë, si më poshtë:

"Këto fakte të sigurta hedhin poshtë idenë e ushqyer kaq gjerësisht në shkrimet e krishtera, se gjoja myslimanët kudo që shkuan, detyruan njerëzit të pranojnë Islamin me tehun e shpatës."<sup>9</sup>

Në librin e tij "*Perspektiva e Islamit*", Brauni shkon më tej, duke thënë se arsyeja e vërtetë pas pushtimeve të myslimanëve ishte vëllazëria e Islamit. Shumica dërrmuese e administruesve myslimanë, që qeverisën vendet



**Perandoria Osmane ishte një sistem që garantonte liri fetare për të gjithë. Në vendet osmane mbizotëronte një mozaik i paqtë e multikulturor. Shteti i mbronte qytetarët sipas mësimeve morale islame, duke siguruar ndihmë për të varfërit e saj, pa marrë parasysh se çfarë feje i përkisnin.**



muslimane përgjatë historisë, i trajtuan anëtarët e besimeve të tjera me tolerancën dhe respektin më të madh. Hebrenjtë edhe të krishterët, brenda kufijve të shteteve islame, kanë jetuar në paqe dhe liri.

Mbretëria e Turqve Selxhukë dhe Perandoria Osmane njiheshin gjithashtu, për pikëpamjet e tyre tolerante në lidhje me Islamin. Në librin e tij "Përhapja e Islamit në Botë", studiuesi britanik Sër Tomas Arnold, bën të qartë shkakun, se përse të krishterët dëshironin të ishin nën qeverisjen selxhuke:



"Po në atë kohë, përsëri kjo ndjenjë sigurie për jetën fetare nën qeverisjen myslimane, bëri që shumë të krishterë të Azisë së Vogël, t'i mirëprisnin turqit selxhukë si çliruesit e tyre... Në mbretërinë e Mikaelit VIII (1261 – 1282), turqit u ftuan shpesh nga banorët vendas, për të marrë nën kontroll qytete të vogla në brendësi të Azisë së Vogël. Në këtë mënyrë, banorëve u krijohet mundësia që t'i shpëtonin tiranisë së perandorisë. Gjithashtu, të varfër e të pasur shpërnguleshin shpesh në vendet e sunduara nga turqit."<sup>10</sup>

Malik Shah, udhëheqësi i Perandorisë Islame Selxhuke në kohën kur ajo njohu kulmin e shkëlqimit të saj, i trajtonte njerëzit e vendeve të pushtuara me tolerancë e dashamirësi dhe për këtë arsye, ai kujtohej prej tyre me respekt e dashuri. Të gjithë historianët objektivë bëjnë fjalë në veprat e tyre për tolerancën dhe drejtësinë e Malik Shahut. Qëndrimi i tij dashamirës nxiti gjithashtu, ndjenja dashurie ndaj tij edhe në zemrat e Ithtarëve të Librit. Për këtë arsye, në një formë të pashembullt në histori, shumë qytete hynë nën qeverisjen e Malik Shahut me vullnetin e tyre të lirë. Sër Tomas Arnold përmend gjithashtu, se Odo de Dioxhilo, një murg i Shën Denisit, kishte marrë pjesë në Kryqëzatën e Dytë si kapelan personal i Luigjit VII. Ai bënte fjalë në kujtimet e veta për drejtësinë, me të cilën myslimanët qeverisnin, pavarësisht nga përkatësia fetare e subjekteve të ndryshme. Mbështetur në rrëfimin historik të Odo de Dioxhilos, Sër Tomas Arnold shkruan:

"Gjendja e të mbijetuarve do të kishte qenë tërësisht e pashpresë, nëse pamja e tyre e mjeruar nuk do t'i kishte prekur zemrat e muhamedanëve dhe nuk do t'i kishte nxitur ata në mëshirë. Ata u kujdesën për të sëmuret, u siguruan ndihmë të varfërve e të uriturve me bujari të madhe. Disa madje morën paratë frënge që grekët ua kishin marrë pelegrinëve me forcë apo dhëlpëri dhe ua shpërndanë me tepri e zemërgjerësi nevojtarëve. Kaq i madh ishte ndryshimi mes trajtimit që pelegrinëve iu bë nga jobesimtarët dhe mizorisë që iu

shkaktua atyre nga bashkëfetarët e tyre të krishterë, grekët, të cilët i detyruan të punonin me dhunë, i rrahën dhe u grabitën edhe atë pak gjë që u kishte mbetur, duke i detyruar që shumë prej tyre të pranojnë me dëshirë fenë e çlirimtarëve të tyre. Një kronikan i vjetër [Odo de Dioxhilo] thotë: "Duke iu shmangur bashkëfetarëve të tyre, të cilët kishin qenë aq mizorë me ta, ata shkuan e gjetën siguri pranë të pafeve, të cilët u treguan të mëshirshëm dhe sikurse morëm vesh, më shumë se tre mijë iu bashkuan turqve, duke i ndjekur ata edhe pasi u larguan."<sup>11</sup>

Këto fjalë të historianëve tregojnë, se administruesit myslimanë, të cilët zbatonin me sinqeritet moralin e Islamit, qeverisnin gjithmonë me tolerancë, mirësi e drejtësi. Në të njëjtën mënyrë, historia e Perandorisë Osmane që qeverisi për shekuj me radhë vende të shumta në tre kontinente, është e mbushur me shembuj tolerance.

Mënyra se si çifutët u strehuan në vendet osmane gjatë kohës së sulltan Bajazidit II, pasi iu nënshtruan masakrave dhe shpërnguljes nga mbretëritë katolike të Spanjës e Portugalisë, është një shembull shumë i mirë i tolerancës që buron nga morali islam. Mbretërit katolikë, të cilët qeverisnin Spanjën në atë kohë, ushtruan trysni të madhe mbi çifutët që më parë kishin jetuar në paqe nën qeverisjen myslimane në Andaluzi. Ndërsa myslimanë, të krishterë e çifutë ishin në gjendje të jetonin së bashku në paqe në Andaluzi, mbretërit katolikë u përpoqën ta detyrojnë gjithë vendin që të bëhet i krishterë, u shpallën luftë myslimanëve dhe i shtypën egërsisht çifutët. Për pasojë, qeverisësit myslimanë të rajonit të Granadës në jug të Spanjës, u rrëzuan në vitin 1492. Myslimanët iu nënshtruan masakrimeve të tmerrshme dhe u vranë. Edhe çifutët që nuk pranonin të ndryshonin fenë e tyre, u shpërngulën me dhunë.

Një grup prej këtyrë çifutëve, të mbetur pa atdhe, kërkoi strehë në Perandorinë Osmane dhe shteti i lejoi ata që të qëndrojnë. Flota Osmane,



Në vitin 1492, hebrenjtë të cilët refuzuan të konvertoheshin u dëbuan prej Spanjës nga mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Izabela. (në të majtë). Hebrenjtë u pranuan nga Perandoria Osmane, e cila ishte streha e drejtësisë islame dhe e dashurisë.

nën komandën e Kemal Reisit, i solli çifutët e shpërngulur, si dhe myslimanët që mundën të mbijetojnë, në vendin e osmanëve.

Sulltan Bajazidi II është i njohur në histori si një udhëheqës e besimtar i mirë dhe në pranverën e vitit 1492, ai i strehoi çifutët e shpërngulur nga Spanja në disa vende të perandorisë, pranë Edrenesë dhe Selanikut. Më shumë se 25,000 çifutë turq që jetojnë në Turqinë e sotme, janë pasardhësit e çifutëve spanjollë. Ata kanë ruajtur fenë dhe traditat që kishin në Spanjë 500 vjet më parë në kushtet e Turqisë së sotme dhe vazhdojnë të jetojnë të qetë e me të drejta të barabarta me qytetarët e tjerë. Ata kanë shkollat, spitalet, azilet e pleqve, shoqëritë kulturore dhe gazetatat e tyre. Ata kanë tregëtarë e sipërmarrës të mëdhenj, përfaqësues në profesione të shumta, nga çështjet teknike, te marketingu, me qarqe intelektuale në rritje. Ndërsa bashkësitë çifute në Evropë, për shekuj me radhë, i janë nënshtruar frikës nga sulmet raciste antisemite, çifutët në Turqi kanë jetuar në paqe e siguri. Ky shembull është i mjaftueshëm për të treguar tolerancën dhe konceptin për drejtësinë që Islami mbart me vete.



**Sulltan Bajaziti i II-të ishte një mysliman i devotshëm. Ai i mirëpriti hebrenjtë që ishin dëbuar nga persekutimi spanjoll dhe u dha atyre të drejtën për të praktikuar fenë e tyre në tokat myslimane.**

Mirësia dhe toleranca, e shprehur nga Sulltan Bajazidi II, vihen re te të gjithë sulltanët osmanë. Kur sulltan Mehmet Fatihu mori Kostandinopojën, ai i lejoi të krishterët dhe çifutët që të jetonin të lirë në atë vend. Andre Mikel, i cili është i njohur për veprat me vlera të veçanta mbi praktikën e drejta e tolerante të myslimanëve dhe botës së Islamit, thotë:

"Bashkësitë e krishtera jetonin në një shtet të miradministruar që ata nuk e kishin njohur gjatë periudhës bizantine e latine. Ata nuk iu nënshtruan kurrë përndjekjes sistematike. Përkundrazi, perandoria dhe veçanërisht Stambolli, u shndërruan në strehë për çifutët spanjollë, të cilët ishin keqtrajtuar në vendin e tyre. Njerëzit nuk u islamizuan kurrë me forcë; lëvizjet e islamizimit erdhën si rezultat i proceseve shoqërore."<sup>12</sup>





**Sulltan Mehmet Fatihu i dha shumë konçesione Patriarkanës. Për herë të parë në histori, patriarku gëzonte autonomi nën sundimin turk. Në foto shohim Sulltan Mehmet Fatihun dhe Patriarkun.**

Jomyslimanëve u janë dhënë shumë të drejta edhe në shtetet islame para-osmane. John L. Esposito, profesori i Universitetit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe për Fetë në Georgetown, përshkruan se si hebrenjtë dhe të krishterët, që kishin ardhur nën administrimin e shteteve myslimane gjetën përkrahje dhe mirëkuptim të madh:

Për popullsinë jomyslimane në territoret Bizantine dhe Perse, tashmë nën pushtetin e sundimtarëve të huaj, shteti islam solli një shkëmbim të sundimtarëve, ata ishin fleksibël dhe tolerantë dhe jo thjesht sundues. Shumë prej këtyre popullatave gëzonin autonominë lokale dhe shpesh paguanin taksat më të ulta ... Islami ishte një fe tolerante, duke ofruar më shumë liri fetare si për hebrenjtë, ashtu edhe për indigjenët e krishterë.<sup>13</sup>

*Ata që besuan dhe besimin e tyre  
nuk e ngatërruan me besim të kotë,  
atyre u takon të jenë të sigurt dhe  
ata janë në rrugë të drejtë.*

*(Kuran, 6:82)*



# FYTYRA E VËRTETË E TERRORISTËVE QË VEPROJNË NË EMËR TË FESË

Të gjithë shembujt tregojnë se organizimi i veprave të terrorit kundër njerëzve të pafajshëm, është plotësisht në kundërshtim me Islamin. Përkundrazi, myslimanët janë përgjegjës për t'i ndaluar edhe të tjerët nga krimi, për të larguar "mizorinë në tokë" dhe për të sjellë paqe e siguri për të gjithë njerëzit në botë.

Nuk është e mundur të flitet për "terror të krishterë", "terror çifut" apo "terror islamik". Në të vërtetë, një hulumtim i sfondit shoqëror të përgjegjësve për aktet terroriste tregon se terrorizmi nuk është një çështje fetare, por një dukuri shoqërore.

## **Kryqtarët: barbarët që morën nëpër këmbë fenë e tyre**

Mesazhi i vërtetë i një feje apo i një sistemi besimi mund të shtrembërohet nga pseudo-aderuesit e saj. Kryqëzatat, periudha e të cilave përbën një episod të errët në historinë e Krishterimit, janë një shembull i këtij shtrembërimi.

Kryqtarët ishin të krishterë evropianë, të cilët ndërморën, nga fundi i shekullit XI, ekspedita për të rimarrë nën kontroll nga myslimanët Tokën

e Shenjtë (Palestinën dhe zonën rrethuese të saj). Ata u shfaqën me një qëllim të ashtuquajtur fetar, por ata lanë të shkretë çdo pëllëmbë dhe ku shkelën dhe përhapën frikë e tmerr kudo që shkuan. Civilët që u hasën gjatë rrugës iu nënshtruan ekzekutimeve masive. U plaçkitën fshatra e qytete. Pas pushtimit, Jeruzalemi ku myslimanët, çifutët dhe të krishterët kishin jetuar në paqe, nën qeverisjen islame, u shndërrua në skenë gjakderdhjeje të pafund. Ata masakruan, pa mëshirë të gjithë myslimanët në qytet.

Sipas fjalëve të një historiani, **"ata vranë të gjithë saraçenët dhe turqit që gjetën... meshkuj a femra qofshin"**.<sup>15</sup> Një nga kryqtarët, Rajmondi i Agijës, krenohet kështu për dhunën e ushtruar:





"Pamje të mrekullueshme mund të shiheshin. Disa nga njerëzit tanë (dhe kjo ishte forma më e mëshirshme) u prenë kryet armiqve të tyre; të tjerë i goditën ata me heshta dhe ata binin nga kullat; të tjerë i torturuan ata edhe më gjatë, duke i hedhur në flakë. **Pirgje me koka, duar e këmbë u panë në rrugët e qytetit.** Njerëzve u duhej të ecnin duke shkelur mbi kufoma njerëzish e kuajsh. E megjithatë, këto ishin vogëlsira në krahasim me atë që ndodhi në Tempullin e Solomonit, i cili është një vend ku zakonisht, këndoheshin shërbesa fetare... Në Tempullin e Solomonit dhe në oborrin e tij, **njerëzit kalëronin në gjak deri në gjunjët dhe kapistrat e kuajve.**"<sup>16</sup>

Në dy ditë, ushtarët kryqtarë vranë afro 40,000 myslimanë në mënyrat barbare që u përshkruan.<sup>17</sup>

Barbaria e kryqtarëve ishte aq e tepruar saqë gjatë Kryqëzatës së Katërt, ata plaçkitën Kostandinopojën (Stambolli i sotëm), një qytet i krishterë dhe grabitën sendet e arta nga kishat.

Natyrisht që e gjithë kjo barbari ishte në kundërshtim të plotë me doktrinën e krishterë. Krishterimi, sipas fjalëve të Biblës, është një "mesazh dashurie". Në "Ungjillin sipas Mateut", thuhet se Jezusi u tha ndjekësve të tij: **"Duajini armiqtë tuaj dhe lutuni që ata të mos ju përndjekin!"** (Mateu 5:44). Në "Ungjillin sipas Lukës", thuhet se Jezusi ka thënë: **"Atij që të godet në njëren faqe, ktheji edhe tjetrën!"** (Luka 6:29) Kështu, vrasja e njerëzve të pafajshëm është e paimagjineshme. Konceptin e "vrasjes së të pafajshmëve" mund ta gjejmë në Bibël, por për këtë akuzohet mbreti mizor çifut Herodi, i cili u përpoq të vraste Jezusin qysh kur ky ishte foshnjë.

Nëse Krishtërimi është një fe e mbështetur në dashuri dhe që nuk nxit dhunë, si mundën kryqtarët e krishterë të kryejnë aktet më të dhunshme të historisë? Arsyeja kryesore për këtë është që kryqtarët ishin kryesisht njerëz të paditur që mund të cilësohen më mirë me emrin "turmë". Masat e tyre, të cilët nuk dinin asgjë nga feja e vet dhe që ndoshta s'e kishin lexuar

apo parë kurrë Biblën në jetën e tyre dhe që ishin në përgjithësi plotësisht të panjohur me vlerat morale të urdhëruara prej Biblës, u shtynë në barbari përmes sloganeve të Kryqëzatave, të cilat paraqiteshin si "Vullneti i Zotit". Duke përdorur këtë metodë mashtruese, shumë prej tyre u nxitën për të kryer veprime të frikshme, të ndaluara në fenë e tyre.

Vlen të përmendet se në atë periudhë, të krishterët lindorë, apo populli i Bizantit, të cilët nga pikëpamja kulturore, qëndronin shumë më lart se të krishterët perëndimorë, treguan vlera më të mëdha njerëzore. Edhe përpara, edhe pas pushtimeve të Kryqëzatave, të krishterët ortodoksë jetuan së bashku me myslimanët. Sipas komentatorit të BBC-së, Terri Xhons, me tërheqjen e kryqtarëve nga Lindja e Mesme "jeta e qytetëruar filloi përsëri dhe anëtarët e tre besimeve monoteiste iu rikthyen bashkekzistencës paqësore."<sup>18</sup>


Shembulli i kryqtarëve është tregues për një dukuri të përgjithshme. Sa më të paqytetëruar, të pazhvilluar intelektualisht e të paditur të jenë



aderuesit në një ideologji, aq më të prirur janë ata për të shpërthyer në akte dhune. Kjo vlen edhe për ideologjitë që nuk kanë të bëjnë fare me fenë. Të gjitha lëvizjet komuniste në botë janë të prirura nga terrori. Më të egrat e më të përgjakshmet e tyre ishin ato të khmerëve të kuq në Kamboxhia. Veprimet e tyre vinin për arsye të injorancës së thellë.

Në të njëjtën mënyrë, njerëzit injorantë mund ta justifikojnë dhunën deri në kufijtë e çmendurisë; ata mund të ushtrojnë dhunë nën petkun e feve hyjnore, të cilat janë në kundërshtim të plotë me dhunën. Ashtu si tek të krishterët dhe tek hebrenjtë, shembuj të akteve të dhunës hasen në botën islame edhe në ditët tona.

Në mënyrë që të shohim fytyrën e vërtetë të atyre që kryejnë terror në emër të fesë, le të njihemi me tiparet e karakterit beduin në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë me të).



Krishterimi është një fe e bazuar në dashuri, por kryqtarët kryen disa prej akteve më barbare në histori. Këta barbarë, të cilët nuk dinin pothuajse asgjë për fenë e tyre, dhe të cilët ndoshta nuk e kishin lexuar ndonjëherë Biblën në jetën e tyre, kryen masakra nën justifikimin e çmendur se barbaria ishte "Vullneti i Zotit".

## Karakteri beduin në Kuran

Në kohën e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të), në Arabi ekzistonin dy struktura bazë të shoqërisë. Këta ishin banorët e qytetit dhe beduinët (arabët e shkretëtirës). Në qytete mbizotëronte një kulturë e sofistikuar. Marrëdhëniet tregtare i lidhnin qytetet me botën e jashtme dhe kjo shërbente për formimin e "sjelljeve të mira" mes arabëve qytetarë. Ata kishin vlera estetike të rafinuara, pëlqenin letërsinë dhe veçanërisht poezinë. Arabët e shkretëtirës, nga ana tjetër, ishin fise nomade që jetonin në shkretëtirë dhe që kishin një kulturë shumë të papërpunuar. Ata ishin plotësisht të panjohur me artet dhe shkencat dhe zhvillnin një karakter të parafinuar.

Islami lindi dhe u zhvillua mes banorëve të Mekës, qytetit më të rëndësishëm të gadishullit. Sidoqoftë, Islami u përhap në të gjithë gadishullin dhe atë e përqaftuan të gjitha fiset arabe. Mes këtyre fiseve ishin gjithashtu arabët e shkretëtirës, por këta ishin disi problematikë. Sfondi i tyre intelektual e kulturor i pengonte disa prej tyre që ta kuptonin thellësinë dhe shpirtin fisnik të Islamit. Lidhur me këtë, Zoti në Kuran ka shpallur këtë varg:

**"Arabët e shkretëtirës janë më të këqinjët në mosbesim e hipokrizi dhe më të prirur për të mos i njohur kufijtë që Zoti i ka bërë të ditur të Dërguarit të Tij. Mirëpo Zoti është i Gjithëditur, i Urtë." (Kuran, 9:97)**

Disa nga arabët e shkretëtirës, të cilët ishin "më të këqinjët në mosbesim e hipokrizi", si dhe të prirur për të mos iu bindur urdhëresave të Zotit, u bënë pjesë e komunitetit islam në kohën e Profetit. Nuk duhet të harrojmë se jo të gjithë arabët e shkretëtirës ishin negativë. Sidoqoftë, në kohët e mëvonshme, sekti i quajtur "harixhi", i cili lindi mes beduinëve përbën një shembull. Tipari më i dallueshëm i këtij sekti pervers (të quajtur "harixhi", që do të thotë "rebel", për shkak të shmangies së madhe nga



Në kohën e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të) beduinët ishin fise nomade të shkretëtirës. Për shkak të kushteve të vështira në të cilat jetonin, ata kishin tradita dhe zakone jo të lehta për t'u praktikuar.



praktikat sunite), ishte natyra e tyre e egër dhe fanatike. "Harixhitët", të cilët e kuptonin fare pak thelbin e Islamit apo virtytet dhe vlerat e shprehura në Kuran, luftuan kundër të gjithë myslimanëve të tjerë, duke u mbështetur në një numër të vogël vargësh kuranore, të cilët ata i keqinterpretuan dukshëm. Për më tepër, ata kryen "akte terrorizmi" të vërtetë. Aliu që ishte njëri nga shokët më të dashur të Profetit, u vra nga një harixhi.

E thënë ndryshe, njëlloj sikurse kryqtarët dëmtuan dhe keqinterpretuan Krishtërimin, sikur të ishte një doktrinë egërsie, disa grupe që e kishin burimin te bota islame, e keqinterpretuan Islamin, duke përdorur brutalitetin. E përbashkëta mes këtyre sekteve dhe kryqtarëve ishte natyra injorante, e parafinuar e pakulturuar, e paaftë për ta kuptuar fenë. Dhuna e përdorur prej tyre erdhi si pasojë e kësaj paaftësie për të kuptuar dhe jo nga feja që ata pretendonin se i përkisnin. Ata nuk i njihnin konceptet bazë të fesë së tyre dhe vepruan në bazë të bestytnive që vetë i sajuan.

Do të ishte plotësisht e gabuar të mendohej se karakteri beduin ishte vetëm në atë kohë dhe nuk ekziston më. Prania e njerëzve me të njëjtin

karakter sot është e dukshme. Këta njerëz, si askush tjetër më parë dhe në mënyrë të palogjikshme, nxisin përdorimin e dhunës kundër atyre që nuk ndajnë të njëjtin besim. Kjo për ata është si një urdhëresë fetare. Denoncimi i njerëzve si jobesimtarë dhe keqinterpretimet e ndryshme, janë disa prej këtyre shembujve.

### **Arsyet e palogjikshme të atyre që derdhin gjak në emër të Islamit**

Në botën islame, disa myslimanë të cilët besojnë në të njëjtin Zot, që e pranojnë Profetin Muhamed (paqja qoftë me të) si të dërguarin e Tij dhe Kuranin si librin e vërtetë, e akuzojnë njëri-tjetrin për blasfemi dhe kryejnë vrasje. Vrasjet masive të shiitëve dhe shkatërrimi i xhamive të tyre, që kanë ndodhur kohët e fundit, kanë tërhequr vëmendjen për devijimet radikaliste në botën islame. Edhe sulmet e disa grupeve shiite kundër sunive, në disa rajone të tilla si Iraku, kanë kontribuar në rritjen e radikalizmit. Megjithatë, kjo mendësi gjakatare nuk kufizohet vetëm te këto organizata radikaliste dhe kjo nuk është një sëmundje e re.

Vrasjet në Egjipt vetëm për shkak se ata ishin besimtarë shia, apo ata që u vranë dhe u tërhoqën zvarrë nëpër rrugët e Irakut për shkak se ata ishin suni, bëjnë përgjegjës vendimet, apo fetvatë e lëshuara nga disa të ashtuquajtur dijetarë që pretendojnë së flasin në emër të Islamit. Këta të ashtuquajtur dijetarë flasin në xhamitë e tyre, ose shfaqen në kanalet televizive dhe me fetvatë e tyre i tërheqin njerëzit (kryesisht injorantët) në një brutalitet të tillë. Në Lindjen e Mesme, ky koncept i gabuar, i bazuar në bestytni, është parë në luftën e ashpër mes shiitëve dhe grupeve sunite brenda të njëjtit vend. Ndërkohë dhuna haset edhe në luftërat sektare ndërmjet përfaqësuesve të grupeve dhe organizatave. Sigurisht dhuna e ushtruar nga këto grupe është e gabuar. Por ky gabim mund të ndreqet, vetëm nëse ata i kthehen burimit të besimit, Kuranit.

## Denoncimi i njerëzve si jobesimtarë

Kjo mendësi e tmerrshme, e konsideron vrasjen e të pafajshmëve si një "akt adhurimi", ajo refuzon të drejtën e jetës për ata që nuk ndajnë të njëjtin besim; për pasojë, kemi një përhapje të rebelimit, i cili vazhdimisht shkakton gjakderdhje në vendet islame. Një nga problemet themelore të kësaj ideologjie devijante është "tekfirizmi".

"Tekfirizmi" është të deklaruarit e një individi (apo grupi) si jobesimtar (kafir), duke e akuzuar atë për devijim nga besimi islam. Kur grupet të referuara si "tekfiriste" marrin këtë vendim në lidhje me një person ose një



Kuvajti (Imam Xhafer es-Sadiku, në xhami pas bombardimit)



Sulmi në një xhami në Jemen



Masakra në Camp Speicher, ku u vranë 1700 kadejtët Shiiia, të avionit ushtarak të Irakut



grup njerëzish, ata gjithashtu deklarojnë se është e detyrueshme që këta njerëz të vriten; kjo vjen prej fanatizmit të tyre të bazuar në besëtytni. Megjithatë në Kuran, Zoti nuk i jep asnjë njeriu të drejtë të gjykojë besimin e të tjerëve. Nga ana tjetër, edhe në qoftë se një person devijon apo i shmanget besimit të tij, është Zoti, Ai që i gjykon.

**Për çdo çështje që nuk pajtoheni, gjykimi për të është tek Allahu. Ai është Allahu (gjykatësi suprem), Zoti im, vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm Atij i drejtohem. (Kuran, 42:10)**

**Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, përveç Allahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër, por vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Kuran, 12:40)**

Në ditët tona, disa grupe suni i deklarojnë shiitët jobesimtarë, po ashtu edhe shiitët i deklarojnë sunitët jobesimtarë. Ata flasin me urrejtje për njëri-tjetërin, ata nuk luten së bashku dhe në shumë vende vrasin njëri-tjetërin në beteja të ashpra. Tekfirizmi që ka hyrë në fenë Islame nuk gjendet në

**Në ditët tona, disa grupe suni i konsiderojnë shiitët jobesimtarë, ndërsa shiitët deklarojnë se sunitët janë jobesimtarë. Ne shohim se ata nuk luten së bashku. Megjithatë, tekfirizmi që ka hyrë në fenë Islame, nuk gjendet në Kuran.**





Kuran; ky rebelim është i bazuar në një hadith të njohur si "el-Firkat el-Naxhijeh" (sekti Savedi) që i atribuohet Profetit tonë (paqja qoftë me të). Një pjesë e këtij hadithi - që është pjesë e transmetimeve të ndryshme, por nuk ka bazë në ajetet e Kuranit - është si vijon:

***"Populli im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjithë janë në zjarr, përveç një të vetmi: në të jam unë dhe pasuesit e mi".***

Kjo linjë arsyetimi gjendet në transmetime të ndryshme me shtesa të ndryshme, ose në version edhe më të shkurtër. Për shembull, te Tirmidhiu nuk përmendet "të gjithë janë në zjarr, përveç një të vetmi". Te Hakimi, ky hadith është transmetuar shumë shkurt duke thënë: "

***Populli im do të ndahet në shtatëdhjetë sekte; më i madhi prej tyre është ai që të ligjshmen e bën të paligjshme, dhe të paligjshmen e bën të ligjshme." (El-Mustedrek, 4/430)***

Shpërbërja dhe fragmentizimi që ne shohim në botën islame është rezultat i një mentaliteti që nuk e sheh si të mjaftueshme mbështetjen në Kuran, por kërkon të sjellë një formë tjetër të Islamit nëpërmjet bestytnive, fanatizmit, hadithe të fabrikuara dhe traditës. Në vend që të ndjekin shembullin e myslimanëve në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë me të), grupe të tilla fanatike trillojnë duke e bërë të ligjshme atë që është e paligjshme dhe besojnë vetëm në hamendësimet e tyre; ata i quajnë renegatë, myslimanët e tjerë të cilët praktikojnë Islamin në një mënyrë të ndryshme. Megjithatë, Zoti e ka ndaluar një mendësi të tillë mjaft qartë në Kuran:

**O ju që besuat, kur marshoni në rrugën e Allahut, të jeni të matur (të mos nguteni), e mos i thoni atij që ju shpreh selamin (besimin): "Nuk je besimtar!", duke kërkuar me të përfitim të jetës së kësaj bote, sepse te Allahu janë begatitë e mëdha. Ashtu (jobesimtarë) ishit edhe ju më parë, e Allahu ju dhuroi (besimin), pra sqarohuni mirë! Allahu di në hollësi çfarë veproni. (Kuran, 4:94)**

## *Islami Dënon Terrorizmin*

Në hadithet që vijojnë, shohim se Profeti ynë (paqja qoftë me të) i udhëzon myslimanët të mos e akuzojnë njëri-tjetrin për mosbesim:

*... Ai që etiketon dikë për mosbesim, ose e quan atë armik të Zotit, dhe ai në fakt nuk është kështu, ajo që tha bie mbi të. (Sahih Muslim, Libri 1, Hadithi 118)*

*... Ta mallkosh një besimtar është si ta vrasësh atë, dhe kushdo që akuzon një besimtar për mosbesim, atëherë kjo është sikur ai ta kishte vrarë atë. "(Buhariu, Libri 73, Hadithi 126)*

*Kushdo që falet si ne dhe kthehet nga kibla jonë dhe ushqehet nga bagëtitë e therura nga ne, është mysliman dhe është nën mbrojtjen e Zotit dhe të dërguarit të Tij. Pra, mos e tradhtoni Zotin duke tradhtuar ata që janë në mbrojtjen e Tij. (Sahih Bukhari, Libri 8, Hadithi 386)*

*Cilido që e thërret vëllanë e tij: O jobesimtar (në fakt ka bërë një akt prej jobesimtari), ai do të kthehet në një prej tyre. Nëse ndodh kështu, pasi ai e pohoi (atëherë mosbesimi i njeriut është konfirmuar,*

**por në qoftë se ajo nuk ishte e vërtetë), atëherë ajo i kthehet atij (njeriut që e ka etiketuar vëllain e tij mysliman). (Sahih Muslim, Libri 1, Hadithi 117)**

**Kur një njeri e quan vëllain jobesimtar, ajo (akuza) i bie (të paktën) njërit prej tyre. (Sahih Muslim, Libri 1, Hadithi 116)**

Në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë me të), ka pasur hipokritë që nuk kishin besim në zemrat e tyre dhe ishin të devijuar: Zoti na ka informuar në shumë ajete në Kuran që ka pasur njerëz, të cilët nuk kanë qenë të kënaqur me gjykimin e Pejgamberit (paqja qoftë me të), dhe u bënë jobesimtarë. Megjithatë, Profeti ynë (paqja qoftë me të) u ka komunikuar besimin, bëri përpjekje për të forcuar besimin e të gjithëve pa përjashtim dhe kurrë nuk i akuzoi ata për mosbesim. Nuk është e lejuar që një shërbëtor i Zotit të gjykojë dikë për besimin e tij, ose ta dënojë atë në bazë të kësaj.

Allahu na informon neve se myslimanët që shkaktojnë përçarje, ngarkohen me një gjynah për të cilin do të japin llogari në botën tjetër:

**Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm te Allahu, Ai do t'i njohë ata me atë që punuan. (Kuran, 6: 159)**

Në Kuran, ne jemi informuar se myslimanët duhet të jenë të bashkuar dhe të jetojnë si vëllezër, se ata nuk duhet të ndahen dhe duhet të jenë bashkë si radhët e një ndërtese të fortifikuar:

**Respektojeni Allahun dhe të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete, e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Jini të durueshëm, se Allahu është me të durueshmit. (Kuran, 8:46)**

**Mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi argumentet e qarta u erdhën atyre. Ata do të kenë dënim të madh. (Kuran, 3:105)**

Në vend që të kontribuojnë në unitetin e myslimanëve, ata bëjnë deklarata për përçarje dhe urrejtje, japin fetva ku deklarojnë se disa janë jobesimtarë dhe i nxisin myslimanët drejt dhunës dhe gjakderdhjes. Atyre që shpallin një të ashtuquajtur xhihad kundër vëllezërve të tyre myslimanë, bazuar në deklarimet e drejtuesve të sektit të tyre, janë në humbje dhe llogarinë e kanë të rëndë në botën tjetër. Zoti urdhëron të bëhet pajtim ndërmjet myslimanëve, si më poshtë:

**Besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar. (Kuran, 49:10)**

### **Keqinterpretimi i kisasis (hakmarrjes)**

Urdhëresat në Kuran synojnë shmangien e dënimeve arbitrare, që rrjedhin si prej hakmarrjeve personale ashtu edhe prej pakënaqësive; hakmarrja ishte një dukuri e zakonshme në shoqërinë arabe të kohës së Profetit Muhamed (paqja qoftë me të). Parimi i parandalimit, i hasur në të gjithë Kuranin, është i dukshëm gjithashtu në urdhërimin e "Kisas-it", i cili ka për qëllim mbrojtjen e jetës me anë të parandalimit dhe shmangies së krimit:

**"O ju që besuat! Hakmarrja është bërë obligim për ju në rastin e njerëzve të vvarë: njeriu i lirë për njeriun e lirë, robi për robin, femra për femrën. Por në qoftë se dikush është shfajësuar nga vëllai i tij, gjaku, paratë duhet të kërkohen me korrektësi dhe të paguhen me dëshirë. Ky**




**është lehtësim dhe mëshirë nga Zoti yt. Kushdo që shkon përtej kufijve pas kësaj, do të marrë një dënim të dhembshëm. (Kuran, 2:178)**

Pika e rëndësishme në lidhje me këtë ajet, pra në lidhje me hakmarrjen, është se ajo inkurajon faljen dhe se kjo është mënyra më e mirë e sjelljes. Në këtë kuptim, ligji i hakmarrjes është një siguri për jetën e njerëzve.

Për hakmarrjen dhe për mënyrën e aplikimit të saj, ka rregulla; pra nga kush, si dhe kujt. Në Kuran, Zoti shpjegon se ata që gëzojnë të drejtën e hakmarrjes janë "të afërmit":

**Mos vrisni asnjë që Zoti ua ka ndaluar, përveçse me drejtësi. Nëse dikush është vrarë gabimisht, Ne u kemi dhënë pushtet të afërmve (të kërkojnë drejtësi). Por ata nuk duhet ta kalojnë kufirin.... (Kuran, 17:33)**

Përveç kësaj, siç shpjegohet në Kuran (5:178), të afërmve u kërkohet që nëse kanë mundësi të heqin dorë nga



hakmarrja dhe të kërkojnë kompensim, pra ta falin. Në një ajet tjetër, Zoti shpjegon se falja është e preferuar:

**Ndëshkimi i të keqes bëhet me të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek Allahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët. (Kuran, 42:40)**

Siç vërehet qartë në ajetet e Kuranit, sigurisht më e mira është falja dhe përmirësimi. Citohet se kjo është një sjellje që Zoti e ka favorizuar edhe para Islamit:

**Ne u caktuam atyre në të (në Teurat) kundërmasat ndëshkuese: njeriu (vritet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e fal atë (hakmarrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. Ata që nuk gjykojnë sipas asaj që zbriti Allahu, të tillët janë zullumqarë. (Kuran, 5:45)**

### **Sipas Kuranit, është e gabuar t'i përgjigjesh së keqes me të njëjtën monedhë**

Udhëheqësit e organizatave terroriste që abuzojnë me fenë Islame, ose kleri që kërkon t'i legjitimojë ato, kur janë pyetur se përse ata nxjerrin fetva që justifikojnë masakra të tilla dhe bombat vetëvrasëse, ata thonë se kjo është hakmarrje për sulmet e kryera mbi myslimanët. Është e vërtetë se myslimanët janë masakruar në vende të ndryshme të botës, janë gjymtuar, shtypur dhe janë trajtuar padrejtësisht; megjithatë, Zoti ndalon t'i përgjigjesh tiranisë me tirani. Për këtë arsye, falja ka përparësi ndaj hakmarrjes.

### **Sipas Islamit, përgjegjësia është individuale dhe hakmarrja nuk duhet t'i kalojë kufijtë**

Në Kuran, Zoti e ndalon ligësinë. Për më tepër, Islami thekson

parimin se përgjegjësia për krimin është "individuale". Bombardimi i njerëzve, pavarësisht se shumë prej tyre janë civilë të pafajshëm, fëmijë, gra apo pleq, nuk është gjë tjetër vetëm se vrasje. Po ashtu, vrasja e njerëzve për shkak të kombësisë, besimit, sektit të tyre, apo hakmarrja bazuar në shkaqe të tilla, është tërësisht kundër Islamit.

Në bazë të ligjit të luftës në Islam qëndron drejtësia, dhe gjithmonë ka përparësi paqja, kompromisi dhe falja. Qëllimi është që gjithmonë të sigurohet vazhdimësia e jetës si për veten, ashtu edhe për të tjerët. Për këto arsye, Zoti e ka lejuar "hakmarrjen" vetëm si një parandalues kundër vrasjes së qëllimshme; Ai vendosi disa kufizime dhe kushte mbi të cilat duhet dhuruar falja dhe ua ndaloi hakmarrjen individëve apo shoqërive bazuar në mendimet e tyre personale.

Urdhëresat në Kuran janë krejtësisht të qarta, por përsa kohë ekzistojnë njerëz që kryejnë terror në emër të fesë, del për detyrë që ne të analizojmë psikologjinë e terrorit:

### **Metodat terroriste dhe psikologjia e sëmurë**

Koncepti i terrorit ka një kuptim më të gjerë në gjuhën e sotme. Në përgjithësi, ai i referohet luftës së armatosur, e cila nxitet prej grupeve me mendësi radikaliste. Terror do të thotë kërcënim, por ky kërcënim shtrihet në një fushë të gjerë, e cila përfshin çdo sferë të jetës njerëzore; njerëzit ndiejnë kërcënim, kanosje të dhunës dhe të frikës. Terrori, si çdo veprim i dhunshëm që kryhet për të nxitur frikë, përfshin një kërcënim të dendur e të rregullt që synon t'i mësojë njerëzit të përvetësojnë një mënyrë të caktuar të menduari dhe sjelljeje. Në çdo rast, objektivi i terrorizimit janë drejtpërdrejt apo tërthorazi vetë qytetarët.

Organizatrat e terrorit përdorin terrorin për të siguruar mbështetje. Kërcënimet e përdorura prej tyre llogariten që të rrisin forcën e tyre dhe në këtë mënyrë, t'u sigurojnë me hir a me pahir, mbështetjen e një pjese apo të të gjithë qytetarëve.

Gjëja e parë që njerëzve u vjen në mend kur përmendet fjala "terror", është në përgjithësi, lloji i njohur si "terror i majtë", por ekziston gjithashtu një lloj terrori që vihet re në vendet e Botës së Tretë dhe që vihet në jetë nga regjime diktatoriale. Në të vërtetë, realiteti këtu nuk është asgjë veçse një zbatim i taktikave të terrorit të majtë. Një diktator apo një grup në pushtet është shtypës dhe e përdor pushtetin vetëm për përfitime personale dhe për këtë arsye, përjetohen lloje të ndryshme të një opozite shoqërore. Në këtë situatë, regjimi diktatorial shpreh gjithmonë të njëjtën formulë për të treguar se është më i fortë se opozita. Ai përdor terrorin në mënyrë që qytetarët të jetojnë me frikë e zemër të ngrirë dhe pushteti të përforcojë pozitën e veta.

**Për terroristët, vrasja e njerëzve dhe mizoria janë një mënyrë jetese. Për ta, gjakderdhja është një veprim i qëllimshëm. Ata vrasin të pafajshëm, fëmijë ose hedhin në erë shtëpi pa ndërje fare dhembshuri.**





Organizatat e terrorit nga ana tjetër, pretendojnë se qëllimi i tyre është largimi i qeverive dhe i drejtuesve, të cilët ata i shohin si të paligjshëm e të egër; për të realizuar qëllimin e tyre, ata propagandojnë se do të sjellin një mënyrë jetese më të lumtur e më të drejtë. Sidoqoftë, ky nuk është një pretendim realist. Në Kuran, në vargjet e sures "Bekare", Zoti i kritikon ata që mendojnë në këtë mënyrë:

**Kur u thuhet: "Mos shkaktoni shturje në tokë," ata thonë: "Ne vetëm po përmirësojmë." Jo, në të vërtetë janë pikërisht ata që sjellin trazira, por nuk e kuptojnë. (Kuran, 2:11-12)**

Terroristët nuk janë pjesë e një kategorie të vetme, sepse shkaqet që i shtyjnë ata drejt dhunës janë të ndryshme; për shumë terroristë, vrasja është një mënyrë jetese. Shumica e tyre janë të zhveshur nga cilësitë njerëzore. Shpesh, ata përdorin armët e tyre kundër njëri-tjetrit dhe kryejnë spastrime të përgjakshme brenda fraksioneve të brendshme, të vetë organizatës ku militojnë.

Siç mund të shihet, terrorizmi nuk është gjë tjetër, veçse një burim gjakderdhjeje. Kushdo që e mbështet terrorizmin, është duke mbrojtur një sistem djallëzor. Fjalët e terroristëve nuk duhet të mashtrojnë askënd. Ata që kryejnë akte të tilla në emër të fesë, janë përgjegjës dyfish, si për gjakderdhjet, ashtu edhe për propagandën antifetare që përhapin përmes kryerjes së këtyre krimeve.

Dhuna dhe feja janë në kundërshtim të plotë me njëra-tjetrën. Terrorizmi ndjek rrugën e agresionit, dhunës dhe barbarisë. Kurani këshillon për pajtim dhe për marrëveshje. Ai nuk dënon vetëm terrorin, por edhe ata që kryejnë akte të tilla:

**Përsa u përket atyre që e shkelin marrëveshjen e Zotit, pasi vetë e dhanë besën dhe e këpusin atë që Zoti ka urdhëruar të jetë e bashkuar, që shkaktojnë mizori në tokë, mbi ta do të jetë mallkimi. (Kuran, 13:25)**

Cilësitë themelore të terrorit, hasen tek të gjithë të infektuarit nga mizoria e tij; droja dhe dashuria për Zotin, janë krejt të huaja për ta. Zemrat e tyre janë të ngurta dhe të sëmura.

### Terroristi nuk ka mëshirë, qëllimi i tij i vetëm është që të shkatërrojë


Themeluesi i anarkisë ruse, Michael Bakunin dhe dishepulli i tij Nechayev e përkufizojnë "idealin" terrorist në këtë mënyrë:

E gjithë çështja e ekzistencës së tij [e një revolucionari], nuk bazohet vetëm te fjalët, por edhe te veprat, ai është në luftë me rendin ekzistues të shoqërisë dhe me të gjithë të ashtuquajturën botë të qytetëruar, me ligjet, moralin dhe zakonet, ai është një kundërshtar i pakompromis ... Ai njeh vetëm një shkencë; shkencën e shkatërrimit.<sup>18</sup>

Siç kuptohet nga këto fjalë të Bakunin dhe Nechayev, terroristët janë njerëz që shkëpusin marrëdhëniet e tyre me çdo institucion, qoftë shtetëror apo edhe shpirtëror, duke refuzuar çdo vlerë morale; ata i shohin këto institucione si pengesa për planet e tyre. Bakunin gjithashtu ka thënë: "Ditë e natë [revolucionari] guxon dhe ai ka vetëm një mendim, një synim, shkatërrimin e pamëshirshëm; ndërsa ai ndjek këtë qëllim, gjakftohtë dhe pa pushim, ai vetë duhet të jetë gati për të vdekur në çdo kohë dhe i gatshëm për të vrrarë me duart e tij, çdo njëri që kërkon të pengojë qëllimet e tij." Në artikullin e tij *Bazat e Revolucionit Social*, gjendet përshkrimi se ç'lloj njeriu duhet të jetë një terrorist:

**Ai duhet të jetë i rreptë me veten e tij, por edhe me të tjerët. Të gjitha ndjenjat e dobëta në drejtim të lidhjeve, miqësisë, dashurisë dhe mirënjohjes duhet të shtypen me pasionin e vetëm e të ftohtë, të punës revolucionare.<sup>19</sup>**

Këto fjalë nxjerrin në shesh fytyrën e errët të terrorizmit dhe tregojnë se ajo është plotësisht në kundërshtim me fenë Islame, e cila ka në themel paqen, dhembshurinë dhe dashurinë.



Terroristët i shfrytëzojnë aktet e tyre shkatërruese si mjete propaganduese; ata shpresojnë të përhapin frikë si me vrasjet e njerëzve, ashtu edhe me shkatërrimin e pronave.

### **Islami dënon të gjitha aktet e terrorit dhe të dhunës, pa harruar edhe sulmin në Boston**

Sulmi i tmerrshëm terrorist në maratonën e Bostonit në SHBA në vitin 2013, u dënua nga të gjithë myslimanët e vërtetë, njësoj si sulmet e tjera terroriste të 11 Shtatorit.

Ky akt terrorist, ku tre persona humbën jetën dhe qindra të tjerë u plagosën, ka qenë një akt i egër e barbar, i projektuar për të vendosur botën perëndimore dhe atë islame kundër njëra-tjetrës. Akte të tilla të pamëshirshme, janë kryer disa herë në vende të ndryshme për t'i dhënë Perëndimit përshtypjen, se Islami është një fe që i përket dhunës dhe terrorit. Në fakt, në prag të sulmeve në Boston, nga disa organizata mediatike në SHBA janë bërë thirrje për të dhunuar myslimanët dhe për t'i izoluar ata nga shoqëria. Provokime të tilla ka pasur gjithmonë dhe do të ketë edhe në të ardhmen. Megjithatë, myslimanët kanë një detyrë shumë të rëndësishme, që edhe në këtë klimë të mos ngurrojnë së dënuari sulmet terroriste dhe të ftojnë njerëzimin në moralin e vërtetë islam.

Kushdo që pretendon se është mysliman dhe thotë se feja i justifikon aktet e terrorit dhe të dhunës, ose është një provokator i infiltruar, që hiqet si mysliman, ose dikush, i cili është krejtësisht injorant përse i përket besimit. Dikush që thotë gjëra të tilla, i duhet treguar se çfarë thotë në të vërtetë Kurani. Njerëzit mund të informohen siç duhet për Islamin, por jo ata që kanë për qëllim





Sipas Kuranit, vrasja e një të pafajshmi është një mëkat i madh. Zoti i ndalon aktet terroriste dhe i dënon ata që i kryejnë.

provokimin. Në qoftë se njerëzit besojnë se Islami e sheh dhunën dhe urrejtjen si të papranueshme, atëherë nuk do të ketë më hapësirë për provokatorët dhe ekstremistët.

Në botën perëndimore ka prej atyre, që përpiqen të nxisin armiqësi ndaj Islamit, por edhe në botën islame ka të atillë, që përpiqen të nxisin armiqësi ndaj Krishtëritit dhe Judaizmit. Këta njerëz janë fanatikë që lëshojnë deklarata provokuese, që nuk janë të bazuara në Kuran, por në hadithet që ata vetë i sajojnë. Kjo është një gjë shumë serioze dhe një problem i madh në botën islame dhe ne nuk mund ta injorojmë atë. Të gjithë myslimanët e vërtetë janë thellësisht të shqetësuar që ka njerëz të tillë, të cilët konsiderohen si anëtarë të botës islame dhe si përfaqësues të besimit; këta njerëz nuk kanë të bëjnë me vlerat që mbart Islami. Ata e kanë privuar veten e tyre prej ndjenjave fisnike, të tilla si dashuria dhe dhembshuria. Ata janë të mbushur me urrejtje dhe zemërim, jo vetëm ndaj anëtarëve të besimeve të tjera, por edhe ndaj myslimanëve. Ata e urrejnë dikë, që kurrë nuk e kanë takuar, vetëm për shkak se ai i përket një grupi që është i ndryshëm. Ky është një këndvështrim i mbrapshtë dhe i papranueshëm për myslimanët.

Ata që dëshirojnë të përhapin luftë, fusin përçarje ndërmjet anëtarëve të besimeve ose etnive të ndryshme; nxitja e konfliktit mes tyre ka qenë një teknikë e përdorur me sukses, gjatë gjithë rrjedhës së historisë. Megjithatë, kjo botë është e gjerë dhe të

gjithë mund të jetojnë në paqe, lumturi dhe mirëqenie. Nuk ka asnjë arsye pse duhet të ketë konflikt ose dhunë. Të gjitha arsyet e supozuara për luftë dhe konflikt janë thjesht dredhi.

Të jetuarit në paqe dhe në dashuri është shumë më e lehtë, sesa konflikti dhe lufta. Për shembull, është e papranueshme që palestinezët apo izraelitët duhet të jetojnë pas mureve, nën frikën e bombave, predhave dhe armëve të tjera. Gjendja e këtyre dy popujve, ku njëri është pasardhës i Profetit Ismail dhe tjetri i Profetit Jakub (paqja qoftë mbi ta), është një turp për të gjithë njerëzimin.

Ne shpresojmë që njerëzit me pikëpamje radikaliste në fund t'i kthehen rrugës së drejtë dhe tolerante, që ndjekin njerëzit e arsyeshëm; historikisht, në mënyrë të pashmangshme, lëvizjet radikaliste shkojnë drejt shpërbërjes së tyre, dhe që të ndodhë kjo është absolutisht thelbësore që besimtarët e vërtetë myslimanë, kristianë dhe hebrenj, të bashkëveprojnë së bashku në frymën e solidaritetit. Një aleancë e njerëzve të mirë është thelbësore. Kjo aleancë duhet formuar, jo vetëm midis myslimanëve, por edhe me ithtarët e Librit. Përndryshe, terrori dhe aktet e dhunës s'do mund të ndalen asnjëherë.

Allahu thërret për në  
Xhennet dhe atë që do,  
e vë në rrugë të drejtë.  
(Kuran, 10:25)





# KËNDVËSHTRIMI I ISLAMIT MBI ITHTARËT E LIBRIT

Një tjetër çështje e rëndësishme që ka qenë në rendin e ditës, pas akteve të terrorit kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, janë marrëdhëniet mes Perëndimit dhe Botës Islame. Siç dihet, në vitet '90, disa intelektualë hodhën pretendimin se në një të ardhme të afërt, mes Perëndimit dhe botës Islame do të kishte përplasje. Kjo është çështja themelore e tezës së njohur të Samuel Huntingtonit "Përplasia e qytetërimeve". Sidoqoftë, kjo tezë që Eduard V. Said e quan me të drejtë "Përplasia e injorancës", mbetet një skenar imagjinar i gjeneruar nga teprimi i ndikimit të disa grupimeve radikale e injorante që janë pjesë e të dy këtyre qytetërimeve. Ideja Huntingtonit të "Përplasia e qytetërimeve" është një teori pa baza shkencore apo intelektuale. Qytetërimet e ndryshme kanë ekzistuar gjithmonë, në pjesë të ndryshme të botës. Gjatë historisë këto qytetërimet kanë ndërvepruar me njëri-tjetrin, si në aspektin shoqëror, ashtu edhe në atë kulturor nëpërmjet "shkëmbimit të qytetërimeve." Çdo racë, komb, apo komunitet ka një qytetërim të ndryshëm dhe çdo qytetërim ka cilësitë e tij unike; në përputhje me parimet e mirëkuptimit dhe të pajtimit të

ndërsjelltë, njerëzit arrijnë gjithmonë të marrin diçka nga të gjitha qytetërimet.

Kjo ide e konfliktit u vërtetua kohët e fundit me komunizmin, i cili kulmoi në shekullin e 20-të me humbje të përgjakshme. Megjithatë, në këtë moment, bota ka nevojë për paqe e jo për luftë.

Për më tepër, nga politikat që favorizojnë konfliktet, nuk mund të përfitojë askush ndaj nuk mund të ketë përplasje mes qytetërimit perëndimor dhe atij islam, sepse shumë nga besimet dhe normat judeo-kristiane që gjenden në qytetërimin perëndimor, janë në harmoni me Islamin.

Në Kuran, çifutët dhe të krishterët quhen "Ithtarë të Librit" sepse anëtarët e të dy këtyre besimeve mbështeten në libra me prejardhje hyjnore të shpallur nga Zoti. Këndvështrimi i Islamit mbi Ithtarët e Librit është tejet i drejtë dhe i njerëzishëm. Qëndrimi ndaj Ithtarëve të Librit është zhvilluar gjatë viteve të lindjes së Islamit, sipas parimeve të shpallura në Kuran. Në atë kohë, myslimanët përbënin një pakicë që luftonte për të mbrojtur fenë, duke vuajtur nën shtypjen dhe keqtrajtimet e tmerrshme të paganëve të qytetit të Mekës. Për shkak të kësaj përndjekjeje, disa myslimanë vendosën të largohen nga Meka dhe të kërkojnë strehë në një vend të sigurtë, ku qeveriste një sovran i drejtë. Profeti Muhamed u tha atyre të strehohen te mbreti i krishterë i Etiopisë. Myslimanët që shkuan në Etiopi, gjetën një administratë shumë të ndershme që i pranoi ata me dashuri e respekt. Mbreti kundërshtoi kërkesat e të dërguarve paganë që kishin shkuar në Etiopi për t'i kërkuar atij që t'u dorëzohen myslimanët. Ai u bëri të ditur myslimanëve se mund të jetonin të lirë në vendin e tij.

Qëndrimet plot dhembshuri, mëshirë e drejtësi të të krishterëve, janë përmendur në një varg në Kuran, i cili thotë:

**...Do të shihni se njerëzit më të afërt me besimtarët (myslimanët) janë ata që thonë: "Ne jemi të krishterë," për arsye se ndër ta ka priftërinj e murgj dhe sepse ata nuk janë kryelartë. (Kuran, 5:82)**

## Besimet dhe vlerat e përbashkëta që myslimanët ndajnë me Ithtarët e Librit

Besimi islam, i krishterë dhe ai judaik, kanë disa aspekte të përbashkëta. Në Kuran, Zoti thotë se myslimanët kanë disa pika besimi të njëjta me Ithtarët e Librit dhe i përshkruan kështu fjalët që myslimanët u thonë atyre:

**"Ne besojmë në atë që na është shpallur neve dhe në atë që u është shpallur juve; Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe ne i jemi dorëzuar Atij." (Kuran, 29:46)**

Aderuesit e vërtetë të këtyre tre besimeve të mëdha:

\* besojnë se Zoti ka krijuar mbarë gjithësinë nga asgjëja dhe se Ai sundon me Fuqinë e vet gjithçka që ekziston,

\* besojnë se Zoti ka krijuar njeriun dhe qeniet e gjalla në një mënyrë të mrekullueshme dhe se njeriu zotëron një shpirt të dhuruar nga Zoti,

\* besojnë në ringjalljen, në Parajsën, ferrin dhe në engjëjt dhe se Zoti

Sipas Kuranit, vrasja e një të pafajshmi është një mëkat i madh. Zoti i ndalon aktet terroriste dhe i dënon ata që i kryejnë.



i ka krijuar jetët tona me një përfundim të caktuar,

\* besojnë se Zoti ka dërguar në rrjedhën e historisë shumë profetë si Nuhun (Noe), Ibrahimin (Abrahamin), Is'hakun (Isakun), Jusufin (Jozefin) e Musain (Moisiun) dhe i duan të gjithë këta profetë.

Në një varg nga Kurani tregohet se myslimanët nuk bëjnë dallim mes profetëve. Ata besojnë se Musai (Moisiu), profeti i çifutëve dhe Isai (Jezusi), profeti i të krishterëve, janë dy nga profetët më të spikatur te të cilët besojnë myslimanët.

**I Dërguari beson në atë që i është shpallur atij nga Zoti i tij dhe, po ashtu, besojnë edhe besimtarët. Secili beson në Zotin dhe engjëjt e Tij, dhe Librat e tij, dhe të Dërguarit e Tij. Ne nuk bëjmë dallim mes ndonjërit nga të Dërguarit. Ata thonë: "Ne dëgjojmë dhe bindemi. Falna ne, o Zoti ynë! Te Ti do të kthehemi!" (Kuran, 2:285)**

Besimet e Ithtarëve të Librit mbi vlerat morale janë në harmoni me ato të myslimanëve. Sot, në një botë ku forma të tilla imoraliteti si tradhëtia bashkëshortore, dhënia pas drogës dhe modeli i një egoizmi të egër, janë rritur e përhapur, Ithtarët e Librit dhe myslimanët ndajnë të njëjtat virtyte si: nderi, dliresia, thjeshtësia, vetëfljimi, dhembshuria, mëshira apo dashuria e pakushtëzuar.

Edhe pse koncepte të tilla si "Fundi i Historisë" dhe "Përplasja e Qytetërimeve" kanë filluar të jehojnë nga vitet 90-të e tutje, një e vërtetë po shfaqet në këto kohë të vështira; këto koncepte s'kanë asnjë vlefshmëri dhe nuk mund të ofrojnë zgjidhje. Përvoja na ka mësuar, se ne nuk mund të ndërtojmë lumturinë mbi mjerimin e të tjerëve. Duke qenë kështu, ne kemi nevojë të gjejmë rrugën për t'i lidhur këto plagë dhe t'i "shërojmë" sa më shpejt të jetë e mundur. Një hap i rëndësishëm është të kuptojmë vlerën që kanë ithtarët e librit në Kuran.



## Pozita që kanë ithtarët e Librit në Kuran

Sot u lejuan për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet e ithtarëve të librit janë të lejuara për ju, edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ta. Gratë e ndershme besimtare dhe (gra) të ndershme nga ata të cilëve u është dhënë libri para jush, kur atyre u jepni pjesën e caktuar të

Sot myslimanët dhe ithtarët e librit janë të angazhuar në një luftë të gjerë kundër imoralitetit, perversioneve seksuale dhe varësisë nga droga. Secila prej këtyre tri feve pranon se dëlirësia, ndershmëria dhe altruizmi janë prej virtyteve më të larta.



**kurorës, por duke pasur për qëllim martesën, e jo imoralitetin dhe jo si të dashura ilegale. E kush mohon (tradhton) besimin, ai ka asgjësuar veprën e vet dhe ai në botën tjetër është prej të shkatërruarve. (Kuran, 5:5)**

Ky ajet përshkruan pozitën që gëzojë ithtarët e librit për myslimanët. Sipas këtij ajeti myslimanit i lejohej të martohet me një grua prej ithtarëve të librit. Kjo është e rëndësishme, për shkak se në një ajet tjetër thuhet, **"Të këqijat (gru) janë për të këqinjët edhe të këqinjët janë për të këqijat, ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit dhe të ndershmit janë për të ndershmet..."** (Kuran, 24: 26); myslimanët këshillohen të lidhin jetën me njerëz të mirë e të ndershëm. Kjo tregon se hebrenjtë dhe të krishterët janë njerëz të mirë e të ndershëm.

Përveç kësaj, gjendet një kriter shumë i rëndësishëm në këtë varg. Një mysliman mund të martohet me një grua hebreje ose të krishterë, ajo është gruaja e tij, e thërret atë "e dashur" apo "zemër", ndërton familjen dhe kalon jetën me të në këtë botë madje edhe në jetën e përjetshme. Ajo është e vetmja me të cilën ai do të ndajë të gjitha problemet dhe lumturinë e tij. Ata përkujdesen për njëri-tjetrin kur janë të sëmurë dhe besojnë te njëri-tjetri.

Njerëzit me mendësi fanatike ndiejnë armiqësi ndaj atij që e thërret gruan "e dashur", me të cilën ai kalon dhe ia beson jetën e tij, e cila është nëna e fëmijëve të tij; ata e mallkojnë atë vetëm për shkak se ajo është një e krishterë apo çifute. Të tillët jenë në një gjendje të trazuar psikologjike. Ky ajet përshkruan dashurinë që një mysliman, duhet të ketë ndaj hebrenjve dhe të krishterëve.

Ajeti gjithashtu u lejon myslimanëve të konsumojnë ushqimet e përgatitura nga ithtarët e Librit. Kjo është shumë e rëndësishme. Siç e dimë, myslimanët duhet të kushtojnë vëmendje të madhe për ndalime të caktuara gjatë përgatitjes së ushqimit; derri, dhe mishi i një kafshe që nuk është therrur në emër të Zotit, janë të ndaluara në Islam. Fakti se ushqimi i përgatitur

nga hebrejët dhe të krishterët u lejohet myslimanëve, tregon se këta njerëz janë të besës. E njëjta gjë vlen edhe për të krishterët edhe për hebrejët, sepse ajeti i bën të lejuara për ta, ushqimet e përgatitura nga myslimanët.

Ai gjithashtu i referohet një tjetër shprehjeje të miqësisë. Ithtarët e Librit dhe myslimanët ulen së bashku nën të njëjtën çati, janë mysafirë të njëri-tjetrit, ulen në të njëjtën tryezë dhe shtrojnë gosti për njëri-tjetrin. Ky është një përshkrim i miqësisë. Ajeti nuk përshkruan një klimë në të cilën dominon urrejtja dhe vrasja, por dashuria, miqësia dhe vëllazëria.

Ky nuk është i vetmi ajet, i cili vlerëson ithtarët e librit. Zoti i lavdëron Ithtarët e Librit në shumë ajete të Kuranit. Ja disa nga vargjet në lidhje me këtë:

**Edhe prej popullit të Musait (hebrejve) që një grup që udhëzoi drejt dhe iu përmbajt asaj (drejtësisë). (Kuran, 7:159)**

**Ata nuk janë të njëjtë. Nga ithtarët e librit (hebrejët dhe të krishterët) ka që janë në rrugë të drejtë, gjatë natës lexojnë ajetet e Allahut duke u lutur. I besojnë Allahut dhe ditës së gjykimit,**

**Në Kuran, të krishterët dhe hebrejët janë quajtur si ithtarët e Librit; myslimanët urdhërohen që të tregojnë respekt, mëshirë dhe mirësi ndaj tyre. Të krishterët dhe hebrejët besojnë në Zot dhe ndajnë të njëjtat vlera morale, njëjtë si myslimanët.**



**këshillojnë për mirë dhe largojnë nga të këqijat, përpiqen për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve. E çfarëdo të mire që bëjnë, ajo nuk u mohohet. Allahu i njeh shumë mirë të devotshmit. (Kuran, 3:113-115)**

**Po edhe ka nga ithtarët e librit që e besojnë Allahun, e besojnë atë që u është shpallur juve, dhe besojnë atë që u është shpallur atyre; janë të bindur ndaj Allahut, dhe argumentet e Allahut në shpallje nuk i shesin për pak gjë të kësaj jete; të tillët kanë shpërblimin tek Zoti i tyre, e Allahu është i shpejtë në llogari. (Kuran, 3:199)**

Këto ajete tregojnë qartë, se hebrenjtë dhe të krishterët e ndershëm dhe të sinqertë janë vlerësuar në Kuran dhe atyre u është premtuar shpërblim nga Zoti; Zoti thotë se Ai do t'u dhurojë atyre parajsën. Kjo është një shprehje e dashurisë së Tij. Si mund të jetë myslimani armik me dikë që e do Zoti, që është i kënaqur me të dhe që e mirëpret në parajsë? Kjo është e pamundur sipas Kuranit. Një armiqësi e tillë është një krim sipas Kuranit. Prandaj, fanatikët, të cilët i pranojnë hadithet e rreme si udhërrëfyes të tyre - pavarësisht nga ajetet e Kuranit që në mënyrë të qartë tregojnë të kundërtën - sipas pikëpamjeve të Islamit, po kryejnë veprën penale të nxitjes së armiqësisë ndaj Ithtarëve të Librit.

Myslmanët duhet t'i ftojnë Ithtarët e Librit në Islam, me mirësjellje dhe pa imponim.

### **Myslmanët i ftojnë Ithtarët e Librit në "Njëshmërinë e Zotit"**

**Me ithtarët e librit mos polemizoni ndryshe (kur i ftoni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më e mira, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: "Ne besojmë në atë që na është shpallur neve dhe në atë që u është shpallur juve; Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe ne i jemi dorëzuar Atij." (Kuran, 29:46)**



**Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit, ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, tjetër veç Allahut, të mos i shoqërojmë (në adhurim) Atij askënd dhe të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zota përveç Allahut"! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)"! (Kuran, 3:64)**

Këto ajete tregojnë se misioni i myslimanëve nuk është denigrimi i ithtarëve të Librit, as izolimi, urrejtja dhe vrasja e tyre, ashtu siç sugjerojnë disa hadithe të fabrikuara. Misioni i myslimanëve është ftesa për në njëshmërinë e Zotit, në mënyrën më të këndshme. Monoteizmi është doktrina themelore e tre besimeve. Myslimanët nxiten që të dialogojnë me ithtarët e Librit dhe t'i ftojnë për të besuar në njëshmërinë e Zotit dhe në të gjitha shkrimet e shenjta që janë shpallur. Ata duhet të jenë të komunikueshëm, predikues dhe miqësorë. Sipas Kuranit, një mysliman nuk duhet të tregohet indiferent, por nxitet që të dialogojë me mirësi me një hebre ose të krishterë dhe t'i ftojë ata për të besuar në njëshmërinë e Zotit duke përdorur komunikimin më të mirë.

### **Sipas Kuranit, hebrenjtë gëzojnë të drejtën për të jetuar në Tokën e Shenjtë**

Disa komunitete myslimane nuk janë në dijeni të vargjeve të Kuranit dhe janë të paditur rreth Islamit, ata kërkojnë largimin e hebrenjve nga Toka e Shenjtë ose fshirjen e shtetit të Izraelit nga harta. Ata nuk janë në dijeni se duke bërë këtë, ata po rebelohen kundër Kuranit.

Sipas Kuranit, hebrenjtë kanë të drejtë të jetojnë në Tokën e Shenjtë. Ja disa ajete në lidhje me temën:

**Përkujto kur Musai i tha popullit të vet: "O populli im, përkujtoni dhuratën e Allahut ndaj jush, kur në mesin tuaj dërgoi profetë, ju mundësoi të jeni sundues dhe ju dha çfarë nuk i dha askujt prej**

**popujve". O populli im, hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu ua premtoi, dhe mos u ktheni mbrapa, sepse atëherë do të ktheheni të dëshpëruar. (Kuran, 5:20-21)**

**Pas tij, bijëve të israelit u thamë: "Rrini në vend, e kur të vijë koha e botës tjetër, Ne ju sjellim të gjithëve së bashku". (Kuran, 17:104)**

Siç tregohet qartë në ajetet e Kuranit, si Teurati ashtu edhe Kurani theksojnë se hebrenjtë duhet të jetojnë në Tokën e Shenjtë. Në të vërtetë është një e drejtë që të ketë hebrenj në Tokën e Shenjtë, dhe kjo është një burim gëzimi për myslimanët e vërtetë. Ky është një premtim i bërë prej Zotit 3.000 vjet më parë dhe ne jemi dëshmitarë të asaj që është parathënë nga profetët Ibrahim dhe Musa (paqja qoftë me ta). Zoti shpalli se "judenjtë do të jenë në ato toka" mijëra vjet më parë, dhe ne e shohim se kjo mrekulli manifestohet tani. Kjo është një situatë që duhet respektuar me entuziazëm dhe gëzim.

**Myslimanët duan që së bashku me hebrenjtë dhe të krishterët të jetojnë në paqe dhe harmoni, me mirëkuptim, miqësi, respekt dhe dhembshuri.**



Është me rëndësi të madhe të deklarojmë se Zoti vendos një kusht themelor për besimtarët e sinqertë, si në Kuran ashtu edhe në Teurat – ai kusht është "paqja." Në Tokën e Shenjtë do të ketë hebrenj; do të ketë edhe myslimanë edhe të krishterë, dhe ata së bashku do të sigurojnë që dashuria dhe paqja të mbizotërojnë në të gjithë rajonin. Ata do të jetojnë në vëllazëri. Ka mjaft hapësirë për të gjithë. Askush nuk do të jetë i detyruar të dëbohet nga shtëpia e tij. Kjo nuk do të ndodhë. Ky është një shërbim për fenë e hebrenjve, të krishterëve dhe atë të myslimanëve. Zoti dëshiron paqe për të gjithë ne.

### **Sipas Kuranit manastiret, kishat dhe sinagogat duhet të respektohen**

Një tjetër fakt i rëndësishëm që mësojmë nga Kurani është se myslimanët duhet të respektojnë vendet e adhurimit të hebrenjve dhe të krishterëve. Në Kuran, vendet e adhurimit të ithtarëve të librit, dmth. manastiret, kishat dhe sinagogat, përmenden si vende adhurimi të mbrojtura nga Zoti.

**E sikur Allahu të mos i zbrapste disa, me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i Allahut. E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon në rrugën e Tij, se Allahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. (Kuran, 22:40)**

Ky ajet i tregon çdo myslimani rëndësinë e respektimit dhe të mbrojtjes së vendeve të shenjta, të Ithtarëve të Librit.

Në të vërtetë, Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) bëri marrëveshje si me paganët ashtu edhe me Ithtarët e Librit. Paganët janë trajtuar gjithmonë me drejtësi, dhe kur ata kërkuan që të merren në mbrojtje, kërkesat e tyre u pranuan nga Profeti (paqja qoftë me të). Këto komunitete kërkuan mbrojtjen e të Dërguarit të Zotit (paqja qoftë me të) për shkak të


sulmeve apo akuzave të rreme. Gjatë gjithë jetës së tij, shumë jomuslimanë dhe paganë kërkuan mbrojtje nga Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) dhe ai i mori nën mbrojtjen e tij duke u ofruar siguri. Në Kuran, Zoti këshillon që kërkesat e paganëve që kërkojnë mbrojtje, duhet të pranohen nga besimtarët. Për këtë, Zoti thotë në vijim:

**E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t'i dëgjojë fjalët e Allahut (Kuranin) e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt... (Kuran, 9:6)**

Më të afërt me myslimanët janë hebrenjtë dhe të krishterët. Secila prej







këtyre feve ka librin e saj të shpallur nga Zoti. Ata, në bazë të shkrimeve të tyre, e dinë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar, çfarë është e ligjshme dhe çfarë është e paligjshme, dhe të gjithë i respektojnë profetët dhe ata që i pasuan. Ata të gjithë besojnë në botën tjetër, se do të dalin para Zotit dhe do të japin llogari për gjithçka që kanë vepruar. Pra, ka një themel të përbashkët nga ku ne të gjithë mund të bashkohemi.

**Xhamitë, kishat dhe sinagogat janë vende të veçanta të lutjes, ku përmendet emri i nderuar i Zotit. Në Kuran, Zoti thotë se të gjitha këto faltore duhet të respektohen dhe të mbrohen.**

## Bashkë në një fjalë të përbashkët

Në lidhje me ithtarët e Librit, Zoti i urdhëron myslimanët në Kuran, që ata të bashkohen në një fjalë të përbashkët:

**Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit, ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, tjetër veç Allahut, të mos i shoqërojmë (në adhurim) Atij askënd dhe të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zota përveç Allahut"! (Kuran, 3:64)**

Kjo është me të vërtetë thirrja jonë për të krishterët dhe hebrenjtë: Njerëzit që besojnë në Zot dhe ndjekin shpalljet e Tij, le të bashkohen te një fjalë e përbashkët - "te besimi". Ne e duam Zotin, i Cili është Krijuesi ynë, i respektojmë urdhëresat e Tij dhe i lutemi Zotit që të na udhëzojë në rrugën e drejtë.

Kur myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë të bashkohen në një fjalë të përbashkët; kur ata të kuptojnë se ata janë miq e jo armiq, atëherë bota do të jetë një vend shumë i ndryshëm. Luftërave në shumë pjesë të botës, hasmërive, frikës dhe sulmeve terroriste do t'u vijë fundi. Një qytetërim i ri, i bazuar në dashuri, respekt dhe paqe, po vjen; por së pari, bashkimi te kjo "fjalë e përbashkët" duhet të zhvillojë një luftë intelektuale kundër ideve radikaliste dhe ideologjive që çojnë në mohimin e Zotit.

Ka fakte të rëndësishme që myslimanët duhet t'i marrin në konsideratë. Zoti na mëson në Kuran për popujt dhe për besimet e ndryshme: morali i Kuranit përjashton çdo lloj racizmi.

Është e qartë se disa nga hebrenjtë që kanë jetuar në të kaluarën kanë kryer shumë gabime, të cilat janë deklaruar dhe kritikuar në Kuran. Por e gjithë kjo nuk duhet të merret nga myslimanët si një shkak për armiqësi kundër të gjithë hebrenjve. Krimi i kryer nga disa hebrenj, nuk duhet të përgjithësohet me judaizmin dhe kombin hebre.



**Të këqijave në botë do t'u vijë fundi, kur myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë do t'i shërbejnë Zotit në unitet, duke respektuar dallimet mes tyre.**

Kurani thekson se nuk duhet paragjykuar mbi njerëzit, vetëm për shkak se ata i përkasin një race të veçantë, kombi apo feje. Në çdo komunitet, ka njerëz të mirë dhe njerëz të ligj. Ky diferencim është theksuar në Kuran. Për shembull, pas përmendjes së natyrës rebele, të disa prej njerëzve në mesin e hebrenjve dhe të krishterëve, të cilët dolën kundër Zotit dhe kundër fesë së Tij, menjëherë pas kësaj vjen edhe përjashtimi:

**Ata nuk janë të njëjtë. Nga ithtarët e librit (hebrenjtë dhe të krishterët) ka që janë në rrugë të drejtë, gjatë natës lexojnë ajetet e Allahut duke u lutur. I besojnë Allahut dhe ditës së gjykimit, këshillojnë për mirë dhe largojnë nga të këqijat, përpiqen për punë të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve. E çfarëdo të mire që bëjnë, ajo nuk u mohohet. Allahu i njuh shumë mirë të devotshmit. (Kuran, 3: 113-115)**

Zoti i shpalli të gjithë të dërguarve, se Ai është unik dhe nuk ka tjetër si Ai; njerëzit duhet të adhurojnë, t'i shërbejnë dhe t'i binden vetëm Atij. Mesazhi Hyjnor, që Zoti u përcolli njerëzve nëpërmjet të dërguarve të Tij, u është komunikuar atyre që nga krijimi i njeriut të parë. Disa shoqëri e



pranuan mesazhin dhe ndoqën rrugën e drejtë, ndërsa të tjerët mohuan dhe devijuan. Kjo vlen edhe për ditët e sotme. Disa njerëz do të jenë të drejtë, ndërsa disa të tjerë do të zhyten në telashe. Ky është ligji i Zotit. Ata që besojnë, nuk duhet të harrojnë se njerëz të sinqertë, të devotshëm dhe që kanë frikë nga Zoti, ka në mesin e anëtarëve të të gjitha feve.

Shpresa jonë është që bota të ndryshojë dhe njerëzit të jenë në gjendje të jetojnë së bashku në paqe, pa marrë parasysh se çfarë race apo feje ata i përkasin; çdo perversion racist do të refuzohet dhe të drejtat e të gjithëve do të ruhen dhe të gjithë do të respektohen. Shpresojmë se përpjekjet në rrafshin intelektual, kundër radikalizmit dhe ideologjive anti-fetare, do të sjellin paqen që të gjithë dëshirojmë. Zoti shpall në Kuran:

**Ata që e mohuan të vërtetën janë miq të njëri-tjetrit. E nëse nuk e bëni atë (të ndihmoni e të kujdeseni për njëri-tjetrin), bëhet trazirë dhe rrëmujë e madhe në tokë. (Kuran, 8:73)**

**Vallë! A nuk ka pasur njerëz të mençur te popujt para jush, të cilët pengonin ngatërresat në Tokë? Ka pasur vetëm disa prej tyre, që Ne i shpëtuam... (Kuran, 11:116)**





## Pse myslimanët dhe ithtarët e Librit duhet të reagojnë së bashku

Një tjetër faktor i rëndësishëm që nxiti Krishtërimin, Judaizmin dhe Islamin, drejt reagimit të përbashkët, janë edhe filozofitë ateiste që janë kaq ndikuese në ditët e sotme. Ekziston edhe dëmi i shkaktuar nga pikëpamjet e ndryshme radikaliste, që më vonë janë bërë pjesë e tri feve hyjnore.

Ndër filozofitë më të mirënjohura dhe më të dëmshme të kohës sonë, mund të përmenden materializmi, komunizmi, fashizmi, anarkizmi, racizmi, nihilizmi dhe ekzistencializmi. Shumica e njerëzve që ndoqën tezat e gabuara dhe mashtruese, të ideologjive materialiste, në lidhje me gjithësinë, shoqërinë dhe vetë njeriun, e kanë humbur besimin dhe në zemrat e tyre ka zënë vend dyshimi. Për më tepër, këto ideologji i kanë shtyrë njerëzit, shoqëritë dhe kombet në kriza të mëdha, në konflikte e luftra. Përgjegjësia e tyre e përbashkët për dhimbjet dhe shqetësimet që njerëzimi vuan në ditët tona, është e pafund.

Ndërsa mohojnë Zotin dhe krijimin, të gjitha ideologjitë e lartpërmendura, janë të mbështetura në një kornizë të përbashkët, apo në një të ashtuquajtur "bazë shkencore": Teoria e Evolucionit" e Çarls Darvinit. Darwinizmi përbën bazën e filozofive ateiste. Kjo teori pretendon se qeni-



et e gjalla janë zhvilluar si rezultat i rastësive dhe përmes luftës për ekzistencë. Për këtë arsye, Darwinizmi i dërgon këtë mesazh mashtrues njerëzimit:

"Ju nuk jeni përgjegjës ndaj askujt, ia detyroni jetën tuaj rastësive, keni nevojë të luftoni dhe për të pasur sukses ju duhet të shtypni të tjerët. Kjo është bota e përplasjes dhe e interesit vetjak."

Mesazhet shoqërore që ngrihen nga konceptet darviniste si "përzgjedhja natyrore", "lufta për ekzistencë" apo "mbijetesa e më të përshtatshmit", janë mjete indoktrinimi. Ky moral i ulët u këshillon njerëzve, të jenë egoistë, mizorë e shtypës. Ai i rrënon virtyte të tilla si mëshira, dhembshuria, vetëflijimi dhe përulesia, të cilat përbëjnë vlerat morale të tre besimeve të mëdha monoteiste dhe e paraqet këtë si nevojë të "rregullave të jetës".

Indoktrinimi darvinist është thjesht në kundërshtim me besimet e Ithtarëve të Librit dhe me mesazhin e Kuranit. Për pasojë, doktrina darviniste përbën bazën e një bote, e cila u kundërvihet tre besimeve me origjinë hyjnore.

Në këto kushte, është e nevojshme që Ithtarët e Librit dhe myslimanët të bashkëpunojnë, përderisa besojnë në Zotin dhe të pranojnë moralin që Ai mëson. Ndjekësit e këtyre tre

besimeve duhet t'i paraqesin botës pavërtetësinë e Darwinizmit, i cili nuk ka asnjë bazë shkencore, edhe pse disa njerëz po përpiqen ta mbrojnë për hir të filozofisë materialiste. Ata duhet të ndërmarrin së bashku një luftë intelektuale kundër të gjitha ideve mashtruese (komunizmi, fashizmi, racizmi) që i shërbejnë ateizmit. Ata duhet të përpiqen të shpjegojnë të vërtetën, se idetë radikaliste që më pas u bënë pjesë e çdo feje, janë të gabuara. Pasi të jetë realizuar këto, bota do të përqafojë në një kohë shumë të shkurtër, paqen, qetësinë dhe drejtësinë.



### **Mizoria e antisemitizmit duhet të ndalet**

Që nga Hulagu Khan, i cili mburrej për vrasjen e 200.000 myslimanëve gjatë një jave tërbimi e të dhunshme në qytetin e Bagdadit, që solli më pas shkatërrimin e plotë të trashëgimisë shekullore, te vikingët që merrnin me forcë atë që dëshironin, e deri në ditët tona me regjimin sirian, i cili vuri në shënjestër popullin e vet, mund të themi se bota jonë ka dëshmuar disa akte të paimagjinueshme të dhunës; këto akte vazhdojnë të ndodhin ende në vende të tilla si, Turkistani Lindor, Kashmir, në Irak dhe në mesin e shumë të tjerëve.

Megjithatë, gjatë gjithë historisë, disa grupe janë në shënjestër më shumë se të tjerët. Si psh. populli hebre, përvoja e hidhur e të cilit filloi qysh në kohën e Faraonit; ai i vriste djemtë dhe i lente gjallë vetëm vajzat e tyre. Shtypja kundër hebrenjve ka vazhduar gjatë gjithë antikitetit, në kohën e Asirisë, Babilonisë dhe romakëve, të cilët masakruan, dëbuan dhe shkatërruan tempujt dhe qytetet e tyre. Në kohët mesjetare, hebrenjtë ishin në shënjestër përsëri; kudo që ata ndodheshin, etiketoheshin, diskriminoheshin dhe liheshin mënjanë. Shtypja vazhdoi edhe kohëve të fundit. Gjashtë milionë hebrenj u masakruan nga nazistët.

Persekutimi vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Anti-semitizmi në Evropë është ende gjallë në formën e ngacmimit në vende publike, vërejtjeve fyese dhe sjelljes diskriminuese në jetën sociale dhe më së shumti, në formën e sulmeve brutale; vandalizmi dhe grabitja ndaj bizneseve të



hebrenjve, djegia e makinave, turma që brohorasin në protestat e dhunshme "hebrenjtë në gaz", "vdekje hebrenjve", të shtënat dhe sulmet me bomba kundër sinagogave dhe sulmi i fundit në Créteil të Francës, ku një çift hebre u sulmua brutalisht në shtëpinë e tyre. Kjo ngjarje ishte një kujtesë e tmerrshme e incidentit të vitit 2006, përsëri në Francë, ku një hebre torturohet për disa javë dhe pastaj lihet i zhveshur për vdekje.

Franca nuk është i vetmi vend që dëshmon për anti-semitizëm. Nga Argjentina në Tunizi, nga Irlanda në Spanjë, komunitetet e hebrenjve gjenden të shënjestruar në një cikël të vazhdueshëm të urrejtjes. Edhe në SHBA, e cila njihet për mbështetjen e saj të palëkundur për Izraelin, hebrenjtë bëjnë kujdes në shfaqjen e identitetit të tyre, apo në praktikimin e riteve fetare në publik. Një sulm i papritur nga katër burra në Bruklin, ndaj një 24-



vjeçari hebre, i veshur me një Kippa (kapele); sulmi ndaj një vajze 12-vjeçare, e cila u qëllua me një shishe nga një grup vajzash që ulëritnin, "çifute e pistë"; dhe sulmi mbi një hebre në Los Angeles, Kaliforni, i cili ishte i rrethuar nga pesë të dyshuar, të cilët para se ta goditnin bërtisnin "rroftë Hitleri!"; të gjitha këto janë incidentetet më shqetësuese të kohëve të fundit në SHBA.

Lindja e Mesme është rajoni me rastet më të këqija të anti-semitizmit. Sidomos pas luftës së fundit në Gaza, urrejtja ndaj popullit hebre, pavarësisht nga mosha, gjinia apo përfshirja në konflikt, është rritur në mënyrë shqetësuese e të shpejtë.

Por përse disa njerëz mendojnë se urrejtja ndaj hebrenjve është e ligjshme?

Në të kaluarën, disa njerëz i shihnin hebrenjtë si komplotistë të fshehtë, siç janë Protokollat e të Urtëve të Sionit; i shihnin si të veçuar mënjanë nga shoqëria, për shkak të propagandës së gjerë

**Persekutimi i hebrenjve përgjatë historisë, ishte në thelb një pasojë e paragjytimeve raciale, të cilat janë në kundërshtim me fenë Islame. Myslimanët duhet t'i dënojnë padrejtësitë dhe mizoritë që kryhen ndaj hebrenjve të pafajshëm.**





anti-semite. Ndjesitë janë ushqyer edhe më tej me gënjeshtër famëkeqe, duke i portretizuar hebrenjtë si mishërim i vërtetë i së keqes. Sot, konflikti mes izraelitëve dhe palestinezëve është forca lëvizëse prapa kësaj urrejtje, dhe përdoret shpesh për të justifikuar dhunën ndaj hebrenjve të zakonshëm.

Sigurisht, të inkriminuar mund të hasen kudo, si në administratën politike, ashtu edhe në komunitet. Megjithatë, urrejtja ndaj një komuniteti të tërë, për shkak të akteve të një pakice, nuk gjen justifikim as në Kuran e as në moralin e përgjithshëm. Populli hebre shquhet për sjelljen e tij të mirë dhe modeste. Ata janë përgjithësisht njerëz të qetë, që angazhohen me praktikën e tyre të përditshme rutinore dhe fetare. Por, ajo që është edhe më tronditëse, është fakti se një popull i tillë, modest dhe i rezervuar, është persekutuar gjatë gjithë historisë.

Pakënaqësitë në lidhje me politikat e qeverisë izraelite duhen shprehur në mënyrë civile, pa bërë me faj një komunitet të tërë. Zoti i ndalon myslimanët nga një sjellje e tillë. Në Kuran, Zoti i paralajmëron besimtarët si vijon:

**O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini frikë Allahun se Allahu di hollësisht për atë që veproni. (Kuran, 5:8)**

Është mëse e natyrshme që të ketë njerëz të mirë dhe të këqinj në çdo grup, bashkësi ose komb. Ashtu si ka vrasës, gënjeshtarë dhe kriminelë në vendet myslimane, është e natyrshme që në komunitetet hebraike të ketë njerëz, aktet e të cilëve janë të dënueshme. Megjithatë, është absurde dhe krejtësisht qesharake të ketë antipati ndaj një komuniteti për veprimet e një pakice. Për më tepër, kjo është në kundërshtim me mësimet e Kuranit.

Sipas Kuranit, hebrenjtë janë ithtarë të librit dhe duhet të respektohen, të mbrohen dhe të trajtohen me dashuri. Në shumë ajete, Zoti i vlerëson hebrenjtë për përkushtimin dhe për devotshmërinë e tyre; populli hebre me besnikërinë e tyre të palëkundur ndaj Profetit Musa, shërbeu si një shembull për myslimanët.

Të gjitha këto fakte bëjnë të qartë se nuk ka asnjë bazë, as në Islam e as në Judaizëm, që mund të çojë në një armiqësi të tillë. Kur të gjithë të kuptojnë, se Zoti e krijoi këtë botë, që të mbizotërojë dashuria dhe jo armiqësia ndaj njëri-tjetrit, atëherë do të ketë vëllazëri dhe paqe.



## **Marrëdhëniet e Profetit tonë (paqja qoftë me të) me ithtarët e librit**

- Në disa transmetime thuhet se Profeti ynë (paqja qoftë me të) ka qenë i pranishëm në gëzimet e ithtarëve të Librit, i vizitonte ata kur ishin të sëmurë dhe u jepte atyre dhurata.
- Kur të krishterët e Nexhranit e vizituan atë, Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) shtriu mantelin e tij në tokë, që ata të zinin vend dhe u uroi atyre mirëseardhjen.
- Një nga gratë e Profetit tonë (paqja qoftë me të) Maria bint Sham'ûn (e njohur edhe si Merjem el-Kubtijeh), ishte një kopte e krishterë nga Egjipti.
- Nëna jonë Safijja bint Hujejj, një nga gratë e Profetit (paqja qoftë me të), ishte e bija e prijësit të fisit hebre Benu Nadir në Medinë, Hujajj ibn Akhtab.
- Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) i lejoi hebrenjtë të bëhen palë në Kushtetutën e Medinës nënshkruar me fiseve Eus dhe Hazrexh, duke i konsideruar hebrenjtë si një komunitet i veçantë fetar në mesin e myslimanëve.
- Në nenin, "hebrenjtë e Benu Auf janë një komunitet së bashku me besimtarët. Hebrenjtë kanë fenë e tyre, dhe myslimanët kane fenë e tyre," të Kushtetutës së Medinës, u hodhën themelet e respektit që myslimanët kanë për traditat dhe besimet e hebrenjve. Nenet 26-33 të së njëjtës kushtetutë, sanksionojnë se anëtarët e ithtarëve të Librit gëzojnë të njëjtat të drejta si myslimanët, ndërsa neni 16 përcakton se asnjë padrejtësi nuk u duhet bërë atyre.

- Në vitin 630 pas Krishtit, Profeti ynë (paqja qoftë me të) ka lëshuar urdhëresën e mëposhtme për të dërguarit e Mbretit të Himjar-it, që erdhën në Medinë për të dëshmuar se ata ishin bërë myslimanë: "Në qoftë se një hebre, ose një i krishterë konvertohet në mysliman, ai bëhet i barabartë me besimtarët [gëzon të njëjtat të drejta ligjore me myslimanët]. Kushdo që dëshiron të mbetet hebre ose i krishterë, ndaj tij nuk ka imponim." (Ibni Hisham, es-Seera, II, 586)
- Të krishterët e Nexhranit dërguan një delegacion prej 60 anëtarësh në Medinë. Kur delegacioni mbërriti në Medinë te Profeti ynë (paqja qoftë me të), sapo kishte hyrë koha e namazit dhe ata dëshironin të vizitonin xhaminë. Njerëzit e kundërshtuan këtë, por Profeti (paqja qoftë me të) i lejoi të vizitonin xhaminë. Ata u kthyen nga Lindja dhe u lutën. (Ibn Hisham, es-Seera, Bejrut, I, 573-574; Hamidullah, Profeti i Islamit, I, 619-620)
- Të drejtat e ithtarëve të Librit janë vënë nën mbrojtjen e besimtarëve në kohën e Profetit (paqja qoftë me të) në bazë të marrëveshjeve të bëra me hebrenjtë dhe të krishterët. Sa herë që shfaqej një mosmarrëveshje, në kohët e mëvonshme, ithtarët e Librit do të sillnin këto marrëveshje. Për shembull, kur të krishterët e Damishk-ut kishin ndonjë problem, ata sillnin në kujtesë premtimin nga Hazreti Umer. Ky është një fakt i njohur në librat e historisë.
- Teksti i një marrëveshje të Profetit tonë (paqja qoftë me të) me të krishterin Ibn Harith ibn Ka'b dhe popullin e tij, përmban këto pasazhe; "Për Sejjid ibn Harith ibn Ka'b, për bashkëfetarët e tij, dhe për të gjithë ata që aderojnë në fenë e krishterë, qofshin ata në Lindje apo në Perëndim, në rajonet pranë ose në rajonet e largëta,

qofshin ata arabë apo të huaj, të njohur apo të panjohur. ...Unë angazhohem për të mbështetur ata, për të vendosur njerëzit e tyre nën mbrojtjen time, kishat e tyre, manastiret, murgjit e tyre, banesat e autoriteteve të tyre, kudo që gjenden, qofshin ata në male apo në lugina, shpella ose rajone të banuara, në fusha apo në shkretëtirë. Unë do të mbroj fenë e tyre dhe Kishën e tyre, kudo që të gjenden, qoftë në tokë apo në det, në Perëndim apo në Lindje, me vigjilencë të madhe nga ana ime, njerëzit e Shtëpisë sime, dhe myslimanët në tërësi. ... Asnjë i krishterë nuk do të detyrohet të bëhet mysliman: mos polemizoni me ithtarët e Librit, përveçse në mënyrën më të mirë (29:46). Ata duhet të mbulohen nga krahu i mëshirës. Të mbrohen nga çdo dëm që i kërcënon ata, kudo që gjenden dhe në çdo vend ku ata janë. "

- Kartat e të drejtave të dhëna nga Profeti ynë (paqja qoftë me të) ithtarëve të librit në Adruh, Makna, Hajber, Nexhran dhe Akaba' tregojnë gjithashtu se jeta dhe prona e ithtarëve të Librit, ishin nën mbrojtjen e myslimanëve dhe ithtarët e Librit gëzonin lirinë e tyre të besimit dhe të adhurimit.
- Kur Profeti ynë (paqja qoftë me të) nisi të predikonte fenë, në Mekë jetonin disa të krishterë. Në të vërtetë, një nga njerëzit e parë që e këshilloi Profetin tonë (paqja qoftë me të) dhe gruan e tij Hatixhen, në ditët e para të shpalljes ishte Uaraka bin Naufal, një i krishterë që zotëronte kopje të Ungjillit të shkruara me dorë. (Sahih Bukhari)
- Kishat që u shkatërruan në kohën e kalifëve u rindërtuan nga myslimanët, dhe u dha leje që të ndërtoheshin sinagoga dhe kisha të reja. Për shembull, Manastiri i Shën Serxhios që ishte djegur nga

Patriarku Mar Amme u rindërtua në kohën e Hazretit Othman.

- Pas pushtimit të Sirisë, myslimanët kryenin faljen e xhumasë në Kishën e Shën Gjonit në Damask. Të krishterët i kryenin ritet e tyre fetare të dielave. Anëtarët e të dy besimeve adhuronin Zotin në paqe, në të njëjtin vend.

### Hadithet e Profetit (paqja qoftë me të) në lidhje me Teuratin dhe Ungjillin

*Transmeton Ebu Hurejre: ithtarët e Librit e lexonin Teuratin në hebraisht dhe pastaj ua shpjegonin atë në arabisht myslimanëve. (Sahih Bukhari, Libri 92, Hadithi 460)*

*El-Hafiz el-Zahabi transmeton se Abdullah ibn Selami, një i konvertuar në Islam nga Judaizmi, erdhi tek Profeti (paqja qoftë me të) dhe i tha: "Kam lexuar (mbrëmë) Kuranin dhe Teuratin." Ai u përgjigj: "Lexo njërin në një natë dhe tjetrin në natën tjetër." (el-Thalabi, el-Iman el-Thalabi Tathkarar el-Huffadh, Vol. 1, f. 27)*

*Abdullah ibn Amr, njëri nga shokët e afërt të Profetit (paqja qoftë me të), shpesh lexonte Teuratin. Një natë pa në ëndërr se ai po mbante vaj në njërën anë dhe mjaltë në tjetrën, dhe se ai nganjëherë hante nga njëra anë dhe nganjëherë nga tjetra. Abdullah ibn Amr ia përshkroi ëndrrën e tij Profetit (paqja qoftë me të). Profeti (paqja qoftë me të) e interpretoi ëndrrën e tij, që nënkuptonte dy librat dhe leximin e tij, disa herë njërin dhe disa herë tjetrin. (Sahih Bukhari, Vol. 6, Hadithi 987, f. 439)*



*Nga Ebu Seid el-Kudri: Ne e pyetëm Pejgamberin (paqja qoftë me të): "O i Dërguari i Allahut! A duhet të kemi marrëdhënie të mira me bijtë e Izraelit? "Ai tha:" Po, ju duhet të keni marrëdhënie të mira me bijtë e Izraelit. Nuk ka ndonjë problem. E në qoftë se ju i mbani marrëdhëniet me ata, do të ketë dobi për ju." (Musnedi i Ibn Hanbel, 111/12, Hadith 11034)*

### **Profeti ynë (paqja qoftë me të) gjithmonë favorizonte paqen**

Profeti ynë (paqja qoftë me të) nuk e ka dëshiruar luftën dhe përgjatë viteve, ai ka bërë përpjekje të mëdha për të përhapur Islamin me mjete paqësore. Ai ishte i durueshëm përballë presionit dhe sulmeve të ashpra. Kur sulmet u rritën atëherë u bë e domosdoshme që ai të niste luftën, sepse Zoti ja shpalli në libër. Ai kurrë nuk shpalli luftë, përsa kohë kishte ende mundësi për paqe dhe përsa kohë presioni dhe sulmet e armikut nuk përbënin rrezik për jetën.

Gjatë gjithë jetës së Profetit tonë (paqja qoftë me të), ekspedita në Mu'tah ishte më e përgjakshme dhe më e vështira për myslimanët. Ai emëroi Zejd ibn Harithin për të komanduar ushtrinë dhe i paralajmëroi trupat:

"Luftoni në emër të Zotit, në rrugën e Zotit, kundër atyre që mohojnë Zotin. Mos tradhëtoni. Mos u prisni veshët dhe hundët dhe pjesë të tjera të trupit. Mos vrisni gratë dhe fëmijët, të

moshuarit dhe njerëzit e fesë në vendet e tyre të adhurimit. Mos prisni hurmat dhe pemët e tjera, dhe mos shkatërroni ndërtesat." (Buhariu)

Bazuar në urdhëresat profetike për luftën, parimet e mëposhtme, të cilat mund të quhen "Parimet islame të luftës", përshkruhen kështu nga dijetarët myslimanë:

1. Lufta duhet të zhvillohet vetëm kundër atyre që nxisin dhe që angazhohen në të.
2. Priftërinjtë në kisha, fëmijët, gratë dhe të moshuarit nuk duhet të dëmtohen.
3. Fushat e mbjellura nuk duhet të dëmtohen.
4. Marrëveshjet dhe ujditë duhen respektuar.
5. Kafshët nuk duhet të dëmtohen.
6. Nuk duhet të ketë mizori dhe tortura.
7. Qytetet nuk duhet të shkatërrohen. (*Ahmet Hamdi Akseki, Abdurrahman Azzam Pasa'nin "Allah'in Peygamberlerine emanet ettigi ebedi risalet", Diyanet Isleri Baskanligi Nesriyat, Ankara, 1948*)

Një arsye se përse koha në të cilën jetoi Profeti (paqja qoftë me të) ishte e bekuar me paqe dhe siguri, ishte për shkak të drejtësisë së tij, që ishte në përputhje me moralin e Kuranit. Disa shkrimtarë të huaj, të impresionuar me karakterin e tij të lartë, thurën lavde për moralin e Profetit tonë (paqja qoftë me të).

Në librin e tij Islami, feja e vërtetë, George Bernard Shaw përshkruan këto tipare të larta:

"Gjithnjë e kam çmuar lart besimin e Muhammedit (a.s.), thjesht për shkak të vitalitetit të tij të jashëzakonshëm. Mendimi im është se Islami është besimi i vetëm, i aftë që të drejtojë me sukses ndryshimet e shumta të jetës. Unë e kam studiuar jetën e Muhammedit... Atë, duhet ta quajmë shpëtimtar të njerëzimit. Jam i bindur se një njeri i ngjashëm me të, po të merrej me problemet e kohës moderne, do t'i kishte zgjidhur me sukses ato, duke i sjellur njerëzimit paqen dhe lumturinë..." (Sir George Bernard Shaw, Genuine Islam 1936 [http://www.geocities.com/Athens/Forum/9192/main\\_quote2.html#shaw](http://www.geocities.com/Athens/Forum/9192/main_quote2.html#shaw))

Në kohën tonë, ndjekja e parimeve morale të Kuranit, të cilat nuk kanë lidhje me fanatizmin, është e vetmja zgjidhje për të gjitha konfliktet, luftërat, dhe krizën që ka kapluar botën. Ashtu si Profeti ynë (paqja qoftë me të), ne kurrë nuk duhet të largohemi nga rruga e drejtësisë dhe gjithmonë duhet të respektojmë të drejtat e komuniteteve të ndryshme dhe individëve, pavarësisht besimit apo identitetit të tyre.

### **Profeti ynë (paqja qoftë me të) bëri mjaft marrëveshje me ithtarët e librit**

Marrëveshjet e ndryshme, të bëra në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë me të) u dhanë komuniteteve hebraike dhe të krishtera, privilegje të caktuara dhe u garantuan të drejtat dhe liritë e tyre. Shembuj për këtë, janë të drejtat për priftërinjtë e Manastirit të Shën Katerinës në Mt. Sinai. Këto dokumente garantuan të drejtat ligjore, fetare dhe shoqërore të hebrenjve





dhe të krishterëve, të cilët jetuan nën sundimin mysliman, ose në vendet me sovranitet Islam. Mosmarrëveshjet janë zgjidhur duke iu referuar këtyre dokumentave. Për shembull, në librat e historisë përmendet se të krishterët në Damask theksonin në dokumentet e regjistrimit, të drejtat e tyre të garantuara nga Kalifi Omer; kur ata hasnin ndonjë problem, i dërgonin atij kërkesë dhe i kërkonin zgjidhje.



O ju që besuat! Përqaftoni  
Islamin tërësisht.

Mos ndiqni gjurmët e  
djallit, sepse Ai është  
armik i hapët për ju.

(Kuran, 2: 208)



# ISLAMI KA SJELLË PAQE DHE HARMONI NË LINDJEN E MESME

Historia ka dëshmuar gjithmonë për paqe, drejtësi dhe dashuri në vendet e drejtuara nga administruesit myslimanë, të cilët respektonin udhëzimet kuranore. Kalifët e drejtë pasuan traditën e Profetit Muhamed (paqja qoftë me të). Ata ndoqën hapat e të Dërguarit të Zotit dhe nuk iu shmangën kurrë moralit të Kuranit. Virtytet që dominonin në kohën e këtyre drejtuesve ishin, drejtësia e vërtetë dhe ndershmëria e përshkruar në Kuran. Sigurisht që ky ishte një shembull i shkëlqyer për brezat që do të pasonin.

## **Paqja dhe drejtësia që i solli Palestinës kalifi Omer**


Jeruzalemi ishte kryeqyteti i çifutëve deri në vitin 71 p.e.s. Në atë vit ushtria romake u lëshua në një sulm të gjerë mbi çifutët dhe i përzuri ata nga zona me një egërsi të paparë. Pasi nisi koha e diasporës çifute, Jeruzalemi dhe rrethinat e tij filluan të shndërroheshin në një vend të braktisur.

Sidoqoftë, Jeruzalemi u bë përsëri qendër interesash me pranimin e Krishtëritimit në kohën e perandorit romak Kostandin. Të krishterët romakë ngritën kisha në Jeruzalem. Ndalimet ndaj çifutëve në atë zonë u hoqën. Palestina mbeti territor romak (bizantin) deri në shekullin e 7-të. Persët e pushtuan rajonin për një kohë të shkurtër, por bizantinët e rimorën atë.

Një pikë e rëndësishme kthese në historinë e Palestinës ndodhi në vitin 637, kur ajo u mor nën kontroll nga ushtritë myslimane. Ky ishte viti që solli paqen dhe harmoninë në Palestinë, e cila kishte qenë për shekuj skenë e luftrave, shpërnguljeve, zisë dhe masakrave dhe që kishte njohur egërsinë e çdo kohe me ndryshimet e shpeshta të qeverisjeve të huaja. Ardhja e Islamit përbënte nisjen e një epoke të re, ku njerëzit e besimeve të ndryshme do të mund të jetonin në paqe e harmoni.

Palestina u mor nga Omeri, kalifi i dytë pas vetë Profetit (paqja qoftë me të). Hyrja e kalifit në Jeruzalem, toleranca, pjekuria dhe urtësia që ai

**Fortesa e Jeruzalemit, litografi në ngjyra nga L. Haghe pas D. Roberts, 1841.**





tregoi ndaj njerëzve të besimeve të ndryshme ishin vetëm fillimi i një epoke të bukur që po niste. Historiana britanike dhe specialistja e çështjeve të Lindjes së Mesme, Karen Armstrong, e përshkruan kështu marrjen e Jeruzalemit nga kalifi Omer në librin e saj "*Lufta e Shenjtë*":

Kalifi Omer hyri në Jeruzalem hipur mbi një deve të bardhë, i shoqëruar nga një magjistrat i qytetit, patriarku grek Sofroni. Kalifi kërkoi të dërgohej menjëherë në Malin e Tempullit dhe u përul në lutje në vendin ku Profeti Muhamed kishte kryer Udhëtimin e tij të Natës. Patriarku po mendonte i frikësuar: kjo duhet të ishte fatkeqësia që kishte profetizuar profeti Daniel; ky duhet të ishte Antikrishti që do të lajmëronte afrimin e Ditëve të Fundit. Më pas, Omeri kërkoi të shihte faltoret e krishtera dhe ndërsa ishte në Kishën e Varrit të Shenjtë, hyri koha e faljes së namazit. Patriarku e ftoi atë me mirësjellje që të falej aty ku ishte, por Omeri kundërshtoi me të njëjtën mirësjellje. **Nëse ai do të përulej për t'u falur në kishë, shpjegoi ai, myslimanët do të dëshironin të nderonin kujtimin e kësaj ngjarjeje duke ngritur aty një xhami dhe kjo do të thoshte se ata do të mund ta prishnin Varrin e Shenjtë.** Në vend të kësaj, Omeri shkoi të lutej pak më tutje në drejtim të kundërt me Varrin e Shenjtë. Ende sot, në po atë vend, gjendet një xhami e vogël kushtuar kalifit Omer.

Xhamia tjetër e madhe e Omerit u ngrit në Malin e Tempullit për të shënuar çlirimin mysliman, bashkë me xhaminë Aksa. **Për vite të tëra, të krishterët e kishin kthyer tempullin e rrënuar të hebrenjve, në një vend për të grumbulluar mbeturinat e qytetit. Kalifi dhe myslimanët menjëherë filluan të pastronin plehrat.** Aty u ngritën dy faltore, për të lartësuar Islamin në qytetin e tretë të shenjtë, të botës islame.<sup>20</sup>

Me marrjen e Jeruzalemit nga myslimanët, qyteti u bë i sigurtë e i qetë dhe të tre besimet mundën të jetojnë në paqe. Xhon L. Espozito shkruan:

Kur ushtritë arabe morën Jeruzalemin në vitin 638, ato pushtuan një qendër, faltoret e së cilës ishin shndërruar në një vend të rëndësishëm pelegrinazhi për Krishtërimin. Kishat dhe popullsia e krishterë u lanë të paprekura. Çifutëve që më parë u ishte ndaluar nga qeveritarët e krishterë për të jetuar në atë zonë, u lejuan të kthehen, të jetojnë dhe të kryejnë ritet e tyre në qytetin e Solomonit dhe të Davidit.<sup>21</sup>

Marrëveshja e përmendur në faqet e mësipërme, që kalifi Omer nënshkroi kur hyri në Jeruzalem me patriarkun e Jeruzalemit, është tregues i dhembshurisë së tij.

Kjo është siguria, e cila Omeri, shërbëtori i Zotit, udhëheqësi i besimtarëve, u garanton njerëzve të Elisë. Ai u garanton të gjithëve, të sëmurë a të shëndetshëm qofshin, siguri për jetët, pronat, kishat dhe kryqet e tyre dhe për gjithçka që lidhet me fenë e tyre. Kishat e tyre nuk do të shndërrohen në vende banimi, as nuk do të shkatërrohen, as nuk do të zvogëlohen ato apo përkatësitë e tyre në asnjë lloj mënyre, as nuk do të ushtrohet ndonjë shtrëngim ndaj njerëzve në çështje të fesë dhe asnjërit prej tyre nuk do t'i shkaktohet asnjë e keqe.<sup>22</sup>



Shkurt, myslimanët sollën qytetërimin në Jeruzalem dhe në të gjithë Palestinën. Në vend të besimeve që nuk tregojnë respekt për vlerat e shenjta të njerëzve të tjerë dhe që kishin sjellë më parë vrasje vetëm për shkak të ndryshimeve në bindjet fetare, ata qeverisën me drejtësi, tolerancë dhe me kulturën e moderuar të Islamit. Pas marrjes së Palestinës nga Omeri, myslimanët, të krishterët dhe çifutët jetuan së bashku në paqe e harmoni në atë vend. Myslimanët kurrë nuk u përpoqën për të përdorur forcën në konvertimin e njerëzve, ndërsa shumë jomyslimanë që arritën të shohin se Islami ishte feja e vërtetë, e pranuan këtë fe me vullnetin e tyre të lirë.

Paqja dhe harmonia në Palestinë qëndruan aq gjatë sa ç'qëndroi qeverisja myslimane në atë rajon. Sidoqoftë, në fund të shekullit të XI, një forcë pushtuese hyri në rajon nga jashtë dhe Jeruzalemi i qytetëruar u plaçkit me një barbari që nuk ishte parë kurrë më parë. Këta barbarë ishin kryqtarët.



## Egërsia e kryqtarëve në Palestinë

Ndërsa aderuesit në të tre besimet jetonin në paqe në Palestinë, të krishterët e Evropës vendosën të organizonin një kryqëzatë. Duke iu përgjigjur thirrjes së papës Urban II, më 27 nëntor 1095 në Koncilin e Klermontit, më shumë se 100,000 njerëz nga e gjithë Evropa u nisën për në Palestinë, me qëllim që të çlironin vendin e shenjtë nga myslimanët dhe të shtinin në dorë pasuritë përrallore të Lindjes. Pas një udhëtimi të gjatë dhe të lodhshëm dhe pas një numri të madh grabitjesh e masakrash që kryen gjatë rrugës, ata arritën në Jeruzalem në vitin 1099. Qyteti ra pas një rrethimi prej pesë javësh. Pasi kryqtarët u futën në të, ata ushtruan një egërsi e barbari që rrallëherë bota e ka parë. Të gjithë myslimanët dhe çifutët në qytet u shkuan në shpatë.

Paqja dhe harmonia që kishin mbretëruar në Palestinë qysh nga koha e Omerit, përfunduan me një masakër të tmerrshme. Kryqtarët dhunuan



**Myslimanët dhe hebrenjtë në Jeruzalem u masakruan barbarisht nga kryqtarët.**



të gjitha ligjet etike të Krishtëritimit dhe përhapën terrorin në emër të Krishtëritimit.


### Drejtësia e Salahudin Ejubit

Ushtritë e egra kryqtare e bënë Jeruzalemin kryeqytet të tyre dhe ngritën Mbretërinë Latine, kufijtë e së cilës shtriheshin nga Palestina në Antioki. Sidoqoftë, kryqtarët që sollën egërsinë në Palestinë nuk mundën të qëndrojnë gjatë. Salahudini i mblodhi të gjitha mbretëritë myslimane dhe i mundi kryqtarët në betejën e Hitinit në vitin 1187. Pas betejës, dy udhëheqësit e ushtrisë kryqtare, Rejnaldi i Shatijonit dhe mbreti Gij, u sollën para Salahudinit, i cili ekzekutoi Rejnaldin e Shatijonit, që njihej për barbaritë e tmerrshme që kishte kryer, ndërsa mbretin Gij e la të lirë, pasi nuk kishte kryer të njëjtat krime. Palestina edhe një herë u njoh me drejtësinë e vërtetë.

Menjëherë pas betejës së Hitinit dhe në të njëjtën ditë që Profeti Muhamed (paqja qoftë me të) kishte kryer nga Meka për në Jeruzalem udhëtimin e mrekullueshëm të Natës së Miraxhit, Salahudini hyri në Jeruzalem dhe e çliroi atë nga 88 vitet e pushtimit kryqtar. Kur kryqtarët kishin hyrë në Jeruzalem 88 vjet më parë, ata kishin vrarë myslimanët në qytet dhe për këtë arsye, trembeshin se mos Salahudini do të bënte me ta të njëjtën gjë. Sidoqoftë, ai nuk preku asnjë qytet të krishterë. Përveç kësaj, ai thjesht i urdhëroi të krishterët latinë (katolikë) që të largoheshin. Të krishterët ortodoksë, të cilët nuk ishin kryqtarë, u lejuan të jetojnë në qytet dhe të kryejnë ritet si të dëshironin. Sipas fjalëve të Xhon L. Espozitos, "ushtria myslimane u tregua zemërgjerë në fitore po aq sa ç'kishte qenë këmbëngulëse në betejë. Civilët nuk u prekën. Kishat dhe faltoret u lanë pa prekur... Salahudini i qëndroi besnik fjalës së tij dhe u tregua i mëshirshëm ndaj atyre që nuk luftuan."<sup>23</sup>


Karen Armstrong e përshkruan marrjen e dytë të Jeruzalemit me këto fjalë:

Më 2 tetor 1187 Salahudini dhe ushtria e tij hynë në Jeruzalem dhe për 800 vjetët që do të pasonin, Jeruzalemi do të mbetet një qytet mysliman. Salahudini e mbajti fjalën dhe e mori qytetin sipas idealeve më të larta islame. **Ai nuk u hakmorr për masakrën e vitit 1099, sikurse këshillon edhe Kurani (16:126) dhe tani që vrasjet pushuan ai u dha fund armiqtëve (2:193).** As edhe një i krishterë i vetëm nuk u var dhe nuk u plaçkit. Shpërblezat për lirim ishin tejet të ulëta... Salahudini liroi shumë prej tyre falas, sikurse nxiste Kurani. Vëllai i tij El-Adili,



ishte aq i brengosur nga pamundësia e robërve për të paguar, saqë i kërkoi Salahudinit të blinte njëmijë prej tyre si skllëvër për vete dhe sapo i mori, i liroi ata në çast që të gjithë... Të gjithë udhëheqësit myslimanë u skandalizuan tek panë se si të krishterët e pasur ia mbathnin me gjithë pasurinë e tyre, e cila mund të përdorej fare mirë për të paguar lirimin e skllëvërve... [Patriarku] Herakli pagoi shumë prej dhjetë dinarësh, sa ç'kërkohej nga të gjithë të tjerët dhe atij iu krijua mundësia të mbante shoqërues të veçantë që të ruante thesarin në udhëtimin e tij për në Tir.<sup>23</sup>

Shkurt, Salahudini dhe myslimanët, nën udhëheqjen e tij, i trajtuan të krishterët me mirësi e drejtësi të madhe dhe treguan ndaj tyre edhe më



**Salahudini hyri në Jerusalem në vitin 1187 dhe e çliroi atë pas 88 vitesh të pushtimit kryqtar. Ai u bë i famshëm për këtë triumf në fushën e betejës; por Salahudini ishte gjithashtu shumë falës jo vetëm ndaj kryqtarëve, por dhe ndaj të gjithë të krishterëve të tjerë. Edhe pse kryqtarët kishin shkaktuar barbarizma ndaj myslimanëve, kur u çlirua Jeruzalemi, Salahudini nuk mori hak mbi ta dhe askush nuk u dëmtua.**

shumë dhembshuri nga ç'treguan vetë udhëheqësit e tyre. Jo vetëm të krishterët, por edhe çifutët fituan paqe e siguri me marrjen e Jeruzalemit nga myslimanët. Poeti i mirënjohur çifut spanjoll, Jehuda el Harizi, i shprehu kështu ndjenjat e veta në një nga veprat e tij:

Zoti... vendosi që vendi i shenjtë të mos mbetet më në duart e bijve të Esaut... Kështu, në vitin 4950 të Krijimit [1190 e.s.] Zoti zgjoi shpirtin e princit të ismaelitëve [Salahudinit], një njeri i urtë e i guximshëm që erdhi me gjithë ushtrinë e tij, rrethoi Jeruzalemin, e mori atë dhe shpalli nëpër të gjithë vendin se do ta mirëpriste racën e Efraimit, ngado që ata të vinin. Dhe kështu, ne erdhëm nga të gjitha anët e botës për t'u strehuar këtu. Ne tani jetojmë nën hijen e paqes.<sup>24</sup>

Pas dorëzimit të Jeruzalemit, kryqtarët vazhduan me barbaritë e tyre, ndërsa myslimanët vendosën drejtësi edhe në qytetet e tjera të Palestinës. Në vitin 1194, Rikard Zemërluani që portretizohet si hero i madh në

**Salahudini dhe  
Guy de  
Lusignan pas  
betejës së  
Hitinit më  
1187.**







Mbreti Rikard barbarisht ekzekutoi 3,000 civilë myslimanë në Kështjellën e Akrës, në mesin e të cilëve shumë gra dhe fëmijë.

historinë britanike, ekzekutoi poshtërsisht në kështjellën e Akrës 3,000 myslimanë, nga të cilët shumë gra e fëmijë. Megjithëse myslimanët qenë dëshmitarë të kësaj egërsie, ata kurrë nuk përdorën të njëjtat metoda. Ata iu përmbajtën urdhëresës së Zotit, **"Mos lejoni që urrejtja ndaj një populli që ju ndaloi një herë nga Xhamia e Shenjtë t'ju shtyjë në teprim..."** (Kuran, 5:2) dhe nuk ushtruan kurrë dhunë ndaj civilëve të pafajshëm. Ata nuk përdorën kurrë dhunë të panevojshme, qoftë edhe ndaj ushtrive kryqtare që mposhtën. Egërsia e kryqtarëve dhe drejtësia e myslimanëve treguan edhe një herë një të vërtetë historike: **Një qeverisje e ndërtuar mbi parimet e Islamit, bëri të mundur që njerëzit e besimeve të ndryshme të jetojnë në paqe së bashku.** Kjo paqe vazhdoi edhe për 700 vite pas Salahudinit, sidomos gjatë periudhës osmane.

... Allahu është i mëshirshëm  
ndaj robërve të Tij.  
(Kuran 3:30)



# RRËNJËT E TERRORIZMIT: DARVINIZMI DHE MATERIALIZMI

Më parë, kemi shpjeguar se terrorizmi ka dy burime kryesore. Ne treguam me shembuj dhe dëshmi që një prej tyre është terrorizmi radikal, i cili, keqinterpreton fetë hyjnore dhe merr për bazë, referenca paragjyquese që janë trilluar me kalimin e kohës. Ne demonstruam në dritën e vargjeve kuranore, se aktet e organizatave terroriste, që pretendojnë se veprojnë në emër të Islamit, janë në kundërshtim me Islamin. Burime të tjera të terrorizmit janë: botëkuptimi materialist dhe ai darvinist.

Shumë njerëz mendojnë se teoria e evolucionit u paraqit për herë të parë nga Çarls Darvini dhe se ajo mbështetet në prova, vëzhgime dhe eksperimente shkencore. Sidoqoftë, e vërteta është se ajo nuk e ka prejardhjen te Darvini dhe se nuk mbështetet në asnjë provë shkencore. Teoria orvatet t'i shpjegojë fenomenet natyrore, duke u bazuar në filozofinë materialiste. Në vend që të mbështetet tek zbulimet shkencore, ajo mbështetet verbërisht te filozofia materialiste. *(shih librin "Gjunjëzimi i Evolucionit, Harun Jahja)*

Për pasojë, ky fanatizëm ka sjellë të gjitha llojet e fatkeqësive. Bashkë me përhapjen e Darwinizmit dhe të filozofisë materialiste që ai mbështet, përgjigja e pyetjes "Ç'është qenia njerëzore?" ka ndryshuar. Njerëzit që përgjigjeshin: "Qeniet njerëzore u krijuan nga Zoti dhe u duhet të jetojnë sipas moralit të bukur që Ai na mëson", kanë filluar të mendojnë se "Njeriu erdhi në ekzistencë rastësisht dhe ai është një kafshë që zhvillohet përmes luftës për mbijetesë." Ky mashtrim i madh ka një çmim shumë të shtrenjtë e të rëndë. Ideologjitë e dhunshme si racizmi, fashizmi dhe komunizmi, si dhe shumë pikëpamje të tjera barbare në botë, të cilat mbështeten në konfliktin, kanë gjetur që të gjitha një burim force tek ky mashtrim.

Kjo pjesë e librit do të analizojë fatkeqësitë që i ka sjellë botës Darwinizmi dhe lidhjet që ai ka me terrorizmin, si një nga problemet botërore më të rëndësishme të kohës sonë.

### Gënjeshtër darviniste: "Jeta është konflikt"

Darvini vendosi një kusht themelor në zhvillimin e teorisë së tij: **Zhvillimi i qenieve të gjalla varet nga lufta për mbijetesë. Të fortët e fitojnë betejën. Të dobët janë të dënuar të humbasin dhe të harrohen.**

Sipas Darvinit, ekziston një luftë e pamëshirshme për mbijetesë dhe një konflikt i brendshëm në natyrë. I forti gjithmonë e mposht të dobët dhe kjo i hap rrugën zhvillimit. Nëntitulli që ai i dha librit të tij ishte: "*Origjina e llojeve nëpërmjet përzgjedhjes natyrore ose ruajtjes së racave të zgjedhura në luftën për jetë*". Ky titull e përmbledh më së miri pikëpamjen e përmendur më sipër.

**Më pas, Darvini shtroi pretendimin se "lufta për mbijetesë" zbatohet edhe mes grupeve racore të qenieve njerëzore.** Sipas këtij pretendimi mitik, racat e zgjedhura do të ishin fituesit e betejës. Sipas pikëpamjes së Darvinit, këto raca të zgjedhura ishin evropianët. Racat afrikane apo aziatike kishin mbetur prapa në luftën për mbijetesë. Darvini shkoi edhe më tej,



duke hedhur mendimin se disa raca do të humbisnin së shpejti në tërësi luftën për mbijetesë dhe në këtë mënyrë, do të zhdukeshin:

Në një kohë më të vonshme, jo shumë të largët, të matur me shekuj, racat e qytetëruara të njeriut, me siguri do të shfarosin dhe zëvendësojnë racat e egra nëpër botë. Në të njëjtën kohë, majmunët antropomorfë... nuk ka dyshim se do të shfarosen. Hendeku mes njeriut dhe aleatëve të tij më të afërt do të jetë atëherë më i gjerë, sepse ai do të jetë, siç mund të shpresojmë, në një gjendje më të qytetëruar **edhe se raca kaukaziane, dhe disa llojeve të ulëta si babuni, në vend të zezakut, australianit dhe gorrillës, siç ndodh sot.**<sup>27</sup>

Antropologu indian Lalita Vidjarti shpjegon se si teoria e evolucionit e Darvinit e imponoi racizmin në skenat shoqërore:

**Teoria e tij (Darvinit) e mbijetesës së më të fortit u mirëprit ngrohtësisht nga shkencëtarët shoqërorë të kohës dhe ata besuan se njerëzimi kishte arritur nivele të ndryshme evoluimi që arrinin pikën më të lartë me qytetërimin e njeriut të bardhë. Në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, racizmi u pranua si një e vërtetë nga shumica e shkencëtarëve perëndimorë.**<sup>28</sup>






më të ngushta, t'i mbingarkojmë shtëpitë me shumë njerëz dhe të joshim kthimin e murtajes. Fshatrat duhet t'i ndërtojmë pranë ujërave të ndenjtur dhe të nxisim në veçanti ngritjen e vendbanimeve në të gjitha vendet moçalore dhe të pashëndetshme, e kështu me radhë." <sup>29</sup>

Si rrjedhojë e kësaj politike mizore, të dobëtit dhe ata që do ta humbisnin betejën për mbijetesë do të asgjësoheshin dhe si përfundim, rritja e shpejtë e popullsisë do të ekuilibrohej. Kjo e ashtuquajtur politikë e "shtypjes së të varfërve", u vu në jetë në Britaninë e shekullit të 19-të. U ngrit një rend industrial, në të cilin fëmijët tetë dhe nëntë vjeçarë u detyruan të punojnë gjashtëmbëdhjetë orë në ditë në minierat e qymyrit dhe mijëra prej tyre vdiqën në kushte të tmerrshme. Lufta për mbijetesë që kërkonte teoria e Maltusit, bëri që miliona britanikë të bënin një jetë të mbushur me vuajtje të rënda.



Thomas Malthus dhe Charles Darwin





**Zbatimi në shekullin e 19-të i tezës së Maltusit, mbi domosdoshmërinë e luftës për mbijetesë, solli mjerimin për fëmijët e vobektë dhe të varfër të Anglisë. Feja, përpiqet për mbrojtjen e fëmijëve. Zemrat tona duhet të drejtohen nga mirësisa dhe virtyti, por kjo është e mundur vetëm nëse praktikohen mësimet morale të fesë.**

I ndikuar nga këto ide, Darvini e zbatoi konceptin e konfliktit në të gjithë natyrën dhe hodhi idenë, se nga kjo luftë për ekzistencë, fitimtarë do të dalin vetëm të fortët dhe të aftët. Për më tepër, ai pretendoi se e ashtuquajtura luftë për mbijetesë ishte një ligj i justifikuar dhe i pandryshueshëm i natyrës. Nga ana tjetër, ai i ftoi njerëzit që të braktisin besimet e tyre fetare, të mohojnë Krijimin dhe kështu i rrënoi të gjitha vlerat etike që mund të bëheshin pengesë ndaj luftës së pamëshirshme për mbijetesë.

Njerëzimit iu desh të paguajë një çmim shumë të shtrenjtë në shekullin e 20-të për çrrënjosjen e këtyre ideve mizore që i shtynë njerëzit në zemërgurësi e mizori.



## Roli i Darwinizmit në përgatitjen e terrenit për Luftën e Parë Botërore

Ndërsa Darwinizmi sundonte kulturën evropiane, nisi të shfaqet ndikimi i luftës për mbijetesë. Kombet kolonialiste evropiane në veçanti nisën t'i portretizojnë kombet e kolonizuara si "**kombe të prapambetura në ciklin e evolucionit**" dhe gjetën te Darwinizmi justifikimin për veprimet e tyre.

Ndikimi politik më i përgjakshëm i Darwinizmit, ishte shpërthimi i Luftës së Parë Botërore në vitin 1914.

Në librin e tij "*Evropa që nga 1870-a*", profesori i mirënjohur britanik i historisë Xhejms Xholl shpjegon se një nga faktorët që përgatitën terrenin për Luftën e Parë Botërore, ishte besimi i udhëheqësve evropianë të kohës te Darwinizmi.

Është e rëndësishme të kuptohet se sa fjalë për fjalë u mor doktrina e luftës për ekzistencë dhe për mbijetesën e më të fortit nga ana e udhëheqësve të Evropës në vitet që i paraprinë Luftës së Parë Botërore. Për shembull, shefi i shtabit austrohungarez Franc Baron Konrad fon Hëcendorf, shkruan kështu në kujtimet e tij të pasluftës:

Fetë filantropike, mësimet morale dhe doktrinën filozofike, pa dyshim, mund të shërbejnë nganjëherë për **të dobësuar luftën e njerëzimit për ekzistencë** në formën e saj më të ashpër, por ato nuk do t'ia arrijnë kurrë ta shmangin plotësisht atë si një motiv lëvizës për botën... **Vetëm në përputhje me këtë parim të madh, erdhi katastrofa e luftës botërore, si rrjedhojë e forcave motivuese në jetët e shteteve dhe popujve, si një rrufe që duhet të shkarkohet nga vetë natyra e saj.** E parë nga ky lloj sfondi ideologjik, këmbëngulja e Konradit në nevojën për një luftë parandaluese, në mënyrë që të ruhet monarkia austrohungareze, bëhet plotësisht e kuptueshme.

Ne kemi parë gjithashtu se këto pikëpamje nuk ishin të kufizuara vetëm te personalitetet ushtarake dhe se Maks Veberi, për shembull,

ishte i shqetësuar thellë për luftën ndërkombëtare për mbijetesë. Kurt Ricler, asistenti personal dhe i besuari i kancelarit gjerman Teobald fon Betman-Holveg, shkroi në vitin 1914:

Armiqësia e përjetshme dhe absolute është themelore dhe e natyrshme në marrëdhëniet mes njerëzve; dhe **armiçësia që ne vërejmë kudo...** nuk është rezultat i ruajtjes së natyrës njerëzore por është **thelbi i botës dhe burimi i vetë jetës.**<sup>30</sup>


Frederik fon Bernardi, një gjeneral i Luftës së Parë Botërore, bën një lidhje të ngjashme mes luftës dhe ligjeve të luftës në natyrë. "Lufta," shprehet Bernardi, "është një nevojë biologjike"; ajo është "po aq e nevojshme sa beteja e elementeve në natyrë"; ajo "merr një vendim biologjikisht të drejtë, përdërisa vendimet e saj mbeten në natyrën e thjeshtë të sendeve."<sup>29</sup>



Sikurse kemi parë, Lufta e Parë Botërore shpërtheu për arsye se mendimtarët, gjeneralët dhe administratorët evropianë e shihnin luftën, gjakderdhjen dhe vuajtjet si një lloj zhvillimi dhe mendonin se ato ishin një ligj i pandryshueshëm i natyrës. Rrënjët ideologjike që e zvarritën gjithë atë brez në rrënim nuk ishin tjetër, veçse konceptet e Darvinit për "luftën për mbijetesë" dhe për "racat e zgjedhura".

Lufta e Parë Botërore la pas vetes 8 milionë të vdekur, qindra qytete të shkatërruara dhe miliona të plagosur, të gjymtuar, të pastrehë e të papunë.

Shkaku themelor i Luftës së Dytë Botërore, e cila shpërtheu 21 vite më vonë dhe la 55 milionë të vdekur, ishte gjithashtu Darwinizmi.



Fashizmi, i cili në filozofinë e tij ka koncepte darviniste, shkaktoi vdekjen e miliona njerëzve të pafajshëm. Kjo ideologji e tmerrshme i shtyu shumë vende të botës drejt vorbullës së shkatërrimit dhe mjerimit.

**Lufta e Dytë Botërore shkaktoi vdekjen e 55 milionë njerëzve, duke lënë shumë të tjerë të plagosur dhe të pastrehë. Lufta shkatërroi mjaft qytete dhe i rrënoi ato ekonomikisht.**



**Nazizmi, një ndërthurje e darvinizmit social dhe e neopaganizmit, ka vrarë miliona njerëz dhe ka përhapur tmerr në zemrat e shumë të tjerëve.**





## "Ligji i Xhunglës" dhe përfundimi i tij: Fashizmi

Ndërsa Darwinizmi ushqente racizmin në shekullin e 19-të, ai formoi bazën ideologjike që do të zhvillohej dhe do të përgjakte botën në shekullin XX: Nazizmin.

Në ideologjinë naziste mund të vihet re një ndikim shumë i fortë darvinist. Kur marrim në shqyrtim këtë teori që u zhvillua nga Adolf Hitleri dhe Alfred Rozenbergu, vërejmë koncepte të tilla si "përzgjedhje natyrore", "çiftëzimi i përzgjedhur" dhe "lufta për mbijetesë mes racave", të cilat përsëriten shpesh në veprat e Darvinit. Kur e titulloi librin e tij "*Mein Kampf*" (Beteja ime), Hitleri u frymëzua nga beteja darviniste për mbijetesë dhe nga parimi se fitorja i përket më të fortit. Ai bën fjalë në veçanti për betejën mes racave:

Historia do të arrijë kulmin në një perandori të re njëmijëvjeçare të një shkëlqimi të pashoq, të mbështetur në një hierarki racore të rregulluar nga vetë natyra.<sup>30</sup>

Në një kongres të madh të partisë së tij në Nurenberg në vitin 1933, Hitleri shpalli se "një racë më e lartë nënshton një racë më të ulët... një e drejtë që ne e shohim në natyrë dhe që mund të pranohet si e vetmja e drejtë e konceptueshme."<sup>31</sup>


Fakti që nazistët ishin të ndikuar nga Darwinizmi, është i pranuar nga të gjithë historianët që janë të specializuar në këtë çështje. Peter Krisp, autori i librit "*Ngritja e Fashizmit*", e shpreh këtë të vërtetë si më poshtë:

Teoria e Çarls Darvinit se qeniet njerëzore kishin evoluar nga majmunët, u trajtua me humor kur u botua për herë të parë, por më vonë u pranua gjerësisht. Nazistët i shtrembëruan teoritë e Darvinit, duke i përdorur ato për të justifikuar luftën dhe racizmin.<sup>32</sup>

Historiani Hikman e përshkruan kështu ndikimin e Darwinizmit të Hitleri:




(Hitleri) ishte një besimtar i vendosur dhe predikues i evolucionit. Sado të thella dhe të ndërlikuara të kenë qenë problemet e psikozës së tij, është e sigurtë që [koncepti i luftës ishte i rëndësishëm për arsye se]... libri i tij "Mein Kampf", hedh qartazi një numër idesh evolucioniste, veçanërisht ato që theksojnë luftën, mbijetesën e më të fortit dhe shfarosjen e të dobëtit për të prodhuar një shoqëri më të mirë.<sup>33</sup>



Udhëheqësit komunistë, idetë e të cilëve gjithashtu janë të bazuara te darvinizmi, do të hyjnë në histori si njerëzit që me politikën e tyre mizore, shkaktuan vuajtje të tmerrshme.





**Komunizmi aplikoi pikëpamjen darviniste të luftës së klasave. Ai legjitimoi vrasjen dhe gjakderdhjen, si metoda të ligjshme për të sunduar.**



Hitleri, përmes këtyre pikëpamjeve, e zvarriti botën në një dhunë të paparë kurrë më parë. Shumë grupe etnike dhe politike, veçanërisht çifutët, iu nënshtruan mizorisë dhe masakrave të tmerrshme në kampet naziste të përqendrimit. Lufta e Dytë Botërore, e cila filloi me pushtimet gjermane, kushtoi 55 milionë jetë njerëzish. Ajo që qëndronte pas tragjedisë më të madhe në historinë e botës, ishte koncepti i Darwinizmit për "luftën për mbijetesë."

### Aleanca e përgjakshme mes Darwinizmit dhe Komunizmit

Ndërsa fashistët gjenden në krahun e djathtë të Darwinizmit Social, krahu i majtë është i zënë nga komunistët. Këta kanë qenë gjithmonë ndër mbrojtësit më të zjarrtë të teorisë së Darvinit.

Kjo lidhje mes Darwinizmit dhe Komunizmit shkon deri te themeluesit e të dy këtyre "izm"-ave. Marksi dhe Engelsi, themeluesit e komunizmit, e lexuan veprën "*Origjina e llojeve*" të Darvinit, sapo ajo doli në qarkullim dhe u mahnitën me qëndrimin e tij materialist dialektik. Letërkëmbimi mes Marksit dhe Engelsit tregon se ata e shihnin teorinë e Darvinit si "bartëse të bazës në historinë natyrore për Komunizmin." Në librin e tij "*Dialektika e Natyrës*", të cilin ai e shkroi nën ndikimin e Darvinit, Engelsi shprehet plot lëvdata për Darvinit dhe përpiqet të japë kontributin e vet për teorinë në kapitullin me titull "Roli i punës në kalimin nga majmuni te njeriu".

Komunistët rusë që ndoqën hapat e Marksit dhe të Engelsit, si Plehanovi, Lenini, Trocki dhe Stalini, ishin të gjithë në një mendje për teorinë e evolucionit. Plehanovi që shihet si themeluesi i komunizmit rus, e cilësonte Marksizmin si "**Darvinizmi në zbatimin e tij në shkencën shoqërore.**" Trocki thoshte: "**Zbulimi i Darvinit është triumfi më i madh i dialektikës në fushën e lëndës organike.**"<sup>35</sup>

Arsimimi darvinist kishte një rol kryesor në formimin e kuadrove komuniste. Për shembull, historianët vërejnë se **Stalini ishte fetar në rininë e tij, por ai u bë ateist kryesisht për shkak të librave të Darvinit**. Mao Ce Duni që ngriti qeverisjen komuniste në Kinë dhe vrau miliona njerëz, u shpreh hapur se "**socializmi kinez është i themeluar mbi Darwinin dhe teorinë e evolucionit**".<sup>36</sup>

Historiani i Universitetit të Harvardit, Xhejms Riv Pëzej, në veprën e tij kërkimore "*Kina dhe Çarls Darvini*", e shqyrton deri në hollësitë më të vogla ndikimin e Darwinizmit te Maoja dhe te komunizmi kinez.

Shkurt, ekziston një lidhje e pashkëputshme mes teorisë së evolucionit dhe komunizmit. Teoria pretendon se gjallesat janë prodhim i rastësisë dhe siguron të ashtuquajturën mbështetje shkencore për ateizmin. Komunizmi si ideologji ateiste, është i lidhur ngushtë me Darwinizmin. Për më tepër, teoria e evolucionit pretendon se zhvillimi në natyrë, është i mundur falë konfliktit (me fjalë të tjera, "luftës për mbijetesë") dhe mbështet konceptin e "dialektikës", i cili është themelor për komunizmin.

Nëse mendojmë për konceptin komunist të "konfliktit dialektik", i cili vrau më shumë se 120 milionë njerëz gjatë shekullit XX, si për një "makinë vrasëse", atëherë mund t'i kuptojmë më mirë përmasat e rrënimit që Darwinizmi përhap mbi tokë.

### Konflikti dialektik nuk ndihmon në zhvillimin e shoqërive, por në rrënimin e tyre

Sikurse thamë më parë, Darwinizmi ngriti pretendimin se lufta mes qenieve të gjalla është shkak i zhvillimit të tyre dhe kështu siguroi të ashtuquajturën bazë shkencore për filozofinë e materializmit dialektik.

Ashtu si mund të kuptohet nga emri i tij, materializmi dialektik i qëndron idesë së "konfliktit". Karl Marksi, si themeluesi i kësaj filozofie, propagandonte idenë se "**nëse s'do të kishte luftë dhe kundërshti, gjithçka**

**do të mbetej ashtu siç ishte.**" Në një rast tjetër ai thotë: "**Forca është bashkëshortja e çdo shoqërie që është shtatzënë me një shoqëri tjetër.**"<sup>37</sup> Duke thënë këtë, ai u bëri thirrje njerëzve për dhunë, luftë e gjakderdhje, në mënyrë që të mund të zhvilloheshin.

I pari që vuri në jetë teorinë e Marksit në fushën politike, ishte Lenini. Duke nxitur mendimin se "**zhvillimi vjen si rrjedhojë e konfliktit dhe e kundërshtive**", Lenini pretendonte se njerëzit me ide të kundërta, duhet të ishin në konflikt të vazhdueshëm. Lenini gjithashtu shprehej gjithmonë se ky konflikt do të kërkonte gjakderdhje, pra, terrorizëm. Një fragment i shkruar nga Lenini dhe i titulluar "*Lufta guerrilase*", i cili është botuar për herë të parë në gazetën "*Proletari*" në vitin 1906, njëmbëdhjetë vjet përpara Revolucionit Bolshevik, tregon për metodat terroriste që ai parapëlqente:

**Dukuria, për të cilën jemi të interesuar, është beteja e armatosur.**

Ajo udhëhiqet nga individë dhe nga grupe të vogla. Disa i përkasin organizatave revolucionare, ndërsa të tjerët (shumica në disa vende të Ruisë) nuk i përkasin ndonjë organizate revolucionare. Lufta e armatosur ndjek dy qëllime kryesore, të cilat duhet të dallohen në mënyrë të prerë: në radhë të parë, **kjo luftë synon vrasjen e individëve, shefave dhe vartësve të ushtrisë dhe policisë; në radhë të dytë, ajo synon konfiskimin e fondeve monetare si nga qeveria, ashtu edhe nga personat privatë.** Këto fonde të konfiskuara shkojnë pjesërisht në thesarin e partisë, pjesërisht disa për qëllimin e veçantë të armatimit dhe për përgatitjen e kryengritjes dhe pjesërisht për mbajtjen e personave të angazhuar në luftën që po përshkruajmë.<sup>38</sup>

Në shekullin e njëzetë, një nga ideologjitë më të njohura për kundërvënien ndaj komunizmit, ishte fashizmi. Më interesantja është se edhe fashizmi megjithëse vetëdeklarohet si kundërshtar i komunizmit, mbështeste të njëjtin besim si komunizmi në konceptin e luftës. Komunistët besonin në nevojën e luftës së klasave; fashistët thjesht ndryshuan arenën



Është e natyrshme që të ketë mosmarrëveshje, por ato nuk duhet të bëhen shkak për konflikte dhe luftëra mes njerëzve. Nëpërmjet respektit reciprok dhe dhembshurisë, mund të arrihen marrëveshje dhe të sigurohet bashkëjetesa edhe midis palëve që kanë mospajtime.

Vlerat morale të Kuranit ofrojnë për njerëzit, rrugën për të arritur jetë të begatë dhe të gëzuar, ndërsa lufta dialektike sjell gjithmonë urrejtje, shkatërrim dhe vdekje.





e luftës, duke u përqëndruar në idenë e luftës mes racave dhe kombeve. Për shembull, historiani gjerman Hajnrih Trajçke, vepra e të cilit ishte një nga burimet më të rëndësishme për idetë naziste dhe raciste, shkruante: **"kombet nuk mund të kenë mirëqenie pa konkurrencë të dendur, sikurse lufta për mbijetesë e Darvinit."**<sup>39</sup> Hitleri gjithashtu thoshte se ishte frymëzuar nga koncepti i Darvinit për luftën:

**E gjithë bota e natyrës përbën një betejë të fuqishme mes forcës dhe dobësisë, si një fitore e përjetshme e të fortit mbi të dobëtin.** Nuk do të kishte asgjë tjetër veç mashtrimin në të gjithë natyrën nëse nuk do të ishte kështu. Ai që do të jetojë, duhet të luftojë. Ai që nuk dëshiron të luftojë në këtë botë ku beteja e përhershme është ligj i jetës, nuk e ka të drejtën për të ekzistuar.<sup>40</sup>

Të dyja këto ideologji darviniste nxisnin besimin se për një shoqëri që të rritej e të forcohej, ishte e nevojshme gjakderdhja. Pasojat që sollën këto ideologji në shekullin XX janë tashmë të njohura. Miliona njerëz humbën jetën; miliona të tjerë u plagosën apo u gjymtuan; ekonomitë kombëtare u rrënuan; paratë që do të mund të përdroreshin në shëndetësi, kërkime shkencore, teknologji, arsim e art, u shpenzuan për armatim, për ilaçe që të mjekoheshin plagët e shkaktuara nga armët, për rindërtimin e qyteteve të rrënuara. U bë e qartë se koha kalonte dhe lufrat e terrori nuk nxisnin zhvillimin e njerëzimit por shkatërrimin e tij.

### **Mendimet e ndryshme nuk nënkuptojnë konfliktin. Përkundrazi, prej tyre ka përfitime**

Sigurisht që në botë ekzistojnë kontradikta. Ashtu sikurse në natyrë ekzistojnë drita dhe errësira, dita dhe nata, e nxehta dhe e ftohta, edhe kontradiktat në mendime e në praktika janë të dukshme. Mirëpo kundërshtitë në mendime nuk është e nevojshme të sjellin konflikte dhe luftë. Përkundrazi, nëse kundërshtitë trajtohen me paqe, mirëkuptim,

dashuri, dhembshuri e mëshirë, mund të arrihen përfundime të mira. Kushdo që krahason mendimet e veta me ato të të tjerëve, mund të zhvillojë apo të njohë dobësitë dhe mangësitë e veta dhe t'i përmirësojë ato. Ata që mbrojnë mendime të ndryshme mund të angazhohen në dialog, shkëmbim idesh apo në kritikë konstruktive. Vetëm njerëzit e sinqertë, që dinë të falin, që e duan paqen, që dinë të sillen dhe që mbi të gjitha pohojnë mësimet morale të Kuranit, mund të zhvillojnë një mënyrë të tillë të trajtimit të mendimeve të ndryshme.

Të vrasësh apo të dëmtosh një njeri për shkak të ideve, besimeve, racave apo kombësive të ndryshme përbën një vepër mizorie të pamatë. Vetëm për këtë arsye, në rrjedhën e historisë dhe kudo në botë, bijtë e bijat e të njëjtit komb, kanë luftuar me njëri-tjetrin deri në vdekje, duke vrarë shoku-shokun pa mëshirë; apo njerëz të kombeve apo racave të ndryshme, përfshirë gra e fëmijë, janë masakruar pa dallim. Vetëm ai që nuk njihet respekt për qeniet njerëzore dhe që i sheh njerëzit rreth vetes si kafshë të zhvilluara, vetëm ai që nuk beson se një ditë do të japë llogari përpara Zotit për gjithçka që ka bërë, mund të veprojë në këtë mënyrë.

Qëndrimi më i mirë dhe më i drejtë që mund të mbahet ndaj dikujt, me të cilin ndajmë mendime të ndryshme, është përshkruar në Kuran. Përplasjet e mendimeve kanë ndodhur shpesh në rrjedhën e historisë dhe një nga shembujt më të mirë është ai i kundërshtisë mes Musait (Moisiut) dhe Faraonit të kohës së tij. Megjithë egërsinë dhe mizorinë e Faraonit, Zoti e dërgoi Musain (Moisiun) për ta ftuar atë në fenë e Zotit dhe i shpjegoi atij mënyrën se si duhej ta shtronte këtë ftesë:

**Shkoni te faraoni! Ai i ka kapërcyer kufijtë. Megjithatë, flitini atij me fjalë të buta, me shpresën se ai do të kushtojë vëmendje apo do të frikësohet. (Kurani 20:43-44)**

Musai iu bind urdhrimit të Zotit dhe i sqaroi Faraonit me durim fenë e

Zotit. Për ta ndaluar mohimin e Zotit nga ana e Faraonit dhe mizorinë që ai ushtronte ndaj njerëzve, Musai u mundua të sqaronte çdo çështje. Sidoqoftë, Faraoni tregoi qëndrim të papajtueshëm ndaj durimit dhe fisnikërisë së Musait, duke e kërcënuar me vrasje atë dhe të gjithë ata që ndanin të njëjtat mendime me të. Megjithatë, nuk ishte qëndrimi i Faraonit ai që do të mbizotëronte. Përkundrazi, ai dhe njerëzit e tij u mbytën ndërsa Musai dhe njerëzit e tij dolën fitimtarë.

Sikurse tregon ky shembull, fitorja e një ideje apo lufta për zhvillim nuk vjen nga armiqësia dhe agresioni. Takimi mes Musait (Moisiut) dhe Faronit përbën një mësim nga historia: fituesit nuk dalin prej atyre që janë në anën e barbarisë dhe të luftës, por prej atyre që përkrahin paqen dhe drejtësinë. Vënia në jetë e parimeve më të mira morale, shpërblehet si në këtë botë, ashtu edhe në jetën e përjetshme.

### Lidhja ndërmjet darvinizmit dhe terrorizmit

Sikurse kemi parë deri tani, Darwinizmi qëndron në rrënjët e ideologjive të dhunës që i kanë sjellë fatkeqësi të tmerrshme njerëzimit në shekullin XX. Koncepti themelor që qëndron pas ideve e metodave të tilla është: **"të luftosh këdo që nuk është prej nesh."** Ekzistojnë besime, pikëpamje e filozofi të ndryshme në botë. Është e natyrshme, që ndërmjet këtyre ideve mund të ketë mospërputhje me njëra-tjetrën. Sidoqoftë, qëndrimet e ndryshme mund të vihen përballë njëra-tjetrës në dy mënyra:

1) Ato mund ta respektojnë ekzistencën e atyre që janë ndryshe dhe të përpiqen të vendosin dialogun me njëri-tjetrin në një mënyrë shumë njerëzore. Kjo metodë është në përputhje me moralin e Kuranit.

2) Ato mund të zgjedhin si rrugëdalje, luftën ndaj njëri-tjetrit dhe të përpiqen ta sigurojnë epërsinë e tyre përmes luftës. Me fjalë të tjera, të sillen si kafshët. Kjo është një metodë e nxitur nga materializmi dhe është natyrisht, afetare.

Tmerri i quajtur "terrorizëm" nuk është tjetër veçse vënia në jetë e pikëpamjes së dytë.

Nëse i marrim në shqyrtim këto dy qëndrime, mund të shohim se ideja e "njeriut që lufton si kafshë", e cila u imponohet në mënyrë të pavetëdijshme njerëzve nga Darwinizmi, është shumë ndikuese. Individët dhe grupet që zgjedhin rrugën e konfliktit mund të mos kenë dëgjuar kurrë të flitet për Darwinizmin dhe për parimet e asaj ideologjie, por në përfundim, ata bien në një mendje me një pikëpamje, baza filozofike e së cilës është

Darvinizmi. Ajo që i shtyn ata të besojnë në drejtësinë e kësaj pikëpamjeje janë slloganet darviniste si "në këtë botë mbijeton më i forti", "peshku i madh e ha të voglin", "lufta është virtyt", "jeta është luftë" etj... Nëse u heqim Darwinizmin, ato s'janë gjë tjetër veçse sllogane boshe.

**Mund të ketë mosmarrëveshje midis shteteve apo shoqërive, por problemet nuk duhet të zgjidhen me konflikte dhe luftë. Siç na është thënë në Kuran, të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen me durim reciprok, mëshirë dhe mirëkuptim.**





Në të vërtetë, nëse heqim Darwinizmin, nuk mbetet filozofi konflikti. Tri fetë me prejardhje hyjnore, Islami, Krishterimi dhe Judaizmi, në të cilat besojnë shumica e njerëzve, i kundërvihen dhunës. Të trija këto fe dëshirojnë t'i sjellin paqe e harmoni botës dhe t'i kundërvihen vrasjeve dhe vuajtjeve çnjerëzore. Konflikti dhe dhuna, janë dy rrugë në kundërshtim të plotë me moralin që Zoti ka shpallur për njeriun. Kurse Darwinizmi e sheh dhe e portretizon konfliktin dhe dhunën si të natyrshme, të justifikuar dhe si koncepte të drejta që duhet të ekzistojnë.

Prandaj, është kjo ideologji e zvetnuar që qëndron prapa aktiviteteve terroriste në botë, sepse ajo i sheh luftën dhe dhunën si rrugë më të shkurtra drejt qëllimit.

### **Çdo njeri që dëshiron paqen duhet të njohë rrezikun e Darwinizmit**

Zgjidhja, për problemet që na rrethojnë, do të vijë kur të thërrmohet baza ideologjike që i ushqen ato. Për shembull, s'ka rëndësi se me sa vështirësi do të përpiqet dikush të largojë erën e keqe nga një ambient me mbeturina. Përderisa mbeturinat janë aty, era e rëndë nuk do të largohet. Zgjidhja e vërtetë është pastrimi i burimit të mbeturinave. Në të kundërt, kjo do t'i ngjante të shpenzuarit të viteve për të rritur gjarpërinj helmues në një fermë dhe më pas të lënit të tyre të lirë dhe të habiturit se përse ata vijnë rrotull, duke kafshuar e helmuar njerëzit. Më e rëndësishmja nuk është që ata të kapen pasi të jenë përhapur kudo, por në radhë të parë, të mos ushqehen e të mos shtohen.

Edhe në rastin e terrorizmit, kërkimi i terroristëve një nga një nuk siguron shmangien e ndikimit të tyre dhe nuk është një zgjidhje e përhershme. **Mënyra më e mirë për çrrënjosjen e murtajes së terrorizmit nga faqja e dheut, është identifikimi i burimeve themelore që ushqejnë**

**terroristët dhe zhdukja e tyre. Burimi i terrorizmit, nga ana tjetër, janë ideologjitë e gabuara dhe edukimi i marrë nën dritën e këtyre ideologjive.**

Sot, në shumicën e vendeve të botës, Darwinizmi është futur në programin e shkollave dhe trajtohet sikur të ishte ndonjë fakt shkencor. Të rinjve nuk u mësohet se janë të krijuar nga Zoti dhe se janë të pajisur me shpirt, urtësi e ndërgjegje. Atyre nuk u thuhet se do të dënohen në Ferr apo do të shpërblehen në Parajsë në përjetësi. Përkundrazi, atyre u mësohet se janë krijesa, etërit e të cilëve kanë qenë kafshë që erdhën në ekzistencë përmes rastësive. Në një indoktrinim të tillë, ata e shohin vetveten si qenie të rastësishme që nuk janë përgjegjëse përpara Zotit dhe e shohin të ardhmen ose më saktë, mbijetesën e tyre, në daljen fitimtarë në betejë. Pas këtij mesazhi, është fare e thjeshtë që njerëzve të indoktrinuar gjatë gjithë jetës së tyre shkollore t'u bëhet një lavazh truri dhe të shndërrohen në armiq mizorë të njerëzimit, të aftë për të vrarë edhe fëmijë të pafajshëm. Të rinj të tillë mund të tërhiqen lehtë nga ideologji të kota. Ata mund të



veprojnë nën ndikimin e kushtëzimit nga ana e terroristëve dhe të përfshihen në veprime të papërfytyrueshme dhune e mizorie. Grupet komuniste, fashiste e raciste që ekzistojnë qysh nga shekulli XIX, janë prodhime të këtij sistemi arsimimi.

Dëmi i dytë që ky sistem arsimiti shkakton, është distancimi i arsimit nga feja. Kështu, sfera e fesë kufizohet vetëm në botën e njerëzve të paarsimuar. Si rezultat i instalimit, në programet mësimore, të darvinizmit e materializmit, njerëzit e arsimuar nuk kanë njohuri nga edukata fetare. Për pasojë, lindin dhe zhvillohen bestytni dhe ide të gabuara, me anë të të cilave, antifetarët marrin nën kontroll fetë.

Në përfundim, mënyra më e mirë për t'i dhënë fund terrorizmit, është dhënia fund e arsimimit darvinisto-materialist, i cili është burimi kryesor i terrorizmit. Arsimimi i të rinjve duhet bërë sipas programeve të mbështetura në zbulime të vërteta shkencore; ata duhen edukuar me dashurinë dhe drojën ndaj Zotit të Lartësuar dhe me dëshirën për të vepruar me urtësi e kujdes. Frytet e një arsimimi të tillë janë bashkësitë, ku në to ka njerëz paqësorë, të dhembshur e të besueshëm, që dinë të falin e të tolerojnë.



### **Efektet e dëmshme të arsimit të njëanshëm darvinist, që çojnë në dhunë**

Duke përhapur gënjeshtër se jeta e njeriut nuk mbart asnjë qëllim, arsimimi darvinist i kthen njerëzit në individë psikologjikisht të sëmurë, pesimistë dhe depresivë, të cilëve u mungon çdo shpresë dhe gëzim.

Një nga shembujt është norvegjezi Anders Behring Breivik. Breivik ka pranuar kryerjen e dy sulmeve terroriste në Norvegji më 22 Korrik 2011. Një nga këta ishte një sulm me bombë në ndërtesën qeveritare në Oslo, në të cilën humbën jetën 8 njerëz. Tjetri ishte një sulm ndaj një kampi rinor të partisë Laburiste në ishullin Utoja. Në këtë sulm humbën jetën 69 njerëz.

Para sulmeve, Breivik kishte shkruar pikëpamjet e tij në librin e tij "Manifesti i Pavarësisë Evropiane." Në faqen 1518, ai deklaroi se e konsideron veten, një kampion të mendimit shkencor botëror dhe të biologjisë moderne. Ndër librat që ai "më së shumti vlerësoi" ishte Origjina e Specieve<sup>1</sup> i Çarls Darvinit. Sipas Breivik, që një Evropë të jetë e "përsosur" duhet të bazohet te ligjet e darvinizmit social.<sup>2</sup>

Në faqen 1202, në lidhje me rizbatimin e eugenikës, Breivik thotë se në tërësi pajtohet me biologun darvinist Lee Silver nga Universiteti i Princetone. Ai pajtohet me pikëpamjen e Silverit, se në të ardhmen duhet të zbatohen politika radikale që popullsia e botës të reduktohet në më pak se gjysma e asaj që është sot, ose 3.8 miliard.<sup>3</sup> Në të njëjtën faqe, Breivik





**Terroristët, për të arritur synime të caktuara, i dëmtojnë njerëzit si fizikisht ashtu edhe psikologjikisht. Megjithatë, morali i fesë është kundër terrorizmit dhe ka si qëllim dashurinë, mirëqenien, dhembshurinë, gëzimin dhe shpresën në mbarë shoqërinë.**

bën të qartë se ai mbështet tezën e Darvinit se "gjenocidi dhe përzgjedhja natyrore ... shkojnë dorë për dorë":

"Në qoftë se vendet e botës së dytë dhe të tretë injorojnë thirrjen e kësaj "hegemonie" [për të ulur lindjet], natyra do t'i ndëshkojë me vetëvrasje, sepse ata nuk do të jenë në gjendje të ushqejnë popullsinë e tyre."<sup>4</sup>

Breivik vazhdon të thotë se nëse bie zia e bukës, në këtë proces natyror nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje.

"Nëse uria kërcënon vendet që kanë dështuar të ndjekin



udhëzimet tona [në kapacitetet për frymë], ne duhet t'i lëmë të rrënohen, duke forcuar pozitat e udhëheqësve të tyre të korruptuar dhe nuk duhet të dërgojmë asnjë ndihmë."<sup>5</sup>

"Ndihmat ushqimore në vendet e botës së tretë, duhet të ndalen menjëherë, pasi ky është shkaku kryesor i mbipopullimit."<sup>6</sup>

Këto fjalë të shkruara nga vetë Breivik tregojnë qartë se ai i kishte humbur të gjitha vlerat humane; për shkak të edukimit të tij darvinist, ai kryeu me gjakftohtësi sulmet terroriste, që u morën jetën dhjetëra njerëzve.

Një tjetër shembull i rënies morale dhe egërsisë së shkaktuar nga edukimi darvinist, është vrasësi serial amerikan Jeffrey Dahmer, i cili para se të kapej vrau dhe hëngri 17 fëmijë. Në një intervistë të fundit në kanalin NBC, pak para se të dënohej me vdekje, Dahmer bëri deklaratën e mëposhtme:

"Nëse një njeri mendon se nuk ka Zot, apo llogari për të dhënë, atëherë përse duhet të përpiqet për të ndryshuar sjelljen, në mënyrë që ajo të jetë brenda kufijve të pranueshëm? **Gjithësesi, kjo është ajo që mendoja. Gjithmonë e kam besuar si të vërtetë teorinë e evolucionit, që ne të gjithë erdhëm prej baltës [rastësisht]. Kur ne vdesim, ju e dini, që atje nuk ekziston asgjë.**"<sup>7</sup>

Bestytnitë e Darvinit kanë helmuar një numër të madh njerëzish, duke i transformuar ata në vrasës serial, të çmendur, e kanibalë. Kjo është ajo që vjen nga kjo fe e rreme që kërkon të indoktrinojë njerëzit me idenë se ata nuk kanë përgjegjësi ndaj Krijuesit, se ata janë subjekte të paqëllimtë dhe pa përgjegjësi; ajo i konsideron qeniet njerëzore si kafshë dhe kërkon t'i largojë nga e vërteta e botës tjetër, duke ua portretizuar vdekjen si fundin e tyre.

Darvinizmi ishte mashtrimi dhe problemi më i madh i shekullit të kaluar. Kjo ideologji ishte shkaku i vrasjeve, shtypjes, terrorit, masakrave masive, degjenerimit dhe mundimeve të të gjitha llojeve për 200 vitet e fundit. **DARVINIZMI ISHTE MASHTRIMI DHE PROBLEMI MË I MADH I SHEKULLIT TË KALUAR**, dhe kjo ideologji ishte shkaku i luftërave botërore, i komunizmit, i fashizmit, i ateizmit, i racizmit dhe i masakrave masive të hasura në të njëjtën periudhë.

Ky kamzhik i errët darvinist, vazhdon të shkaktojë dëme në shoqëritë tona, madje edhe në ditët e sotme. Libri i fundit nga Richard Dawkins, një prej ithtarëve më të përkushtuar të Darvinizmit, sugjeron se duhet të hiqet dorë nga besimi në Zot; ky libër të shpie në pesimizëm dhe në depresion.

Një nga rastet më të rënda ishte ai i Jesse Kilgore, një student 22-vjeçar në Amerikë, i cili kreu vetëvrasje prej traumës që i shkaktoi libri i Dawkins, të cilin ja rekomandoi një mësues.<sup>8</sup> Efekti i pikëpamjeve të tmerrshme të Dawkins, i bazuar në ideologjinë e errët të Darwinizmit, nuk kufizohet vetëm te ky shembull. Në parathënien e librit të tij *Shpërbërja e Ylberit*, Dawkins e pranon vetë këtë fakt:

"Një botues i huaj i librit tim të parë, pranoi se ai nuk mundi të flinte për tre netë pas leximit të tij, ai ishte aq i turbulluar, sepse e shihte si të ftohtë, mesazhin e tij të zyrtë. Të tjerë më kanë pyetur se si unë mund të fle deri në mëngjes. Një mësues nga një vend i largët më shkroi qortueshëm, se një nxënëse i kishte ardhur tek ai me lot në sy pas leximit të të njëjtit libër, sepse asaj i dukej jeta e kotë dhe e paqëllimtë. Ai e këshilloi atë që të mos ua tregonte librin askujt prej miqve të saj, nga merakuri se mos infektoheshin edhe ata me të njëjtin pesimizëm nihilist."<sup>9</sup>

Darvinizmi, është një fe perverse që shkakton vdekje, vrasje, dëshpërim, indiferencë, terror, egërsi dhe inkurajon njerëzit të mendojnë, se ata nuk janë gjë tjetër veçse kafshë, që kanë ardhur në ekzistencë rastësisht. Përfaqësuesit e këtij besimi, janë ende duke luftuar me të gjithë fuqinë e tyre, që t'i largojnë njerëzit prej besimit në Zot. Kjo është arsyeja pse ata përpiqen të fshehin në tekstet shkollore mangësitë e teorisë së Darvinit, fshehin fosilet që vërtetojnë Krijimin, asnjëherë nuk pranojnë se proteina s'mund të vijë në ekzistencë rastësisht dhe se më shumë se 450 milionë fosile



hedhin poshtë krejtësisht Darwinizmin. Megjithatë, njerëzit në shekullin e 21 nuk mund të gënjejnë kaq lehtë. Të gjitha përpjekjet e bëra për të mbajtur gjallë Darwinizmin kanë qenë të kota, sepse ajo teori është faktuar se është një mashtrim.

- 
- 1- <http://www.darwinthenandnow.com/2011/07/breivik-a-darwinist/?cb=09394448816310614>
  - 2- Anders Behring Breivik, een Europese Verklaring van Onafhankelijkheid, S.1386
  - 3- <http://www.darwinthenandnow.com/2011/07/breivik-a-darwinist/?cb=09394448816310614>
  - 4- Anders Behring Breivik, een Europese Verklaring van Onafhankelijkheid, S.1202
  - 5- Anders Behring Breivik, een Europese Verklaring van Onafhankelijkheid, S.1202
  - 6- Anders Behring Breivik, een Europese Verklaring van Onafhankelijkheid, S.1203
  - 7- Kelly J. Coghlan, Houston Chronicle zondag-15 februari 2009
  - 8- <http://www.worldnetdaily.com/index.php?fa=PAGE.view&pagelid=81459>
  - 9- Richard Dawkins, Unweaving The Rainbow New York: Houghton Mifflin Company, 1998, blz. ix.
- 

## **Edukimi darvinist në shkolla, i bën njerëzit të prirur drejt dhunës dhe terrorit**

Asgjë në këtë botë nuk është rastësi, po ashtu edhe terri në të cilin bota u zhyt në shekujt 20-të dhe 21-të. Zoti, me anë të këtyre fazave të dhimbshme të historisë, ka treguar një shembull shumë të rëndësishëm për njerëzimin dhe Ai ende dëshiron që ata ta shohin atë. Njerëzit duhet të kuptojnë: nëse ata harrojnë se janë krijuar për dashuri, vëllazëri, miqësi dhe altruizëm, dhe nëse ata zgjedhin përçarjen dhe luftën në vend të forcimit të bashkimit, dhe nëse ata nuk heqin dorë nga lëvizjet apo ideologjitë e rreme dhe nga mendimi se "vrasja dhe lufta janë të nevojshme për t'u përmirësuar", ata nuk do të fitojnë gjë tjetër veç rrënimit dhe vuajtjes. Por, ata në fund do të vërejnë se konfliktet nuk do të sjellë përmirësim, por vetëm shkatërrim.

### **Darvinizmi dhe derivati i tij komunizmi, bazohen në të ashtuquajturën - nevojë për luftë dhe konflikt**

Dialektika, e cila për herë të parë haset në Greqinë e lashtë dhe nënkupton "debat", u përshkrua nga Heraklitus (576-480), me fjalët e mëposhtme: "...Të gjitha gjërat vijnë në ekzistencë nga një konflikt i të kundërtave". Për Heraklitusin, konflikti është burimi i çdo gjëje. Prandaj, duhet të ketë një konflikt midis tezës dhe antitezës. Nëse mbrojtësit e tezës duhet të mposhten nga pala tjetër, ajo duhet bërë me anë të luftës, gjakderdhjes dhe duhet të shkatërrohen me çdo kusht. Atëherë sinteza do të kthehet në një tezë të re dhe lufta do të duhet vazhdojë me ritëm të shpejtë.

Hegeli dhe Marksi, që pasuan shekuj pas tij, e quajtën atë "konflikt" dhe ky "konflikt" nuk nënkuptonte thjesht luftën. Sigurisht ky botëkuptim nuk zgjati shumë, sepse udhëheqësit e përgjakshëm komunistë e perceptuan atë si, luftë dhe masakra. Ata besonin në domosdoshmërinë e luftës dhe e konsideronin atë si kusht themelor për marksizmin. Edhe pse komunistët e gjelbër sot e refuzojnë këtë koncept të luftës, komunizmi kërkon intriga, luftë guerile dhe masakra të pamëshirshme. Masakrat e tanishme në Siri, gjakderdhjet e shkaktuara nga PKK-ja komuniste në Juglindje të Anadollit, janë prova të mjaftueshme.

### **Komunizmi: Një bazë themelore e organizatave terroriste**

Vendet që janë duke vuajtur nga terrorizmi, duke përfshirë edhe Turqinë, përballen më shpesh me grupe të ndryshme rebele, komuniste ose terroriste. Komunizmi është shumë i gjallë sot, edhe pse nuk pranchet zyrtarisht; ai kontrollon

pjesë të Amerikës Veriore, të Evropës Veriore dhe pothuajse të gjithë Lindjes së Mesme. Gjithashtu ka vende të cilat janë zyrtarisht nën regjimin komunist, vende të Amerikës së Jugut, Kinës dhe sigurisht, Koreja e Veriut. Ky regjim marksist-komunist nxit terrorizmin në të gjithë botën. Ata që mbyllin sytë përballë këtij kërcënimi të hapur marksist, janë ende në kërkim të zgjidhjeve për terrorizmin me anë të debateve të pafundme televizive. Por, në të njëjtën kohë, ata vazhdojnë t'u mësojnë nxënësve në shkolla dialektikën e tyre. Mendjet e fëmijëve të tyre janë të mbushura me gënjeshtër, se dy ide të kundërta janë në luftë me njëra-tjetrën, sepse sipas tyre historia është e mbushur me konflikte të tilla, dhe vetëm konfliktet e tilla mund të sjellin zhvillim dhe përfitim për shoqëritë. Vetë terroristët janë të indoktrinuar me të njëjtat gënjeshtër. Ironikisht, si vendet komuniste, ashtu edhe vendet kapitaliste propagandojnë të njëjtën mendësi; pra, mentaliteti marksist vazhdon të përparojë në çdo vend, fshehtas dhe me hapa të shpejtë.

Një tjetër pikë duhet të mbahet në mend: Kapitalizmi nuk është kundër marksizmit. Përkundrazi, sipas Marksit, kapitalizmi është një kërkesë e rëndësishme, që shoqëritë të përparojnë drejt komunizmit. Komunizmi është në pritë, duke pritur për të zënë në grackë njerëzit dhe shoqëritë, të cilët falë kapitalizmit egoist, braktisën vlerat e tyre morale, fetare dhe njerëzore, duke menduar vetëm për veten e tyre. Kriza e sotme ekonomike po luhet në duart e komunizmit. Sipas marksistëve dhe komunistëve, tashmë gjithçka është gati. Çdokush që dëshiron ta kuptojë këtë fenomen më mirë, duhet të vështrojë më nga afër problemet e shumta të botës ku jetojmë.

### **Ekzistenca e të kundërtave nuk nënkupton luftë**

E kundërta ka ekzistuar gjithmonë. Konflikti mes të mirës dhe të keqes ka ekzistuar qysh nga fillimi i botës. Megjithatë, ky konflikt duhet kuptuar saktë. Ekzistenca e të kundërtave nuk nënkupton luftë. Të kundërtat mund të hasen gjatë komunikimit apo debatit intelektual, gjatë paraqitjes së provave, por askush nuk detyrohet të pranojë çdo ide dhe askush nuk duhet të vritet thjesht, sepse ai mendon ndryshe. Lufta nuk ka sjellë ndonjëherë zhvillim. Luftërat e përgjakshme dhe konfliktet e shekullit të 20, por edhe luftërat e pafundme në ditët e sotme, kanë ndihmuar industrinë e armatimit të arrijë përfitime mbi prodhimin e armëve, duke shkatërruar njerëzit, civilizimet, teknologjinë, qytetet dhe ekonominë globale. Nuk mund të ketë zhvillim ose përmirësim kur njerëzit jetojnë





në frikë. Nuk mund të ketë progres, kur njerëzit janë të uritur, më pak të ushqyer, më pak të arsimuar, më pak produktiv. Nuk mund të kemi zhvillim të qyteteve, nëse infrastruktura dhe teknologjia e tyre shkatërrohet prej bombardimeve. Asnjë shoqëri nuk mund të lëvizë përpara nëse shuhet brezi i ri. Bombat atomike të lëshuara në Hiroshimë dhe Nagasaki nuk kanë sjellë asgjë tjetër përveç shkatërrimit ndër breza. Dialektika e përgjakshme e parashtruar nga marksizmi, nuk i solli shoqërisë përparimin e imagjinuar dhe kjo nuk do të ndodhë as në të ardhmen. Nëse ne lejojmë që bota të ngulfatet me fatkeqësi edhe më të rënda, ajo do të mbytet në gjak.

Darvinizmi është sfondi filozofik i shumë konflikteve në botë. Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme (origjinën e të cilës Darwinistët kurrë nuk mund ta shpjegojnë), si rezultat i një vargu rastësish. Sipas tyre, lufta është një nga elementet evolues të këtij procesi imagjinar. Baza e kësaj ideologjie të dhunshme, e cila pretendon se gjallesat mund të zhvillohen vetëm përmes luftës, argumentohet me mbijetesën e më të fortit. Paraqitja e teorisë mashtruese të Darvinit, si një teori shkencore dhe përfshirja e saj në kurrikulat e shkollave në gjithë botën, ka arritur të mashtrojë shumë njerëz; idetë e mbrapshta darviniste gjetën terrenin e duhur , 'mbollën' luftëra të përgjakshme dhe 'korrën' miliona njerëz të vdekur.



**Zgjidhja e vetme kundër ideologjive të përgjakshme, është dhënia fund e arsimimit të njëanshëm, i cili favorizon darvinizmin**

Mendimet e kundërta mund të japin rezultate pozitive, vetëm falë dashurisë dhe dhembshurisë, respektit, lirisë së mendimit dhe fakteve shkencore dhe jo përmes forcës apo dhunës. Tashmë ka ardhur koha për të gjithë, që të kuptojmë arsyen e fatkeqësive që kanë kapluar botën. Marksizmi arsyeton se duhet bërë luftë; shoqëritë marksiste i hodhën themelet e tyre në mënyrë të fshehtë. Mënyra më efektive, për të ndaluar këtë dialektikë të përgjakshme që justifikon luftërat, është nëpërmjet informimit publik, se ajo është një dogmë joshkencore. Ajo që duhet të thuhet kudo, është se e ashtuquajtura dialektikë e natyrës s'është gjë tjetër veçse një



absurditet i pastër; edhe pse në natyrë gjenden grabitqarë të shumtë, ekzistojnë po ashtu gjallesa vetëmohuese dhe altruiste. Një mënyrë efektive do të ishte ndryshimi i këtij sistemi arsimor, i cili u mëson të rinjve në të gjithë botën, idetë e dialektikës së përgjakshme. Kjo botë nuk është një fushëbetejë, as për ne, as për qeniet e tjera. Bota do të jetë e bukur vetëm falë dashurisë; kjo është shpallur nga Zoti, në librat e të gjitha feve hyjnore. Zoti dëshiron që ne të jemi të dashur me njëri-tjetrin. Zoti dëshiron që ne të jemi vëllezër. Zoti i do ata që e duan. Kjo botë do të ndryshojë, vetëm nëse ndjekim urdhërat e Zotit dhe "dashurinë."

## Këshilla të rëndësishme për luftën intelektuale kundër darvinizmit dhe materializmit

Dijetari i madh islam Bediuzzaman, i cili ia kushtoi gjithë jetën e tij luftës intelektuale kundër mosbesimit, shpjegoi në veprat e tij, se mosbesimi gjën strehë te darvinizmi dhe materializmi. Ai ka thënë se lufta intelektuale kundër ideologjive të tilla do të luajë një rol jetik.

Bediuzzaman shpjegon ndikimin e materializmit mbi jobesimtarët:

**"Dhe së treti: Për të korruptuar ata me vese joshëse dhe mashtruese, u injektohen helmet e filozofisë materialiste; më pas e shkatërrojnë solidaritetin e tyre dhe i denigrojnë drejtuesit e tyre me gënjeshtër të pabaza; i diskreditojnë ata me disa parime të shkencës dhe të filozofisë ..."** (Bediuzzaman, Përmbledhja Mesazhet e Dritës, Rrezet, Rrezja e trembëdhjetë)

Për të shfuqizuar veprat intelektuale të Bediuzzamanit, jobesimtarët kërkonin të mashtronin besimtarët me kënaqësitë e përkohshme dhe joshëse të kësaj bote; të inkurajuar nga kultura materialiste, ata u përpoqën të dëmtojnë unitetin dhe solidaritetin e besimtarëve duke shpifur ndaj tij në mënyrë të përsëritur. Megjithatë ata sigurisht që dështuan.

Bediuzzaman thotë se darvinizmi dhe materializmi do të pasohen më shumë sidomos në Fundin e Kohës dhe mosbesimi do të përhapet falë këtyre dy ideologjive; Por Profeti Isa (paqja qoftë me të) dhe Hazreti Mehdi (paqja qoftë me të) do t'i japin fund këtij problemi përmes një luftë të efektshme intelektuale. Siç ka shpjeguar ai, Hazreti Mehdi (paqja qoftë me të) do ta përmbushë misionin e tij dhe do t'i japë fund darvinizmit dhe materializmit dhe kjo do të jetë një lehtësim që njerëzit të gjejnë besimin e tyre.

**"E para: Nën ndikimin e shkencës, filozofisë dhe përhapjes së epidemisë materialiste e natyraliste te njerëzit, detyra e parë [e Hazretit Mehdi] është para së gjithash ruajtja e besimit, duke bërë**



**që filozofitë dhe mendësitë materialiste të heshtin krejtësisht."**

(Bediuzaman, Përmbledhja Mesazhet e Dritës, Emirdag Addendum, f. 259)

Bediuzaman thotë se darvinizmi dhe materializmi janë shtyllat kryesore të antikrishtit, dhe se Profeti Isa (paqja qoftë me të) do të kryejë një luftë të madhe intelektuale kundër tyre, duke i dhënë fund atyre në mënyrë efektive:

"...Në fund të kohës feja e krishterë do të vetëpastrohet dhe do të heqë dorë nga bestytnitë që u futën prej ateizmit, prej filozofive materialiste dhe do të transformohet në Islam. Në këtë pikë, personaliteti kolektiv i krishterimit do të vrasë personalitetin kolektiv të frikshëm të mosbesimit me shpatën e shpalljes qiellore; Jezusi (paqja qoftë me të) që përfaqëson personalitetin kolektiv të krishterimit [shpirtërisht], do të vrasë antikrishtin, i cili përfaqëson personalitetin kolektiv të mosbesimit, pra është, ai që do të vrasë mendimin ateist [ai do ta eliminojë atë intelektualisht]." (Bediuzaman, Përmbledhja Mesazhet e Dritës, Letrat, Letra e parë, f. 22)

"... Do të vrasin [intelektualisht] personalitetin gjigant kolektiv të materializmit dhe të mosbesimit të cilin do të formojë Antikrishti - pra Antikrishti do të vritet nga Jezusi" (paqja qoftë me të) me shpatën [e njohurisë] - dhe do të shkatërrojë mosbesimin dhe idetë e tij të cilat janë ateiste." (Bediuzaman, Përmbledhja Mesazhet e Dritës, Fleshet, Fleshi 5, f. 589)

Bediuzaman Said Nursi na bën të qartë, se është darvinizmi dhe materializmi, dy ideologjitë që i largojnë njerëzit prej vlerave morale të fesë dhe i çojnë ata në mosbesim. Ai shpjegon se myslimanët do të kryejnë një luftë të madhe intelektuale kundër këtyre dy ideve të zvetnuara, nën udhëheqjen e Profetit Isa dhe Hazreti Mehdiut (paqja qoftë me ata). Me vullnetin e Zotit, këto ideologji do të marrin fund; falë këtyre dy njerëzve të bekuar, vlerat morale të Islamit do të mbretërojnë në të gjithë botën.

Ai i shpall shërbëtorit të Tij  
argumente të qarta  
për t'ju nxjerrë juve prej  
errësirave në dritë. ...  
(Kuran, 57: 9)



# PËRFUNDIM: REKOMANDIME PËR BOTËN PERËNDIMORE DHE PËR MYSLIMANËT

Edhe pse kalojnë dekada apo shekuj, një faktor mbetet i pandryshuar: Terrorizmi vazhdon të shkatërrojë. Njerëz në vende të ndryshme jetojnë me frikën e terrorizmit. Për më tepër kjo frikë nuk kufizohet vetëm nga kërcënimet prej vendeve të tjera. Në mjaft vende njerëzit përballen me kërcënimet e bashkëkombasve, ose anëtarëve të vetë fesë së tyre. Informacionet e dhëna në parathënien e këtij botimi të ri, pasqyrojnë shtrirjen e frikshme që ka arritur terrorizmi në ditët e sotme. Ky është një tregues i qartë, se masat ushtarake dhe politike të marra deri tani, për të zgjidhur problemin e terrorizmit, nuk kanë sjellë rezultat.

Sot bota perëndimore është shunë e shqetësuar për organizatat radikaliste që përdorin terrorin nën maskën e Islamit dhe ky shqetësim nuk është krejt i pavend. Sigurisht, ata që kryejnë akte terroriste, por edhe mbështetësit e tyre, duhet të gjykohen sipas kritereve të drejtësisë. Sidoqoftë,

çështja më me rëndësi që duhet trajtuar, është vënia në zbatim e strategjive afatgjata, të cilat do të sjellin zgjidhje të qëndrueshme për këto probleme.

Vlerësimet e mësipërme nxjerrin në pah se terrori nuk ka vend në Islam dhe se është një krim kundër njerëzimit. Ato, më tej, tregojnë natyrën kontradiktore të konceptit "terror islamik". Kjo na siguron neve një pikë përparësie të rëndësishme:

1) Kohët që po vijnë kërkojnë nga të gjithë kombet që të tregojnë kujdes, ndjeshmëri e urtësi. Bashkësia ndërkombëtare duhet të shfrytëzojë mundësitë që ka për të gjetur rrugën drejt paqes, duke shkëmbyer e mësuar nga njëri-tjetri, duke studiuar historinë e njëri-tjetrit, duke njohur veçantitë e njëri-tjetrit në fe, art, letërsi, filozofi, shkencë, teknologji e kulturë dhe kjo do të pasurojë jetët e të gjithëve.

2) Që Islami është fe e dashurisë, e miqësisë, e paqes dhe e vëllazërisë, duhet shpjeguar në çdo aspekt dhe komunitetet myslimane duhen inkurajuar ta kuptojnë këtë fakt. Zgjidhja e luftës ndaj grupimeve radikale në vendet islame nuk duhet të përbëjë një "sekularizim të detyruar". Përkundrazi, një politikë e tillë do të nxiste reagim te masat e njerëzve. Zgjidhja është përhapja e Islamit të vërtetë dhe shfaqja e shembullit të myslimanit që përfaqëson vlerat kuranore si të drejtat njerëzore, demokracia, liria, morali i lartë, shkenca, spiritualiteti, estetika dhe që i ofron lumturi e bekim njerëzimit. Myslimanët duhet të udhëhiqen prej virtyteve morale të shpallura në Kuran dhe në traditën profetike të Muhamedit (paqja qoftë me të). Myslimanët kanë përgjegjësinë ta "rërmbajnë" Islamin nga duart e atyre që e zbatojnë keq atë (gjë që çon në keqkuptime rreth Islamit) dhe ta vendosin në duart e atyre që jetojnë me mësimet e virtytshmërisë islame dhe sipas shembullit të Muhamedit, të Dërguarit të Zotit.

3) Disa nga burimet e terrorizmit janë injoranca dhe fanatizmi dhe zgjidhja për terrorizmin është arsimimi. Siç e kemi sqaruar më lart fanatizmi përfaqëson mënyrën e gabuar të të kuptuarit të fesë. Qarqeve që ndjejnë simpati për terrorin duhet t'u bëhet e qartë se terrori është në kundërshtim të plotë me Islamin dhe se ai shërben vetëm për të dëmtuar Islamin,



myslimanët dhe mbarë njerëzimin. Këta fanatikë duhet të edukohen që të heqin dorë nga rruga e fanatizmit.

4) Duhet të përgatiten zgjidhje kulturore afatgjata për të luftuar terrorizmin që i ka rrënjët në ideologjitë komuniste, fashiste dhe raciste. Sot në vendet anembanë botës, sistemi i arsimit është i ndikuar nga Darwinizmi. Siç sqaruar më lart, Darwinizmi është një ideologji e rrezikshme që e sheh njeriun si kafshë që u zhvillua në sajë të luftës për mbijetesë. Kjo përbën një bazë të përbashkët për të gjitha format e terrorizmit. Një ideologji që predikon se vetëm ata që janë të fuqishëm mund të mbijetojnë dhe që e konsideron luftën si një virtyt, është si një moçal i tërë që nuk do të reshtë kurrë së zhyturi botën në rrënim. Në këto kushte, krahas masave juridike dhe formave të tjera që do të përdoren për të luftuar terrorizmin, ekziston edhe nevoja për një fushatë të fuqishme arsimimi në të gjithë botën. Kjo fushatë do zbulojë fytyrën e vërtetë të darvinizmit dhe materializmit; ajo do u mësojë njerëzve, vlerat më të mira



që Zoti ka shpallur dhe që janë bazë për edukimin. Paqja dhe stabiliteti mund të arrihen vetëm duke jetuar në vlerat e fesë së vërtetë. Pa e tharë moçalin darvinist, nuk do të jetë e mundur që bota të shpëtojë nga fatkeqësitë.

Në rrjedhën e historisë, disa njerëz injorantë (si për shembull, kryqtarët) nuk kanë arritur ta kuptojnë këtë fakt dhe kanë shkaktuar konflikte ndërmjet dy feve. Për të parandaluar përsëritjen e këtij skenari, i cili propagandohet me moton si "përplasja e qytetërimeve" apo "Lufta e Shenjtë kundër Perëndimit", të krishterët dhe myslimanët e vërtetë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

Në të vërtetë, zhvillimet që pasuan ngjarjet e rënda të terrorit tregojnë se fara e këtij bashkëpunimi është mbjellë. Aktet e rënda të terrorizmit i sollën bashkësitë myslimane dhe të krishtera më afër njëri-tjetrit, nxitën



shumë të krishterë që të mësojnë më tepër për Fenë Islame dhe inkurajuan myslimanët të bëjnë përpjekje më të mëdha për të bërë të ditur moralin e vërtetë islam, të përshkruar në Kuran.

Të gjitha këto zhvillime janë lajme të mira që tregojnë se njerëzit do t'i kuptojnë më mirë vlerat islame dhe do të jenë të aftë, ta çlirojnë vetveten nga paragjykimet që mund të kenë pasur. Me vullnetin e Zotit, shekulli i 21-të do të jetë koha kur njerëzit do të kuptojnë se mbjellja e vlerave të Islamit është e vetmja mënyrë për të arritur paqen e shumëdëshiruar në botë.


**"Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi. Të tij janë emrat më të bukur. Atë e madhëron çfarë ka në qiej e në tokë dhe Ai është Ngadhënjyesi, i Urti!" (Kuran, 59:24)**







*Shtëjçë*

# MASHTRIMI I EVOLUCIONIT







Darvinizmi, apo me fjalë të tjera teoria e evolucionit, ka si qëllim të saj mohimin e faktit të krijimit, por në të vërtetë, ajo nuk është gjë tjetër veçse një teori e dështuar, joshkencore dhe e pakuptimtë. Kjo teori, e cila pretendon se jeta erdhi rastësisht nga materia pa jetë, është zhvleftësuar nga zbulimet shkencore që vërtetojnë rendin e mrekullueshëm si në univers, ashtu edhe në krijesat e gjalla; po ashtu janë zbuluar rreth 300 milion fosile që vërtetojnë se evolucionit nuk ka ndodhur asnjëherë. Në këtë mënyrë, shkenca konfirmon faktin se Zoti krijoi universin dhe gjithë krijesat e gjalla në të. Propaganda që mban gjallë sot teorinë e evolucionit, bazohet në shtrembërimin e fakteve shkencore, në keqinterpretimin e tyre, në gënjeshtër dhe falsitete të servirura si shkenore.

Por kjo propagandë nuk mund ta fshehtë të vërtetën. Teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës, dhe për këtë fakt, gjatë 20-30 viteve të fundit, është përfolur shumë në qarqet shkencore. Veçanërisht mbas viteve 1980 kërkimet nxorën në dritë se pretendimet e darvinizmit janë tërësisht të pabaza; kjo gjë u pohua prej mjaft shkencëtarëve. Sidomos në Shtetet e Bashkuara, shumë biologë, biokimistë dhe paleontologë, pohuan pavlefshmërinë e darvinizmit dhe vërtetuan se zanafilla e jetës është krijimi.

Ne kemi vëzhguar rrënimin e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mjaft aspekte shkencore, në disa prej punimeve tona dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë gjë. Ky subjekt është i një rëndësie të madhe, por edhe përfitimet janë po aq të mëdha.

### Dështimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë pagane që i ka fillimet nga grekët e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin XIX. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit *Origjina e Llojeve*. Në këtë libër Darvini doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjiysh i përbashkët dhe kanë ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor objektiv. Ashtu siç tregohet edhe në kapitullin me titull "Vështirësitë e Teorisë" në të njëjtin libër, teoria linte hapësira të mëdha përballë një sërë pyetjeve shumë të rëndësishme.



Darvini shpresonte që vështirësitë që i dilnin teorisë do të kapërceheshin me zhvillimin e shkencës dhe zbulimet e reja shkencore do ta forconin atë edhe më tepër, gjë të cilën e deklaronte shpesh në libër. Por shkenca përparonte plotësisht në kah të kundërt me shpresat e Darvinit dhe në vend që ajo t'i përkrahte hipotezat themelore të teorisë, i shtoi akoma dhe më tepër pikëpyetjet rreth kësaj teorie.

Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbliidhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk shpjegon kurrë se si ka filluar jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që provon se "mekanizmat e evolucionit", të propozuara nga kjo teori, kanë ndonjë forcë evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë të kundërtën e ideve të parashtruara nga teoria e evolucionit.

Le t'i shtjellojmë këto, në vija të përgjithshme:



## Pengesa e parë: Origjina e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në një tokë primitive afërsisht 3.8 miliardë vjet më parë si pasojë e një sërë rastësish. Pyetja që nuk mund ta shpjegojë teoria është se si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile? Por në fillim, duhet të ndalojmë në shkallën e parë të procesit të evolucionit: **Si u shfaq "qeliza e parë"?**

**Teoria e evolucionit, meqë e refuzon krijimin, supozon se qeliza e parë është shfaqur rastësisht në mënyrë aksidentale pa asnjë projektim apo planifikim.** D.m.th., sipas teorisë, lëndët inorganike duhen të kenë nxjerrë në dritë qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më themelore të biologjisë.


## "Jeta rrjedh nga jeta"

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur fare mbi origjinën e jetës, sepse koncepti primitiv në periudhën kur jetoi ai, supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë elementar. Sipas teorisë së "lindjes së rastësishme" që

besohej në mesjetë, lëndët inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi, se buburrecat formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një farë kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte një argument që

Lui  
Pastër





provonte se jeta rrjedh prej lëndëve inorganike. Por më vonë do të kuptohej se ato krimba mbi mishin nuk formoheshin aksidentalisht, por nga larvat që silleshin nga mizat.

Në periudhën që Darvini shkroi librin "Origjina e Specieve", besimi se bakteriet formoheshin nga lëndë inorganike shihej si një ide e pranuar gjerësisht në botën e shkencës. Por vetëm 5 vjet pas botimit të librit të Darvinit, biologu i shquar francez Lui Pastër e çrrënjosi plotësisht këtë besim, i cili përbënte bazat e evolucionit. Përfundimi i arritur pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata, ishte si më poshtë:

*"Pretendimet se lëndët inorganike mund të formojnë jetë u varrosën plotësisht në histori." (Sidney Fox, Klaus Dose, Molecular Evolution and The Origin of Life, New York: Marcel Dekker, 1977, p. 2)*


Mbrojtësit e teorisë së evolucionit, i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pastërit, mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi lindjen e rastësishme të jetës.

### Përpjekjet e dështuara të shekullit të 20-të

Evolucionisti i parë, i cili mori në dorë çështjen e origjinës së jetës në shekullin XX ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të formohej rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej të bënte këtë rrëfim:

*"Origjina e qelizës fatkeqësisht përbën pikën më të errët të gjithë teorisë së evolucionit." (Alexander I. Oparin, Origin of Life, (1936) New York, Dover Publications, 1953 (Reprint), p. 196)*

**Përpjekjet e Alexander Oparin, për të ofruar një shpjegim evolucionist për origjinën e jetës, përfunduan në një fiasco të madhe.**





**Siç pranohet edhe nga teoricienët më në zë të evolucionit, origjina e jetës është ende një mister i pazgjidhur për teorinë e evolucionit.**

e përdorur në eksperiment ishte shumë e ndryshme nga atmosfera e tokës. (*"New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", Bulletin of the American Meteorological Society, vol. 63, Nov 1982, pp. 1328-1330*)

Pas një periudhe të gjatë qetësie, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte aspak reale. (*Stanley Miller, Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules, 1986, p. 7*)

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit XX për të zgjidhur problemin e origjinës së jetës përfunduan pa sukses. Jeffrey Bada, gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips, San Diego, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën evolucioniste "Earth", këtë të vërtetë e pohon kështu:

*"Sot, duke lënë pas shekullin e 20-të, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në këtë shekull: Si filloi jeta në tokë?" (Jeffrey Bada, Earth, Feb 1998, p. 40)*

Evolucionistët që ndoqën rrugën e Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje mbi origjinën e jetës. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai i organizuar në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazet, që pretendoheshin se ekzistonin në atmosferën primitive dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, formoi disa molekula organike (aminoacide) që përdoren në ndërtimin e proteinave.

Ky eksperiment, i cili në ato vite paraqitej si një fazë e rëndësishme e evolucionit, pas disa vitesh u bë tërësisht i pavlefshëm, pasi u zbulua se "atmosfera"

## Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi origjinën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë, është ndërtimi jashtëzakonisht i ndërlikuar i gjallesave, të cilat më parë supozoheshin se zotëronin një ndërtim elementar. Qeliza është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. **Edhe nëse përdorim laboratorin më të përparuar të botës, duke grupuar përbërje kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përftojmë asnjë proteinë të vetme e jo më të pretendojmë për një qelizë.**

Kushtet që duhen të krijohen për shfaqjen e qelizës janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Sidoqoftë nuk është e nevojshme shpjegimi i situatës në detaje. Evolucionistët janë në një rrugë pa krye, sepse propabiliteti i krijimit rastësisht të një proteine, e cila është një prej pjesëve kryesore të qelizës, është matematikisht "0".

**Që të formohet një proteinë e vetme nevojiten proteina të tjera dhe kjo hedh poshtë mundësinë e formimit në mënyrë të rastësishme. Ky fakt është i mjaftueshëm për të bërë të pavlefshme pretendimet e evolucionistëve se qeliza u krijua rastësisht. Për ta përmbledhur:**

1. Proteina nuk mund të formohet pa enzima dhe enzimat janë të gjitha proteina.

2. Që një proteinë të formohet duhet të jenë prezente rreth 100 proteina. Pra nevojiten proteina që të ekzistojë një proteinë.

3. ADN-ja prodhon enzimat që formojnë proteinën. Proteina nuk mund të formohet pa ADN. ADN-ja duhet të jetë prezente që të formohen proteinat.

4. Të gjitha organelet në qeliza kanë detyra të rëndësishme në formimin e qelizës. Me fjalë të tjera, që proteinat të formojnë një qelizë të saktë dhe tërësisht funksionale, duhet që ato të jenë prezente bashkë me të gjitha organelet.



Një nga faktet që zhvleftëson teorinë e evolucionit është struktura tejet komplekse e jetës. Një shembull i kësaj është molekula e ADN-së e vendosur në bërthamën e qelizave të qenieve të gjalla. ADN-ja është një informacion kompleks i formuar prej bashkimit të katër molekulave në sekuenca të ndryshme. Ky informacion bazë përmban kodet dhe të gjitha tiparet fizike të një qenieje të gjallë. Sikur të shkruhej informacioni i ADN-së së njeriut, do të duhej një enciklopedi e përbërë nga 900 vëllime. Padyshim, një informacion i tillë i jashtëzakonshëm, hedh poshtë konceptin se jeta erdhi në ekzistencë rastësisht.

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do të hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN<sup>ja</sup> e njeriut, do të krijohej një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë e çuditshme: ADN-ja mund të kopjojë veten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Por formimi i këtyre enzimave bëhet i mundur vetëm falë informacionit të koduar në ADN. Meqë ata varen prej njëri-tjetrit, ata duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për të kopjuar informacionin. Kjo hedh poshtë pretendimin se jeta erdhi në ekzistencë rastësisht. Profesor Leslie Orgel, një evolucionist i shquar nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, rrëfen këtë fakt në një artikull të revistës *Scientific American* në Shtator të vitit 1994:



**Është tërësisht e pamundur që proteinat dhe nukleotidet, si dy përbërës me struktura komplekse, të jenë shfaqur rastësisht në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë.** Duket e pamundur të ekzistojë njëra pa tjetrën. Dhe kështu, në një shikim të parë, arrijmë në konkluzionin se jeta nuk mund të ketë lindur thjesht nga elementet kimike. (*Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth," Scientific American, vol. 271, October 1994, p. 7849.*)

Padyshim, nëse formimi i rastësishëm i jetës është i pamundur, atëherë do të na duhet të besojmë se jeta është e krijuar. Ky fakt zhvleftëson teorinë e evolucionit, e cila ka si qëllim kryesor mohimin e Krijimit.

### Mekanizmi imagjinar i evolucionit

Pengesa e dytë që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se "të dy mekanizmat e supozuar të evolucionit", nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në mekanizmin e "seleksionimit natyror". Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit "*Origjina e Specieve nëpërmjet seleksionimit natyror*".

Seleksionim natyror do të thotë përzgjedhje e natyrës. Ai mbështetet në logjikën se, të përfshirë në luftën për mbijetesë, në natyrë do të mbesin gjallë vetëm ato gjallesa që i përshtaten më mirë kushteve natyrore dhe fizike. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbesin gjallë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet vetëm nga individë të fortë dhe të shpejtë. Sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të ndërhyjë në evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë ato p.sh. në kuaj. Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj dhe në librin e tij *Origjina e Specieve* u detyrua të pohonte:

*Seleksionimi natyror është i pavlefshëm, nëse nuk shfaqen shanset e favorshme. (Charles Darwin, The Origin of Species by Means of Natural Selection, The Modern Library, New York, p. 127)*

### Ndikimi i Lamarkut

Si mund të formohen këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej duke u mbështetur te Lamarku. Sipas këtij biologu francez, i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcjellin brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, që kanë përjetuar gjatë jetës së tyre. Si përfundim i akumulimit të këtyre cilësive brez pas brezi, dalin në ekzistencë specie të reja. P.sh., sipas Lamarkut, gjirafat kanë evoluar nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta duke zgjatur qafën.

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm në librin e tij, ku pretendon se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit janë shndërruar në balena. (Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.)

Por me zbulimet e Mendelit dhe me zhvillimin e njohjes së ligjeve të



trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkencat e gjenetikës në shekullin XX, u shemb plotësisht legjenda e përcjelljes së karakteristikave, të fituara nga brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.


### Neo-darvinizmi dhe mutacionet

Në këtë gjendje, darvinistët, për të gjetur një zgjidhje, nxorën në dritë në fund të viteve 30' "Teorinë Sintetike Moderne", apo siç njihet ndryshe neo-darvinizmin, i cili i konsideroi mutacionet, krahas seleksionimit natyror, si "shkaqe të ndryshimeve të dobishme". Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është neo-darvinizmi.

Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u shfaqën si rezultat i mutacioneve, apo gabimeve gjenetike në organet e ndërlikuara të këtyre gjallesave si veshët, sytë, mushkëritë apo krahët. Por ekziston një fakt shkencor që e hedh poshtë teorinë: **Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, gjithmonë i dëmtojnë ato.**

Arsyeja është shumë e thjeshtë: ADN<sup>-ja</sup> zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar. Çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund të shkaktojë vetëm dëme. Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si më poshtë:

Së pari, mutacionet janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, mutacionet më të shumta janë të dëmshme, përderisa janë të pastrukturuara në ndryshimet gjenetike që pësojnë; çdo ndryshim rastësor që ndodh në një sistem kompleks do të jetë në dëm e jo në dobi të tij. Për shembull, **nëse një tërmet do të godiste një strukturë komplekse siç është një ndërtesë, kjo do të sillte deformim të strukturës së ndërtesës dhe në të shumtën e rasteve një dëmtim të saj.** (B.G. Ranganathan, *Origins?, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988.*)



Që nga fillimi i shekullit të 20-të, biologët evolucionistë kanë kërkuar shembuj të mutacioneve të dobishme, duke eksperimentuar te fluturat. Por këto përpjekje kanë rezultuar gjithmonë në krijesa të sëmura dhe të deformuara. Fotografia në të majtë tregon kokën e një mize frutash normale, kurse fotoja në të djathtë tregon këmbët në kokën e një mize frutash, që ndodhen aty për shkak të mutacionit.

Deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm. Dihet se mutacionet, të cilat teoria e evolucionit i paraqet si "mekanizma evoluese" janë raste gjenetike që i dëmtojnë dhe i lënë të gjymtuara gjallesat. (Ndikimi më i shpeshtë i mutacioneve te njerëzit janë kanceret.) Sigurisht që një mekanizëm shkatërrues nuk mund të ketë efekte evoluese, kështu që edhe seleksionimi natyror, ashtu siç pohon edhe Darvini, "s'mund të bëjë asgjë i vetëm". Ky realitet na bën të besojmë se **në natyrë nuk ekziston asnjë mekanizëm evolues**, ndaj dhe ai përfytyrim imagjinar që e quajnë evolucion, nuk është përjetuar në asnjë periudhë.

### Të dhënat fosile: asnjë gjurmë e formave kalimtare

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë, se skenari që pretendohet nga teoria evolucionit nuk është përjetuar kurrë. Sipas supozimit joshkencor të teorisë, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga njëra-tjetra. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, kthehej në një urë kalimi për formimin e një specijeje tjetër dhe në këtë mënyrë janë shfaqur të gjitha speciet e tjera. Me fjalë të tjera, ky transformim u krye gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Brenda këtij intervali të gjatë transformimi, duhet të jenë formuar



dhe të kenë jetuar miliarda "specie kalimtare". P.sh., në të kaluarën duhet të ketë ekzistuar një qenie gjysmë peshk - gjysmë zvarranik, apo gjysmë zog - gjysmë zvarranik. Meqë ajo ishte një periudhë transformimi, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë defektesh. Evolucionistët, këto qenie imagjinare, që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë "forma kalimtare".

**Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë larmia dhe numri i tyre do të ishte shumë herë më i madh se larmia dhe numri i specieve ekzistuese. Kështu që mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të haseshin në të dhënat fosile.** Darvini, në librin e tij, këtë fakt e shpjegon kështu:

*"Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre në të shkuarën mund të gjenden vetëm në mbetjet fosile."* (Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, p. 179)

Sidoqoftë, **Darvini ishte i vetëdijshëm se asnjë fosil i formave kalimtare nuk ishte gjetur ende.** Ai e shihte këtë si një vështirësi të madhe për teorinë e tij. Në një kapitull të librit të tij, i titulluar "Vështirësitë e Teorisë" ai shkroi:

...N.q.s. speciet kanë rrjedhur nga specie të tjera nëpërmjet një shkallëzimi gradual, **atëherë përse ne nuk gjejmë asgjëkundi forma kalimtare? Përse e gjithë natyra nuk është në konfuzion dhe ka specie, ashtu siç i shohim ne, të përcaktuara e të ndara mirë nga njëra-tjetra? ...Sipas kësaj teorie, forma të panumërta kalimtare duhet të kenë ekzistuar, atëherë përse nuk i gjejmë ato në koren e tokës? ...Përse ne sot nuk gjejmë varietete të ndërmjetme?** (Charles Darwin, *The Origin of Species*, pp. 172, 280)



**Kjo gjethe 50 milion vjeçare e fosiles së rrapit u zbulua në SHBA. Gjethet e rrapit kanë mbetur të pandryshuara për 50 milion vjet dhe kurrë nuk kanë evoluar.**



**Ky fosil krokodili nga periudha Kretak është 65 milion vjet i lashtë. Ky është identik me krokodilët që jetojnë sot.**

**Ky peshk fosil i zbuluar në Itali është 54 deri në 37 milionë vjet i lashtë.**



## Shpresat e venitura të Darvinit

Nga mesi i shekullit të 19-të e deri më sot, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive mbi fosilet, kurrë nuk janë gjendur forma kalimtare. Në kundërshtim me shpresat e evolucionistëve, të gjitha zbulimet që dolën në dritë nga gërmimet dhe kërkimet e ndryshme, tregojnë se gjallesat erdhën në këtë botë të përsosura dhe pa mangësira.

Paleontologu i njohur anglez Derek Ager, edhe pse ishte një evolucionist, u detyrua ta pohonte këtë realitet:

*"Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji për llogari të një tjetri."*

*(Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record," Proceedings of the British Geological Association, vol 87, 1976, p. 133.)*

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, **të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përkryer, pa forma të ndërmjetme mes tyre.** Kjo është pikërisht e kundërta e asaj që parashikoi Darvini. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar, sepse i vetmi shpjegim që një specie e gjallë shfaqet papritmas, e përkryer dhe pa paraardhës nga i cili mund të kishte evoluar, duhet të jetë **që speciet janë krijuar.** Kjo e vërtetë është pranuar nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

*"Krijimi dhe evolucioni janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose janë zhvilluar gradualisht. Në rast se janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.."* (Douglas J. Futuyuma, *Science on Trial, Pantheon Books, New York, 1983, p. 197*)

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në botë të formuara plotësisht e përsosmërisht. Me fjalë të tjera "**origjina e llojeve**", në kundërshtim me atë që mendonte Darvini, është krijimi dhe jo evolucioni.

### Përralla e evolucionit të njeriut

Çështja që trajtohet më shpesh, nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit, është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot, kanë rrjedhur nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Në këtë periudhë, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar "forma kalimtare" midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Në fakt, ka katër "kategori" bazë në gjithë këtë skenar imagjinar:

1. Australopitekët
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens


Evolucionistët i japin emrin "australopitek" (që do të thotë "majmuni i jugut"), të ashtuquajturit paraardhës të parë majmunor të njeriut. Këto qenie të gjalla nuk ishin në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lord Solly Zuckerman dhe profesorit Charles Oxnard, dy anatomistë me famë botërore nga Britania dhe SHBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një lloji majmuni të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore. (Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, 75-14; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389)

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor "homo" ose



"klasa njerëzore". Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë "homo" ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës dhe përpiluan një plan imagjinar evolucioni. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht nuk është provuar ndonjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme. Evolucionisti më i shquar i shekullit të 20-të thekson në librin e tij me titull *Një Argument i Gjatë* se "veçanërisht historia e origjinës së jetës së klasës Homo Sapiens është e vështirë për t'u besuar, madje për të nuk gjendet ndonjë argument bindës." (J. Rennie, "Darwin's Current Bulldog: Ernst Mayr", *Scientific American*, Dec 1992)

Kur përmendin zinxhirin **Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens**, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Zbulimet më të fundit të paleo-



antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në rajone të ndryshme të botës. (*Alan Walker, Science, vol 207, 1980, p. 1103; A. J. Kelso, Physical Anthropology, First Ed., New York: J. B. Lipincott Co., 1970, p. 221; M. D. Leakey, Olduvai Gorge, vol 3, Cambridge: Cambridge University Press, 1971, p. 272*)

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohët moderne. Neandertalët dhe Homo Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon. (*Time, Nov 1996*)

Kjo provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stephan Jay Gould, një prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrrokakun në të cilën gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Ç'mund t'i ndodhë shkallëzimit tonë, nëse bashkëkzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitek dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit në tokë. (*S. J. Gould, Natural History, vol 85, 1976, p. 30*)

Me pak fjalë, vizatimet e krijesave imagjinare "gjysmëmajmun-gjysmënjeri", që shfaqen në media apo në librat shkollorë dhe njëkohësisht, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë vetëm me metoda propagandistike, s'janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lord Solly Zuckerman, një nga shkencëtarët më të njohur e më të spikatur, e ka studiuar këtë çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se në të vërtetë nuk ekziston asnjë pemë familjare midis majmunit dhe njeriut.

Zuckerman gjithashtu ka bërë një "radhitje të shkencave". Ai ndërtoi një "spektër" të shkencave, duke i radhitur ato, sipas mendimit të tij, nga

ato më shkencoret tek ato më jo-shkencoret. Sipas këtij spektri, më shkencoret, duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, ishin fizika dhe kimia. Më pas vinin shkencat biologjike dhe pastaj ato sociale. Në fund fare, në pjesën e konsideruar si "më jo-shkencore", krahas koncepteve të "perceptimit jashtëshqisor" dhe "shqisës së gjashtë", vendosej dhe "evolucioni i njeriut". Zuckerman shpjegon arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim kuadrin e së vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës, të supozuara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtëshqisor apo **interpretimi i historisë së fosileve të njeriut. Për ndjekësit e këtyre ideve nuk ekziston asgjë e pamundur. Ata janë të gatshëm të besojnë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.** (*Solly Zuckerman, Beyond the Ivory Tower, p. 19*)

Siç shihet, evolucioni njerëzor nuk është gjë tjetër veç një përmbledhje e "disa interpretimeve të paragjykuara" të disa njerëzve që ndjekin verbërisht idetë e tyre.

### Formula darviniste

Përtej të gjitha informacioneve shkencore të cilat i kemi shqyrtuar deri tani, le të analizojmë me anë të një shembulli të thjeshtë, që mund të kuptohet madje edhe nga fëmijët, se në çfarë bestytinie besojnë evolucionistët.

Teoria e evolucionit pretendon se jeta erdhi në ekzistencë rastësisht. Sipas këtij pretendimi jo të logjikshëm, atomet e pandërgjegjshme u mbledhën dhe formuan qelizën dhe më pas formuan krijesa të tjera të gjalla dhe njeriun. Le të mendojmë rreth kësaj. Kur ne bashkojmë elementet bazë të jetës si karbonin, fosforin, nitrogenin dhe potasiumin, ne përftojme thjesht një përzierje kimike. Sado që ne të përpiqemi, kjo përzierje atomesh nuk do të prodhojë ndonjë qenie të gjallë. Nëse dëshironi, le të kryejmë

një "eksperiment" rreth kësaj dhe të ekzaminojmë se çfarë pretendojnë evolucionistët nga "**formula darviniste**".

Le të marrin materialistët elementët përbërëse të gjallesave si psh. fosforin, nitrogjenin, karbonin, oksigjenin, hekurin dhe magneziumin dhe le t'i vendosin ato në fuçi të mëdha. Për më tepër, le të shtojnë në këto fuçi, cilindro material që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojnë se është e nevojshme. Le të shtojnë në këtë përzierje, shumë aminoacide dhe shumë proteina (si njëra, si tjetra s'mund të formohen rastësisht) si të dëshirojnë ata. Le ta ekspozojnë këtë përzierje ndaj nxehtësisë dhe lagështisë sa të duan. Pastaj ta përziejnë me çfarëdo pajisje të zhvilluar teknologjikisht. Le të vënë shkencëtarët më eminentë përkrah këtyre fuçive dhe këta ekspertë të rrinë në pritje pranë këtyre fuçive për miliarda, dhe madje edhe për trilion vjet. Le të përdorin të gjitha llojet e kushteve që ata besojnë se janë të domosdoshme për formimin e një njeriu. **Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë ata, ata nuk mund të prodhojnë nga këto fuçi një njeri, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizave të tij në mikroskopin elektronik.** Ata nuk mund të prodhojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokallë, mollë, hurma, domate, pjepër, shalqinj, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, fazanë, ngjyrat e fluturave, apo miliona qenie të tjera të gjalla, të tilla si këto. Në të vërtetë, ata nuk mund të përftojnë madje asnjë qelizë të vetme prej tyre.

Shkurtimisht, **atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë asnjë qelizë.** Ata nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë në dy, pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikën mikroskopin elektronik dhe pastaj shqyrtuan strukturën e tyre qelizore me atë mikroskop. **Materia është një masë e pavetëdijshme, e pajetë dhe çdo gjë vjen në jetë me krijimin madhështor të Zotit.**





A mund të lind jeta, nëse përmbushen të gjitha kushtet e përcaktuara nga evolucionistët? Sigurisht që jo! Për të treguar pse jo, le të kryejmë eksperimentin në vijim: Vendosini të gjitha enzimat, hormonet dhe proteinat në një fuçi të tillë, si kjo në foton më lart, pra çdo gjë që konsiderohet nga

evolucionistët si thelbësore për të formuar jetën. Pastaj bashkujini të gjitha këto substanca, duke përdorur të gjitha teknikat e mundshme fizike dhe kimike. Por, pavarësisht asaj që ju do të bëni, pa marrë parasysh se sa kohë do të prisni, nga kjo fuçi nuk do të mund të krijohet ndonjë qelizë e gjallë.

Teoria e evolucionit, e cila pretendon të kundërtën, është një besim i rremë, tërësisht në kundërshtim me arsyen. Duke menduar edhe një herë për pretendimet e evolucionistëve, shembulli që sollëm më lart pasqyron më së miri realitetin.

### Teknologjia e syrit dhe e veshit

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?". Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet qendra e shikimit. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Duke u bazuar në këto njohuri, le të mendojmë pak:

**Truri është i izoluar tërësisht nga drita.** Kjo do të thotë që pjesa e brendshme e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësirë të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë me anë të kësaj errësire të plotë.

**Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa as teknologjia e shekullit të 20-të nuk ka arritur ta realizojë.** P.sh. shikoni librin që lexoni, pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani i televizorit më të zhvilluar i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimensional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër.

Për më tepër se 100 vjet, mijëra inxhinierë janë përpjekur të arrijnë këtë qartësi. Janë ndërtuar fabrika, janë bërë shumë kërkime, plane e

projekte, megjithatë, po të shikoni ekranin e televizorit dhe librin që mbani në duar, do të shihni se ka një ndryshim të madh në qartësi dhe mprehtësi. Për më tepër, ekрани i televizorit tregon një imazh dy-dimensional, ndërsa me anë të syrit, njeriu është në gjendje të shohë imazhe tre-dimensionale.

Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimensional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimensional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3D. Për më tepër, bëhet fjalë për një tre-dimensional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

N.q.s. një paisje që prodhon një imazh më primitiv se **syri nuk mund të jetë formuar rastësisht**, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht.

E njëjta gjë ndodh edhe me veshin. Veshi i jashtëm i kap tingujt dhe i drejton për nga veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. **truri është i izoluar nga tingujt**, ashtu si është izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më

të mprehtë perceptohen nga truri. **Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e luajtur nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz.** Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, shikojmë se një qetësi absolute mbizotëron atje.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruesit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfutur asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga

**Krahasuar me kamerat dhe pajisjet e regjistrimit, syri dhe veshi janë shumë më komplekse, shumë më cilësorë dhe kanë karakteristika shumë më superiore se këto produkte të teknologjisë së lartë.**





veshi. Sistemet HI-FI janë produktet e cilësisë më të lartë, që janë prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë muzikore. Edhe në këto paisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI, gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga **krijimi i njeriut.**

Nuk ekziston ndonjë aparaturë zëri apo figure, që mund të jetë aq e ndjeshme dhe e përkryer sa veshi dhe syri i njeriut. Sidoqoftë, përsa i përket shikimit dhe dëgjimit, tek këto shqisa fshihet një e vërtetë e madhe.

### Kush ia mundësoi trurit shikimin dhe dëgjimin?

Përse truri ynë sheh një bote tërheqëse, dëgjon simfoni, cicërimat e zogjve dhe percepton aromat e trëndafilave?

Impulset që vijnë prej syve, veshëve, dhe hundës udhëtojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në biologji, fiziologji, dhe në librat e biokimisë, ju mund të gjeni shumë detaje, se si formohen këto imazhe në tru. Megjithatë, ju mbase nuk jeni në dijeni për faktin më të rëndësishëm: Kush e bën të mundur që këto impulse nervore elektro-kimike të perceptohen si imazhe, tinguj, aroma dhe si ndijime shqisore në tru? **Ka një projektim inteligjent në tru që i mundëson atij perceptimin e gjithë këtyre ndijimeve pa pasur nevojë për sy, veshë, apo hundë.** Kujt i takon ky projektim? Sigurisht që nuk i takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që ndodhen në tru. Kjo është arsyeja pse darvinistët dhe materialistët, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund t'u përgjigjen këtyre pyetjeve.

**Ky projektim i vetëdijshëm është shpirti i krijuar prej Zotit,** i cili (shpirti) nuk ka nevojë për sy për të shikuar imazhet dhe as për veshë për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë as për trurin për të menduar.

Kushdo që e lexon këtë fakt të qartë duhet të meditojë rreth Zotit të Plotfuqishëm, t'i druhet Atij dhe të kërkojë strehim tek Ai, sepse Ai krijoi gjithësinë dhe Ai ka fuqi për gjithçka.

### Një besim materialist

Ajo që kemi studiuar deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës nuk pranohet nga shkenca. Mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë efekt evolutiv, ndërsa të dhënat fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Në këtë rast, teoria e evolucionit duhet të hidhet tej, sepse është një ide që bie në kundërshtim të hapur me shkencën.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të kësaj teorie si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë..?


Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shndërruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Liuontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është "së pari materialist, pastaj shkencëtar" me këto fjalë:

*Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim materialist për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materialiste, edhe nëse janë kundër*

**intuitës. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.** (Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World," *The New York Review of Books*, January 9, 1997, p. 28)

Këto fjalë janë deklaratë e qartë se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Ajo predikon se lënda pa jetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo pranon që miliona specie të gjalla, si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, apo qeniet njerëzore u shfaqën si pasojë e ndikimit të fenomeneve fizike (shiut dhe rrufeve) mbi lëndën në natyrë. Ky besim është në kundërshtim të plotë me mendjen dhe shkencën. Por darvinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim, me qëllim që "mos të lejojnë daljen në skenë të një Qenieje Hyjnore."



**Sinjalet që vijnë nga një objekt, perceptohen në tru duke u kthyer në sinjale elektrike. Kur themi ne shohim diçka, ne në të vërtetë jemi duke perceptuar sinjalet elektrike në trurin tonë. Truri është i izoluar nga drita. Pjesa e brendshme e trurit është e errët dhe drita nuk mund të hyjë në tru. Zona e njohur si korja e trurit është në errësi të plotë; drita nuk mund të arrijë atë. Por përsëri, nga kjo zonë e errët, ju arrini të shikoni një botë plot me ngjyra të shndritshme.**

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist, do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Krijuesi është Zoti, i cili krijoi të gjithë universin nga asgjëja, i cili e projektoi atë në mënyrën më të përkryer dhe i krijoi dhe i dha formë të gjitha gjallesave.

### **Teoria e evolucionit: magjia më e madhe e kësaj bote**

Kushdo që është i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, e cila të kujton bestytnitë e disa shoqërive pagane të prapambetura dhe jo të qytetëruara, është krejt absurd.

Siç u shpjegua më lart, ata që besojnë në teorinë e evolucionit, mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti; shkencëtarë të tillë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë të tillë si Humphrey Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçiano Pavaroti; po ashtu antilopat, frutat e limonit dhe karafilat. Por, meqë shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si "magjia më e madhe në histori." Asnjëherë më parë, asnjë besim apo ideologji tjetër nuk ka mundur t'i largojë njerëzit aq shumë nga arsyeja, sa të refuzojnë të mendojnë me mençuri dhe me logjikë; kjo teori ua ka fshehur të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e madhe dhe më e pabesueshme se adhurimi i totemit në disa vende Afrikane, se adhurimi i Diellit nga populli i Sebeit, se adhurimi i idhujve që kishin bërë me duart e tyre populli i profetit Ibrahim (paqja qoftë me të), ose se adhurimi i viçit të artë nga populli i profetit Musa (paqja qoftë me të).

Në fakt, Zoti e ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë ajete, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se



ata nuk do të mund të shohin të vërtetën. Disa nga këto ajete janë si më poshtë:

**E ata që mohuan, për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde, e ata kanë një dënim të madh. (Kuran, 2: 6-7)**

... Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët. (Kuran, 7: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e t'i shihnin fshehtësitë). Ata gjithsesi do të thonin: "Sytë na janë mjegulluar. Jo, ne jemi njerëz të magjepsur". (Kuran, 15: 14-15)



Ashtu siç duket e çuditshme dhe e pabesueshme besimi i paganëve, të cilët adhuronin krokodilët, po aq i pabesueshëm është edhe besimi i darvinistëve. Darvinistët besojnë se rastësia dhe atomet e pavetëdijshme, kanë fuqi krijuese dhe janë aq të përkushtuar ndaj këtij besimi, tamam sikur të ishte një fe.

Fjalët nuk mund ta shprehin habinë e madhe, se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet kaq të gjerë në skllavëri, duke i larguar njerëzit nga e vërteta për 150 vjet. Është e kuptueshme se do ketë njerëz që mund të besojnë në skenare dhe pohime të pabesueshme, plot marrëzi dhe palogjikshmëri. Megjithatë, "magjia" është i vetmi shpjegim i mundshëm për ata që besojnë se disa atome të pavetëdijshëm dhe të pajetë, papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi, që funksionon si një sistem i përsosur, i organizuar dhe i vetëdijshëm; një planet të quajtur Tokë, që funksionon në mënyrë të përkryer me të gjitha karakteristikat e tij të përshtatshme për jetën; dhe gjallesa me sisteme të panumërta, komplekse dhe të përkryera.

Në të vërtetë, në Kuran, Zoti rrëfen ngjarjen e Profetit Musa (paqja qoftë me të) dhe Faraonit, për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste, në të vërtetë kanë ndikim tek të tjerët me anë të magjisë. Kur i tregoi për fenë e vërtetë, Faraoni i kërkoi Profetit Musa (paqja qoftë me të) një takim me magjistarët e tij. Kur Profeti Musa (paqja qoftë me të) i takoi, ai u tha që të tregojnë aftësitë e tyre. Ajetet vijojnë:

**Ai (Musai) tha: "Hidhni ju"! E kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe. (Kuran, 7: 116)**

Siç e shohim, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtronin të gjithë, përveç Profetit Musa (paqja qoftë me të) dhe atyre që besuan në të. Megjithatë, mrekullia e tij e prishi magjinë, ose "gëlltiti atë që ata kishin trilluar", siç është shpallur në ajetin e mëposhtëm:

**E Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopin tënd!" E, ai (shkopi) filloi t'i gëlltisë të gjitha ato që i trilluan ata. Dhe, kështu, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që bënë ata. (Kuran, 7: 117-118)**

Siç mund të shohim, kur njerëzit e kuptuan se ajo ishte një magji e

hedhur mbi ta dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit e humbën gjithë kredibilitetin. Në ditët e sotme, ka të tillë që janë nën ndikimin e një magjie të ngjashme dhe besojnë në këto pretendime qesharake, të fshehura nën maskën e tyre shkencore dhe i kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato; ata duhet t'i braktisin besimet e tyre paragjyquese, sepse kur të shfaqet e vërteta e plotë dhe magjia të prishet, ata do të poshtërohen. Shkrimtari dhe filozofi britanik Malcolm Muggeridge, ishte një ateist që kishte mbrojtur evolucionin për gati gjashtëdhjetë vjet. Pasi e kuptoi të vërtetën, ai paraqiti rolin që do të ketë teoria e evolucionit në të ardhmen e afërt, me këto fjalë:

Unë jam i bindur se **teoria e evolucionit**, veçanërisht shkalla me të cilën zbatohet, **në të ardhmen do të jetë një prej gafave më të mëdha në librat e historisë**. Brezat e ardhshëm do të habiten që një hipotezë e tillë, kaq e paqartë dhe jozerioze, mund të pranohet me një mendjehetësi kaq të pabesueshme ashtu si sot. (*Malcolm Muggeridge, The End of Christendom, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43*)

E ardhmja nuk është larg; përkundrazi, njerëzit së shpejti do të shohin se "rastësia" nuk është hyjni dhe kur të shohin prapa do të kuptojnë se **teoria e evolucionit ishte mashtrimi dhe magjia më e madhe e kësaj bote**. Ajo magji tashmë ka filluar me shpejtësi të ngrihet prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë, po pyesin me habi, se si ndodhi që u marrosën prej saj.

*"Larg nga të metat je Ti, ne s'kemi  
dije tjetër veç asaj që na ke mësuar  
Ti. Me të vërtetë dija dhe mençuria  
Jote janë të përsosura."*

*(Kuran 2:32)*

## SHĒNİME

1. Prof. Thomas Arnold, *The Spread of Islam in the World, A History of Peaceful Preaching*, Goodword Books, 2001, pp. 79-80
2. <http://www.ibtimes.com/why-do-people-join-isis-psychology-terrorist-1680444>
3. Karen Armstrong, *Holy War*, MacMillan London Limited, 1988, p. 25
4. Tabari, *Ta'rih*, 1, 1850, cited in Majid Khadduri, *War and Peace in the Law of Islam*, Johns Hopkins Press, Baltimore, 1955, p. 102
5. Karen Armstrong, *Holy War*, MacMillan London Limited, 1988, p. 25
6. W.H.C. Frend, "Christianity in the Middle East: Survey Down to A.D. 1800", *Religion in the Middle East*, Ed. A.J. Arberry, I-II Cambridge, 1969, Volume I, p. 289
7. Prof. Thomas Arnold, *The Spread of Islam in the World, A History of Peaceful Preaching*, Goodword Books, 2001, p. 56
8. Prof. Thomas Arnold, *The Spread of Islam in the World, A History of Peaceful Preaching*, pp. 71-72
9. L. Browne, *The Prospects of Islam*, pp. 11-15
10. Prof. Thomas Arnold, *The Spread of Islam in the World, A History of Peaceful Preaching*, p. 96
11. Prof. Thomas Arnold, *The Spread of Islam in the World, A History of Peaceful Preaching*, pp. 88-89
12. André Miquel, *L'Islam et sa Civilisation* Librairie Vile - XXe siècle, Librairie Armand Colin, Paris 1968, p. 244
13. John L. Esposito, *The Islamic Threat: Myth or Reality*, Oxford University Press, New York, 1992, p. 39
14. *Gesta Francorum*, (The Deeds of the Franks and the Other Pilgrims to Jerusalem), trans. Rosalind Hill, (London, 1962,), p. 91
15. August C. Krey, *The First Crusade: The Accounts of Eye-Witnesses and Participants*, (Princeton & London: 1921,), p. 261
16. August C. Krey, *The First Crusade: The Accounts of Eye-Witnesses and Participants*, (Princeton & London: 1921,), p. 262
17. Alan Ereira, David Wallace, *Crusades: Terry Jones Tells the Dramatic Story of Battle for Holy Land*, BBC World Wide Ltd., 1995
18. The Alarm Newspaper Article, "Bakunin's Ground-Work for the Social Revolution," 1885 Dec. 26, p. 8
19. The Alarm Newspaper Article, "Bakunin's Ground-Work for the Social Revolution," 1885 Dec. 26, p. 2
20. Karen Armstrong, *Holy War*, 30-31
21. John L. Esposito, *Islam: The Straight Path*, p. 58
22. John L. Esposito, *Islam: The Straight Path*, p. 59
23. Karen Armstrong, *Holy War*, p. 185
24. Francis E. Peters, *Jerusalem: Holy City in the Eyes of Chroniclers, Visitors, Pilgrims, and Prophets from the Days of Abraham to the Beginnings of Modern Times*, Princeton, Princeton University Press, 1985, p. 363
25. Charles Darwin, *The Descent of Man*, 2nd edition, New York, A L. Burt Co., 1874, p. 178
26. Lalita Prasad Vidyarathi, *Racism, Science and Pseudo-Science*, Unesco, France, Vendôme, 1983. p. 54
27. Theodore D. Hall, "The Scientific Background of the Nazi "Race Purification" Program",
28. James Joll, *Europe Since 1870: An International History*, Penguin Books, Middlesex, 1990, p. 164
29. M.F. Ashley-Montagu, *Man in Process*, New York: World. Pub. Co. 1961, pp. 76, 77 cited in Bolton Davidheiser, W E Lammers (ed) *Scientific Studies in Special Creationism*, 1971, pp. 338-339
30. L.H. Gann, "Adolf Hitler, The Complete Totalitarian", *The Intercollegiate Review*, Fall 1985, p. 24; cited in Henry M. Morris, *The Long war Against God*, Baker Book House, 1989, p. 78
31. J. Tenenbaum., *Race and Reich*, Twayne Pub., New York, p. 211, 1956; cited by Jerry Bergman, "Darwinism and the Nazi Race Holocaust", <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
32. Peter Chrisp, *The Rise of Fascism*, Witness History Series, p. 6
33. Hickman, R., *Biocreation*, Science Press, Worthington, OH, pp. 51-52, 1983; Jerry Bergman, "Darwinism and the Nazi Race Holocaust", *Creation Ex Nihilo Technical Journal* 13 (2): 101-111, 1999
34. Robert M. Young, *Darwinian Evolution and Human History*, *Historical Studies on Science and Belief*, 1980
35. Alan Woods and Ted Grant, *Reason in Revolt: Marxism and Modern Science*, London: 1993
36. K. Mehnert, *Kampf um Mao's Erbe*, Deutsche Verlags-Anstalt, 1977
37. Karl Marx, *Das Capital*, Vol. I, 1955, p. 603
38. Vladimir Ilich Lenin, *Collected Works*, 4th English Edition, Progress Publishers, Moscow, 1965, Volume 11, p. 216
39. L. Poliakov, *Le Mythe Aryen*, Editions Complexe, Calmann-Lévy, Bruxelles, 1987, p. 343
40. Robert Clark, *Darwin: Before and After*, Grand Rapids International Press, Grand Rapids, MI, 1958., s., pp. 115-116; cited by Jerry Bergman, "Darwinism and the Nazi Race Holocaust", <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>